



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Korçë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË KORÇË

Tiranë, 2024

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	24
II. HYRJE.....	28
1. Objekti i Auditimit.....	29
2. Qëllimi i auditimit.....	29
3. Identifikimi i çështjes.....	29
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	29
5. Përgjegjësitë e audituesve	29
6. Kriteret e vlerësimit	30
7. Standardet e auditimit	32
8. Metodat e auditimit	32
9. Dokumentimi i auditimit.....	33
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	35
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Korçë	35
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	36
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	36
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	40
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	58
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	83
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	199
2.6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	211
2.7. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	214
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	223
A. MASA ORGANIZATIVE.....	223
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	238
C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.....	239
D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)	244
E. MASA DISIPLINORE	248
V. ANEKSET	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi të ardhurat	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Pasqyrat Financiare.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi prokurimet publike.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi lejet e ndërtimit	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së FI ncave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Korçë:

Korça kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me Bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Korçës.

Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron prej 75.994 banorësh, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 129.065 vetë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 805.99 km².

Bashkia Korçë përbëhet nga qyteti i Korçës dhe shtatë Njësi Administrative, të cilat përfshijnë 62 fshatra.

Kryetar i BASHKISË KORÇË është z. S.F. dhe Këshilli Bashkiak i Korçës përbëhet nga 41 anëtarë, të cilët janë zgjedhur në vitin 2019.

Për vitin 2022, planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime ka qenë 1,889,325 mijë lekë, planifikimi përfundimtar ka qenë 2,138,790 mijë lekë, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka qenë 1,607,320 mijë lekë me një diferencë 282,005 mijë lekë nga plani fillestar ose 531,470 mijë lekë nga plani përfundimtar, në masën 85% nga plani fillestar dhe 75% nga plani përfundimtar. Planifikimi i të ardhurave ka qenë 1,062,056 mijë lekë, ndërsa realizimi ka qenë 751,455 mijë lekë ose në masën 71%.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Bashkia e Korçës është njësi vendore e pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish Bashkia Korçë dhe shtatë ish komunitat në afërsitë të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe janë: NjA Korçë (qyteti), NjA Qëndër Bulgarec, NjA Voskop, NjA Voskopojë, NjA Lekas, NjA Vithkuq, NjA Mollaj dhe NjA Drenovë.

Bashkia Korçë ka në administrim Aparatin e Bashkisë dhe 5 njësi të tjera shpenzuese, të cilat janë: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike; Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes; Qendra e Arsimit dhe Kulturës; Klubi Shumësportësh dhe Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të auditimeve për muajin janar 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87 prot., datë 16.01.2024.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Referuar nivelit të materialitetit, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 21 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Korçë dhe njësitë e saj shpenzuese për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, me fond limit 629,482,501 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 507,674,978 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të M dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 48 gjetje dhe ka dhënë 55 rekomandime, nga ku masa organizative 30 gjetje me 33 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 4 gjetje me 4 rekomandime, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike 6 gjetje me 7 rekomandime dhe masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) 8 gjetje me 11 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik rezultoi se:

- Menaxhimi i lartë i Bashkisë Korçë, nuk ka ngritur dhe nuk ka siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Punonjësit e BASHKISË KORÇË nuk janë trajnuar mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Bashkia Korçë nuk ka hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut duke identifikuar dhe evidentuar sektorët me risk të lartë.
- Bashkia Korçë nuk ka hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Korçë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime ka qenë 1,889,325 mijë lekë, planifikimi përfundimtar ka qenë 2,138,790 mijë lekë, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka qenë 1,607,320 mijë lekë me një diferencë 282,005 mijë lekë nga plani fillestar ose 531,470 mijë lekë nga plani përfundimtar, në masën 85% nga plani fillestar dhe 75% nga plani përfundimtar. Planifikimi i të ardhurave ka qenë 1,062,056 mijë lekë, ndërsa realizimi ka qenë 751,455 mijë lekë ose në masën 71%. Bashkia Korçë në riplanifikimin e shpenzimeve duke parë realizimin e ulët të të ardhurave, në vend që të bënte ulje në planin e shpenzimeve, ka bërë rritje, duke e thelluar hendekun e mosrealizimit nga 85% në 75% të totalit.

Stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2022 ka qenë 95,967 mijë lekë ose në masën 4.5% e totalit të shpenzimeve të planifikuara, të cilat duke pasur parasysh kohën e krijimit të tyre duhet të ishin likuiduar.

- Nga auditimi rezultoi se në zonën Pyjore e Kullosore, aset i Bashkisë Korçë, sipas lejeve aktive të marra nga regjistri i AKBN-së ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi për gurore 7 subjekte, nga të cilët 5 subjekte janë brenda fondit pyjor/kullosor. Nga ana e BASHKISË KORÇË nuk rezulton që për subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet tregtar për shfrytëzim mineralesh, të jetë lidhur kontratë qeraje për përdorimin e tokës e cila është aset i Bashkisë Korçë. Nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Korçë), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

- Nga auditimi i hapësirave publike (tavoli t) sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2022 rezulton se për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavoli jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, për muajt maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tarifa është 19 lekë/m² në ditë, për muajt mars, prill, tetor, nëntor tarifa është 10 lekë/m² në ditë. Nga auditimi rezultoi se llogaritja nga ana e BASHKISË KORÇË nuk është kryer sipas ditëve por është përlllogaritur për çdo muaj me 30 ditë, në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 137 datë 25.11.2021 pika 7/5, faqe 24, për hapësirën publike e cila e përcakton qartë se tarifa është 10/19 lekë/ditë për m², duke sjellë të ardhura të munguara në shumën **226,963 lekë** në buxhetin e Bashkisë Korçë.

- Bashkia Korçë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur **125 kontrata/marrëveshje** për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qera pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **11 subjekte** debitore në vlerën **57,917,505** lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

- Vlera totale e detyrimit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Korçë paraqitet:

Vlera e detyrimeve tatimore të paarkëtuara nga debitorët e krijuar gjatë vitit 2022, është **110,094 mijë lekë**. Kjo vlerë është e kontabilizuar dhe përbëhet nga:

Detyrime nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, në vlerën totale 40,715 mijë lekë;

Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 69,379 mijë lekë.

Për vitin 2022 gjendja progresive e debitorëve në Bashkinë Korçë është:

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, në vlerën 203,003 mijë lekë;

Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 234,521 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresivë për bizneset dhe familjarët është **437,524 mijë lekë, vlerë kjo që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.**

- Nga auditimi, u konstatua se për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet, është i paqartë planifikimi i të ardhurave të kësaj takse nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, duke mos u bazuar në parashikime realiste të të ardhurave faktike të viteve të mëparshme. Vlera e planifikuar (prej 60,425,066 lekë) nuk është e mbështetur në asnjë fakt, për më tepër, në vitin 2021 kjo taksë është planifikuar 36,873,515 lekë dhe janë arkëtuar 5,125,663 lekë, ndërkohë që në vitin 2022, kjo taksë është planifikuar në vlerën 60,425,066 lekë dhe realizimi është 16,782,885 lekë, pavarësisht se borxhi progresiv nga viti 2018 deri në dhjetor të vitit 2021 ka qenë në vlerën 19,925,978 lekë.

Gjithashtu lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë u konstatua se, nga legalizimet e bëra ndër vite, deri në 31.12.2022, 381 qytetarë në vlerën 19,925,978 lekë nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë. Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 337 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 13,692,213 lekë. Nga auditimi rezultoi se, kanë paguar detyrimet 195 qytetarë/individë me vlerë 8,268,310 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 142 qytetarë me vlerë totale 5,423,903 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Për vitin 2022, nuk e kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë ndaj BASHKISË KORÇË 142 qytetarë/individë që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara qytetarë, për vlerën totale 5,423,903 lekë dhe 381 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2022, me vlerë totale të detyrimeve 19,925,978 lekë. Në total, vlera e detyrimeve nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi 25,349,881 lekë për 523 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

- Nga auditimi rezultoi se 25 subjekte janë pajisur me leje ndërtimi edhe pse kanë qenë debitorë ndaj BASHKISË KORÇË në vlerën 2,127,093 lekë.

- Nga auditimi janë konstatuar diferenca në përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 6 objektet të pajisura me leje ndërtimi me sipërfaqe >250 m², në shumën totale prej **13,847,443 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

- Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË u konstatua se, për vitin 2022 në total janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale në vlerën 15,936,605 lekë. Kjo vlerë nuk është e kontabilizuar saktë, për arsye se në pasqyrat financiare të Qendrës së Artit dhe Kulturës është kryer pakësim në vlerën 4,000,000 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare të konsoliduara është kontabilizuar si nxjerrje jashtë përdorimit. Gjithashtu në regjistrin e aktiveve të Aparatit të BASHKISË KORÇË është kryer nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën 3,270,276 lekë ndërkohë që në bilancin e konsoliduar është kontabilizuar si pakësim.

- Për vitin 2022, Kryetari i BASHKISË KORÇË për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Aparatit të Bashkisë dhe Njësive Administrative ka nxjerrë Urdhrin nr. 1157, datë 01.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit, Referuar raportit mbi përfundimin e procesit të inventarit, komisioni i inventarizimit ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit

aktive që i përkasin inventarit ekonomik në vlerën 3,270,275 lekë dhe inventar i imët në vlerën 330,004 lekë, ku totali shkon në vlerën 3,600,280 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procesin e asgjësimit të aktiveve, u konstatua se, në listë e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cila konsiderohen të dëmshme (pajisje elektrike dhe elektronike), për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga z. S.F , Kryetar i Bashkisë dhe z. K.K , Nënkyetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi inventarizimin e aktiveve të institucionit të bashkisë dhe njësisive në varësi, rezultoi se:

a. Klubi Shumësportësh Skënderbeu, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 1, datë 29.12.2022. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit, nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara, ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit duhet t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

b. Qendra Ditore e Zhvillimit, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 92, datë 31.12.2021. Komisioni i vlerësimit është i njëjtë me komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

c. Drejtori i Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 78/1, datë 27.10.2022. Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 25.11.2022, komisioni i inventarizimit ka hartuar raportin për inventarin fizik, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive që i përkasin llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 46,714 lekë. Me Urdhrin nr. 79/2, datë 28.10.2022, të znj. D.L , Drejtor i QRZH, është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit është i përbërë nga tre anëtarë dhe jo nga pesë anëtarë.

- Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*” dhe pasqyrës nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, pjesë e pasqyrave financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes, u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 11,899,991 lekë që i përkasin llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, në vlerën 2,098,296 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, në vlerën 9,791,595 lekë për të cilat nuk është kryer procedurë asgjësimi, për më tepër nga NSHMAÇ nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre. Duke u bazuar në dokumentacionin mbi realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të NSHMAÇ, nga znj. J.T me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës është mbajtur relacioni mbi vlerësimin për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra sipas inventarit fizik të vitit 2022, sipas shkresës nr. 366 prot., datë 14.11.2022, miratuar nga z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ. Me shkresën nr. 366 prot., datë 14.11.2022, NSHMAÇ ka informuar Këshillin Bashkiak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit. Vetëm dy shkresat e sipërpërmendura janë i vetmi dokumentacion i cili disponon NSHMAÇ në lidhje me procesin

e asgjësimit.

Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” pjesë e pasqyrave financiare të Qendrës Rezidenciale e Zhvillimit u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 46,714 lekë, e cila i përket llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”. Kjo situatë nuk pasqyrohet në procesin e inventarizimit të aktiveve të institucionit apo të jetë pjesë e informacionit të dërguar pranë Këshillit Bashkiak pas përfundimit të procesit të inventarizimit, por thjesht ka mbetur në fazën e ngritjes së komisionit të asgjësimit sipas Urdhrit nr. 79/2, datë 28.10.2022, të titullarit të institucionit. Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se, nga QRZH për vlerën 46,714 lekë të nxjerrë jashtë përdorimit, nuk është kryer një procedurë vlerësimi dhe asgjësimi pra nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre.

- Llogaria 520 “*Disponibilitet në thesar*” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 243,257,382 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” në vlerën 165,855,343 lekë dhe llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” në vlerën 42,398,117 lekë. Llogaria 520 “*Disponibilitet në thesar*” është mbivlerësuar në vlerën 79,782,715 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë (400,000 lekë NjA Drenovë + 529,300 lekë NjA Mollaj + 100,000 lekë NjA Bulgarec + 137,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë (59,289,103 lekë NjA Drenovë + 111,081,721 lekë NjA Mollaj + 24,298,721 lekë NjA Vithkuq + 12,667,671 lekë NjA Lekas + 30,703,530 lekë NjA Voskopojë + 75,177,420 lekë NjA Voskop + 101,161,565 lekë NjA Bulgarec), e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë (128,064,232 lekë NjA Drenovë + 172,096,034 lekë NjA Mollaj + 97,316,422 lekë NjA Vithkuq + 6,235,020 lekë NjA Lekas + 70,267,947 lekë NjA Voskopojë + 83,147,853 lekë NjA Voskop + 210,558,456 lekë NjA Bulgarec) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Në gjendjen e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë (2,988,000 lekë NjA Drenovë + 2,565,400 lekë NjA Mollaj + 480,000 lekë NjA Voskopojë + 2,800,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Këto vlera të pa analizuar, të trashëguara nga bilanci i ish-komunave të mësipërme, ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Nga auditimi mbi administrimin e pronave të BASHKISË KORÇË për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve i janë transferuar kësaj njësie vendore gjithsej **1742 prona**, nga të cilat 1549 prona në pronësi dhe 193 prona në përdorim. Nga pronat në pronësi, nga Bashkia Korçë janë pajisur me certifikatë pronësie gjithsej 246 prona dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie 1158 prona. Ndërsa nga **193 pronat** në përdorim, janë pajisur me certifikatë pronësie 7 prona dhe nuk janë pajisur me certifikatë 186 prona.

Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të BASHKISË KORÇË dhe Njësive Administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Voskop, Voskopojë dhe Lekas, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit

hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37.

Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, Bashkia Korçë nga 451 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 181 prej tyre posedojnë titull pronësie.

Nga Bashkia Korçë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” (nuk disponohet asnjë çertifikatë pronësie), llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “*Për aktive afatgjata materiale*” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 56,040,598 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” e cila paraqitet në vlerën 14,319,706 lekë dhe llogarinë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*” në vlerën 72,152,293 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë, 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në vlerën 2,350,476 lekë, 435 “*Sigurime shoqërore*” në vlerën 13,991,302 lekë, 436 “*Sigurime shëndetësore*” në vlerën 1,926,994 lekë dhe 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në vlerën 9,813,633 lekë ku totali shkon në vlerën 50,421,514 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, në vlerën 66,171,637 lekë.

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 4,770,920 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 22,339,109 lekë dhe pakësime në vlerën 4,770,920 lekë, ndërsa më datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë e cila i përket faturave të pa likuiduara nga Bashkia Korçë. Kjo vlerë kryesisht përbëhet nga shpenzime për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., si rezultat i angazhimeve të marra mbi bazën e burimit të fl ncimit nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat deri më datën 01.01.2022, janë në vlerën 33,876,466 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,554,125 lekë dhe pakësim në vlerën 33,616,958 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 9,813,633 lekë.

- Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 9,813,633 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për objektet e përfunduara dhe të marra në dorrëzim nga Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes janë ngurtësuar fonde në vlerën totale 2,039,521 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 2,039,521 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

- Çelja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 7,653,040,409 lekë. Llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i*

akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 1,881,147,211 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 36,718,839 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 1,540,850,382 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 505,191,521 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 7,524,864,556 lekë.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, u konstatua se, nga totali i përgjithshëm vetëm 39 mjete janë të pajisura me certifikatë të kontrollit teknik. Referuar këtij dokumentacioni janë konstatuar parregullsi në evidentimin e kilometrave të përshkuara nga këto mjete ndër vite si më poshtë:

Në 11 raste, nuk evidentohen kilometrat e përshkuara nga mjeti, konkretisht: për 8 mjete të NSHP, për 2 mjete të NSHMAÇ dhe për 1 mjet të MZSH-së;

Në 7 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara nga mjeti në vitet e mëparshme, por vetëm në vitin e fundit që është kryer kontrolli teknik, konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 3 mjete të NSHP dhe për 2 mjete të MZSH-së;

Në 14 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara nga mjeti në mënyrë të rregullt sipas viteve, por pjesërisht, konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 11 mjete të NSHP dhe për 1 mjet të MZSH-së;

Në 10 raste evidentohet ulja e kilometrave të përshkuara nga mjeti në certifikatën e kontrollit teknik nga viti në vit, konkretisht: për 1 mjet të Bashkisë Korçë, për 6 mjete të NSHP dhe për 3 mjete të MZSH-së.

Mosevidentimi në mënyrë të saktë dhe kronologjike të përvitshme apo ulja e kilometrave nga viti në vit, referuar certifikatave të kontrollit teknik, bën të paverifikueshëm/pamonitorueshëm procesin e përcaktimit të normativave apo rakordimin e karburantit të konsumuar dhe të dhënave të pasqyruara në fletët e udhëtimit për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin.

- Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë u konstatua se, pjesë e zërave të projekteve artistike është edhe zëri honorare të cilat **nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit** (nuk janë prokuruar së bashku me zërat e tjerë të projekteve artistike), parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën””, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 6, datë 27.01.2022, të Këshillit Bashkiak “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2022, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë””. Nga Bashkia Korçë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total për Qendrën e Kulturës “Vangjush Mio”, Teatrin “Andon Zako Çajupi” dhe Bibliotekën “Thimi Mitko” pjesë të Qendrës së Artit dhe Kulturës është likuiduar shuma **19,150,000 lekë**, e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik, duke i përjashtuar këto procedura.

- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme të Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

- Në Bashkinë Korçë, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjithsej 53 procedura prokurimi me vlerë të madhe (Bashkia Korçë: 8 procedura “e hapur”, 21 “e hapur e thjeshtuar”; (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike: 5 procedura “e hapur”, 8 “e hapur e thjeshtuar” dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes: 3 procedura “e hapur”, 8 “e hapur e thjeshtuar”), nga të cilat pas analizës së riskut dhe duke filluar nga vlera më e madhe e prokuruar u audituan gjithsej 21 procedura, me fond limit 629,482,501 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 507,674,978 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje.

- Në 20 procedura nga 21 të audituara, sipas pasqyrës së mëposhtme, me vlerë totale të fondit limit prej 578,382,286 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 473,293,971 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit, mungesa e personelit të kualifikuar/specialistë të fushës apo caktimi i vetëm një personi për hartimin e fondit limit. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

- Në 18 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 570,065,841 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 452,213,618 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifitime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës, për vlerën totale të kontraktuar 452,213,618 lekë pa TVSh;

- Në 11 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 445,020,075 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 340,885,638 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Korçë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Në objektin “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 41,257,208.8 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifitimeve teknike dhe detajit të projektit, për 3 (tre) zëra punimesh në shumën **383,349 lekë pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

- Në objektin “Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Korçë”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “XH ” me nr. 8405/2 prot. datë 13.10.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 75,565,671 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre ndryshuar me Amendim Kontrate datë 17.03.2023, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË

KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 3 (tre) zëra punimesh në shumën **327,384 lekë pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

- Në objektin “*Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efikasitetit të energjisë)*”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “I ” ShPK & “E ” ShPK & “I ” ShPK, me nr. 1797/2 prot., datë 27.03.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 63,428,254.2 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me Amendim Kontrate datë 18.09.2023, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 4 (katër) zëra punimesh në shumën **566,377 lekë** pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

- Në objektin “*Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)*”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “A ” ShPK, me nr. 2520/3 prot. datë 05.04.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 46,629,580.66 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 4 (katër) zëra punimesh në shumën **249,807 lekë** pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

- Nga auditimi i procedurës me blerje të vogël, me objekt “*Blerje prozhektor dhe neone për palestrat e shkollave*” rezultoi se:

Procedura e prokurimit është prokuruar nga AK Bashkia Korçë për llogari të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, ku kjo e fundit ka planifikuar dhe realizuar prokurimin me objekt “*Blerje materiale elektrike*”, ku përfshiheshin edhe mallrat objekt prokurimi të tenderuar nga Bashkia Korçë. Sa më sipër, janë realizuar dy procedura prokurimi me objekt të njëjtë, me fond limit total në shumën 1,386,000 lekë pa TVSh, duke e copëzuar në dy procedura prokurimi me blerje të vogël respektivisht në vlerën 586,000 lekë dhe 800,000 lekë pa TVSh, veprim në kundërshtim me VKM-në 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 56, pika 2 dhe 11.

Kërkesa për këto mallra nuk ka ardhur nga AK përfitues, por është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore jashtë objektit të veprimtarisë së saj.

Specifikimet teknike nuk janë hartuar nga një komision ku në përbërje të kishte specialist të fushës.

Përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë mbi bazën e ofertave të pretenduara nga komisioni i blerjeve të vogla, pasi ato nuk janë pjesë e dosjes, gjithashtu njëri prej OE është me statusin i pezulluar në periudhën kur pretendohet se janë marrë ofertat.

U konstatuan diferenca të mëdha të çmimeve për artikujt e njëjtë të tenderuar nga AK Bashkia Korçë dhe AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve.

Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë identifikuar mallrat e dorëzuara nga kontraktuesi sipas karakteristikave dhe numrit serial (E), gjë e cila nuk vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK, duke vepruar në mospërputhje me rekomandimin e APP nr. 2106 prot. datë 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkojë nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo procesverbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël “*Kompjuter, printer, fotokopje*” rezultoi se:

Modeli i kompjuterit dhe monitorit të dorëzuar nga kontraktuesi janë prodhime të vitit 2015. Monitori Samsung model S22E450BW është 22 inch dhe jo 23 inch siç parashikohet në ftesën e AK.

Kompjuteri Fujitsu “Esprimo P910 E85+” është i gjeneratës së 3-të dhe jo të 4-të, siç kërkohet nga AK në ftesën për ofertë.

Kompjuteri, monitori, tastiera dhe mouse nuk janë i të njëjtit brand.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar pajisjet me numrat serialë, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre pajisjeve.

Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë identifikuar mallrat e dorëzuara nga kontraktuesi sipas karakteristikave dhe numrit serial (E), gjë e cila nuk vërtetohet përmes specifikimeve teknike të kërkuara nga AK,

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël “*Bojëra printimi fotokopje*” rezultoi se:

Kontraktuesi i ka dorëzuar me 4 ditë vonesë mallrat, sipas afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, duke përfshirë dhe afatin e ankimimit.

Nga verifikimi në faqen e internetit <https://aqscert.org/>, rezultoi se OE “B ” nuk është i pajisur me certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO/IEC 27001:2013.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar mallrat me numrat *part number*, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre mallrave. Për sa më lart, vlera e kontratës prej **771,228 lekë** me TVSh, do të konsiderohet shpenzim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet për buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, Bashkia Korçë.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Investime në infrastrukturën rrugore*”, rezultoi se OE “K ”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë, duke i shkaktuar BASHKISË KORÇË përdorim të fondeve pa Efikasitet, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **4,824,193 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji”*”, rezultoi se OE “N ”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë, duke i shkaktuar BASHKISË KORÇË përdorim të fondeve pa Efikasitet, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **2,063,302 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi miratimin e lejeve të ndërtimit nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Korçë, rezultoi se:

Në 4 procedura, nuk janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit, hapësirat e gjelbërta dhe hapësirat e parkimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, për objektet:

1. “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: Lagjja 18, rruga “Dhora Leka”, Korçë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

3. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

4. “*Banesë 3 kate + Podrum*”, miratuar me vendimin nr. 7246/22, datë 05.10.2022, me

zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën: Lagjja 1, Rruga e Bilbilave, Korçë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 20, “Plani i Përgjithshëm Vendor”, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, nenet 54 dhe 56.

Në 3 procedura, nuk janë paraqitur në mënyrën e saktë planvendosjet, nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve, si edhe distancat nga trupi i rrugës, për objektet:

1. “Banesë kolektive (8 kate + podrum)”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjja 18, Rruga “Dhura Leka”, Korçë;

2. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë;

3. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

Sa më sipër, është në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 34, pika 2; pika 3; pika 7 dhe neni 36, pika 3/a; Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, neni 58, pika 14.

Në 1 (një) procedurë, leja e zhvillimit për objektin “Voskopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.” ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë, është miratuar pa miratuar më përpara planin dhe kondicionet urbane mbi të cilën do të zhvillohet njësia strukturore përkatëse dhe pa pasur të ngarkuar në sistemin e-leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi.

- Nga verifikimi i realizimit të aktmarrëveshjeve ndërmjet subjektit zhvillues dhe bashkisë përpara miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, u konstatuan problematika në **5 procedura**, si më poshtë vijon:

Në 2 procedura të lejeve të ndërtimit të miratuar, në aktmarrëveshjen e realizuar ndërmjet subjektit dhe bashkisë, nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për objektet:

1. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

2. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

Në 1 procedurë të lejes së ndërtimit të miratuar, nuk është realizuar aktmarrëveshja ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe subjektit zhvillues, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, për objektin:

1. “Banesë kolektive (8 kate + podrum)”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjja 18, rruga “Dhura Leka”, Korçë.

Në 2 procedura të certifikatave të përdorimit të miratuara, nuk është realizuar kalimi i sipërfaqes ndërtimore në favor të bashkisë, por është akumuluar në formë “borxhi” për një afat 5 vjeçar, pas miratimit të certifikatave të përdorimit, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi, për objektet:

1. “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

- Nga auditimi i certifikatave të përdorimit, u konstatuan **2 procedura**, në të cilat nuk është paraqitur në sistemin e-Leje dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit, për objektet:

1. “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë;

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

- Nga auditimi i procedurave për miratimin e “Certifikatave të përdorimit”, u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, **nuk përputhet me zbatimin në terren të objektit**.

- Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan **2 procedura** në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur në përputhje me PPV-në dhe legjislacionin në fuqi. Nga verifikimi i sipërfaqeve të projektit të ndërtimit dhe mënyrës së përlllogaritjes së taksës, duke marrë për bazë çmimin e shitjes për metër katror dhe me koeficientët përkatës sipas ambienteve (hapësirë parkimi, hapësirë shërbimi ose hapësirë banimi), rezultuan diferenca për objektet: 1. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L” ShPK, në adresën rruga Rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë, me një diferencë në vlerën 141,980 lekë; 2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L” ShPK, në adresën rruga Rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë, me një diferencë në vlerën 137,949 lekë; 3. “*Voskopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.”ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë, ku zhvillohen objekte të cilët mund të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në lejen e ndërtimit nga “*Objekte për qëllim turizmi*” në “*Objekte për qëllim banimi*”. Nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, duhet të përlllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës në vlerën 1,525,253 lekë.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

- Nga auditimi, u konstatua se gjatë vitit 2022, IMT ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 4 vende vakante. Bashkia Korçë është një bashki me shtrirje të gjerë territoriale, e cila përmbledh edhe 7 njësi administrative, çka do të thotë që 2 inspektorë janë të pamjaftueshëm për të mbuluar një territor me përmasa të tilla, duke rrezikuar në parandalimin e ndërtimeve të paligjshme.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT, rezultojë se nuk janë arkëtuar disa gjopa të mbajtura për kundërvajtjet e konstatuara për “dënim me gjobë” në vlerën totale prej **135,000 lekë** për shtetasit: G.J.S , F.I dhe L.F , veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, Kreu V, neni 31, pika 5.

- Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 3845/20, datë 28.07.2020 nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5, 6) - 8 kate me bodrum*”, me zhvillues shoqërinë L. ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr. 5526/22 datë 13.07.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren dhe nga verifikimi i fotove ajrore, u konstatuan ndryshime, pasi daljet konsol nuk janë realizuar sipas projektit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit të miratuar, por janë realizuar me një tjetër konfigurim, duke ndryshuar njollën e objektit.
- Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 8058, datë 08.11.2019, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë “B. ” ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr. 1236/22, datë 16.03.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi është shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin e fundit, duke ndryshuar edhe konfigurimin e fasadës.
- Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 1372, datë 01.04.2022, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Kompleks turistik Divizioni, me godI 3 katëshe + 1 kat nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë L dhe O.L , në adresën: Lagjia nr. 3, Rruga “Çlirimi i Korçës”, Korçë, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi objektet në lartësinë e 3 kateve të ndërtimit mbi tokë dhe një kat nën tokë, janë realizuar në 4 kate mbi tokë, duke tejkaluar lartësinë dhe numrin e kateve të lejuar në zonë.
- Nga verifikimi i zbatimit në terren të ndërtimeve të kundërligjshme, u konstatua se në fshatin Dishnicë, Korçë, është ndërtuar strukturë kolonash dhe trarësh beton arme, mbi katin e dytë të një objekti ekzistues. Për këtë shkelje është mbajtur procesverbali nr. 25, datë 13.10.2022 për konstatimin e kundërvajtjes dhe vendimi për prishje nr. 7, datë 16.10.2022, i cili nuk është ekzekutuar.

Të ndryshme të dala gjatë auditimit

- Në gjendjen e inventarit të Bashkisë Korçë, në të cilën përfshihet edhe Sektori i MZSH-së dhe Njësive Shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes, ndodhen në total 84 mjete/makineri dhe pajisje në gjendje pune të llojit: autoveturë, furgon, kamion, fadromë, eskavator, traktor, prerëse asfalti, vinç, fryrëse gjethesh, makinë vijëzimi, borëpastruese, skrep, bobcat, autoskallë, zjarrfikëse, rul, betoniere, kaldajë, motokorrëse, motosekë, gjenerator, motor pompe etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit.

Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit, si dhe shpenzimet që do të kryhen për to. Gjithashtu, duhet të jetë i evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim dhe fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

Gjithashtu, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, u konstatua se, 3 mjete nuk janë të pajisur me çertifikatë pronësie, 13 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik dhe 12 mjete nuk janë të pajisura me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi përcaktimin e normativave për konsumin e karburantit, u konstatua se:

a. Nga Bashkia Korçë për mjetet në përdorim nuk disponohet urdhër për ngritjen e grupit të punës mbi përcaktimin e normativave me qëllim kryerjen e një analize mbi caktimin e normativave të konsumit të karburantit për secilin mjet të institucionit, mbi bazën e testimeve duke u mbajtur procesverbalet përkatëse.

b. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për mjetet në përdorim të cilat kanë njësi matëse kilometrazhin, nuk janë evidentuar kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit përgjatë procesit të testimit, me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

c. Nga NSHMAÇ për mjetet në përdorim nuk janë kryer testime në rrugë urbane dhe nacionale apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit), në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km), me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

- Nga auditimi i shpenzimeve të konsumit të karburantit, u konstatua se Bashkia Korçë, përfaqësuar nga z. S.F. , Kryetar i Bashkisë, ka nënshkruar pesë kontrata hua-përdorimi me personat fizikë për vitin 2022. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nga Bashkia Korçë nuk dokumentohet në mënyrë shkresore apo elektronike nëpërmjet emaileve, komunikimi ndërmjet palëve për vendosjen e automjeteve në dispozicion të bashkisë, përpara fazës së nënshkrimit të kontratave të hua-përdorimit. Gjithashtu nuk ka një vendimarrje nga Këshilli Bashkiak për marrjen e këtyre mjeteve me kontratë-huapërdorimi.

Në total, për vitin 2022 kanë qenë aktive pesë kontrata hua-përdorimi, për të cilat automjetet janë përdorur nga Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop dhe Vithkuq. Sasia e karburantit e tërhequr sipas kontratave të hua-përdorimit të sipërpërmendura, i përket administratorëve të NjA, konkretisht: z. M.M (NjA Drenovë), 1,100 litra naftë, në vlerën 247,256 lekë, z. L.SH (NjA Mollaj), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. K.Z (NjA Voskopojë), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. E.D (NjA Voskop), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë dhe z. I.P (NjA Vithkuq), 1,320 litra naftë, në vlerën 295,872 lekë.

Si dokumentacion justifikues, nga administratorët e NjA të cilët kanë përfituar karburant, paraqiten fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit, por nuk ka një kërkesë, program pune për lëvizjen e tyre drejt fshatrave apo qytetit të Korçës. Theksojmë që punonjësit të cilët kanë tërhequr këtë sasi karburanti, ushtrojnë funksionin e administratorëve të NjA dhe detyra funksionale e këtyre punonjësve është në zyrë dhe jo në terren.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

- Menaxhimi i lartë i Bashkisë Korçë, të marrë masat për të ngritur dhe siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin:

- Duke trajnuar punonjësit e BASHKISË KORÇË mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Duke hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut, në përputhje me kërkesat e MFK, duke angazhuar strukturat përgjegjëse në identifikimin e risqeve dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë.

- Duke hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

- Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e FI ncës, Buxhetit dhe Menaxhimit financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit

dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

Të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura sipas faturave të palikuiduara për blerje mallra dhe shërbime, gjendje në fund të vitit 2022.

- Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Korçë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), sipas regjistrit të AKBN, të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjor, t'i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjnë kërkesën për zbritje nga fondi pyjor, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të kryejë faturimet sipas ditëve të muajve, referuar tarifave të përcaktuara në paketën fiskale, si dhe të kërkojë në rrugë administrative vlerën e pataksuar prej **226,963 lekë**.

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për:

- Ndjekjen e të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **57,917,505 lekë** nga 11 qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.

- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Korçë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **110,094 mijë lekë**, sipas përcaktimeve ligjore.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Korçë, të marrë masa për:

- Planifikimin e të ardhurave bazuar në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme sipas legjislacionit në fuqi.

- Të bashkëpunojë me DTTV Bashkia Korçë për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **523 debitorë në vlerën 25,349,881 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

- Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të miratojnë lejet e ndërtimit pasi të sigurohen që subjektet i kanë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura në Bashkinë Korçë, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **2,127,093 lekë ndaj 25 subjekteve** të pajisur me leje ndërtimi, sipas Aneksit A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe specialistin e buxhetit Bashkia Korçë të marrin masa që të arkëtojnë diferencat e shkaktuara nga përlllogaritjet e gabuara për taksën e ndikimit në infrastrukturë për **6 leje ndërtimi në shumën 13,847,443 lekë**, përkatësisht si më poshtë:

- **vlera 11,914,178 lekë** me pronar dhe zhvillues **L.L. dhe O.L** për **5** leje ndërtimi.

- **vlera 1,933,265 lekë** me zhvillues dhe pronar trualli **BASHKISË KORÇË** .

Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

- Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të

marrë masa për sistemimin e saktë të vlerave të kontabilizuara nga pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2022 të Aparatit të BASHKISË KORÇË dhe Qendrës së Artit dhe Kulturës në pasqyrat financiare të konsoliduara, në lidhje me klasifikimin e gabuar të aktiveve afatgjata materiale nga pakësim në nxjerrje jashtë përdorimit dhe e kundërta.

- Bashkia Korçë të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

- Klubit Shumësportësh Skënderbeu, Qendrës Ditore të Zhvillimit dhe Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit në çdo rast të kryerjes së inventarizimit të aktiveve, duhet të mbahet në konsideratë:

- Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, të paraqitet para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

- Ngritja e komisioneve të vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

- Nga Kryetari i Bashkisë Korçë, të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale 11,946,705 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes dhe Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë të gjitha masat për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të kaluara me VKM në ASHK Dega Korçë.

- Drejtoria e FI ncës, Bashkia Korçë, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha asetëve të llogarive 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjisllacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

- Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Investime në proces*” me kundërparti llogaritë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*”, 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “*Fondi Bazë*”.

- Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Kryetari i BASHKISË KORÇË dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 9,813,633 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit

Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

- Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave për cilat u ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit për mungesë dokumentacioni ligjorë, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik. Për garancitë e të cilat janë brenda afatit ligjorë, në momentin e përfundimit të afatit t'i kërkohet subjekteve zbatuese paraqitja e dokumentacionit ligjorë dhe pas verifikimit të punimeve të behet likuidimi i garancive.

- Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*”, me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, Sektorit të MZSH-së, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë fushe, për verifikimin faktik të kilometrave të përshkruara nga mjetet, duke rakorduar me DSHPTRR Korçë.

- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

- Nga organet drejtuese të Bashkisë Korçë, Sektori i MZSH-së, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes të analizohet vlera **20,751,016 lekë**, e cila ka të bëjë me mosevidentimin e të gjithë procesit mbi konsumin e karburantit, duke hartuar rregulla, në të cilët të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit të shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet dhe pajisjet e institucionit, si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

- Autoritetit Kontraktor të marrë masat që:

Në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me licencat përkatëse, duke përdorur eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike.

Në procedurat e prokurimit publik, të vendosen kritere në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të mirëargumentuara, në përputhje me procedurën e parashikuar, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së ofertuesve dhe konkurrencën e lirë.

- Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa, për arkëtimin e shumës **383,349 lekë** pa TVSh, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga **BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK**, sipas kontratës së lidhur me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 për realizimin e punimeve civile.

- Drejtorinë e Përgjithshme e FI ncës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për arkëtimin e shumës **327,384 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE “**XH ” ShPK**, sipas kontratës së lidhur

me nr. 8405/2 prot. datë 13.10.2022 për realizimin e punimeve civile.

- Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për arkëtimin e shumës **566,377 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e pakryera nuk kryhen, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE **“I ” ShPK & “E ” ShPK & “I ” ShPK** sipas kontratës së lidhur me nr.1797/2 Prot. datë 27.03.2023 për realizimin e punimeve civile.

- Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për arkëtimin e shumës **249,807 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e pakryera nuk realizohen, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE **“A ” ShPK**, sipas kontratës së lidhur me nr. 2520/3 prot., datë 05.04.2023 për realizimin e punimeve civile.

- Kryetari i BASHKISË KORÇË të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e komisioneve të marrjes në dorëzim dhe të blerjeve të vogla, si dhe të hartuesve të kërkesës për këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën të prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të BASHKISË KORÇË në shumën **616,800 lekë** dhe mos përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

- Kyetari i BASHKISË KORÇË të analizojë këto procedura dhe të marrë masa për titullarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, i cili në cilësinë e titullarit të AK dhe në cilësinë e miratuesit të këtyre procedurave, ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve në shumën **771,228 lekë**.

- Titullari i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, të kërkojë nga OE Andis K , zëvendësimin e monitorëve të dorëzuar me monitorë LCD 23 inch, të të njëjtës markë me atë të njësisë së kompjuterëve, pasi është kusht që kompjuterat (pc+monitor) të jenë brand, në rast të kundërt vlera e monitorëve të dorëzuar nga kontraktuesi dhe të marrë në dorëzim nga AK, do të konsiderohet dëm ekonomik në ngarkim të titullarit të institucionit dhe anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

- Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i BASHKISË KORÇË ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese, sipas rastit), të analizojë arsyet e skualifikimit/kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e këtyre praktikave të parregullta, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet urbane, që përfshijnë intensitetin e ndërtimit, koeficientin i shfrytëzimit të territorit, lartësinë e ndërtimit, sipërfaqen e gjelbërimit dhe numrin e parkimeve, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 114, datë 30.09.2021, sipas pikës 7 dhe të realizohet kalimi pa shpërblim i të paktën 3% të sipërfaqes funksionale për strehimin social, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Gjithashtu në aktmarrëveshjet që janë lidhur ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, të përcaktohen të dhëna të sakta e specifike në lidhje

me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

- Nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Korçë, të bëhet kontabilizimi dhe të merren të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **141,980 lekë** për objektin “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*” nga shoqëria zhvilluese “L ” ShPK dhe vlerës **137,949 lekë** për objektin “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*” nga shoqëria zhvilluese “L ” ShPK, të cilat përbëjnë të ardhura të mungura ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

- Nga Bashkia Korçë të merren masa për të monitoruar destinacionin e përdorimit të objektit “*Voskopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.” ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë dhe, nëse ndryshon destl cioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, të përlllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës për vlerën **1,525,253 lekë**.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

- Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për plotësimin e vendeve vakante të IMTV me inspektorë në plotësim të kriterëve të duhura për çdo pozicion pune.

- Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Korçë, të marrë masa ligjore dhe administrative për të arkëtuar gjobat me vlerë **35,000 lekë** për shtetasin G.J.S , **50,000 lekë** për shtetasin F.I dhe **50,000 lekë** për shtetasen L.F , të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.

- Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Korçë, të marrë masa për të realizuar kontrollin e objekteve të cilat janë me leje ndërtimi, nëse e zbatojnë me përpikmëri projektin e ndërtimit të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë.

- Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Korçë, të marrë masa për të ekzekutuar vendimet e prishjes të marra prej tyre sipas afateve ligjore.

Të ndryshme të dala gjatë auditimit

- Sektori i MZSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, të marrë masa për:

- Hartimin e kartelave përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve.

- Pajisjen me certifikatë pronësie, certifikatë të kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për mjetet të cilat nuk i disponojnë këto dokumente, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

- Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, në të ardhmen të merren masa

që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

- Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në rastet e mungesës së mjeteve për kryerjen e shërbimeve të ndryshme të Bashkisë Korçë, të parashikojë fonde dhe të miratojë në Këshillin Bashkiak marrjen me qira të mjeteve të domosdoshme sipas drejtorive, me argumentet e duhura dhe të eliminojë marrjen e mjeteve me qira nga punonjësit e bashkisë të cilët kanë në përdorim mjete, për të eliminuar përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efincencë (3-E), të fondeve për sasinë e karburantit të konsumuar në vlerën **1,282,808 lekë**.

1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i Modifikuar (Kualifikuar) me rezervë mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Korçë, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të parashkruara në paragrafin “*Baza për opinionin*”, pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Korçë më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*”, si dhe ISSAI 30 “*Kodi Etik*” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “*Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të modifikuar me rezervë për auditimin e zhvilluar, duke konkluduar se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

Në gjykimin profesional të audituesit, krahas riskut cilësor, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 30,587,000 lekë për shpenzimet dhe 32,146,000 lekë për të ardhurat, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 243,257,382 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 165,855,343 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 42,398,117 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 79,782,715 lekë.

- Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera 1,166,300 lekë kosto historike, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” 414,379,276 lekë kosto historike, në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është përfshirë vlera 767,685,964 lekë kosto historike dhe në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera 8,833,400 lekë kosto historike, të paanalizuara si në kontabilitet ashtu dhe në gjendjen fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Drenovë, Mollaj, Voskopojë dhe Voskop, e paanalizuar dhe ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Në total, në pronësi të BASHKISË KORÇË janë 1,549 pasuri të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura nga të cilat vetëm për 246 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie.

- Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Korçë nga 451 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 181 prej tyre posedon titull pronësie.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” në vlerën 56,040,598 lekë, ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve”, e cila paraqitet në vlerën 14,319,706 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 72,152,293 lekë.

- Në mbyllje të bilancit, më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë, përmbledhësja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 2,350,476 lekë, përmbledhësja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 13,991,302 lekë, përmbledhësja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,926,994 lekë dhe përmbledhësja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 9,813,633 lekë, ku totali shkon në vlerën 50,421,514 lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në vlerën 66,171,637 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”, më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 7,653,040,409 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, në vlerën 1,881,147,211 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 36,718,839 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 1,540,850,382 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 505,191,521 lekë, sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël, llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”, është nënvlerësuar në vlerën 7,524,864,556 lekë.

- Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes janë nxjerrë aktive jashtë përdorimit në vlerën 11,899,991 lekë për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre.

II. Opinion i Kundërt mbi përputhshmërinë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Korçë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Korçë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Korçë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “*Baza për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kundërt për përputhshmërinë.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

➤ Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Korçë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime ka qenë 1,889,325 mijë lekë, planifikimi përfundimtar ka qenë 2,138,790 mijë lekë, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka qenë 1,607,320 mijë lekë me një diferencë 282,005 mijë lekë nga plani fillestar ose 531,470 mijë lekë nga plani përfundimtar, në masën 85% nga plani fillestar dhe 75% nga plani përfundimtar. Planifikimi i të ardhurave ka qenë 1,062,056 mijë lekë, ndërsa realizimi ka qenë 751,455 mijë lekë ose në masën 71%. Bashkia Korçë në riplanifikimin e shpenzimeve duke parë realizimin e ulët të të ardhurave, në vend që të bënte ulje në planin e shpenzimeve, ka bërë rritje, duke e thelluar hendekun e mosrealizimit nga 85% në 75% të totalit.

➤ Nga auditimi i administrimit të asetëve në pronësi apo në përdorim, u konstatua se janë gjithsej 11 subjekte debitore në vlerën 57,917,505 lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

➤ Vlera totale e detyrimeve tatimore të paarkëtuara nga debitorët në Bashkinë Korçë, në mënyrë progresive është 110,094 mijë lekë dhe përbëhet nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 40,715 mijë lekë;

- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 69,379 mijë lekë.

Për vitin 2022 gjendja progresive e debitorëve në Bashkinë Korçë është:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën 203,003 mijë lekë;

- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 234,521 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është 437,524 mijë lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

➤ Në Bashkinë Korçë, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjithsej 53 procedura prokurimi me vlerë të madhe (Bashkia Korçë: 8 procedura “*e hapur*”, 21 “*e hapur e thjeshtuar*”; (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike: 5 procedura “*e hapur*”, 8 “*e hapur e thjeshtuar*” dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes: 3 procedura “*e hapur*”, 8 “*e hapur e thjeshtuar*”), nga të cilat pas analizës së riskut dhe duke filluar nga vlera më e madhe e prokuruar u audituan gjithsej 21 procedura, me fond limit 629,482,501 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 507,674,978 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje;

- Në 20 procedura nga 21 të audituara, sipas pasqyrës së mëposhtme, me vlerë totale të fondit limit prej 578,382,286 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 473,293,971 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me liçencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit, mungesa e personelit të kualifikuar/specialistë të fushës apo caktimi i vetëm një personi për hartimin e fondit limit. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël;

- Në 18 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 570,065,841 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 452,213,618 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës, për vlerën totale të kontraktuar 452,213,618 lekë pa TVSh;

- Në 11 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 445,020,075 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 340,885,638 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Korçë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Në 4 procedura për zbatimin e kontratave të investimeve, u konstatua vlera 1,416,997 lekë pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik, si pasojë e mangësive të ndryshme gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit.

- Në 2 procedura prokurimi, u konstatua kualifikim i padrejtë i OE, me pasojë përdorim të fondeve pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën 6,887,495 lekë pa TVSh.

➤ Nga auditimi i dokumentacionit mbi miratimin e lejeve të ndërtimit nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Korçë, rezultoi se:

- Në 4 procedura, nuk janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor;

- Në 3 procedura, nuk janë paraqitur në mënyrën e saktë planvendosjet, nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve, si edhe distancat nga trupi i rrugës;

- Në 1 (një) procedurë, leja e zhvillimit është miratuar pa miratuar më përpara planin dhe kondicionet urbane mbi të cilën do të zhvillohet njësia strukturore përkatëse dhe pa pasur të ngarkuar në sistemin e-leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm;

- Nga verifikimi i realizimit të aktmarrëveshjeve ndërmjet subjektit zhvillues dhe bashkisë përpara miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për sigurimin e kalimit pa shpërbllim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, u konstatuan problematika në 5 procedura;

- Nga auditimi i certifikatave të përdorimit, u konstatuan 2 procedura, në të cilat nuk është paraqitur në sistemin e-Leje dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit.

- Nga auditimi i procedurave për miratimin e “Certifikatave të përdorimit”, u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar për 1 objekt, nuk përputhet me zbatimin në terren të objektit.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMTV, rezultojë se nuk janë arkëtuar

disa gjoha të mbajtura për kundërvajtjet e konstatuara për “dënim me gjobë” në vlerën totale prej 135,000 lekë.

- Nga auditimi rezultoi se 25 subjekte janë pajisur me leje ndërtimi edhe pse kanë qenë debitorë ndaj BASHKISË KORÇË në vlerën 2,127,093 lekë.

- Nga auditimi janë konstatuar diferenca në përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 6 objektet të pajisura me leje ndërtimi me sipërfaqe >250 m², në shumën totale prej 13,847,443 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Korçë:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së FI ncape dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 862/1, datë 10.10.2023 “Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Korçë”, i ndryshuar me shkresat nr. 862/2 prot., datë 21.11.2023 dhe 862/3 prot., datë 14.12.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Korçë”, nga data 13.10.2023 deri në datën 22.12.2023, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P , Përgjegjës Grupi;
2. M.H ;
3. T.A ;
4. A.L ;
5. O.F ;

6. E.Rr ;
7. S.H , anëtarë.

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Korçë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. S.F , në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. V.Z , Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Korçë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse “Për buxhetin vjetor” dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
 - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
 - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
 - VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”;
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
 - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
 - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
 - Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
 - Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
 - Udhëzimin plotësues të Ministrisë FI ncave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,
 - Udhëzimin e Ministrisë FI ncave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,
 - Udhëzimi plotësues i Ministrisë FI ncave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
 - Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë FI ncave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të

Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe të njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit FI ncave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- **Intervista**

- **Raporte dhe Informacione**

- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar,

u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Korçë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Korça kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me Bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Korçës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron prej 75.994 banorësh, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 129.065 vetë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 805.99 km².

Të dhëna të tjera: Bashkisë së Korçës iu bashkëngjiten disa zona rurale të cilat merren me bujqësi dhe blegtori, por edhe disa prej fshatrave turistike më të spikatur. Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta, por rritja



e numrit të popullsisë si pasojë e zhvendosjes së banorëve nga zonat rurale ka sjellë edhe rritje të numrit të personave të papunë duke ngritur domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve për punësim dhe kualifikimin e këtyre personave për profile të ndryshme.

Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët kanë vetë-siguruar mënyrën e organizimit të ambienteve dhe kuzhinës por edhe aktiviteteve dimërore si një atraksion për turistët. Zonat më të thella si Lekasi dhe Vithkuqi për shkak të klimës së ashpër dhe izolimit të përvitshëm në dimër kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë çka ka minimizuar edhe shërbimet për pjesën e mbetur të banorëve duke nisur nga arsimit, mjekësia, infrastruktura, transporti, etj.

Ndër projektet më të rëndësishme në qytetin e Korçës është ai i Pazarit të Korçës, investimi kolosal i të cilit ka në fokus rikthimin e një elementi autentik kulturor, ruajtjen e origjilitetit të pazarit shekullor të Korçës dhe kthimin e tij në një destinacion turistik. Projektet për rimodelimin e Parkut të qytetit, sheshit para teatrit dhe rrugës Gjon Buzuku janë 3 projekte të tjera të rëndësishme për qytetin.²

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative për vitin 2022 është miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë, me nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”, i ndryshuar. Struktura aktuale është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Institucioni	Numri faktik	Numri i planifikuar
Bashkia Korçë	252	364
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	385	450
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	381	397
Qendra e Arsimit dhe Kulturës	46	51
Klubi Shumësportësh	14	14
Lulet e Vogla	3	7

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësitë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Korçë	Qyteti Korçë
Qëndër Bulgarec	Fshatrat: Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht
Voskop	Fshatrat: Voskop, Dërsnik, Polenë, Vinçan, Goskovë lart, Goskovë poshtë, Damjanec
Voskopojë	Fshatrat: Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonmadh, Lavdar

² Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-korce/>

Lekas	Fshatrat: Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë
Vithkuq	Fshatrat: Vithkuq, Leshnje, Gjanç, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë
Mollaj	Fshatrat: Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë
Drenovë	Fshatrat: Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë

Kuadri ligjor:

Bashkia Korçë e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për secilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe seksionin “Kriteret e vlerësimit” më sipër.

Kryetar i BASHKISË KORÇË është z. S.F dhe Këshilli Bashkiak i Korçës përbëhet nga 41 anëtarë, të cilët janë zgjedhur në vitin 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Për vlerësimin, nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaria dhe kontrolli, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, të kenë mundësuar shërbimeve publike efektive dhe eficiente, për të adresuar drejt risqet pontenciale, për të dhënë garanci të mjaftueshme në realizimin e objektivave të vendosura nga Bashkia Korçë, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive efektive, eficiente dhe me ekonomikitet, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e brendshme, gjenerimit të informacioneve operative dhe financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit dhe të aktiveve nga grupi i auditimit të KLSH, u administrua dokumentacioni si më poshtë, vijon:

- Deklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Njësisë Bashkia Korçë për vitin 2022.

- Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik viti 2022.

- Raporti i performancës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022 i realizuar me asistencën e Projektit “Bashki të forta” një projekt i Agjencisë Zvicerane për zhvillimin dhe Bashkëpunim (SDC).

- Raporti Vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Korçë për periudhën 01.0.1-31.12, 2022.

- Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale nr.8632 Prot. datë 27.11.2018 të Bashkisë Korçë.

- Rregullore nr. 142 datë 01.03.2021 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë”, i ndryshuar me Urdhërin nr. 142/0 datë 11.07.2022.

- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak.

- Raportet e auditimit të brendshëm për periudhën objekt auditimi, etj.

Për vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Korçë, dhe implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura mbi bazën dokumentacionit të sipërpërmendur, për 5 komponentet e mëposhtëm rezultoi se:

- Mjedisi i kontrollit:

Mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën.

Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte:

a. Strukturat formale dhe b. Aspektet e sjelljes individuale.

➤ Menaxhimi i Riskut:

Aktivitetet e kontrollit përqendrohen jo vetëm në çështjet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, por edhe në çështje që lidhen me dhënien e sigurisë, se objektivat e vendosura do të arrihen.

➤ Aktivitetet e Kontrollit:

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve.

➤ Informimi dhe komunikimi:

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

➤ Monitorimi:

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme, se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Situata: Mjedisi i kontrollit: Në lidhje me angazhimin për demonstrimin e integritetit dhe vlerave etike, Bashkia Korçë nuk ka të miratuar Kod Etik, rregullat e etikës janë të përcaktuara në rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë, të miratuar me vendimin nr. 142 datë 01.03.2021, neni 39-40.

- Për periudhën objekt auditimi, nga strukturat përgjegjëse nuk janë planifikuar programe trajnimi me punonjësit në lidhje me integritetin dhe sjelljen etike që duhet të kenë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrës.

- Komunikimi i punonjësve të BASHKISË KORÇË në lidhje njohjen me aktet ligjore apo njoftime të ndryshme të punës së përditshme, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nuk bëhet me adresë e-mail-i zyrtar. Komunikimi brenda dhe jashtë institucionit, në Bashkinë Korçë bëhet nëpërmjet adresave elektronike personale dhe jo zyrtare.

- Referuar Rregullores së Brendshme të Bashkisë Korçë, u konstatua se nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të saj.

- Rregullorja për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së ndërmarrjes së shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdheve (pa nr. e VKB të vitit 2013) i referohet Ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i cili është një ligj i shfuqizuar

- Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Korçë, për periudhën objekt auditimi nuk ka kryer mision auditimi pranë shoqërive aksionare apo ndërmarrjeve në varësi të saj, duke mos gjeneruar raporte dhe rekomandime në lidhje me funksionimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm të këtyre njësive.

- Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Korçë, nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për disa pozicione të strukturës aktuale të miratuar.

- Nga evidenca dokumentare e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, rezulton se punonjësit e BASHKISË KORÇË nuk janë trajnuar mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Menaxhimi i Riskut: Bashkia Korçë nuk ka hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut, në përputhje me kërkesat e MFK-së, gjithashtu strukturat përgjegjëse të BASHKISË

KORÇË nuk janë angazhuar në identifikimin e risqeve dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë.

Aktivitetet e Kontrollit: Për periudhën objekt auditimi janë tejkualuar afatet e pagesës, përtej afatit 30 ditor për 63 fatura tatimore, duke vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 5 “Llogaritja e kamatëvonesës”. - Bashkia Korçë nuk ka hartuar rregullore mbi sigurinë e të dhënave në sistemet IT.

Informimi dhe komunikimi: Bashkia Korçë nuk ka publikuar në faqen zyrtare Web, raportet e auditimit të KLSH-së.

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm i institucionit, bëhet me adresa personale dhe jo me adresa e-mail zyrtar.

Nga auditimi i procedurave të prokurimeve publike, rezultoi se:

Bashkia Korçë, megjithëse është regjistruar me “Domain Name” <https://bashkiakorce.gov.al>, në regjistrin e prokurimit publik për vitin 2022 ka prokuruar me subjekte private shërbimin e pagesës së domain name dhe hostim.

Gjithashtu, administrimi i faqes Web nëpërmjet “Control Panel” nuk administrohet me “full Akses” nga strukturat përgjegjëse të IT në Bashkinë Korçë. Administrator me atribut Full Akses është subjekti privat që ofron shërbimin e hostimit dhe regjistrimit të domanin të Bashkisë Korçë, për më shumë që, edhe administrimi i mail server-it bëhet po nga ky subjekt privat duke i dhënë atribut për të administruar të dhënat e një enti publik.

Administrimi i tyre duhej të bëhej nga AKSHI (pjesa për host-imin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë) dhe pagesa për mirëmbajtjen e faqes nga po ky institucion (AKSHI), ndërkohë për pagesën vjetore të domain name Autoriteti Publik që mbulon emrat e “domain” me prapashtesën “.al” është AKEP.

Për shërbimin e pagesës së domain name dhe host-imit, Bashkia Korçë përfshin edhe një faqe tjetër Web me adresë <https://festaebirres.com>, e cila është një adresë biznesi dhe jo me prapashtesën “.al” dhe për më tepër, kjo faqe nuk ka logo të Bashkisë Korçë në gjithë kontentin e saj.

Bashkia Korçë, eventin e festës së birrës e vendos si “subdomain” brenda Web-it me adresë <https://bashkiakorce.gov.al>, atëherë kjo faqe Web duhet të ishte nën logon e Bashkisë Korçë.

Regjistrimi dhe host-imi i Web-it me adresë <https://festaebirres.com> jashtë strukturave përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, e bën atë një adresë Web-i jozyrtare, të cilën Bashkia Korçë e paguan me pa të drejtë këtë shërbim.

Monitorimi: Bashkia Korçë nuk ka hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi nuk ka realizuar misionet auditimi tek institucionet e varësisë dhe tek shoqëritë publike.

Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi: z. S.F , znj. A.D , në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Juridik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, znj. V.Z , në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe z. E.GJ , përgjegjës i sektorit të IT.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 1; neni 10 “Përgjegjshmëria menaxheriale e koordl torit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordl torit të riskut”; neni 21 “Menaxhimi i riskut”; neni 22 “Veprimtaritë e kontrollit”, pika 1; neni 23 “Informacioni dhe komunikimi”; neni 24 “Monitorimi”, pika 1; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 43 pika 3; neni 8 “Parimi i ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike” të Ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Vendimi nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Në ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të mjedisit të kontrollit.

Shkaku: Moszbatimi i kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rëndësia: E lartë.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Struktura organizative e Bashkisë Korçë për vitin 2022, është miratuar me Urdhërin nr. 46, datë 01.02.2022 të Kryetarit të Bashkisë Korçë.

Në strukturën organizative të miratuar, Njësia e Auditimit të Brendshëm të BASHKISË KORÇË është organizuar në nivel Drejtorie me 4 auditues. Në periudhën objekt auditimi, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka në përbërjen e saj 3 auditues, duke përfshirë edhe Drejtorin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, nga ku 2 prej tyre janë të certifikuar si auditues të brendshëm. Përbërja dhe statusi i audituesve të NjAB të Bashkisë Korçë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual	Arsimimi	Viti i Certifikimit
1	A.T	Drejtorë	I lartë, ekonomi fl ncë	2005-2006
2	E.H	Specialist audit	I lartë, ekonomi plan	2016-2017
3	B.S	Specialist audit	I lartë, ekon fl nc kontabël	Ska
4	Vakant	-	-	-

Situata: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë është organizuar në nivel Drejtorie me 3 punonjës, vetëm dy prej tyre janë auditues të brendshëm të certifikuar.

Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në nivel “Drejtorie” është në mospërputhje me piken 2 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, për të vijuar me përcaktimet e nenit 13 të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Për sa më lart, në kushtet e veprimtarisë së saj, të pasqyruar në planin e miratuar dhe misionet e realizuara për periudhën objekt auditimi, në drejtim të ngarkesës dhe kompleksitetit të veprimtarisë së saj, do ishte e mjaftueshme të organizohej në nivel “Sektori” dhe jo “Drejtorie” në strukturën organizative të Bashkisë Korçë.

➤ Nga auditimi i dosjes së personelit, pjesë e strukturës së Auditimit të Brendshëm, u konstatua se:

- Në dosjen e znj. E.H , me pozicionin pune inspektor i lartë i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë, certifikata me nr. regjistri 1888 datë 30.09.2017, është fotokopje e panoterizuar;

- Në dosjen e znj. B.S , me detyre inspektor i lartë i auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë, e cila nuk është e certifikuar si auditues i brendshëm në sektorin publik, mungon lista e notave të diplomës universitare. Diploma nr. regjistri 286 e datës 12.07.2007 lëshuar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë është fotokopje e panoterizuar;

- Në dosjen e znj. A.T. me detyre drejtor i drejtorisë së auditit të brendshëm, dëshmia me nr. regjistri 0032 datë 30.11.2007 për titullin “Auditues i Brendshëm në sektorin Publik”, është fotokopje e panoterizuar.

Sa më sipër, janë në mospërputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, lidhja 1, pika 4. Gjithashtu kjo dosje nuk është inventarizuar sipas formatit të kërkuar në lidhjen 2 të këtij vendimi.

➤ Programet vjetore të Auditimit të Brendshëm:

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor, analiza sipas llojeve dhe gjetjeve. Në zbatim të bazës ligjore në fuqi për njësitë e auditimit të brendshëm, Bashkia Korçë me shkresën nr. 7474/1, datë 18.10.2021, ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm

(DHAB), planin Strategjik të vitit 2022 dhe 2022-2024. Për vitin 2022, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm janë parashikuar dhe realizuar 6 auditime.

Në referim të raporteve përfundimtare të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi, janë rekomanduar 48 masa organizative respektivisht të ndara si vijon:

- Në subjektin Bashkia, Drejtoria e Prokurimeve, auditim përputhshmërie, 7 masa;
 - Në subjektin Bashkia, Shërbimi i varrezave publike, auditim i kombinuar, 12 masa;
 - Në subjektin Qendra Rezidenciale e Zhvillimit, auditim përputhshmërie, 16 masa;
 - Në subjektin Bashkia, Sektori i integritimit europian, projekti LED, auditim i kombinuar, 6 masa;
 - Në subjektin Bashkia, FI nca për detyrimet e prapambetura, auditim përputhshmërie, 7 masa.
- Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi znj. E.H , znj. B.S , znj. A.T në cilësinë e audituesve të brendshëm dhe Znj. A.D në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Juridik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Kriteri: Pika 2 e VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 13; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, lidhja 1, pika 4.

Ndikimi/Efekt: Moskryerja e auditimeve në fushat me risk që ka veprimtaria e Bashkisë Korçë, sjell mosnjohjen e rreziqeve të mundshme nga titullari dhe menaxhimi për t’i minimizuar e për t’i monitoruar këto risqe.

Shkaku: Moskryerja e auditimeve në fushat me risk.

Rëndësia: E lartë.

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi në lidhje me dokumentacionin e auditimit për vitin 2022, u konstatua se në përgjithësi janë respektuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm. Konkretisht, rezultoi se:

Para fillimit të angazhimit të misionit të auditimit, nga audituesit e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm janë hartuar deklaratat e pavarësisë, janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse janë administruar me numër protokollit të veçantë.

Për çdo auditim janë hartuar deklaratat e konfliktit të interesit. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatës.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar disa vjeçare parashikimin e të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike dhe si i tillë është komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

➤ Kalendari për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024:

- Kalendari për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024 është miratuar me vendimin nr. 140, datë 11.12.2020 “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe të buxhetit vjetor 2022, Bashkia Korçë”.

Në vendimin e sipërcituar janë përcaktuar hapat për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe buxhetin vjetor 2022 gjatë vitit 2021, sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Ligjin nr. 68/2017 “Për fl ncat e vetëqeverisjes vendore”.

➤ Në bazë të kalendarit janë përgatitur dhe miratuar aktet administrative të mëposhtme:

- VKB nr. 9 datë 28.1.2021 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave 2022-2024”;
- Tavanet përgatitore të programeve buxhetore afatmesëm për vitet 2022-2024, me vendimin nr. 32 datë 25.3.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2022-2024 në nivel programi”;
- Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr. 31 datë 19.1.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”;
- Udhëzimi i Kryetarit të BASHKISË KORÇË nr. 223 datë 29.3.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024 të Bashkisë Korçë”;
- Përcjellja e PBA 2022-2024, faza e parë, në Ministrinë e Financave Ekonomisë nëpërmjet shkresës nr. 4422 prot., datë 31.05.2021;
- VKB nr. 73 datë 28.6.2021 “Mbi miratimin e PBA 2022-2024”, faza e parë;
- Në zbatim të kërkesave të udhëzimit plotësues nr. 12425/1 datë 9.7.2021 nga strukturat përgjegjëse është bërë PBA 2022-2024 i rishikuar;
- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve me vendimin nr. 89 datë 29.7.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2022-2024 në nivel programi”;
- Bashkia Korçë ka përcjellë PBA 2022-2024, të rishikuar në MEF me shkresën nr. 7534 prot., datë 13.9.2021;
- VKB nr. 109 datë 30.9.2021 “Mbi miratimin e PBA 2022-2024”, të rishikuar; dhe
- VKB nr. 148 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e PBA 2022-2024”, përfundimtare.

Burimet dhe shpenzimet e përgjithshme të PBA 2022-2024 sipas instrumentit të planifikimit financiar të miratuar me VKB nr. 148 datë 22.12.2021, janë paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2019 dhe vitin 2020, te burimet e përgjithshme përfshihen të dhënat faktike, pra realizimi i burimeve dhe i shpenzimeve.

Shuma prej 154,038 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e mbetur midis burimeve dhe shpenzimeve të realizuara të vitit 2019, është trashëguar në buxhetin e vitit 2020, shuma 135,673 mijë lekë e cila përfaqëson vlerën e mbetur midis burimeve dhe shpenzimeve të realizuara të vitit 2020 është trashëguar në buxhetin e vitit 2021.

➤ Buxheti vjetor 2022:

Buxheti i vitit 2022 është miratuar me VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”.

Buxheti i BASHKISË KORÇË është në 26 programe buxhetore dhe planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analizimi i treguesve analitikë të buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë u konstatua se:

1. Programet me peshën më të madhe në buxhetin e Bashkisë janë:

- *Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 160,896 mijë lekë nga të cilat 156,614 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 4,282 mijë lekë shpenzime kapitale;
- *Menaxhimi i Mbetjeve*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 120,008 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime operative, transferta tek organizatat);

- *Rrjeti rrugor rural*, i cili për vitin 2022 ka një buxhet prej 70,000 mijë lekë shpenzime kapitale;

- *Çështje financiare dhe fiskale*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 66,528 mijë lekë nga të cilat 65,328 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 1,200 mijë lekë shpenzime kapitale;

- *Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 45,170 mijë lekë.

2. Programet me peshën më të madhe në buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike janë:

- *Shërbime Publike Vendore*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 358,006 mijë lekë nga të cilat 341,901 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 16,105 mijë lekë shpenzime kapitale;

- *Ndriçim rrugësh*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 80,287 mijë lekë nga të cilat 72,847 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 7,440 mijë lekë shpenzime kapitale.

3. Programet që zënë peshën më të madhe në buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes janë:

- *Arsimi bazë, përfshirë arsimin parashkollor*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 315,542 mijë lekë, nga të cilat 297,061 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 18,481 mijë lekë shpenzime kapitale.

- *Arsimi i mesëm i përgjithshëm*, për vitin 2022 ka një buxhet prej 55,570 mijë lekë, nga të cilat 47,770 mijë lekë shpenzime korrente, (shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek organizatat, transfertat tek individët), si dhe 7,800 mijë lekë shpenzime kapitale.

➤ Burimet e financimit për vitin 2022:

1. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022, nga qeveria qendrore ka qenë në vlerën 462,077 mijë lekë;

2. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022, nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara në pushtetin vendor në 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, ka qenë në vlerën 334,248 mijë lekë;

3. Të ardhura të planifikuara nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat e Institucioneve në vlerën 1,060,304 mijë lekë (planifikimi fillestar);

4. Projektet IPA të planifikuara në vlerën 32,696 mijë lekë.

➤ Përdorimi i të ardhurave:

Shpenzime personeli (600+601)	742,392 mijë lekë
Shpenzime korrente (602-609)	873,285 mijë lekë
Shpenzimet për investime (230+231)	195,782 mijë lekë
Shpenzimet për pagesën e principalit dhe interesit (166+651)	45,170 mijë lekë
Projektet IPA	32,696 mijë lekë

➤ Shtesat në buxhetin 2022

Buxheti i vitit 2022 ka pësuar ndryshime, përkatësisht me:

- VKB nr. 21 datë 10.2.2022, “*Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë, në buxhetin e vitit 2022*”, 191,202 mijë lekë;

- VKB nr. 146 datë 29.9.2022, “*Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit dhe përdorimin e fondit për rritjen e pagave për funksionin e Arsimit parashkollor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes*”, 3,320 mijë lekë;

- VKB nr. 50 datë 31.3.2022 “*Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2022*”, 1,752 mijë lekë;

- VKB nr. 127 datë 29.7.2022, “Për miratimin e planit të buxhetit dhe përdorimin e grantit për objektin Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë, fl ncuar nga AZHBR”, në shumën 24,756 mijë lekë;
 - VKB nr. 134 datë 22.8.2022, “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit të vitit 2022 për Bashkinë Korçë (Grant nga MSHMS për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve)” në vlerën 19,999 mijë lekë, si dhe miratimin e kontributit të Bashkisë për projektin “Qendër inovacioni dhe kreativiteti multifunksionale”, në vlerën 9,729 mijë lekë;
 - VKB nr. 22 datë 10.2.2022 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit si dhe kalimin e fondit prej 3,000 mijë lekë nga Këshilli i Qarkut, si kontribut për projektin “Qendra Ditore për moshën e tretë”, tek Fondacioni “Misioni Emanuel”.
- Burimet e fl nimit dhe shpenzimet të buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2022, janë paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Buxheti i vitit 2022, i miratuar me VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë””, ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2022, si më poshtë:

- Vlera prej 191,202 mijë lekë janë fonde të cilat u trashëguan nga viti 2021 dhe i shtohen planit të buxhetit 2022. Këto fonde u miratuan në Këshillin Bashkiak;
- Vlera prej 3,000 mijë lekë kontribut nga Këshilli i Qarkut për realizimin e projektit “Qendra Ditore për moshën e tretë” tek Fondacioni “Misioni Emanuel”;
- Gjatë vitit 2022 Bashkia Korçë ka përfituar grant nga AZHBR për investimin “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”, në vlerën 24,756 mijë lekë;
- Bashkia Korçë ka përfituar grant nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve në vlerën 19,999 mijë lekë, për projektin “Qendër inovacioni dhe kreativiteti multifunksionale”;
- Vlera prej 3,320 mijë lekë (transferta e pakushtëzuar sektoriale), janë fonde të cilat u miratuan në KB në zbatim të VKM nr. 465 datë 6.7.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 175 datë 8.3.2017 Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar, të ndryshuar”;
- Pas vënies në funksionim të tregut të gjësë së gjallë me vendimin nr. 50, datë 31.03.2022 të KB, është miratuar rritja e planit të të ardhurave në buxhetin e vitit 2022 sipas tarifave në vlerën 1,752 mijë lekë të ardhura nga tarifatat që do të aplikohen në këtë treg dhe përdorimi i tyre për këtë treg.

➤ Sponsorizimet në vlerën 5,436 mijë lekë të detajuara:

- Sponsorizim për ekipin e volejbollit të femrave të Klubit Shumësportësh në vlerën 2,520 mijë lekë, nga: (E ShPK, D ShPK dhe Eurosiga sha.);
- Sponsorizim nga “Save the children”, 1,852 mijë lekë për terrenet sportive tek shkolla Isuf Dalipi, Mollaj dhe kopshti komunitar shkolla Nuçi Naçi, (zbatuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike);
- Sponsorizim për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në vlerën 354 mijë lekë nga I ShPK dhe P. C. bank;
- Sponsorizim në vlerën 10 mijë lekë për Shtëpinë e Foshnjës për dhurata për fëmijët;
- Sponsorizim në vlerën 700 mijë lekë për Qendrën e Artit dhe Kulturës për Festivalin e Komedisë “Kokofest”;

Burimet e financimit të vitit 2022 me ndryshimet, janë paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar të dhënave të shpenzimeve sipas Aneksit B5, rezulton se:

- *Shpenzimet për paga* janë realizuar në masën 92% kundrejt planifikimit, ndërkohë që zënë rreth 26% të totalit të shpenzimeve për vitin 2022;

- *Shpenzimet për investime* për vitin 2022 janë realizuar në masën 34%, ndërkohë që investimet e realizuara zënë 17.6 % në totalin e shpenzimeve.

Për sa më lart, u konstatua se investimet e realizuara janë në nivel shumë të ulët.

Të dhënat mbi realizimin e shpenzimeve për institucionet e varësisë janë paraqitur në Aneksin B6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Realizimi i shpenzimeve për Bashkinë dhe institucionet e varësisë sipas llogarive ekonomike paraqiten në mënyrë të përmbledhur në Aneksin B7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Realizimi i shpenzimeve sipas institucioneve për vitin 2022.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:

NSHP menaxhon programin e shërbimeve publike, ndriçimin e rrugëve, rrjetin rrugor rural dhe menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Buxheti i ndërmarrjes së shërbimeve publike për vitin 2022 ishte në vlerën 505,684 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 441,632 mijë lekë ose në masën 87%. Buxheti i detajuar sipas programeve dhe artikujve buxhetore është paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes:

Kjo ndërmarrje menaxhon programin e arsimit bazë, përfshirë arsimin parashkollor, arsimin e mesëm të përgjithshëm, konviktet e arsimit parauniversitar dhe kujdesin social për familje dhe fëmijët.

Buxheti për vitin 2022 ishte në vlerën 438,817 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 412,557 mijë lekë ose 94%. Buxheti i detajuar sipas programeve dhe artikujve buxhetorë për vitin 2022 për ndërmarrjen e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdheve është paraqitur në Aneksin B9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Institucioni “Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore”:

Buxheti për vitin 2022 ishte në vlerën 87,956 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 74,513 mijë lekë, ose realizuar në masën 85%. Buxheti i QAK sipas artikujve buxhetore dhe programit është paraqitur në Aneksin B10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Klubi shumësportësh:

Menaxhon të gjitha aktivitetet sportive, si dhe siguron mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive. Buxheti për vitin 2022 ishte në vlerën 48,549 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 40,720 mijë lekë ose realizuar në masën 84%.

Buxheti sipas programeve dhe artikujve buxhetor për vitin 2022 për institucionin e varësisë së BASHKISË KORÇË “*Klubi shumësportësh*”, është paraqitur i detajuar në Aneksin B11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Monitorimi është procesi i vlerësimit të performancës, proces i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara, siç pasqyrohet në Raportin e Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2022.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2022, sipas programeve ekonomike, është paraqitur në Aneksin B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Realizimi i buxhetit sipas njësive shpenzuese, është paraqitur në Aneksin B13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Situata: Në referim të udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, detyrimet e prapambetura të raportuara në MFE për përdhën janar-dhjetor 2022, janë paraqitur në Aneksin B14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2022 ka qenë 95,967 mijë lekë ose në masën 4.5% e totalit të shpenzimeve të planifikuara, të cilat duke pasur parasysh kohën e krijimit të tyre duhet të ishin likuiduar.

Faturat e palikuiduara për blerje mallra e shërbimeve gjendje në fund të vitit 2022 (në lekë) janë paraqitur në Aneksin B15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Korçë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime ka qenë **1,889,325 mijë lekë**, planifikimi përfundimtar ka qenë **2,138,790 mijë lekë**, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka qenë **1,607,320 mijë lekë** me një diferencë **282,005 mijë lekë** nga plani fillestar ose **531,470 mijë lekë** nga plani përfundimtar, në masën **85%** nga plani fillestar dhe **75%** nga plani përfundimtar. Planifikimi i të ardhurave ka qenë **1,062,056 mijë lekë**, ndërsa realizimi ka qenë **751,455 mijë lekë** ose në masën **71%**. Bashkia Korçë në riplanifikimin e shpenzimeve duke parë realizimin e ulët të të ardhurave, në vend që të bënte ulje në planin e shpenzimeve, ka bërë rritje, duke e thelluar hendekun e mosrealizimit nga 85% në 75% të totalit.

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. S.F , në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. V.Z , në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshme të financës, Buxhetit dhe Menaxhimit financiar.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017, “Për fllncat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 26.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Udhëzimi nr. 2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve.

Rëndësia: E lartë.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për periudhën objekt auditimi, Bashkia Korçë nuk ka përfituar fonde nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore:

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në BK është përcaktuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë, me nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”. Bazuar në rregulloren e Bashkisë Korçë, konkretisht në nenin 59, në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit, ndër të tjera përcaktohet se: Përgjegjësi i sektorit “Kryen analiza e raporte mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore mbi ecurinë e sektorit dhe i paraqet pranë eprorit direkt”. Nga ana jonë u kërkuar këto analiza dhe raporte, por nuk u vunë në dispozicion pasi nuk ishin hartuar.

Struktura e drejtorisë për vitin 2022 është organizuar me 34 punonjës (1+4+29), sipas Aneksit A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, DTTV ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 5 vende vakante, jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Urdhërin nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”. Mungesa e punonjësve në strukturën organizative të kësaj drejtorie mund të sjell pasoja në performancën e drejtorisë, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara në planifikimin e të ardhurave për vitin 2022.

Situata: Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, DTTV ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur tre vende vakante në pozicionin “Specialistë” dhe “Përgjegjës Sektori”, kjo, jo në përputhje me strukturën organike të miratuar. Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e njësisë, duke rrezikuar mospërmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Kriteri: Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Korçë, nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”.

Ndikimi/efekti: Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e njësisë, duke rrezikuar mospërmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Shkaku: Moskryerja e procedurave për rekrutimin e punonjësve.

Rëndësia: E mesme.

➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë është miratuar me VKB-në nr. 137, datë 25.11.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Korçës, si dhe penaltitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1165/1 Prot. Datë 07.12.2021.

Referuar të dhënave të paraqitura në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për periudhën nën auditim, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë paraqitet në masën 71%, nga 1,062,056 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 751,455 mijë lekë (310,601 mijë lekë më pak), duke mos arritur objektivat e përcaktuara në planifikimin e vitit 2022.

Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave mund të ndikojë në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për fll ncat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- “Paketa e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 në Bashkinë Korçë”, e miratuar me VKB-në nr. 137, datë 25.11.2022
- VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

Situata: Nga analiza e kryer në Aneksin B2, u konstatua se për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet, është i paqartë planifikimi i të ardhurave të kësaj takse nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, duke mos u bazuar në parashikime realiste të të ardhurave faktike të viteve të mëparshme. Vlera e planifikuar (prej 60,425,066 lekë) nuk është e mbështetur në asnjë fakt, për më tepër, në vitin 2021 kjo taksë është planifikuar 36,873,515 lekë dhe janë arkëtuar 5,125,663 lekë, ndërkohë që në vitin 2022, kjo taksë është planifikuar në vlerën 60,425,066 lekë dhe realizimi është 16,782,885 lekë, pavarësisht se borxhi progresiv nga viti 2018 deri në dhjetor të vitit 2021 ka qenë në vlerën 19,925,978 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për fl ncat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

Kriteri: Gërma “a” dhe “e”, të nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi/efekti: Planifikim i të ardhurave mbi TNI në vlera të larta të pabazuara, sjell pasoja në mosrealizim të planit vjetor.

Shkaku: Planifikim i të ardhurave mbi TNI në vlera të larta të pabazuara.

Rëndësia: E mesme.

Nga grupi i auditimit u analizuan të ardhurat të cilat zënë peshën specifike në realizimin e tyre:

- Tarifa e pastrimit, e cila ka dhe peshën kryesore e të ardhurave me 15.4%;
- Taksa mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë 15% e të ardhurave të realizuara;
- Tarifat e ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe mirëmbajtjes së sistemit ujitës të cilat zënë 7.8% të të ardhurave të realizuara;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet të cilat zënë 11.6% të të ardhurave të realizuara;
- Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve e cila zë 4.2% të të ardhurave të realizuara;

Tarifa e pastrimit është tarifa që ka kontribuar më shumë dhe ka mbajtur peshën kryesore në realizimin e të ardhurave me 15.4% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Detyrimi i tarifës së pastrimit për biznesin likuidohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likuidohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Tarifa e pastrimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 198,227,000 lekë dhe është realizuar në masën 81% kundrejt planifikimit ose në vlerë 160,014,535 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 1% më pak ose 879,718 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 152,874 lekë më shumë nga tarifa e pastrimit për çdo familje dhe 1,032,592 lekë më pak tarifa e pastrimit nga subjektet tregtarë, me një total prej 879,718 lekë më pak se vitin e kaluar.

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë 15% e të ardhurave të realizuara:

- *Taksa mbi ndërtesën* është taksa që ka kontribuar me 11.8% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 185,165,510 lekë dhe është realizuar në masën 66% kundrejt planifikimit ose në vlerë 122,707,066 lekë. Krahasuar me vitin 2021, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 7% më shumë ose 7,861,048 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 7,115,671 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime banimi dhe 745,377 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime biznesi, me një total prej 7,861,048 lekë më shumë se vitin e kaluar.

• *Taksa mbi truallin* është taksa që ka kontribuar me 1.16% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Taksa mbi truallin për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 24,269,471 lekë dhe është realizuar në masën 50% kundrejt planifikimit ose në vlerë 12,042,427 lekë. Taksa mbi truallin përfshin kategoritë e truallit për biznes dhe truallit për banim. Krahasuar me vitin 2021, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 4 më pak ose 558,783 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rënie këtë vit me 327,045 lekë më pak nga truall për qëllim banimi nga individë dhe 231,738 lekë më pak truall për qëllime biznesi, me një total prej 558,783 lekë më pak se vitin e kaluar.

• *Taksa mbi tokën bujqësore* është taksa që ka kontribuar me 1.96% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2022 është planifikuar 59,883,370 lekë dhe është realizuar në masën 34% kundrejt planifikimit ose në vlerën 20,387,837 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga poseduesit e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë që kryen pagesën për detyrimin e vitit 2022 në vlerën 9,770,697 lekë dhe nga debitorët e viteve paraardhëse të cilët kryen pagesën gjatë vitit 2022 në vlerën 10,617,140 lekë. Vlera prej 10,617,140 lekë detyrime është arkëtuar pas dërgimit të 7,814 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në njësitë administrative përkatëse. Kjo taksë ka një mosrealizim prej 39,495,533 lekë kundrejt planifikimit të vitit 2022.

Tarifat e ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe mirëmbajtjes së sistemit ujitës të cilat zënë 7.8 % të të ardhurave të realizuara:

• *Tarifa e ndriçimit* është tarifa që ka kontribuar me 3.37% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Tarifa e ndriçimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 45,020,170 lekë dhe është realizuar në masën 78% kundrejt planifikimit ose në vlerë 35,004,372 lekë. Krahasuar me vitin 2021, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 1% më pak ose 360,533 lekë. Niveli i arkëtimit ka pësuar rënie këtë vit me 722,684 lekë më pak nga tarifa e ndriçimit për çdo familje dhe 362,151 lekë më shumë tarifa e ndriçimit nga subjektet tregtare, me një total prej 360,533 lekë më pak se vitin e kaluar.

• *Tarifa e gjelbërimit* është tarifa që ka kontribuar me 2.24% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Tarifa e gjelbërimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 28,767,070 lekë dhe është realizuar në masën 81% kundrejt planifikimit ose në vlerë 23,210,914 lekë. Krahasuar me vitin 2021, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 2% më pak ose 520,691 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rënie këtë vit me 135,965 lekë më pak nga tarifa e gjelbërimit për çdo familje dhe 384,726 lekë më pak tarifa e gjelbërimit nga subjektet tregtare, me një total prej 520,691 lekë më pak se vitin e kaluar.

• *Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike* është tarifa që ka kontribuar me 1.3% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 18,301,350 lekë dhe është realizuar në masën 72% kundrejt planifikimit ose në vlerë 13,149,366 lekë. Krahasuar me vitin 2021, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit për këtë tarifë me 3% më shumë ose 340,265 lekë.

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, e cila zë 4.2% të të ardhurave planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë. Për vitin 2022 është planifikuar 40,028,515 lekë dhe është realizuar në masën 110% ose në vlerë 44,057,543 lekë. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj referuar akt-rakordimeve mujore mbi numrin e mjeteve dhe vlerën e taksës për çdo mjet.

➤ Të ardhurat nga hapësirat publike (tavoli t) dhe tarifa e parkimit me pagesë:

Situata: Nga auditimi i hapësirave publike (tavoli t) sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2022 rezulton se për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavoli jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, për muajt maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tarifa është 19 lekë/m² në ditë, për muajt mars, prill, tetor, nëntor tarifa është 10

lekë/m² në ditë. Sipas dokumentacionit të siguruar nga sektori i Sektorit të Kontrollit të Ushqimor dhe Licensimit rezultoi të jenë krijuar të ardhurat në vlerën 11,982,174 lekë, sipas Aneksit A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se llogaritja nga ana e BASHKISË KORÇË nuk është kryer sipas ditëve por është përlllogaritur për çdo muaj me 30 ditë, në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 137 datë 25.11.2021 pika 7/5, faqe 24, për hapësirën publike e cila e përcakton qartë se tarifa është 10/19 lekë/ditë për m², duke sjellë të ardhura të munguara në shumën 226,963 lekë për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Kriteri: VKB nr. 137 datë 25.11.2021, pika 7/5, faqe 24.

Ndikimi/efekti: Mosfaturim i saktë i subjekteve përfitues të hapësirave publike sipas VKB nr. 137 datë 25.11.2021, pika 7/5, faqe 24, ka sjellë të ardhura të munguara në shumën 226,963 lekë.

Shkak: Moszbatim i VKB nr. 137 datë 25.11.2021, pika 7/5, faqe 24.

Rëndësia: E mesme.

➤ Tarifat e parkimit me pagesë:

Struktura përgjegjëse është zyra e shërbimit të parkimit me pagesë. Përpara fillimit të punës dhe ndarjes sipas zonave të parkimit me pagesë, punonjësit në prezencë të mbikëqyrësit pajisen me sasinë e nevojshme të blloqeve të cilat janë me numër serial për çdo biletë dhe mandat pagesa. Bileta nuk përcakton më shumë se 60 minuta qëndrim të mjetit. Në përfundim të punës, punonjësit dorëzojnë në prezencë të mbikëqyrësit kondrabilitën që vërteton shitjen e biletës dhe vlerën monetare. Më pas mbikëqyrësi iu pret punonjësve mandat arkëtimi për biletat e shitura dhe vlerën në lekë të xhiros ditore. Të gjitha mandatet e arkëtimit në numër serial përshkruhen nga mbikëqyrësi në librin e arkës dhe dorëzohen më shumë e lekëve në drejtorinë e financës e cila me marrjen në dorëzim, pret mandat arkëtimi me shumën totale të xhiros ditore.

Nga auditimi u konstatua se kjo strukturë nuk ka një metodologji mbi kryerjen e detyrave funksionale dhe proceduriale, që nga mënyra e arkëtimit të xhiros ditore e deri tek punonjësit në terren, të cilët nuk kanë asnjë shenjë dalluese (uniformë, jelek fosforeshent, etj.) përveç dokumentit identifikues. Për më tepër, kjo njësi nuk ka një strukturë kontrolluese, pasi edhe pozicioni i drejtorit të drejtorisë për gjithë periudhën e auditimit e deri në mbajtjen e këtij akti vijon të jetë pozicion vakant.

Gjithashtu, nga auditimi i librit të arkës u konstatua se për një periudhë 6 ditore, nga data 04.05.2022-11.05.2022 kjo strukturë nuk ka funksionuar pasi pretendohet nga ana e subjektit se ka patur mungesë të biletave të parkimit të cilat u lëshohen qytetarëve. Si rrjedhojë ditët e humbura, me arsyetimin e mungesës së biletave të parkimit, përkthehen në të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë, ku xhiro mesatare për këtë periudhë ka qënë nga 40,000-42,000 lekë në ditë.

➤ Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira:

Në kuadër të auditimit të të ardhurave të BASHKISË KORÇË u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave apo marrëveshjeve lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave apo marrëveshjeve.

Situata: Bashkia Korçë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi³ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur

³ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

125 kontrata/marrëveshje për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qera pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej 11 subjekte debitore në vlerën 57,917,505 lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, të pasqyruara në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo vlerë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë, në kundërshtim me Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe VKB nr. 137, datë 25.11.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë për vitin 2022”.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe VKB nr. 137, datë 25.11.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë për vitin 2022”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e BASHKISË KORÇË nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit në vlerën 57,917,505 lekë.

Shkaku: Strukturat e BASHKISË KORÇË nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia: E lartë.

➤ Subjektet me aktivitet gurore:

Situata: Nga auditimi rezultoi se në zonën Pyjore e Kullosore, aset i Bashkisë Korçë, sipas lejeve aktive të marra nga regjistri i AKBN-së ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi për gurore 7 subjekte, nga të cilët 5 subjekte janë brenda fondit pyjor/kullosor. Nga ana e BASHKISË KORÇË nuk rezulton që për subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet tregtar për shfrytëzim minieralësh, të jetë lidhur kontratë qeraje për përdorimin e tokës e cila është aset i Bashkisë Korçë, me arsyetimin se këto subjekte, kanë aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqje nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve të marra për shfrytëzim. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas aplikimit për heqje nga fondi pyjor/kullosor të shoqërive i është drejtuar BASHKISË KORÇË me shkresa, për përgatitje të raportit tekniko ekonomik për kryerjen e aktivitetit minierar. Bashkia Korçë me VKB dhe shkresa përkatëse, shpreh dakordësinë për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqeve sipas lejes së shfrytëzimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet në pikën 5 të nenit 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, dhe neni 38 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. S.F Kryetari i Bashkisë Korçë, z. J.M me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave dhe z. M.B. me detyrë inspektor në sektorin e Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, për periudhën objekt auditimi.

Kriteri: Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25. Pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, dhe neni 38.

Ndikimi/efekti: Të ardhura të munguara.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

➤ **Menaxhimi i borxhit:**

Bazuar në të dhënat e Bashkisë Korçë, subjektet për vitin 2022 sipas gjendjes në fillim, ndryshimet gjatë vitit dhe gjendja në fund, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të rReja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja
1	Biznesi Vogël	3322	363	218	3467
2	Biznesi Madh	801	54	31	824
	Gjithsej	4123	417	249	4291

Burimi: Bashkia Korçë

Sa më sipër rezultojnë se 172 subjekte janë të pezulluar gjatë vitit 2022 dhe 735 subjekte janë me status pasiv.

Në Bashkinë Korçë subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj., dhe në tabelën në vijim paraqiten detyrimet e subjekteve për vitin 2022.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve për subjektet fizikë/juridikë për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Taksat dhe tarifat familjare/biznesit:**

Në Bashkinë Korçë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e gjelbërimit, mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve, tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturve urbane dhe tarifën e ndriçimit. Në mënyrë të përmbledhur, detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative janë paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, subjektet tregtare dhe familjarët debitorë sipas llojeve të taksave/tarifave dhe viteve janë paraqitur në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit të Auditimit. Nga auditimi u konstatua se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Korçë paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 110,094 mijë lekë i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 40,715 mijë lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 69,379 mijë lekë.

Për vitin 2022 gjendja e debitorëve progresiv në Bashkinë Korçë është:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën 203,003 mijë lekë, ku 69,378 mijë lekë është detyrim i 368 subjekteve të cilët rezultojnë me status Pasiv/Mbyllur.
- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën 234,521 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është 437,524 mijë lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

➤ **Dinamika e Borxhit:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas moshës së tij paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
1-3 vit	49,717,678	1,405

3-5 vjet	33,678,989	603
Mbi 5 vjet	160,321,742	1,077
Totali	243,718,409	3,085

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës mbi 5 vjet në vlerën 160,321,742 lekë ose 65% e totalit dhe për debitorët e moshës 1-3 vjet në vlerën 49,717,409 lekë ose 20% e totalit.

➤ **Masat e marra për uljen e borxhit**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet *u konstatua se*, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka njoftuar bizneset/familjarët debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore. Për vitin 2022 drejt debitorëve familjarë veç njoftimeve për detyrimet e akumuluar, DTTV u është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 1886 shkresa për vlerën 56,138,555 lekë, ku 336 familje kanë arritur të paguajnë vlerën prej 7,981,209 lekë. Më hollësisht paraqitur në aneksin II.6.8, tabela për “*Masat shtrënguese për debitorët familjarë*”.

Nga informacioni/dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2022 drejt subjekteve tregtarë veç njoftimeve për detyrimet e akumuluar, DTTV u është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 448 shkresa për vlerën 71,275,636 lekë, ku 147 subjekte kanë reaguar duke paguar vlerën prej 19,246,122 lekë. Gjithashtu DTTV ka komunikuar në mënyrë shkresore edhe me DSHTRR/RBS dhe ZRPP/ASHK duke dërguar gjithsej 217 shkresa, nga të cilat është arritur të mblidhet shuma 679,054 lekë. Detajet për masat shtrënguese, janë paraqitur në Aneksset A8 dhe A9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga sa më sipër, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, për subjektet që vijojnë të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga DTTV nuk duhen të ndalen por duhet të vijojnë me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93.

Situata: Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Korçë paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 110,094 mijë lekë i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifave e bizneseve, në vlerën totale 40,715 mijë lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifave vendore për familjet në vlerën 69,379 mijë lekë.

Për vitin 2022 gjendja progresive e debitorëve në Bashkinë Korçë është:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave e bizneseve, në vlerën 203,003 mijë lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifave vendore për familjet në vlerën 234,521 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresiv për bizneset dhe familjarët është 437,524 mijë lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga ana e DTTV nuk duhen të ndalen por duhet të zbatohen përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Shkaku: Moszbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitetet në fushën e hidrokarbureve:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në fushën e tregtimit me pakicë të lëndëve

djegëse, rezultoi se, në territorin e BASHKISË KORÇË për periudhën objekt auditimi, e kanë ushtruar këtë aktivitet 33 subjekte, nga të cilët 4 subjekte janë autorizuar në vitin 2022, pasi kishin kryer edhe pagesën e plotë, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Për sa sipër trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, ardhur në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024 “Mbi Projektraportin e Auditimit” ku janë shprehur objeksionet nga znj. A.Q , në cilësinë e drejtorit të DPJBNJ, znj. ZH.L , në cilësinë e drejtorit të DPKZHT, z. S.P në cilësinë e drejtorit të DTTV, z. J.M , në cilësinë e drejtorit të DPK, si dhe nga z. A.D , në cilësinë e mbikëqyrësit të parkimit me pagesë, sa më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Në lidhje me planifikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimet, rekomandimi juaj do të mbahet parasysh nga ana jonë.

2. Në lidhje me konstatimin për llogaritjen e tarifës së zënies së hapësirës publike BASHKIA KORÇË gjatë 2024 do të marrë masat që gjatë vitit 2024 të bëjë ndryshimet e nevojshme sipas muajve dhe ditëve kalendarike..

3. Nga ana e BASHKISË KORÇË janë marrë masa dhe ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga kontratat e qerasë. Sqarojmë se pjesa dërmuese e tyre janë në procese gjykimi nga Gjykata e Rrethit Korçë...

4. Në lidhje me konstatimin subjekteve që ushtrojnë aktivitet për gurore në territorin e BASHKISË KORÇË sqarojmë se për 5 subjektet që ushtrojnë aktivitetin e guroreve janë matur sipërfaqet e shfrytëzuara prej tyre por mbështetur në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, neni 5, pika 4 sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti i gurores i cili ndryshon kategorinë e përdorimit të sipërfaqes, kjo sipërfaqe hiqet nga fondi pyjor si dhe në Ligjin Nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”. Neni 24, Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore, Pika 10. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral. Mbështetur në ligjet e sipër përmendura nuk mund të lidhen kontrata pasi nuk ka bazë ligjore për lidhje kontrate....

5. Në lidhje me konstatimin e masave shtrënguese ju sqarojmë se DTTV do të vazhdojë të zbatojë masat shtrënguese të mbledhjes me forcë të detyrimeve...

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionet, nuk janë paraqitur fakte apo argumente shtesë nga ato të paraqitura në observacionet e bëra ndaj aktkonstatimit dhe trajtuar në Projektraport. Sa i përket pikës nr.4 nuk janë paraqitur fakte apo argumente shtesë nga ato të verifikuara nga auditimi në terren. Nuk rezulton që për subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet tregtar për shfrytëzim mineralesh, të jetë lidhur kontratë qeraje për përdorimin e tokës e cila është aset i Bashkisë Korçë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet në pikën 5 të nenit 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, dhe neni 38 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

Sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë.

➤ **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë:**

Nga ana e grupit të auditimit u analizua taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet e cila zë 11.6% të të ardhurave të realizuara;

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

Në Bashkinë Korçë, struktura që ka administruar dokumentacionin dhe ka përlllogaritur vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë deri në tetor të vitit 2022 ka qenë Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Me Urdhërin nr. 1180, datë 04.11.2022 përgjegjësia e përlllogaritjes së vlerës mbi taksën e

ndikimit në infrastrukturë i ka kaluar Drejtorisë së Përgjithshme të FI ncës, Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ndërsa arkëtimin e taksës i është kaluar DTTV.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë u konstatua se, nga legalizimet e bëra ndër vite, deri në 31.12.2022, 381 qytetarë në vlerën 19,925,978 lekë nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 337 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 13,692,213 lekë. Nga auditimi rezultoi se, kanë paguar detyrimet 195 qytetarë/individë me vlerë 8,268,310 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 142 qytetarë me vlerë totale 5,423,903 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2022, nuk e kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë ndaj BASHKISË KORÇË 142 qytetarë/individë që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara qytetarë, për vlerën totale 5,423,903 lekë dhe 381 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2022, me vlerë totale të detyrimeve 19,925,978 lekë. Në total, vlera e detyrimeve nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi 25,349,881 lekë për 523 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe VKB-së nr. 137, datë 25.11.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Korçës”.

Në Bashkinë Korçë, struktura që ndjek procesin dhe mban korrespondencën me ASHK-në për të gjitha objektet që janë në proces legalizimi është DPZHT, e cila ka pjesë të saj inxhinierë të fushës. Si rezultat, kjo strukturë nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia për llogaritjen e detyrimit që iu lind individëve kur përfitojnë legalizimin e objekteve të tyre. Bashkëpunimi efektiv midis këtyre drejtorive do të ulte mundësinë e gabimeve në llogaritjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe do të rriste nivelin e arkëtimeve.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe VKB-së nr. 137, datë 25.11.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Korçës”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Korçë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **25,349,881 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga DPKZHT dhe DTTV, për të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë.

➤ Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja:

Gjatë vitit 2022 Bashkia Korçë ka dhënë gjithsej 83 leje ndërtimi mbi të cilat ka përlllogaritur edhe taksën e ndikimit në infrastrukturë, paraqitur në Aneksin A10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2022, në kapitullin e VII, ndër të tjera përcaktohet se:

“Përpara miratimit të lejes së ndërtimit, lejes së prishjes apo dhe lejeve për ndryshim destI cioni aplikanti duhet të paraqesë vërtetimin e likuidimit të taksës së pasurisë së paluajtshme për pasurinë objekt aplikimi.”

Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë BASHKISË KORÇË vetëm pasi të kenë paguar para zbardhjes së lejes së ndërtimit detyrimet përkatëse për selinë administrative, adresat dytësore, detyrimet për “çdo kantier ndërtimi” si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën për depozitimin e mbetjeve inerte.”

Nga ana jonë nëpërmjet emailit të datës 30.10.2023, u kërkua DTTV vërtetimet e lëshuara për subjektet e pajisura me leje dhe rezultoi se ishin 25 subjekte debitore për vlerën 2,127,093 lekë sipas Aneksit A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa më sipër, nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk janë zbatuar përcaktimet e Paketës Fiskale të miratuar për vitin 2022, duke sjell të ardhura të munguara në buxhetin e BASHKISË KORÇË në vlerën 2,127,093 lekë.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi mbajnë përgjegjësi znj. ZH.L, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe z. E.GJ, Përgjegjës i Sektorit për Zhvillimin e Tokës.

Situata: Nga auditimi rezultoi se 25 subjekte janë pajisur me leje ndërtimi edhe pse kanë qenë debitore ndaj BASHKISË KORÇË në vlerën 2,127,093 lekë, në kundërshtim me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2022, kapitulli VII.

Kriteri: VKB nr. 137, datë 25.11.2021, kapitulli VII.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Korçë, nga mos arkëtimi i vlerës prej 2,127,093 lekë.

Shkaku: Moszbatimi i Paketës Fiskale miratuar për vitin 2022.

Rëndësia: E lartë.

Sa i përket llogaritjes së TNI për lejet e ndërtimeve të reja, nga grupi i auditimit u konstatua se:

Situata: Nga auditimi dhe llogaritja e TNI për lejet e ndërtimeve të reja u konstatua se:

1. *Leja e ndërtimit me nr. protokoli 1372/22, datë 01.04.2022:*

Objekti: “Kompleks turistik “Divizioni” me godI 3 katëshe, me 1 kat nëntokë –GodI 7”, L. 3., rruga “Çlirimi i Korçës” me pronar dhe zhvillues L.L. dhe O.L.

Nga verifikimi i kryer nga Grupi i Auditimit të KLSH-së, u konstatua se kemi të bëjmë me një klasifikim të gabuar të objektit të lejes, pasi nga informacioni marrë nga burime të treta u konstatua se zhvillimi i godI ve 3 katëshe kryhet me qëllim rishitje. Kjo e vërtetuar nëpërmjet linkut <https://facebook.com/dion.imobiliare.9>, datë 28.10.2023 ora 11:01:

- 👉 APARTAMENTE NE SHITJE 👉 KORÇË
- ✓ Objekti 1- 58.2 m²
 - ✓ Objekti 2- 58.2 m²
 - ✓ Objekti 3- 73.3 m²
 - ✓ Objekti 4- 73.3 m²
 - ✓ Objekti 5- 131.5 m²
- 📍 Objektet perbehen nga dyer & dritare tripleks
 - 📍 Punimet jane tepër cilesore
 - 📍 Pozicionohet ne nje lagje te qete & shume te preferuar
 - 📍 Kati: I-II & III
 - 👉 Disponon dokumentacion te rregullt hipotekor
 - 📄 Cmimi: i diskutueshem prane zyres tone.
 - 📍 Adresa: Rr. “Çlirimi i Korçës”



Për këtë arsye duhet që objekti i lejes për efekt të taksës së ndikimit në infrastrukturë të ishte llogaritur sipas paketës fiskale të Bashkisë Korçë, Kapitulli 1.4., pika 2. Sipas VKM-së nr. 207, datë 15.3.2017 për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës, vendi ku është ndërtuar, është zonë ansambël arkitektonike dhe përlllogaritja e taksës duhet të ishte me 8% dhe jo me 3%.

Sa më sipër nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (763.6 m^2) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m^2 sipas EKB) = 741,784 lekë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (763.6 m^2) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m^2 sipas EKB) = 2,797,830 lekë.

Diferenca prej 2,056,046 lekë = 2,797,830 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 741,784 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

2. *Leja e ndërtimit me nr. protokollin 3105/22, datë 28.03.2022:*

Objekti: “Kompleks turistik “Divizioni “me godi 3 katëshe, me 1 kat nëntokë – Godi 8”, L. 3., rruga “Çlirimi i Korçës” me pronar dhe zhvillues L.L. dhe O.L .

Sa më sipër nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (789.4 m^2) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m^2 sipas EKB) = 766,847 lekë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (789.4 m^2) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m^2 sipas EKB) = 2,892,361 lekë.

Diferenca prej 2,125,514 lekë = 2,892,361 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 766,847 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

3. *Leja e ndërtimit me nr. protokollin 7711/22, datë 26.10.2022:*

Objekti: “Kompleks turistik “Divizioni “me godi 3 katëshe, me 1 kat nëntokë – Godi 2”, L. 3., rruga “Çlirimi i Korçës” me pronar dhe zhvillues L L dhe O.L .

Sa më sipër nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit ($719,85 \text{ m}^2$) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m^2 sipas EKB) = 699,284 lekë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:

Sipërfaqja totale e ndërtimit ($719,85 \text{ m}^2$) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m^2 sipas EKB) = 2,637,530 lekë.

Diferenca prej 1,938,246 lekë = 2,637,530 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 699,284 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

4. *Leja e ndërtimit me nr. protokollin 1157/22, datë 17.03.2022:*

Objekti: “Kompleks turistik “Divizioni” me godi 3 katëshe, me 1 kat nëntokë –Godi 3”, L.3, rruga “Çlirimi i Korçës” me pronar dhe zhvillues L L dhe O.L .

Sa më sipër nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (625.2 m²) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m² sipas EKB) = 607,338 lekë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (625.2 m²) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m² sipas EKB) = 2,290,732 lekë.

Diferenca prej 1,683,394 lekë = 2,290,732 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 607,338 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

5. *Leja e ndërtimit me nr. protokoli 1237/22, datë 17.03.2022:*

Objekti: “Kompleks turistik “Divizioni” me godi 3 katëshe, me 1 kat nëntokë –Godi 5”, L.3, rruga “Çlirimi i Korçës” me pronar dhe zhvillues L L dhe O.L .

Sa më sipër nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (736.8 m²) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m² sipas EKB) = 715,750 lekë.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:


Sipërfaqja totale e ndërtimit (736.8 m²) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m² sipas EKB) = 2,699,635 lekë.

Diferenca prej 1,983,885 lekë = 2,699,635 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 715,750 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

6. *Leja e ndërtimit me nr. protokoli 2199/22, datë 27.04.2022:*

Objekti: “Banesë individuale (3 kate + podrum), rruga Nuçi Gogo, Korçë”, me zhvillues dhe pronar trualli BASHKISË KORÇË . Në VKM-në nr. 1096 datë 28.12.2015, neni 3, pika 1, gërma c), përcaktohet se: “Pallat, një ndërtesë apo grup ndërtesash që shërbejnë për banim dhe që mund të kenë lokale shërbimesh e tregtie, i përbërë nga, të paktën, 5 njësi, sipas përkufizimit të termit “njësi” në legjislacionin për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”. Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se leja e dhënë për “Banesë individuale” nuk qëndron, pasi nga verifikimi në terren (nga IMTV në Bashkinë Korçë), rezultoi të ishin nga dy hyrje për kat, në total 6 hyrje.

Sa më sipër tipologjia e ndërtimit është destinuar për rishitje dhe godi hyn në kategorinë e banesës kolektive, çka do të thotë se përlllogaritja për efekt të taksës së ndikimit në infrastrukturë do të jetë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të BASHKISË KORÇË Kapitulli 1.4 pika nr. 2. Më poshtë po paraqesim foto të godinës, të kryera nga IMTV Bashkia Korçë:



Sa më sipër, nga Bashkia Korçë TNI është përlllogaritur si më poshtë:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (718 m²) x 3% x 32,381 lekë (çmimi i kostos për ndërtim për m² sipas EKB) = 697,487 lekë.

Sa më sipër llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte:

Sipërfaqja totale e ndërtimit (718 m²) x 8% x 45,800 lekë (çmimi i shitjes për m² sipas EKB) = 2,630,752 lekë.

Diferenca prej 1,933,265 lekë = 2,630,752 lekë (Llogaritur nga Grupi i KLSH-së) – 697,487 lekë (Taksa e llogaritur nga Bashkia Korçë), përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. S.F Kryetari i Bashkisë Korçë, znj. ZH.L me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, z. I.L me detyrë Kryeinspektor IMT dhe z. E.K me detyrë Inspektor IMT, për periudhën objekt auditimi.

Kriteri: VKB nr. 137, datë 25.11.2021, kapitulli 1.4., pika 2, VKM nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës”, VKM nr. 1096 datë 28.12.2015, neni 3, pika 1, gërma c).

Ndikimi: Përlllogaritje jo në përputhje me paketën fiskale për rrjedhojë duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 13,847,443 lekë.

Shkaku: Mos klasifikim të saktë të objekteve të pajisura me leje ndërtimi me paketën fiskale 2022.

Rëndësia: E lartë.

Konkluzion: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë, për vitin 2022 janë:

- Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 5,423,903 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 13,847,443 lekë;
- Nga hapësira publike (tavoli t) në vlerën 226,963 lekë;
- Subjekte me aktivitet gurore në vlerën 3,022,500 lekë;
- Nga familjet për taksat dhe tarifrat e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., UKKO dhe jo UKKO në vlerën 69,379,000 lekë;
- Nga bizneset debitorë, në vlerën 40,715,000 lekë;
- Nga kontratat e qirave në vlerën 57,917,505 lekë;

Në total 190,532,314 lekë.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

➤ Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

➤ Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË për vitin 2022 (të cilat përfshijnë pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2022 të Aparatit të Bashkisë Korçë, Ndërmarrjen e Shërbimeve të Arsimit dhe Çerdhes, Klubin Shumësportësh Skënderbeu, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Qendrën Ditore të Zhvillimit, Shtëpinë e Foshnjes “Lulet e Vogla”, Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit dhe Qendrën e Artit dhe Kulturës) janë të nënshkruara nga z. S.F Kryetar i BASHKISË KORÇË në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. V.Z me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në cilësinë e nëpunësit zbatues, ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Korçë me shkresën nr. 3382 prot., datë 27.04.2023, brenda afatit ligjor dhe kanë marrë konfirmimin me nr. 468 prot., datë 27.04.2023.

➤ Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor u konstatua se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

➤ Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimit e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me Urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2022, deri në datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 u konstatua se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet 2022 është paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Pjesë përbërëse e aktiveve të cilat janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË janë aktivet e Aparatit të Bashkisë, Ndërmarrjes së Shërbimeve të Arsimit dhe Çerdhes, Klubit Shumësportësh Skënderbeu, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Qendrës Ditore të Zhvillimit, Shtëpisë së Foshnjës “Lulet e Vogla”, Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit dhe Qendrës së Artit dhe Kulturës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilët kanë aktive në përdorim, Urdhërat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjet dhe fletë-daljet etj.

Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” u konstatua se nga Bashkia Korçë disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

Situata: Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË u konstatua se, për vitin 2022 në total janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale në vlerën 15,936,605 lekë. Kjo vlerë nuk është e kontabilizuar saktë, për arsye se në pasqyrat financiare të Qendrës së Artit dhe Kulturës është kryer pakësim në vlerën 4,000,000 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare të konsoliduara është kontabilizuar si nxjerrje jashtë përdorimit. Gjithashtu në regjistrin e aktiveve të Aparatit të BASHKISË KORÇË është kryer nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën 3,270,276 lekë ndërkohë që në bilancin e konsoliduar është kontabilizuar si pakësim.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Aneksi nr. 1 dhe Udhëzimi nr. 30, dat 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të aktiveve afatgjata materiale.

Shkaku: Moszbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Situata: Për vitin 2022, Kryetari i BASHKISË KORÇË për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Aparatit të Bashkisë dhe Njësive Administrative ka nxjerrë Urdhërin nr. 1157, datë 01.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit, i përbërë nga znj. I.M kryetar komisioni dhe anëtarët znj. K.K , z. B.Q , znj. R.E , z. TH.B , znj. J.V , z. E.GJ , znj. M.P , z. O.L , znj. E.M dhe z. E.R . Referuar raportit mbi përfundimin e procesit të inventarit, komisioni i inventarizimit ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive që i përkasin inventarit ekonomik në vlerën 3,270,275 lekë dhe inventar i imët në vlerën 330,004 lekë ku totali shkon në vlerën 3,600,280 lekë.

Me Urdhërin nr. 1405, datë 21.12.2023, të Kryetarit të Bashksië, është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata i përbërë nga znj. V.Z , kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A.ÇN, z. O.P , znj. , z. J.M , znj. M.K .

Me Urdhërin nr. 1431, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit i përbërë nga z. P.M kryetar i komisionit dhe anëtarët z. I.M , z. J.R , znj. K.Z , z. L.SH .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procesin e asgjësimit të aktiveve, u konstatua se, në listë e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cila konsiderohen të dëmshme (pajisje elektrike dhe elektronike), për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga z. S.F Kryetar i Bashkisë dhe z. K.K Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejitimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

Kriteri: Ligji nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, Kreu I, pika 1 dhe pika 2, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 108 dhe pika 122.

Ndikimi/Efekti: Ndikimi negativ në përmirësimin e cilësisë së performancës mjedisore.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Situata: a. Për vitin 2022, znj. O.V , Drejtor i Klubit Shumësportësh Skënderbeu për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhërin nr. 1, datë 29.12.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit, i përbërë nga z. Y.B , kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E.T dhe z. J. Ç . Në datën 05.01.2023, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbali mbi përfundimin e procesit të inventarizimit. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi. z. Y.B , znj. E.T dhe z. J. Ç në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit.

b. Për vitin 2022, znj. Ç.Ç Drejtor i Qendrës Ditore të Zhvillimit për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhërin nr. 92, datë 31.12.2021, për krijimin e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve i përbërë nga znj. E.P kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. P.SH , znj. A.Z , znj. E.T .

Për sa trajtuar më sipër, komisioni i vlerësimit është i njëjtë me atë të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Ç.Ç Drejtor i Qendrës Ditore të Zhvillimit në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. P.SH , znj. A.Z , znj. E.T në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit.

c. Për vitin 2022, znj. D.L Drejtor i Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhërin nr. 78/1, datë 27.10.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit, i përbërë nga znj. P.M kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. B.F , znj. M.L , znj. M.P , znj. M.G . Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 25.11.2022, komisioni i inventarizimit ka hartuar raportin për inventarin fizik ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive që i përkasin llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 46,714 lekë. Me Urdhërin nr. 79/2, datë 28.10.2022, të znj. D.L Drejtorit i QRZH është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve i përbërë nga znj. P.M kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E.XH , z. D.S . Komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit është i përbërë nga tre anëtarë dhe jo nga pesë anëtarë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. D.L Drejtor i Qendrës Rezidenciale e Zhvillimit në cilësinë e nëpunësit autorizues.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 85, gërma “c”, pika 96, gërma “c” dhe pika 100.

Ndikimi/Efekti: Moshartimi i raportit të inventarit fizik pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit, ndikon në mos marrjen e informacionit e duhur dhe të saktë nga strukturat drejtuese të BASHKISË KORÇË në lidhje me gjendjen e aktiveve të institucionit.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Situata: a. Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*” dhe pasqyrës nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, pjesë e pasqyrave financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 11,899,991 lekë që i përkasin llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, në vlerën 2,098,296 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, në vlerën 9,791,595 lekë për të cilat nuk është kryer procedurë asgjësimi, për më tepër nga NSHMAÇ nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre. Duke u bazuar në dokumentacionin mbi realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të NSHMAÇ, nga znj. J.T me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës është mbajtur relacioni mbi vlerësimin për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra sipas inventarit fizik të vitit 2022, sipas shkresës nr. 366 prot., datë 14.11.2022, miratuar nga z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ. Me shkresën nr. 366 prot., datë 14.11.2022, NSHMAÇ ka informuar Këshillin Bashkiak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit. Vetëm dy shkresat e sipërpërmendura janë i vetmi dokumentacion i cili disponon NSHMAÇ në lidhje me procesin e asgjësimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Y.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. J.T me detyrë Përgjegjës i Sektorit të FI ncës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

b. Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*” dhe pasqyrës nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*” pjesë e pasqyrave financiare të Qendrës Rezidenciale e Zhvillimit u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 46,714 lekë, e cila i përket llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”. Kjo situatë nuk pasqyrohet në procesin e inventarizimit të aktiveve të institucionit apo të jetë pjesë e informacionit të dërguar pranë Këshillit Bashkiak pas përfundimit të procesit të inventarizimit, por thjesht ka mbetur në fazën e ngritjes së komisionit të asgjësimit sipas Urdhërit nr. 79/2, datë 28.10.2022, të titullarit të institucionit. Nga auditimi

i procesit të inventarizimit u konstatua se, nga QRZH për vlerën 46,714 lekë të nxjerrë jashtë përdorimit, nuk është kryer një procedurë vlerësimi dhe asgjësimi pra nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. D.L Drejtor i Qendrës Rezidenciale e Zhvillimit në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. K.SH me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe znj. P.M , znj. E.XH , z. D.S në cilësinë e anëtarëve të komisionit për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, dat 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Ndikimi/Efekti: Nxjerrja e aktiveve jashtë përdorimit pa dokumentacion nuk krijon besueshmëri dhe vërtetësi mbi rakordimin gjendjes fizike me atë të pasqyruar në pasqyrat financiare.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u konstatua si më poshtë:

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të BASHKISË KORÇË (pasqyrat financiare të konsoliduara), janë paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” është paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Situata: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë e cila përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në vlerën 165,855,343 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 42,398,117 lekë.

Referuar shkresës nr. 580 prot., datë 24.01.2023, të dërguar pranë Drejtorisë së Financave Vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Buxhetit Publik, Ministrisë së FI ncave dhe Ekonomisë evidentohet akt-mbajtja e të ardhurave për vitin 2022, si më poshtë, në lekë:

Institucioni vendor	Entitet	Min	Kapitulli	6009999	6029999	2319999	6999999	Totali
Bashkia Korçë	122	00	01	26,316,579.80	11,655,826.49	22,834,379	5,645,000	66,470,785.29
Bashkia Korçë	122	00	05	422,283	2,888,439.03	85,833,113.05	34,323,992.98	123,467,628.06
Bashkia Korçë	122	00	06		2,614,342	1,265,476	504,000	4,383,818
Totali				26,738,862.80	17,168,607.52	109,941,968.05	40,472,792.98	194,322,231.35

Llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” është nënvlerësuar në vlerën 28,466,888.35 lekë.

Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet në datën 01.01.2022, në vlerën 243,257,382 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 165,855,343 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 42,398,117 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 79,782,715 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, pika 49 dhe pika 50.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar”.

Shkaku: Moszbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, janë paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2022, paraqiten në vlerën 235,517,633 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 78,097,731 lekë, llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 147,617,815 lekë dhe llogaria 34 “Produkte” në vlerën 9,802,087 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 36,718,839 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”, e cila paraqitet në vlerën 36,718,839 lekë.

- **Llogaria 31 “Materiale”,** ka vlerën 78,097,731 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme në lekë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	51,167,054
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022	301,693,265
Dalje nga magazinë gjatë vitit 2022	274,762,589
Gjendja në 31.12.2022	78,097,731

- **Llogaria 32 “Inventar i imët”,** ka vlerën 147,617,815 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme në lekë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	137,107,283
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022	26,770,063
Dalje nga magazinë gjatë vitit 2022	16,259,531
Gjendja në 31.12.2022	147,617,815

- **Llogaria 34 “Produkte”,** ka vlerën 9,802,087 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme në lekë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	10,524,457
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022	9,977,050
Dalje nga magazinë gjatë vitit 2022	10,699,420
Gjendja në 31.12.2022	9,802,087

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” janë paraqitur në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në datën 01.01.2022, në vlerën 650,602,269 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 717,258,724 lekë me një rritje në vlerën 66,656,455 lekë. Në mënyrë analitike të dhënat paraqiten si më poshtë në lekë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2022	650,602,269
Shtesa (K)	217,145,311
Pakësime (D)	150,488,856
Gjendja debitore në 31.12.2022	717,258,724

Përbërja analitike e llogarisë së mësipërme është paraqitur në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 66,171,637 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “FI ncim i pritshëm nga buxheti” e cila paraqitet në vlerën 66,171,637 lekë, veprime këto në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 5,

datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, seksioni 3.3, pika 59, gërma “a”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”	
Çelje e vitit 2022	58,970,282
Shtesa (K)	66,171,637
Pakësime (D)	58,970,282
Gjendja debitore në 31.12.2022	66,171,637

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi u konstatua se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 0 lekë kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t’u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFATGJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” & 230-231 “Investimet” janë paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 23,374,767 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,645,506 lekë, pakësime në vlerën 17,800,085 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 30,136,793 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 11,560,758 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licensa e të tjera të ngjashme”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 155,210 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 870,000 lekë, pakësime në vlerën 182,600 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 54,375 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 815,625 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 3,242,981,108 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 4,062,487 lekë dhe pakësime në vlerën 1,371,549,904 lekë, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 1,875,493,691 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 93,049,280 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 5,104,270 lekë dhe pakësime në vlerën 3,989,040 lekë, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 94,164,510 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 3,620,269,076 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 305,553,120 lekë, pakësime në vlerën 93,522,455 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 906,117,964 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 3,654,761,761 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 3,673,687,367 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,433,339,513 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,125,961,531 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 4,852,119,017 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 109,940,728 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 66,278,907 lekë, pakësime në vlerën 58,644,350 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 221,397,497 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 107,513,343 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 86,333,445 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 29,692,888 lekë, pakësime në vlerën 9,064,244 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 152,771,923 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 87,768,958 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 114,179,988 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 34,601,110 lekë, pakësime në vlerën 20,100,081 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 211,370,601 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogaria paraqitet në vlerën 114,879,215 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Situata: a. Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë (400,000 lekë NjA Drenovë + 529,300 lekë NjA Mollaj + 100,000 lekë NjA Bulgarec + 137,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Drenovë, Mollaj, Bulgarec dhe Voskop e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë (59,289,103 lekë NjA Drenovë + 111,081,721 lekë NjA Mollaj + 24,298,721 lekë NjA Vithkuq + 12,667,671 lekë NjA Lekas + 30,703,530 lekë NjA Voskopojë + 75,177,420 lekë NjA Voskop + 101,161,565 lekë NjA Bulgarec), e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Lekas, Voskopojë, Voskop dhe Bulgarec e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

c. Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë (128,064,232 lekë NjA Drenovë + 172,096,034 lekë NjA Mollaj + 97,316,422 lekë NjA Vithkuq + 6,235,020 lekë NjA Lekas + 70,267,947 lekë NjA Voskopojë + 83,147,853 lekë NjA Voskop + 210,558,456 lekë NjA Bulgarec) e paanalizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Lekas, Voskopojë dhe Voskop e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

d. Në gjendjen e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë (2,988,000 lekë NjA Drenovë + 2,565,400 lekë NjA Mollaj + 480,000 lekë NjA Voskopojë + 2,800,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave Drenovë, Mollaj, Voskopojë dhe Voskop paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekt: Pasqyrim jo i saktë i llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” dhe llogarisë 215 “*Mjete transporti*”.

Shkaku: Moszbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

➤ Auditim mbi administrimin e aseteve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Korçë ka në pronësi në total 1,549 prona dhe 193 prona në përdorim. Nga pronat në pronësi të transferuara, 246 janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim, 7 janë të pajisura me çertifikatë pronësie si më poshtë:

- Me VKM nr. 1532, datë 19.11.2008, “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, të BASHKISË KORÇË të Qarkut Korçë*”, janë transferuar 739 prona, nga të cilat 735 prona në pronësi dhe 4 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 184 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 551 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 276, datë 18.03.2009, “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Qendër Bulgarec, të Qarkut të Korçës*”, janë transferuar 197 prona, nga të cilat 170 prona në pronësi dhe 27 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 7 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 163 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 742 datë, datë 08.09.2010, “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Drenovë të Qarkut të Korçës*”, janë transferuar 160 prona, nga të cilat 84 prona në pronësi dhe 76 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 14 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 70 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në

përdorim 7 prona janë të pajisura me çertifikatë pronësie dhe 69 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 1057, datë 16.07.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Mollaj të Qarkut të Korçës”, janë transferuar 152 prona, nga të cilat 137 prona në pronësi dhe 15 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 5 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 132 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 455, datë 06.05.2009, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Vithkuq të Qarkut të Korçës”, janë transferuar 212 prona, nga të cilat 184 prona në pronësi dhe 28 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 28 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 156 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 1641, datë 17.12.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Voskop të Qarkut të Korçës”, janë transferuar 67 prona, nga të cilat 60 prona në pronësi dhe 7 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 2 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 58 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 1155, datë 13.08.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Voskopojë, të Qarkut të Korçës”, janë transferuar 42 prona, nga të cilat 34 prona në pronësi dhe 8 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara, 6 prona në pronësi janë pajisur me çertifikatë pronësie dhe 28 prona nuk janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa nga pronat në përdorim nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

- Me VKM nr. 699, datë 21.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lekas të Qarkut të Korçës”, janë transferuar 173 prona, nga të cilat 145 prona në pronësi dhe 28 prona në përdorim. Nga pronat e transferuara nuk është e pajisur asnjë me çertifikatë pronësie, si dhe nga pronat në përdorim nuk është pajisur asnjë me çertifikatë pronësie.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të BASHKISË KORÇË dhe Njësi Administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Voskop, Voskopojë dhe Lekas, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37.

b. Në total në pronësi të BASHKISË KORÇË janë 1,549 pasuri të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura nga të cilat vetëm për 246 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Korçë nga 451 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 181 prej tyre posedon titull pronësie, si më poshtë:

Lekë

Emërtimi i Llogarisë	Nr. i pronave në regjistër	Nga këto	
		Me çertifikatë pronësie	Pa çertifikatë pronësie
210 “Toka, troje, terrene”,	96	88	8
212 “Ndërtesa e konstruksione”	136	58	78
213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”	219	35	184
Totali	451	181	270

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

Nga Bashkia Korçë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” (nuk disponohet asnjë çertifikatë pronësie), llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Kriteri: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrat financiare paraqesin informacion të gabuar për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Shkaku: Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë që paraqitet në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” mos pasqyrimin e vlerave të tyre në aktivin e pasqyrave financiare. Mosmarrja e masave për regjistrimin e pasurive të kësaj llogarie në ASHK.

Rëndësia: E lartë.

4. Invenstimet

Situata: Llogaria 231 “Për aktivet afatgjata materiale” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 96,969,263 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 49,695,427 lekë dhe pakësime në vlerën 90,624,092 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 56,040,598 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2022		96,969,263
Shtesa (K)		49,695,427
Pakësime (D)		90,624,092
Gjendja debitoare në 31.12.2022		56,040,598

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” në vlerën 56,040,598 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve”, e cila paraqitet në vlerën 14,319,706 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 72,152,293 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Aneksi 1, germa “c”.

Ndikimi/Efekti: Moskuadrim i llogariv kontabile.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e BASHKISË KORÇË në datën 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e

punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Situata: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 2,350,476 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 13,991,302 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,926,994 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 9,813,633 lekë ku totali shkon në vlerën 50,421,514 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në vlerën 66,171,637 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Aneksi nr. 1.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Situata: a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, (paraqitur në Aneksin PF17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit) në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 4,770,920 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 22,339,109 lekë dhe pakësime në vlerën 4,770,920 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë e cila i përket faturave të palikuiduara nga Bashkia Korçë. Kjo vlerë kryesisht përbëhet nga shpenzime për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., si rezultat i angazhimeve të marra mbi bazën e burimit të fl ncimit nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat deri në datën 01.01.2022, janë në vlerën 33,876,466 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,554,125 lekë dhe pakësim në vlerën 33,616,958 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 9,813,633 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50 dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, denatyrim i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 47,671,946 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, në lekë.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2022	42,252,813
Shtesa (K)	47,671,946
Pakësime (D)	42,252,813
Gjendja debitore në 31.12.2022	47,671,946

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 2,350,476 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime shtetit për muajin dhjetor, në lekë.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Celje e vitit 2022	2,250,530
Shtesa (K)	2,350,476
Pakësime (D)	2,250,530
Gjendja debitore në 31.12.2022	2,350,476

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit janar të vitit 2023 u konstatua se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
7	06.01.2023	879,125
17	09.01.2023	37,501
30	19.01.2023	11,830
121	14.02.2023	3,817
Totali Bashkia Korçë		932,273
1	09.01.2023	82,391
2	10.01.2023	21,504
3	10.01.2023	804,771
Totali NSHMAÇ		908,666
03	09.01.2023	259,462
Totali NSHP		259,462
1	9.1.2023	59,888
Totali QAK		59,888
4	09.01.2023	22,637
Totali Klubi Shumësportësh		22,637
4	09.01.2023	86,720
Totali QRZH		86,720
3	08.01.2023	52,549
5	09.01.2023	4,935
Totali Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla”		57,484
3	09.01.2023	20,106
8	13.01.2023	3,240
Totali QDZH		23,346
Grand total		2,350,476

Burimi: *Bashkia Korçë.*

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** dhe **Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 13,991,302 lekë dhe 1,926,994 lekë (Aneksi PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 9,813,633 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Korçë (Aneksi PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Lekë

Institucionet	Vlera e 5% të garancive të punimeve
Bashkia Korçë	36,847,830
Ish-Komunat	652,948
NSHP	432,864
NSHMAÇ	4,464,475
Totali	42,398,117

Burimi: *Bashkia Korçë.*

Lekë

Institucionet	Firma e mbyllur	Mungesë dokumentacioni	OE nuk janë paraqitur	Pa plotësuar punimet sipas kontratës	Totali
Bashkia Korçë	353,533	669,918	0	0	1,023,451
Ish-Komunat	0	652,948	0	0	652,948

NSHP	0	0	0	200,181	200181
NSHMAÇ	0	0	162,941	0	162941
Totali	353,533	1,322,866	162,941	200,181	2,039,521

Burimi: Bashkia Korçë.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura për objekte të përfunduara dhe të marra në dorrëzim nga Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes janë ngurtësuar fonde në vlerën totale 2,039,521 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 2,039,521 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Ndikimi/Efekt: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 10,442,362 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Të tjera pasive afatshkurtra

- **Llogaria 470 “Llogari në pritje të ardhura për t’u marrë”**, sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në datën 01.01.2022, paraqitet në vlerën 641,724,899 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 706,757,862 lekë.

II. Pasivet Afat Gjata

- **Llogaria 16,17,18 “Huatë Afat Gjata”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 51,327,411. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Situata: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 7,653,040,409 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 1,881,147,211 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 36,718,839 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 1,540,850,382 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 505,191,521 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 7,524,864,556 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë është paraqitur në Aneksin PF22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, pika 17.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 416,077,483 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 404,818,001 lekë ose me një pakësim në vlerën 11,259,482 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet është paraqitur në Aneksin PF23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 261,099,548 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 265,589,614 lekë ose me rritje në vlerën 4,490,066 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore është paraqitur në Aneksin PF24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Të ardhura të tjera:

- **Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 2,421,193,947 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,639,579,702 lekë ose me rritje në vlerën 218,385,755 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente është paraqitur në Aneksin PF25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Të ardhura të tjera:

- **Llogaria “Të ardhura të tjera”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 100,173,628 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 144,517,314 lekë ose me rritje në vlerën 44,343,686 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente është paraqitur në Aneksin PF26, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 637,339,232 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 603,821,737 lekë ose me një rritje në vlerën 33,517,495 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 106,760,679 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 100,275,598 lekë ose me një rritje në vlerën 6,485,081 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Korçë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është paraqitur në Aneksin PF27, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2021, ka qenë në vlerën 599,547,558 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 633,059,092 lekë ose me një pakësim në vlerën 33,511,534 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Korçë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Për vitin 2022, Bashkia Korçë ka pasur subvencione në vlerën 9,998,610 lekë për diferencë çmimi.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,094,700,135 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 663,337,361 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin. (Aneksi PF29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Shpenzimet financiare

Gjendja e llogarisë së fondeve **65 “Shpenzime financiare”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,502,148 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin. (Aneksi PF30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 3,454,504,630 lekë dhe totali shpenzimeve është 3,288,649,287 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 165,855,343 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” në vlerën 165,855,343 lekë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.F. Kryetar i BASHKISË KORÇË në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. V.Z. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë u konstatua se, pjesë e zërave të projekteve artistike është edhe zëri honorare të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit (nuk janë prokuruar së bashku me zërat e tjerë të projekteve artistike), prashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe

shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”“, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Analiza e detajuar paraqitet më poshtë, në lekë:

Nr.	Qendra e Artit dhe Kulturës	Plan	Fakt
1	Qendra e Kulturës “Vangjush Mio”	11,220,000	11,020,000
2	Teatri “Andon Zako Çajupi”	7,820,000	7,820,000
3	Biblioteka “Thimi Mitko”	310,000	310,000
Totali		19,350,000	19,150,000

Burimi: Bashkia Korçë.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 6, datë 27.01.2022, të Këshillit Bashkiak “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2022, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”“. Nga Bashkia Korçë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total për Qendrën e Kulturës “Vangjush Mio”, Teatrin “Andon Zako Çajupi” dhe Bibliotekën “Thimi Mitko” pjesë të Qendrës së Artit dhe Kulturës është likuiduar shuma 19,150,000 lekë. Vlera 19,150,000 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligji nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”“, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Ndikimi/Efekt: Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 1,778,500 lekë.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F , Kryetar i BASHKISË KORÇË dhe me shkresën nr. 28 prot., datë 26.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/8 prot., datë 29.02.2024, znj. Z.B. (K.) ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prendimi i subjektit:

“.....Në mënyrë të përmbledhur janë evidentuar argumente në lidhje me bazat ligjore si Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2024, Ligji nr. 35, datë 31.03.2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Si dhe Ligjin nr. 25/2014, Kreu IV, neni 26 ku citohet se: “Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike dhe kulturore”, i këtij ligji pika 1, 2 nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik, (megjithse flitet për pushtetin qendror).....”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga Ju se për mos prokurimin e fondeve publike për zërin honorare si pjesë e projekteve artistike, Bashkia Korçë është bazuar në VKM nr. 1173, datë 06.11.2009, “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike të pavaruara”, ky argument nuk qëndron për arsye se nuk citoni në cilin nen apo pikë të VKM trajtohet kjo situatë. Gjithashtu këto fonde duhen prokuruar në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”“, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

Për vitin 2022, numri i punonjësve të BASHKISË KORÇË dhe Ndërmarrjeve të Varësisë së bashku me ndryshimet përkatëse të strukturës organizative janë miratuar me miratuar me Urdhërin nr. 46, datë 01.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për miratimin e strukturës së Administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”, Urdhërin nr. 1111, datë 19.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së Administratës së Bashkisë Korçë””, Urdhërin nr. 1121, datë 21.10.2022, “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 47, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në varësi të BASHKISË KORÇË për vitin 2022”” dhe Urdhërin nr. 1165, datë 02.11.2022, “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 47, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës së Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në varësi të BASHKISË KORÇË për vitin 2022””.

Situata: Nëpunësit e BASHKISË KORÇË i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 2.5.1., “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brëndshëm i njësisë)”, seksioni “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore”.

Kriteri: Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 2.5.1., “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brëndshëm i njësisë)”, seksioni “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore”.

Ndikimi/Efekti: Situatë jo transparente mbi procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Shkaku: Mos implementim i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet më poshtë:

Lekë

Nr.	Institucioni	Plan	Fakt
1	Bashkia Korçë	364	252
2	NSHP	450	385
3	NSHMAÇ	397	381
4	QAK	51	46
5	Klubi shumësportësh	14	14
6	Lulet e Vogla	7	3
Totali		1,283	1,081

Burimi: Bashkia Korçë.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura u konstatua se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 9.8% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 90.2%. Në total realizimi i strukturës është në masën 84.2%. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të BASHKISË KORÇË u konstatua se në total struktura është e përbërë nga 107 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbim Civil dhe 974 punonjës me Kod Pune.

Listëpagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listëprezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë, ku janë shkrehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

Rekomandim 8.1, 8.2

Për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit është kryer procesi i vlerësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, si dhe procedura e asgjesimit të tyre sipas Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 73-74 dhe pika 81-110. Qendra Ditore e Zhvillimit mori masa të menjëhershme për hartimin e raportit për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes se tyre gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacioni e inventarizimit për vitin 2023. Gjithashtu, ka marrë masë për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve në përputhje me dispozitat ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana Juaj për zbatimin e problematikave të evidentuara nga grupi i auditimit në lidhje me procesin e inventarizimit, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion vërtetues dhe justifikues në observacion. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

2. Pretendimi i subjektit:

Sipas rekomandimit 10.1 ju bëjmë me dije se:

Vlera 28,466,888.35 lekë është e përbërë si tabela më poshtë:

<i>Ndryshimi i gjendjes së inventarit, (llogaria 63)</i>	<i>-36,718,839</i>
<i>Detyrime të konstatuara + detyrime të prapambetura të llogarive 401, 467</i>	<i>19,893,374</i>
<i>Llogaria 105 (fonde buxhetore të papërdorura për investime që trashëgohen në vitin pasardhës</i>	<i>41,222,355</i>
<i>Llogaria 12 (rezultat i mbartur)</i>	<i>4,070,000</i>
<i>Totali</i>	<i>28,466,888</i>

Në faqen 51 të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, në pikën “e” theksohet se:

Debitohet llogaria 85 (Rezultati i ushtrimit) për vlerën e llogarisë 63 (Ndryshimi i gjendjeve të inventarit) dhe kreditohet llogaria 63 (Ndryshimi gjendjeve të inventarit) po për këtë vlerë. Në rastin tonë llogaria 63 është në vlerën -36,718,839 lekë, si në tabelën e mësipërme. Vlera 19,893,374 lekë pasqyron detyrimet e konstatuara dhe të prapambetura të cilat pasqyrohen në llogaritë respektive 401, 467 sipas llojit të detyrimit respektiv në pasivet e pasqyrës së pozicionit financiar dhe në llogaritë respektive të klasës 6 në pasqyrën e përformancës, për llogaritë 401, 467 ndërsa për llogarinë 404 vlera e detyrimeve të konstatuara dhe të prapambetura paraqiten në llogarinë 23, Udhëzimi nr. 5, faqe 30 “Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve” pika “c” Konstatohen shpenzimet korrente dhe kapitale. Detyrimet e konstatuara dhe të prapambetura të pasqyruara në llogaritë 401, 467 në pasivet e pasqyrës së pozicionit financiar shkarkohen në llogarinë 85 (Rezultati i ushtrimit). Vlera 41,222,355 lekë përfaqëson fondet buxhetore për investime të cilat nuk janë përdorur gjatë vitit ushtrimor dhe trashëgohen në vitin pasardhës, të cilat nuk mund të përfshihen në llogarinë 85 (Rezultati i ushtrimit), pasi kjo llogari është diferencë midis klasës 7 (Të ardhura) dhe

klasës 6 (Shpenzime) ndërsa shpenzimet për investime kryhen përmes llogarisë 23 (Shpenzime për investime kapitale), por këto fonde janë të pasqyruara në aktin e anulimit dhe zbriten për të nxjerrë vlerën e llogarisë 85 (Rezultati i ushtrimit). Vlera 4,070,000 lekë përfaqëson llogarinë 85 (Rezultati i ushtrimit) i vitit ushtrimor 2021 i papërdorur gjatë vitit ushtrimor 2023 i cili, në zbatim të Udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022, faqe 13 “Për kalimin e rezultatit ushtrimor në rezultat të mbartur”, kalon në kredi të llogarisë 12 (Rezultat i mbartur), por kjo vlerë figuron në aktin e anulimit si fond që trashëgohet në të ardhmen, për këtë arsye me veprim kontabël është shkarkuar nga llogaria 85 (Rezultati i ushtrimit) dhe është ngarkuar te llogaria 12 (Rezultat i mbartur). Pra për arsyet e mësipërme argumentojmë se të gjitha veprimet kontabël për vlerësimin e kësaj llogarie janë kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018”. Më poshtë paraqesim vlerat përbërëse të llogarisë 85 (Rezultati i mbartur) për çdo njësi shpenzuese:

Llogaria 85	Mbështetja financiare sipas VKM 382	Vlera e akt anulimit për kl.6	Ndyshimi i gjendjes së inventarit	Letra me vlerë në arkë 532 (letra me vlerë në arkë)	Detyrime llogaria 401-467	Totali
Bashkia Korçë	32,745,363	120,303,393	(9,384,792)	10,561,500	3,253,236	169,741,812
N.SH.M.A.C	9,370,463	14,675,353	5,335,066	-	1,946,586	16,764,164
KLSH Sp.	260,000	1,855,902	(1,310,288)	-	20,764	3,405,426
NSHP	7,400,000	10,993,913	(33,129,156)	747,600	14,225,252	38,045,417
QAK	890,000	831,466	(668,603)	85,701	344,80	2,130,965
Shtëpia e Foshnjes	280,000	369,849	638,884	-	-	10,965
QDZH	130,000	-	115,755	-	-	14,245
QRZH	240,001	-	1,684,295	-	102,731	(1,547,025)
Totali	51,315,827	149,029,876	(36,718,839)	11,394,801	19,893,374	228,565,969

Llogaria 85 “Rezultati ushtrimor”, përfaqëson diferencën e klasës 7 që janë të ardhurat dhe klasës 6 që janë shpenzimet e institucionit, diferencë e cila është në vlerën 165,855,343 lekë dhe diferenca e llogarisë 85 “Rezultati ushtrimor” në vlerën 62,710,627 lekë, përbëhet nga vlera 51,315,827 lekë që është vlera e mbështetjes financiare sipas VKM nr. 898, datë 29.12.2022, “Mbështetje financiare e menjëhershme e punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”, ku shpenzimet janë konstatuar në llogarinë në klasën 6 dhe në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, pasi transferimi i fondit është kryer me Urdhër nr. 1, datë 04.01.2023, për “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”. Pra kjo vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të pasqyrohet në llogaritë e klasës 4 pasi ato nuk përfaqësonin detyrime të institucionit ndaj personelit, për këtë arsye ky fond është pasqyruar te llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në pasqyrën e pozicionit financiar në bilancin e vitit 2022. Vlera 11,394,800 lekë përfaqëson letrat me vlerë në arkë të cilat në aktiv të bilancit pasqyrohen në llogarinë 532 (Vlera të tjera), llogari e cila bën pjesë në rubrikën mjete monetare. Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” përmban aktin e anulimit për klasën 6 (Shpenzime korrente) në vlerën 149,029,876 lekë, vlerën 41,222,355 lekë që përfaqëson aktin e anulimit për klasën 23 (Shpenzime për investime kapitale), vlerën 4,070,000 lekë e cila figuron në aktin e anulimit por është pasqyruar në llogarinë 12 (Rezultat i mbartur) pasi është vlerë e llogarisë 85 (Rezultat i ushtrimit) i vitit paraardhës i papërdorur, vlerën 51,315,827 lekë mbështetja financiare dhe vlerën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” 42,398,117 lekë. Bashkëngjitur pasqyrave financiare janë akti i anulimit ku të gjitha fondet janë të analizuara sipas emërimit, numër të llogarisë në shtatëshifror, si dhe akti i rakordimit të llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” e cila është e detajuar sipas objekteve dhe vitit përkatës.

Llogaria 520 viti 2022	
466	42,398,117
105	41,222,355
85	200,345,703
12	4,070,000
Totali	288,036,175

Konkretisht akti i anulimit përbëhet nga vlera e aktit të anulimit klasa 6 “Shpenzime korrente” 149,029,876 lekë + vlera e llogarisë 105 “Grande kapitale të brendshme”, 41,222,355 lekë + vlera e llogarisë 12 “Rezultate të mbartura” 4,070,000 lekë = 194,322,231 lekë.

Funksionimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” (Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022) faqe 33, 34

Në kredi të kësaj llogarie përfaqësohen të hyrat ose të ardhurat që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do tu kthehen nga kjo llogari të tretëve. Për të gjitha llojet e hyrjeve dhe daljeve në llogarinë e mjeteve në ruajtje, llogaria 466 me analizat përkatëse funksionon:

a) Kur arkëtohen, hyjnë në institucion mjete në ruajtje:

-Debitohen llogaritë e klasës 5 apo të drejtave të institucionit;

-Kreditohet llogaria 466 për të hyrat përkatëse

b) Kur paguhen nga institucioni mjete në ruajtje për llogari të përfituesve:

-Debitohen llogaritë 466

-Kreditohen llogaritë financiare të kasës 5, 520, 512, 531 sipas rastit specifik.

Duke analizuar veprimet kontabël të renditura sipas udhëzimit për rrjedhojë vlera e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" që ndodhet në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar, do të balancohet në llogarinë 520 "Disponibilitete në thesar" e cila ndodhet në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Llogaria 520 "Disponibilitet në thesar" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 165,855,343 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 42,398,117 lekë. Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" është paraqitur në bilanc në vlerën 165,855,343 lekë. Sipas observacionit të observacionit të mësipërm kjo llogari është paraqitur në vlerën 228,565,969 lekë. Vlera e raportuar në bilanc nuk është e njëjtë me vlerën e observuar. Për këtë arsye është lënë rekomandimi i mësipërm për të pasqyruar në mënyrë të saktë në pasqyrat financiare llogarinë 85 "Rezultat i vitit ushtrimor". **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

3. Pretendimi i subjektit:

Rekomandim 13.1

Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" është në bilanc në vlerën 56,040,598 lekë e cila përbëhet nga investimet në proces që janë në vlerën 30,929,938 lekë me burim financimi nga fonde buxhetore të cilat paraqiten në llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme", në vlerën 14,319,709 lekë të cilat janë investime në proces me burim financimi të ardhurat e institucionit që pasqyrohen në llogarinë 115 "Nga fondet e veta për investime" si dhe nga vlera 10,790,949 lekë e cila përfaqëson detyrimet e konstatuara shpenzime për investime të cilat sipas Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrohen në llogarinë 404 "Furnitorë për investime" ku në bilanc paraqitet në pasiv llogaria 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to" konkretisht i shprehur në Udhëzimi nr. 5, dt.21.02.2022, në faqe 30, seksioni "Detyrimet" ku theksohet se kreditohet llogaria 404 "Furnitorë për investime" në debi të llogarisë 23 "Investime".

Llogaria 231 përmbledhëse	
105	30,929,938
115	14,319,709
404	10,790,949
	56,040,596

Gjithashtu ju bëjmë me dije se llogaria 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, faqe 11, 12 përfaqëson grandet kapitale dhe kontribute të të tretëve për investime në debitin e llogarisë 476 "Të ardhura të caktuara për tu përdorur", kur këto fonde tranzitohen nëpërmjet kësaj llogarie, ose në debit të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" për grande kapitale të brendshme. Pra kjo llogari paraqitet në pasiv të bilancit për vlerën e investimeve në proces me burim financimi fonde buxhetore si dhe grande ose fonde të tjera buxhetore të papërdorura e të trashëgueshme në periudhën e ardhshme ushtrimore pika "a", konkretisht vlera 41,222,355 lekë përfaqëson këto fonde buxhetore të trashëgueshme për vitin 2023 të cilat nuk mund të pasqyrohen në llogarinë 23 (Shpenzime për investime kapitale), pasi janë fonde të përealizuara.

1	Rik. dhe shtese shkolla shk. e mesme "Themistokli Gërmenji"	30,583,505
2	Pyllezime Voskopoje	13,427,964
	Totali investime në proces Bashkia	44,011,469
	Investim ne proces Klubi Shumesportesh	1,238,178
	Totali investime në proces Bashkia+Institucioneve të varësisë	45,249,647
10	"Përmirësim i banesave ekzistuese"	1,224,838

	Mbikqyrje: Punime shitesë tek tregu i gjësë së gjallë	505,243
	Mbikqyrje: Punime ndërtimore në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	93,156
	Kolaudim: Punime ndërtimore në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	11,179
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	560,000
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	20,000
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	1,589,853
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	1,093,680
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	792,000
	Projeksion grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	144,000
	Mbikqyrje: Ndërhyrje për shmangien e përmblytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë	1,280,574
	Rehabilitim i rrjetit të kanalit ujëtës Flog nga burimi i Toplecit	2,055,158
	Mbikqyrje: Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujëtës Flog nga burimi I toplecit	68,995
	Kolaudim: Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujëtës Flog nga burimi I toplecit	10,349
	Pagesa e TVSh për Projektin AuthentiKK (blerje paisje)	58,400
	Pagesa e TVSh për Projektin AuthentiKK (blerje paisje)	19,620
	Totali i detyrimeve të konstatuara Bashkia	9,527,045
	Terren sportiv të shkollë "Isuf Dalipi	1,246,920
	Mbikqyrje kopesht komunitar shkollë "Nuci Naci"	15,100
	Kolaudim kopesht komunitar shkollë "Nuci Naci"	1,884
	Totali i detyrimeve të konstatuara institucionet e varesise	1,263,904
11	Totali detyrimeve të konstatuara Bashkia+Institucioneve të varësisë	10,790,949
	Totali	56,040,596

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në observacionin e mësipërm është përfshirë llogaria 404 si kundërparti të llogarisë 231 "Për aktivet afatgjata materiale". Llogaria 404 është kundërparti e klasës 2 të aktiveve afatgjata materiale të përfunduara. Për më tepër detyrimet regjistrohen në llogarinë 404 kur aktivi është kontabilizuar në Klasën 2 dhe është marrë në dorëzim ndërkohë që konkret në klasën 23 regjistrohen investimet që janë në proces dhe nuk janë marrë në dorëzim me kondraparti llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" dhe 115 "Nga fondet e veta për investime". **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

4. Pretendimi i subjektit:

Rekomandim 14.1

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" kjo llogari shfaqet në aktiv të bilancit dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjeve të financimit për projekte të ndryshme.

Kjo nënkupton që në këtë llogari pasqyrohen vetëm detyrimet e konstatuara ose të prapambetura të cilat kanë si burim financimi fonde buxhetore siç konkretisht në bilanc janë pasqyruar vetëm detyrimet për paga dhe kontribute, përveç rastit kur detyrime të konstatuara dhe të prapambetura që i përkasin llogarive 401 (Furnitorë) ose 467 "Kreditorë të tjerë" të cilat kanë burim financimi fonde buxhetore si në rastin e vlerave të detajuara në tabelën e mëposhtme të cilat i përkasin bilancit të "Shtëpisë së Foshnjës", ndërsa detyrimet e konstatuara ose të prapambetura të cilat kanë si burim financimi të ardhurat e veta pasqyrohen si më poshtë në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, faqe 30 në rubrikën "Detyrimet" citoj: "Kreditohen llogaritë 401, 404, 467 etj., në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 "Shpenzime korrente" dhe llogarisë 23 "Investime" (në rastin e konstatimeve)". Veprimi kontabël i përshkruar në faqen 30: Konstatohen shpenzime korrente

-Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse)

-Kreditohet llogaria 401, 404, 467 etj., me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë.

Po të shohim tabelën më poshtë totali i llogarisë 4342 përmban vlerat e llogarive 42 "Detyrime ndaj personelit", 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", 435 "Sigurime shoqërore", dhe 436 "Sigurime shëndetsore" si dhe llogaria 401 "Furnitorë" dhe llogaria 467 "Kreditorë të tjerë", për vlerat që kanë si burim financimi fondet buxhetore, ndërsa detyrimet e konstatuara dhe të prapambetura të pasqyruara në llogarinë 401 ose 467 të cilat kanë burim financimi të ardhurat e institucionit shkarkohen në llogarinë 85 (Rezultati i ushtrimit). Si konkluzion veprimet kontabël nëpërmjet të cilave dalin vlerat përfundimtare në bilanc janë kryer në mbështetje të plotë të udhëzimit pa lejuar devijime.

Llog.4342	66,171,637	
42	47,671,946	
431	2,350,476	
435	13,991,302	
436	1,926,994	
401	115,809	Shtëpia e foshnjës
467	115,110	Shtëpia e foshnjës
	66,171,637	

Teksojmë se në llogarinë 4342 “Operacione me shteti (të drejta)” përfshihet vetëm llogaria 401 në vlerën 115,809 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 115,110 lekë të cilat janë vlera që i përkasin institucionit të varësisë “Shtëpia e Foshnjës” burim fl nçimi për të cilat janë fonde buxhetore.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është llogari rregulluese e klasës 4, e cila është gjithëpërfshirëse e cila kuadron me klasën 4. Llogaria 401 dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqesin informacion të saktë dhe të drejtë kontabël. Gjithashtu në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” regjistrohen të gjitha të drejtat që i kanë autoritetit si nga të ardhurat e veta dhe ato buxhetore. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

5. Pretendimi i subjektit:

Rekomandim 17.1

Sa i përket llogarisë 101 “fonde bazë” vlera në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar është 10,997,875,671 lekë, e detajuar si më poshtë:

	31.12.2021, 101+109	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2022
Llog. 101	11,168,175,358	1,606,751,891	1,781,273,332	10,997,875,670
201	-	-	-	-
202	57,852,130	1,645,506	17,800,085	41,697,551
203	182,600	870,000	182,600	870,000
210	3,242,981,108	4,062,487	1,371,549,904	1,875,493,691
211	93,049,280	5,104,270	3,989,040	94,164,510
212	4,348,221,760	305,553,120	93,522,455	4,560,252,425
213	4,544,741,034	1,433,339,513	-	5,978,080,547
214	321,903,582	66,278,907	58,644,350	329,538,139
215	219,912,236	29,692,888	9,064,244	240,540,880
216	-	-	-	-
217	-	-	-	-
218	311,748,787	34,601,110	20,100,081	326,249,816
24	-	-	-	-
28	-	-	-	-
209	(34,504,753)	(9,049,699)	(13,363,284)	(30,191,168)
219	(2,142,116,786)	(496,141,822)	(20,639,093)	(2,617,619,515)
31 (viti 2020)	58,807,227			51,167,054 (viti 2021)
32 (viti 2020)	134,679,998			137,107,283 (viti 2021)
34 (viti 2020)	10,717,155			10,524,457 (viti 2021)

Ju bëjmë me dije se në fund të vitit 2021, llogaria 101(fondet e veta) është në vlerën 7,653,040,409 dhe në llogarinë 109 (rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata) në vlerën 3,515,235,914 lekë, vlerë e cila përfaqëson rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale gjë e cila ka rritur vlerën e aktiveve të pasqyruara në klasën 2 që ndodhen në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. **Në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, faqe 22 “Për diferencat nga rivlerësimi i AAGJ, debitohet llogaria 20 ose 21 dhe kreditohet llogaria 109 (diferenca nga rivlerësimi) në rritje. Me veprim kontabël në vitin 2022 kjo vlerë e llogarisë 109 (diferenca nga rivlerësimi) në rritje i është kaluar llogarisë 101(fonde bazë).**

Sqarojmë se sipas shpjegimit të veprimeve kontabël për mbylljen e llogarive në **faqen 51** të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, përshkruhet si më poshtë:

c) Për tepricën debitore të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”

- Debitohet llogaria 1012 “Pakësime në fondin bazë”
- Kreditohet llogaria 8423 “Transferim i ndryshimit të gjendjeve të inventarit”

d) Për kalimin në llogarinë e rezultatit (mbyllje) e llogarisë 8423

- Teprica e llogarisë 8423 transferohet në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”

e) Për kalimin në llogarinë e rezultatit

- Debitohet llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”
- Kreditohet llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”

Pra ndryshimi i gjendjes së inventarit i cili është në vlerën -36,718,831 lekë pasqyrohet në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit” dhe jo te llogaria 101 “Fonde bazë”, këtu paraqitet vlera e klasës 3 të vitit paraardhës e pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Pretendimi i subjektit:

Në observacion nuk janë paraqitur argumenta për mos kuadrimin e vlerave që i përkasin llogarisë 101 “Fonde bazë”. Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me VKB-të përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, konstatoi si vijon:

Për vitin ushtrimor 2022, nga Bashkia Korçë dhe njësitë e saj shpenzuese, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 263 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 795,797,800 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 682,069,774 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 113,728,026 lekë pa TVSh ose 14.29%, të ndara sipas njësive shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Korçë:

Për vitin ushtrimor 2022, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 101 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 473,743,551 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 384,705,698 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 89,037,853 lekë pa TVSh ose 18.79%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	101	473,743,551	386,798,186
- Të hapura	8	389,297,074	316,455,290
- E hapur e thjeshtuar	21	60,884,226	49,049,756
- Me negociim pa shpallje	1	740,000	740,000
- Blerje biletash	1	166,667	41,300
- Të vogla	72	22,655,584	18,419,354
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	17	390,346,096	314,636,422
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	84	83,397,455	72,161,764

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:

Për vitin ushtrimor 2022, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 55 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 173,825,931 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 154,601,439 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 19,224,492 lekë pa TVSh ose 11.09%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	55	173,825,931	154,601,439
- Të hapura	4	121,666,666	106,864,877
- E hapur e thjeshtuar	8	34,384,997	32,979,032
- Të vogla	43	17,774,268	14,757,530
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	8	13,417,168	13,417,168
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	47	160,408,763	142,216,153

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes:

Për vitin ushtrimor 2022, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 45 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 131,131,347 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 125,495,663 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 19,224,492 lekë pa TVSh ose 4.29%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	45	131,131,347	125,495,663
- Të hapura	3	71,953,208	71,311,898
- E hapur e thjeshtuar	8	45,456,247	42,871,589
- Të vogla	34	13,721,892	11,312,177
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	2	11,249,999	10,696,539
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	42	92,554,873	87,477,725

Qendra e Arsimit dhe Kulturës:

Për vitin ushtrimor 2022, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 45 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 14,465,303 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 12,861,292 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 1,604,011 lekë pa TVSh ose 11.09%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	45	14,465,303	12,861,292
- Të vogla	45	14,465,303	12,861,292
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	45	14,465,303	12,861,292

Klubi Shumësportësh:

Për vitin ushtrimor 2022, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 18 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 2,631,662 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,313,194 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 318,468 lekë pa TVSh ose 12.1%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	18	2,631,662	2,313,194
- Të vogla	18	2,631,662	2,313,194
Sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	18	2,631,662	2,313,194

U audituan gjithsej 21 procedura prokurimi (të hapura dhe të hapura të thjeshtuara), me vlerë të fondit limit 629,482,501 lekë dhe vlerë të kontratave 507,674,978 lekë ose 79.1% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 84 OE/BOE, nga të cilat janë kualifikuar 60 OE/BOE. Me 1 OE kanë qenë gjithsej 4 procedura, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë gjithsej 5 procedura.

Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Korçë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë paraqitur në Aneksin P1-P5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Procedurat e audituara janë paraqitur në Aneksin P6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Situata: Në mënyrë të përmbledhur, shkeljet e konstatuara janë paraqitur më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 “Dokumentimi i procesit” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

- Në 20 procedura nga 21 të audituara, sipas pasqyrës së mëposhtme, me vlerë totale të fondit limit prej 578,382,286 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 473,293,971 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit, mungesa e personelit të kualifikuar/specialistë të fushës apo caktimi i vetëm një personi për hartimin e fondit limit. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës” dhe neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pikat 2 dhe 4, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.

Nr.	Nj. Shpenzuese	Prokurimi	OE Fitues	Fondi limit	Kontrata
1	Bashkia Korçë	Investime në infrastrukturën rrugore	A	108,333,333	73,074,183
2	Bashkia Korçë	Rikonstrukcion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji”	XH	82,477,111	62,971,393
3	Bashkia Korçë	Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i eficientësisë së energjisë)	BOE I, E & I	78,357,756	52,856,879
4	Bashkia Korçë	Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë	A	24,755,991	18,913,310
5	Bashkia Korçë	Blerje karburanti i ndarë në lote: loti 1 naftë, loti 2 benzinë	M	16,740,750	16,740,750
6	Bashkia Korçë	Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës	P	13,807,000	12,238,400
7	Bashkia Korçë	Përmirësimi i banesave ekzistuese	N	13,724,917	10,020,218
8	Bashkia Korçë	Punime ndërtimore në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes së infrastrukturës	S	6,619,660	5,592,960
9	NShMAÇ	Blerje Ushqime	G	27,326,475	27,321,400
10	NShMAÇ	Meremetimi i institucioneve arsimore	V.K	24,083,334	23,987,407
11	NShMAÇ	Naftë	K	20,543,400	20,543,400
12	NShMAÇ	Mobilje druri	SH	9,750,000	9,236,250
13	NShMAÇ	F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL	A.C	9,547,460	9,351,659
14	NShMAÇ	Gaz i lëngshëm	T	7,750,000	7,686,000
15	NShP	Materiale Ndërtimi	I	38,990,000	37,630,000
16	NShP	Blerje karburanti, loti 1 naftë, loti 2 benzinë	M	35,422,177	35,422,177
17	NShP	Asfalto beton e bitum për spërkatje	V	33,333,217	24,227,700
18	NShP	Prodhome betoni	A	10,495,000	9,585,000
19	NShP	Materiale elektrike	H	8,324,705	7,994,885
20	NShP	Maki	V	8,000,000	7,900,000
Totali				578,382,286	473,293,971

- Në 18 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 570,065,841 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 452,213,618 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës, për vlerën totale të kontraktuar 452,213,618 lekë pa TVSh;

Vendosja e kritereve të vlerësimit në mënyrë të paargumentuar apo të papërshtatshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, rrjedhimisht në mospërputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, shkel qëllimin dhe parimet kryesore të LPP, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, etj., konkretisht neni 1, “Objekti”; neni 2, “Qëllimi”; neni 3, “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”; neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”; neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”; pika 3; neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; etj.;

Nr.	Nj. Shpenzuese	Prokurimi	OE Fitues	Fondi limit	Kontrata
1	Bashkia Korçë	Investime në infrastrukturën rrugore	A	108,333,333	73,074,183
2	Bashkia Korçë	Rikonstrukcion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji	XH	82,477,111	62,971,393
3	Bashkia Korçë	Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i eficientës së energjisë)	BOE I, E & I	78,357,756	52,856,879
4	Bashkia Korçë	Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë	BOE N & N	51,100,215	34,381,007
5	Bashkia Korçë	Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë	A	24,755,991	18,913,310
6	Bashkia Korçë	Blerje karburanti i ndarë në lote: loti 1 naftë, loti 2 benzinë	M	16,740,750	16,740,750
7	Bashkia Korçë	Përmirësimi i banesave ekzistuese	N	13,724,917	10,020,218
8	NShMAÇ	Blerje Ushqime	G	27,326,475	27,321,400
9	NShMAÇ	Meremetimi i institucioneve arsimore	V.K	24,083,334	23,987,407
10	NShMAÇ	Naftë	K	20,543,400	20,543,400
11	NShMAÇ	Mobilje druri	SH	9,750,000	9,236,250
12	NShMAÇ	F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL	A.C	9,547,460	9,351,659
13	NShMAÇ	Gaz i lëngshëm	T	7,750,000	7,686,000
14	NShP	Blerje karburanti, loti 1 naftë, loti 2 benzinë	M	35,422,177	35,422,177
15	NShP	Asfalto beton e bitum për spërkatje	V	33,333,217	24,227,700
16	NShP	Prodhime betoni	A	10,495,000	9,585,000
17	NShP	Materiale elektrike	H	8,324,705	7,994,885
18	NShP	Maki	V	8,000,000	7,900,000
Totali				570,065,841	452,213,618

- Në 11 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 445,020,075 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 340,885,638 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Korçë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT.

Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjes”; neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”; neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67,

“Klasifikimi i ofertave”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2.

Nr.	Nj. Shpenzuese	Prokurimi	OE Fitues	Fondi limit	Kontrata
1	Bashkia Korçë	Investime në infrastrukturën rrugore	A	108,333,333	73,074,183
2	Bashkia Korçë	Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji	XH	82,477,111	62,971,393
3	Bashkia Korçë	Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i eficientës së energjisë)	BOE I, E & I	78,357,756	52,856,879
4	Bashkia Korçë	Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë	BOE N & N	51,100,215	34,381,007
5	Bashkia Korçë	Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë	A	24,755,991	18,913,310
6	NShMAÇ	Blerje Ushqime	G	27,326,475	27,321,400
7	NShMAÇ	Meremetimi i institucioneve arsimore	V.K	24,083,334	23,987,407
8	NShMAÇ	Naftë	K	20,543,400	20,543,400
9	NShMAÇ	F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL	A.C	9,547,460	9,351,659
10	NShP	Prodhime betoni	A	10,495,000	9,585,000
11	NShP	MakI	V	8,000,000	7,900,000
Totali				445,020,075	340,885,638

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën e fondit limit 629,482,501 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 507,674,978 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e fondit limit, aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi titullarin e institucionit dhe Njësie shpenzuese të Bashkisë Korçë, grupin e hartimit të preventivave/fondit limit, anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar, personel i Bashkisë Korçë, është paraqitur observacioni me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, i administruar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ...Në lidhje me procedurat e prokurimit në të cilat Autoriteti Kontraktor ka qenë Bashkia Korçë, ju sqarojmë se:

Së pari: Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për Lejen mjedisore ku citohet se “AK duhet të kërkojë vetëm “ e pajisur me dokumentacionin tekniko ligjor, sipas fushës të veprimtarisë”, pa hyrë në detaje të këtij dokumentacioni....” ju sqarojmë se:

Bazuar pikën 5 të nenit 77 të LPP ku përcaktohet se “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”, jemi të detyruar nga ligji që të vendosim dokumentacioni konkret që ofertuesit duhet të paraqesin.

I njëjti qëndrim është mbajtur dhe nga APP nëpërmjet rekomandimit Nr 7998 datë 24.12.2021.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Në pikën 5 të nenit 77 të LPP, thuhet që AK duhet të kërkojnë dokumentacion specifik, por ky dokumentacion duhet të jetë I lidhur ngushtë dhe të jetë në funksion të procedurës së prokurimit. Në këtë rast, Leja Mjedisore që kërkoni ju nuk lidhet drejtpërdrejt me procedurën e prokurimit, por me veprimtarinë e OE, për një fushë që nuk ka lidhje me prokurimin.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

Pretendimet e subjektit:

2. Së dyti: Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ju sqarojmë se:

Ky dokument është kërkuar mbështetur në rekomandimin e APP Nr 6732 Prot datë 21.10.2020, rekomandimin e APP Nr 3872 Prot datë 10.06.2021 dhe në formatet e procesverbaleve tip të publikuara nga APP për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta për kualifikim,.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Pavarësisht rekomadimit të APP-së për paraqitjen e Akt Ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar, rekomadimi nuk është detyrues dhe në këtë rast nuk i shërben procedurës së prokurimit. Megjithatë, duke qenë se ju jeni mbështetur në Rekomadimin e APP-së, kjo gjetje nuk do të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit pranohet.

Procedurat e audituara nga prokurimet e AK Aparati i Bashkisë Korçë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Investime në infrastrukturën rrugore”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 986 datë 23.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 986 datë 23.09.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 986/1 datë 23.09.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje – kuadër)	1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxh. agro.ushq. 3. B.M , Inxh.ndërtimi	1. B.TH , Kryetar 2. E.DH , Anëtar 3. A.D , Anëtar 4. E.V , Anëtar 5. K.J , Anëtar
5. Fondi Limit: 108,333,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “A ShPK”, me vlere 73,074,183 lekë pa TVSh Minikontrata 1: Datë 05.04.2023, me vlere 38,857,983 lekë pa TVSh, me afat 3 muaj Minikontrata 2: Datë datë 10.05.2023 me vlere 34,216,166 lekë pa TVSh, me afat 5 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 35,259,150 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 07.11.2022	9. Burimi i FI ncimit: Te ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 11 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 8 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

a- Fondi limit:

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 6497 prot., datë 22.07.2022 “*Për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e dokumentacionit të tenderit*”, për të cilat është ngarkuar Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet projekti/projektet e rrugëve në të cilat parashikohet ndërhyrje;

Preventivi është hartuar nga Ing. B.M dhe Urb. ZH.L , konfirmuar nga titullari i Bashkisë Korçë, z. S.F ;

Nga verifikimi në internet, u konstatua se ing. B.M dhe ZH.L nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit⁴, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 5.

Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 147, datë 22.12.2021 “*Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë*”, me ndryshime.

Duke qenë se kjo procedurë prokurimi konsiston në riparimin/mirëmbajtjen e shumë objekteve rrugore, grupi i auditimit është i mendimit se kjo procedurë duhet të ishte “*Marrëveshje kuadër*” ose “*Me lote*”, duke plotësuar kështu edhe përcaktimet në LPP, neni 2, “*Qëllimi*”.

Përgjegjësia për caktimin e detyrës së projektimit personave të papajisur me licencat profesionale përkatëse, është e titullarit të Bashkisë Korçë, z. S.F .

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 12.10.2022, i cili është i paprotokolluar.

⁴ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

- Për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kritereve të kualifikimit, NjHDT ka kërkuar asistencën e APP-së;

- Në pikën 2.1.1. në DT, kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “...punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në pikën 2.2.6. në DT, është kërkuar “Nyje thyerje materialesh inerte dhe fabrikë asfaltobetoni”, të cilat duhet të jenë të pajisura me “leje mjedisore Kodi III.1B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi, si rregull, një linjë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të funksionojë apo ekzistojë pa këto lloj lejesh dhe nuk mund as të shesë materiale inerte. Ky kriter, është kërkuar të rishikohet edhe nga APP, pasi nuk është i lidhur direkt me LPP, por me personat e tretë dhe institucione të treta.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga M.S , M.B , B.M .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 07.12.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 11 OE ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 8 OE.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	K	68,249,990	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika <u>2.2.1.</u> , ku percaktohet shprehimisht se “ <i>Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</i> <i>a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;</i> <i>ose</i> <i>b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;</i> Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.” Per plotesimin e kriterit te mesiperm ofertuesi ka paraqitur dokumentacionin per objektet: “Rruga Borje-Kufi me Kosoven” me vlerë: <u>53.316.711</u> lek,pa TVSh, i cili eshte i ngjashem me objektin e prokurimit. “Sistemim dhe asfaltim i rruges lidhese te galerise te kuotes 178 MMND NE HEC Fierze” me vlerë totale: <u>57.915.973</u>,pa TVSh, ku vlera e punimeve te kryera nga shoqeria K. C. eshte 43.38% ose <u>25.123.949</u> lek,pa TVSh, i cili eshte i ngjashem me objektin e prokurimit. “Punime per sistemim te jashtme ne godinen e dyte te Universitetit “Aleksandër Moisiu” me vlere <u>44.827.792</u> lek,pa TVSh,i cili eshte i ngjashem me objektin e prokurimit. Vazhdim i ndertimit te kampusit te ri Universitar, GodI e dytë, per Universitetin “Aleksander Moisiu” Durrës” me date fillimi 11.03.2013 dhe date mbarimi 13.07.2018 me vlere 636.303.409 lek me TVSh ose <u>530.252.840</u> lek pa TVSh, i cili nuk eshte i ngjashem me objektin e prokurimit.</p>

			Asnje nga tre objektet e ngjashme me objektin e prokurimit nuk permbush piken "a" sepse vlera e secilit prej tyre eshte me e vogel se vlera e kerkuar 54.166.667 lek.pa TVSh. Gjithashtu nuk permbushet as pika "b" sepse vlera totale e puneve te ngjashme rezulton 123.268.451 lek.pa TVSh pra me e vogel se vlera e kerkuar 216.666.666 lek, pa TVSh.
2	A	73,074,183	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	XH	73,244,482	Kualifikuar
4	BOE N	76,233,396	Kualifikuar
5	M	77,860,677	Kualifikuar
6	I	77,888,874	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika2.1.1 ku percaktohet se " <i>Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet.</i> " Konkretisht vlera e xhiros te ofertuesit per te paktën nje nga vitet e periudhes te kerkuar eshte me e vogel se vlera e perlllogaritur e kontrates qe prokurohet.
7	G	84,223,292	Kualifikuar
8	N	85,740,039	Kualifikuar
9	BOE I & N	88,121,891	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Ofertuesi nuk ka dorëzuar marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë "I" ShPK dhe shoqërisë "N" ShPK, ne kundershtim me kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e pergjithshme te kualifikimit,ku percaktohet se : " <i>Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.</i> "
10	D	90,539,862	Kualifikuar
11	Vëllëzërit Hysa	101,237,660	Kualifikuar

- Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm është bërë me nr. 10437 prot., datë 02.12.2022.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 15.12.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.

- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE "A" ShPK është lidhur me nr. 10779/1 prot., datë 16.12.2022, pa afat.

- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 2520/3 prot., datë 05.04.2023, me vlerë 38,857,983 lekë pa TVSh, me afat 3 muaj. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 2520/4 prot., datë 05.04.2023;

- Është lidhur minikontrata nr. 2: me nr. 3553/3 prot., datë 10.05.2023 me vlerë 34,216,166 lekë pa TVSh, me afat 5 muaj. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 3553/4 prot., datë 10.05.2023;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE A nuk përmbush kriterin e pikës 1., (germa dh), për pagesën e detyrimeve vendore, pasi ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Kamëz, Devoll, Korçë, Fier, Maliq dhe Lezhë, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Mirditë dhe Tiranë, ku u konstatua se ka ushtruar veprimtari biznesi gjatë vitit 2022.⁵

- OE A nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.6., si më poshtë:

- Për makinerinë Greider, pasi mjeti i paraqitur nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën e zhdoganimit të vitit 2001 dhe një fotografi, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*MakI t teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makI ve teknologjike*".
- Për një kamion me kapacitet 5-10 Ton, me targë AA401HF, të marrë me qera nga shoqëria "L", pasi afati i certifikatës së kontrollit teknik ka përfunduar në datën

⁵ https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/2/year/2019/perf_id/ALMOKONSTRUKSION

05.11.2022, afati i pagesës së taksave vjetore ka përfunduar në datën 04.10.2021 dhe certifikata e transportit është “transport mallrash për llogari të vet”;

➤ Nga auditimi, u konstatua se nuk qëndron arsyeja e skualifikimit të OE “I”, pavarësisht se vlera e ofertuar nga ky OE është më e lartë se oferta e shpallur fituese, pasi xhiroja për vitin 2019 është 128,575,005 lekë. Në pikën 2.1.1. në DT, kërkohet që “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet.”. Nga ana tjetër, nqs ky kriter do të ishte aplikuar nga NjHDT në mënyrën e duhur, ky OE mund ta plotësonte këtë kriter për cilindo nga vitet për të cilët ka paraqitur vërtetimin e xhiros.

➤ Nga auditimi, u konstatua se nuk qëndron arsyeja e skualifikimit të OE “K”, pasi ka vërtetuar punë të ngjashme, të pranuar nga AK Bashkia Korçë për vlerën totale 123,268,452 lekë pa TVSh dhe për një punë të vetme me vlerë 53,316,711 lekë pa TVSh. Në DT, në pikën 2.2.1., kërkohet “...punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**”. OE “K”, plotëson pikën a të pikës 2.2.1. për objektin “Rruga Borje, kufi me Kosovën”, me vlerë 53,316,711 lekë pa TVSh.

Konkluzion:

Sa më sipër OE A ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE A ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Gjithashtu, skualifikimi i padrejtë i OE “K”, ka shkaktuar përdorim të fondeve të BASHKISË KORÇË pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **4,824,193 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE A ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **73,074,183 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Skualifikimi i padrejtë i OE “K”, ka shkaktuar përdorim të fondeve të BASHKISË KORÇË pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **4,824,193 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur, në kundërshtim me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga B.TH, kryetar; E.DH; A.D; E.V dhe K.J, anëtarë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar, personel i Bashkisë Korçë, është paraqitur observacioni me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, i administruar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit në lidhje me kriteret e vendosura për procedurën e mësipërme:

I. ... Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se OE A nuk përmbush kriterin e pikës 1 (gërma dh) për pagesën e detyrimeve vendore lidhur me pagesën e detyrimeve në bashkitë Mirditë dhe Tiranë.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Në LPP përcaktohet se OE duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet vendore, pa detajuar llojet apo natyrën e tyre. Në këto detyrime, përshihen edhe detyrimet e nxjerra nga KLSH gjatë auditimeve në vite, pavarësisht se ky nuk është rasti. OE nuk e ka përmbushur detyrimin për të vërtetuar hlyerjen e tyre. Përveç sa më sipër, kjo është një çështje e trajtuar edhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

Pretendimet e subjektit:

2. Lidhur me mjetin grejder, KVO ka vlerësuar se se ky është një mjet që nuk kategorizohet në mjetet që shënohet në regjistrat publike sipas përcaktimeve të bëra në, Në Ligjin nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 10 “Mjetet jashtë norme dhe transportet në kushte jonormale”, pika 1 përcaktohet “Konsiderohet jashtë norme mjeti që i kalon, për kërkesa funksionale të veçanta, kufijtë përmasave gabaritë dhe kufijtë e ngarkesave të përcaktuara në nenet 61 dhe 62. Neni 58, “Makl t Teknologjike”,.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Kjo çështje është trajtuar edhe në Projekt Raportin e Auditimit. Nga grupi i auditimit është vendosur e plotë baza ligjore dhe aktet nënligjore në lidhje me targimin e mjeteve vetëlëvizëse. Për hollësi të mëtejshme, mund t’i drejtoheni DRTRRSH, dega Korçë, si institucioni kompetent në këtë fushë.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji””

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 822 datë 15.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 822 datë 15.08.2022 1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxh. agro.ushq. 3. B.M , Inxh.ndërtimi	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 822/1 datë 15.08.2022 1. B.TH , Kryetar 2. R.H , Anëtar 3. A.D , Anëtar 4. J.Q , Anëtar 5. I.M , Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur		
5. Fondi Limit: 82,477,111 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “XH” ShPK, me vlerë 62,971,392.80 lekë pa TVSh, me kontratë datë 13.10.2022, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 19,505,718,2 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 02.09.2022	9. Burimi i FI ncimit: Buxheti i Shtetit + Te ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 10 OE b) Skualifikuar: 5 OE c) Kualifikuar: 5 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

a- Fondi limit:

Me shkresën datë 11.08.2022, është dërguar nga DPKZhT dokumentacioni teknik për fillimin e procedurës së prokurimit, për objektin “Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji””, ku përfshihet PV për hartimin e dokumentacionit teknik, preventivi, grafiku i punimeve, analizat e çmimeve, etj.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 6497 prot., datë 22.07.2022 “Për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e dokumentacionit të tenderit”, për të cilat është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, e cila ka hartuar edhe Specifikimet Teknike.

Projekti arkitektonik mban emrat e Ark. E.V , Ing. Gjeodet E.GJ dhe Urb. ZH.L .

Nga verifikimi në internet, u konstatua se Ark. E.V dhe Ing. Gjeodet E.GJ disponojnë licencën profesionale për studim/projektim, por nuk kanë kategorinë e nevojshme për të projektuar objekte arsimore (Kat. 2.b. Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; **objekte arsimore**), ndërsa Urb. ZH.L nuk është e pajisur me licencën përkatëse profesionale në fushën e projektimit⁶, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.

Në projekt-idenë konstruktive të palestrës, (18 faqe, duke filluar nga faqja 53 në projektin total), cilësohet se arkitektura është hartuar nga shoqëria “M ”, ndërsa konstruksioni nga

⁶ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

shoqëria “G ”, me licencë nr. N.4956/6. Nga verifikimi në internet, nuk gjendet ky numër licence. Grupi i inxhinierëve përbëhet si më poshtë dhe disponon licencat sipas tabelës⁷:

Shoqëria/Inxhinieri	Zbatimi në Ndërtim	Mbikëqyrje/Kolaudim	Studim/Projektim
G	Ska	MK.3184	Ska
V.Ç	Shoqëria KNC, NZ.7002/1	N Strukturist, MK.2972/1	N Strukturist, K.1064/2
N	Ska	Ska	Ska
E.I	Ska	Ska	Ska
K.D	Ska	Ska	Ska
N.H	Ska	Ska	N Strukturist, K.2586
E.C	Ska	Ska	Ska
E.L	Ska	Ska	Ska

Sa më sipër, personat e sipërpërmendur nuk kanë të drejtë ligjore të kryejnë studime e projekte, ndërsa shoqëria “G ” ka të drejtë të kryejë projekte strukturash.

Nga verifikimi në internet, u konstatua se shoqëria “M ” nuk ekziston dhe nuk ka asnjë licencë profesionale në emër të kësaj shoqërie. Në regjistrin e bizneseve, ekziston një shoqëri me emër të ngjashëm, “M , C. & Development”, me NUIS M...I, me administrator znj. S.GJ , me licencë profesionale nr. NZ.8285/1, për punime të zbatimit në ndërtim dhe znj. A. H., me licencë profesionale nr. MK. 3545, e cila nuk ka lidhje me shoqërinë në fjalë dhe personelin e saj.

Nga verifikimi në internet, u konstatua se shoqëria “M ” nuk ekziston dhe nuk ka asnjë licencë profesionale në emër të kësaj shoqërie. Në regjistrin e bizneseve, ekziston një shoqëri me emër të ngjashëm, “M , Construction & Development”, me NUIS M...I, me administrator znj. S.GJ , me licencë profesionale nr. NZ.8285/1, për punime të zbatimit në ndërtim, e cila nuk ka lidhje me shoqërinë në fjalë dhe personelin e saj.

Projekti hidrosanitar, (31 faqe, duke filluar nga faqja 71 në projektin total), Projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit, (10 faqe, duke filluar nga faqja 102 në projektin total), Projekti i ngrohjes, (14 faqe, duke filluar nga faqja 116 në projektin total), është hartuar nga shoqëria “H”, me NUIS M...R. Nga ekstrakti historik, u konstatua se shoqëria H nuk e ka objekt aktiviteti projektimit e instalimeve hidrosanitare. Grupi i inxhinierëve përbëhet si më poshtë dhe disponon licencat sipas tabelës⁸:

Shoqëria/Inxhinieri	Zbatimi në Ndërtim	Mbikëqyrje/Kolaudim	Studim/Projektim
H	Ska	Ska	Ska
D.L	Ska	Ska	Mjedis RG, M.1207/1
L.D	Ska	Ska	Mjedis, M.1130/2
E.A	Ska	Ska	Ska

Projekti elektrik, (25 faqe, duke filluar nga faqja 126 në projektin total), është hartuar nga shoqëria “M ”, si më sipër, e cila nuk ekziston në regjistrin e biznesit. Për këtë shoqëri është vendosur licenca nr. N.6967. Si inxhinier elektrik është Ing. R.K , me licencë nr. E.1498. Shoqëria “M ”, Ing. R.K dhe numrat e licencave të referuar në projekt nuk figurojnë në regjistrin e licencave⁹.

Sa më sipër, asnjë nga inxhinierët me licencë nuk ka kategorinë e nevojshme për të projektuar objekte arsimore (Kat. 2.b. *Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore*).

Në dosjen e prokurimit nuk gjendet detyra e projektimit dhe asnjë kontratë apo aktmarrëveshje e cila të bëjë lidhjen ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe shoqërive të cilat kanë hartuar projektin për rikonstruksionin dhe ndërtimin e palestrës së shkollës së mesme të përgjithshme “Themistokli Gërmenji”.

Për sa më sipër, duke pasur parasysh që është objekt arsimor dhe ka rëndësi të veçantë projektimi dhe ndërtimi, personat e angazhuar me projektin nuk i plotësojnë kriteret e duhura teknike, duke mos garantuar realizimin me sukses të kontratës, si dhe duke rrezikuar jetën e fëmijëve.

⁷ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

⁸ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

⁹ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 147, datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, me ndryshime.

Përgjegjësia për caktimin e detyrës së projektimit personave të papajisur me licencat profesionale përkatëse, është e titullarit të Bashkisë Korçë, z. S.F .

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 16.08.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Në pikën 2.1.1. në DT, kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “...punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në pikën 2.2.2. në DT, kërkohet “...licenca profesionale e kategorisë NP-2/A “Ndërtime civile dhe industriale””. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo kërkesë nuk është e përshtatshme, pasi duhet të ishte kërkuar kategoria C, e cila përfshin vlerën 51-100 milion lekë;

- Në pikën 2.2.4., në DT, kërkohet një punonjës i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo kërkesë është e tepërt dhe nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordI torit të projektit dhe të koordI torit për realizimin e punimeve”, pika 5.

- Në pikën 2.2.5., në DT, kërkohet që për personelin e specializuar/kualifikuar të paraqitet “Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve”. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo kërkesë është e tepërt dhe mund të kërkohet vetëm për personelin të cilët operojnë me pajisje elektrike, impiante dhe instalimeve elektrike;

- Në pikën 2.2.7., në DT, kërkohet që OE duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”, e cila nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt dhe e papërshtatshme, pasi nuk ka punime të lidhura me inxhinierinë e mjedisit dhe nga ana tjetër, nqs do të kishte punime të tilla, nga AK duhet të ishte kërkuar edhe disponimi i një inxhinieri mjedisi në stafin e shoqërisë;

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga M.S , M.B , B.M .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 02.09.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 10 OE ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 8 OE.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	N	60,908,091	<p>Kualifikuar dhe më pas skualifikuar për arsyet e mëposhtme: -Nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2.6 dhe të deklaruar ne shtojcën 8-Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit për mjetet: Kamion vetëshkarkues me vinç me kapacitet mbajtës 5-10 ton, me targa SH6271E Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton me targë AA328HZ Autobetoniere targa AA613 HB Autopompe betoni targa AA864YV -Nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2.3 dhe 2.2.5, dhe të deklaruar ne shtojcën 8-Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit për stafin e punësuar, konkretisht : Nuk është paraqitur kontrata e punës dhe deshmia e kualifikimit teknik per: Z.M.B –shtrues pllakash, K.N –Specialist sisteme ngrohje ftohje dhe Z.M.D –Elektricit. Certifikata e sigurimit teknik të Z.B.G me profesion Karpentier ka skaduar ne daten 02.06.2022 Nuk është paraqitur Kontrata e punës dhe diploma per Znj.M.T ing.elektrike”.</p>
2	XH	62,971,393	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	B	66,215,431	Kualifikuar
4	BOE G dhe E	68,381,691	Kualifikuar
5	BOE T dhe I	73,345,268	Kualifikuar
6	BOE A dhe B	76,440,541	Kualifikuar
7	I	73,083,163	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Preventivi i paraqitur nuk përputhet me preventivin e publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht ka ndryshim te sasive në zerat: Zëri -Prishje kollona, trare b/a : Sasia e shënuar nga ofertuesi është 2 m³ , Sasia e shenuar ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor eshte 1,5 m³ Zëri -Beton C 20/25 per trare themeli, mure xokoli, solete 0.00: Sasia e shënuar nga ofertuesi është 5 m³ , Sasia e shenuar ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor eshte 4,5 m³ Zëri- Beton C 20/25 per shkalle: Sasia e shënuar nga ofertuesi është 3 m³ , Sasia e shenuar ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor eshte 2,5 m³ Zëri -Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m: Sasia e shënuar nga ofertuesi është 5 m³ , Sasia e shenuar ne preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor eshte 4,5 m³</p>
8	BOE A	74,086,913	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1. Ofertuesi nuk ploteson kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.1 ku percaktohet shprehimisht se: 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet; Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht kontratat e paraqitura nga shoqëria “A ” ShPK nuk jane te ngjashme me objektin që prokurohet. 2. Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” i paraqitur nga shoqëria “A ” ShPK i drejtohet shoqërisë “Ujesjelles Kanalizime Korce”sh.a per objektin “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve per ujerat e ndotura ne fshatin Turan” Gjithashtu nga vlerësimi i te dhenave të deklaruara ne shtojcat 8 te paraqitura nga te dyja shoqëritë rezultojn se nuk jane deklaruar ing.mekanik dhe ing.topograf cka eshte ne kundërshtim me kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.3.</p>
9	BOE I dhe L	74,802,588	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Preventivi i paraqitur nuk përputhet me preventivin e publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht ka ndryshim te sasisë në zerin: F.V Element radiator alumini per klasat , Presioni max. 600 kPa, interaksioni 600 mm, ΔTek = 50°C, Fuqia Termike 150 W. Në preventivin e publikuar nga autoriteti kontraktor sasia e percaktuar per zerin e mesiperme eshte 1295 cope ndersa ne preventivin e dorezuar nga ofertuesi eshte shenuar 246 cope.</p>
10	M	78,309,043	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Ofertuesi nuk ploteson kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.7 ku percaktohet shprehimisht se: 2.2.7 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte • Certifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise” • Certifikaten ISO 14001: 2015 Per menaxhim mjedisi • Certifikaten ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”</p>

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 8405 prot., datë 03.10.2022.
- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 12.10.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “XH ” ShPK është lidhur me nr. 8405/2 prot., datë 13.10.2022, me afat 6 muaj. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 8405/3 prot., datë 13.10.2023;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE XH nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

- OE XH nuk ka plotësuar vetëdeklarimin për kamionat dhe kamionçI t, pasi nuk ka paraqitur kapacitetin mbajtës, sipas kërkesës në DT, por peshën maksimale, e cila nuk është kërkuar nga AK;

- OE XH nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4. në DT, për një punonjës i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, pasi certifikata e paraqitur për ing. A.XH është lëshuar nga shoqëria AQSCERT, e cila nuk është e akredituar për trajnimin e punonjësve;

- OE XH nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.5. në DT, pasi dëshmitë e kualifikimit teknik janë nga shoqëria TCPE, e cila është e akredituar dhe bën vetëm certifikimin e punonjësve të cilët operojnë me pajisje elektrike, impiante dhe instalimeve elektrike, në zbatim të Ligjit 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, të ndryshuar;

- OE XH nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.6. në DT, pasi ekskavatorët me goma që ka paraqitur nuk disponojnë certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën e zhdoganimit të vitit 2001 dhe një fotografi, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “Maki t teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i maki ve teknologjike”.

- XH nuk plotëson pikën 2.2.7. në DT, pasi certifikatat ISO janë lëshuar nga shoqëria Royalcert, e cila nuk është organ i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.¹⁰

Në lidhje me shoqërinë “C”, e cila ka deklaruar se mbështet shoqërinë “XH” me makineri dhe personel nëse shpallet fituese, nga auditimi u konstatua se KVO nuk ka verifikuar nëse shoqëria C i ka angazhuar këto kapacitete të deklaruara në kontrata të tjera. Grupi i auditimit, konstatoi se shoqëria C gjatë vitit 2022 ka deklaruar të njëjtat kapacitete në kontratat:

Nr.	Objekti	Autoriteti Kontraktor	Vlera e kontratës pa TVSh	Data e tenderit
1	Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar “Havzi Nela”, Kukës	Bashkia Kukës	106,042,609	07.11.2022
2	Përmirësim i infrastrukturës së furnizimit me energji elektrike në IEVP Fushë – Krujë	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	2,864,511	12.09.2022
3	Rikonstruksion i stacionit të pompave dhe lidhjet e abonentëve në Ksamil	Sh.A Ujësjellës Kanalizime Sarandë	45,193,477	29.09.2022
	Transformimi urban në hapësira publike kryesore (rajoni 1 dhe 2) ndërtimi i shëtitores së plazhit nga ura e Dajlanit deri në godinën e kavalishencës	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	284,962,076	15.07.2022

Nga grupi i auditimit nuk janë verifikuar kapacitetet e deklaruara nga OE C në kontratat e lidhura gjatë viteve 2021 dhe më herët, të cilat gjitha kanë qenë në proces në kohën e deklarinimit si shoqëri mbështetëse për kapacitetet.

➤ Nga auditimi, u konstatua se, përpara skualifikimit për mangësitë e përmendura më sipër, AK Bashkia Korçë, në zbatim të LPP, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 2, duhet t’i kishte kërkuar sqarime OE N ShPK, si OE me ofertën më të ulët ekonomike të paraqitur.

Grupi i auditimit është i mendimit se mangësitë e konstatuara nga OE N, mund të klasifikohen “të vogla”, në bazë të nenit 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë.

Konkluzion:

¹⁰ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

Sa më sipër, shoqëria C ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me mosangazhimin e kapaciteteve të cilat ve në dispozicion të shoqërisë XH për këtë procedurë prokurimi.

OE XH ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE XH ShPK, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 2.

Duke shpallur fitues OE XH ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **62,971,392.80 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Skualifikimi i padrejtë i OE "N", ka shkaktuar përdorim të fondeve të BASHKISË KORÇË pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **2,063,302 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur, në kundërshtim me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga B.TH, kryetar; R.H; A.D; J.Q dhe I.M, anëtarë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar, personel i Bashkisë Korçë, është paraqitur observacioni me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, i administruar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit në lidhje me kriteret e vendosura për procedurën e mësipërme:

1. ... Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për pjesën e kriterëve teknike të hartuara nga specialisti i fushës Z.B.M Ing.Ndërtimi konkretisht: "Grupi i auditimit ka atakuar përfshirjen e Z.B.M në hartimin e projekteve dhe preventivave pasi ai, pavarësisht se është inxhinier ndërtimi,nuk është i pajisur me licencën profesionale" ju sqarojmë se:

Shkeljet e konstatuara nga ana juaj për të cilat ne kemi paraqitur observacionet tona lidhen me kriteret teknike per kualifikim të hartuara nga specialisti i fushës anetar i njesisë të prokurimit,referuar nenit Nr 78 të VKM Nr.285 datë 19.02.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Në kuptimin e LPP, specialist i fushës konsiderohet një person i cili është i kualifikuar dhe i licencuar sipas legjislacionit të fushës. Z. M nuk ka licence për ushtrimin e profesionit të inxhinierit.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

Pretendimet e subjektit:

2. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se OE XH ShPK nuk përmbush kriterin e pikës 1 (germa dh) për pagesën e detyrimeve vendore

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Kjo çështje është trajtuar edhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

3. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se "KVO nuk krijohet për të marrë të mirëqënë çdo dokument që i ofrohet..." sqarojmë se në nenin 75 të VKM 285 datë 19.05.2021.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

3. Fjalja që citoni është pjesë e qëndrimit të grupit të auditimit ndaj pretendimeve tuaja dhe nuk do të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit

4. Lidhur me skualifikimin e shoqërisë N ShPK ju sqarojmë se ajo është skualifikuar mangësi dokumentacioni thelbësore ,që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin e objekteit të cilat janë cituar në observacionin e paraqitur per aktin e konstatimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Kjo çështje është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dhe nuk është pranuar.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i eficientës së energjisë)"

1. Urdhër Prokurimi:

2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:

3. Komisioni Vlerësimi Ofertave:

Nr. 8 datë 06.01.2023 4. Lloji i Procedurës: E hapur	Nr. 8 datë 06.01.2023 1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxh. agro.ushq. 3. B.M , Inxh.ndërtimi 4. V.P , Inxh.elektrike	Nr. 8/I datë 06.01.2023 1. B.TH , Kryetar 2. R.H , Anëtar 3. A.D , Anëtar 4. S.SH , Anëtar 5. M.B , Anëtar
5. Fondi Limit: 78,357,756 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: BOE "I" ShPK, "E" ShPK & "I" ShPK me vlere 52,856,879 lekë pa TVSh, me kontrate datë 27.03.2023, me afat 6 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 25,500,877 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.01.2023	9. Burimi i FI ncimit: BashkëfI ncim i detajuar si më poshtë: SECO: 66,720,000 lekë pa TVSh MIE do të fI cojë TVSh-në në vlerën 14,629,000 lekë Bashkia Korçë: 11,637,756 lekë pa TVSh TVSh në vlerën 1,042,551 lekë Totali Bashkia Korçë: 12,680,307 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 8 OE b) Skualifikuar: 5 OE c) Kualifikuar: 3 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 18.

Për këtë objekt, është zhvilluar tender në datën 12.12.2022, me fond limit 78,357,756 lekë pa TVSh, me REF.: 48290-11-02-2022, i cili është anuluar pasi janë skualifikuar të gjitha ofertat e paraqitura, si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta
1	BOE I & I & E	72,220,111
2	BOE B	64,164,320
3	I	Pa ofertë
4	BOE L & S	67,363,662
5	M	Pa ofertë
6	BOE N & P	62,309,040
7	BOE XH & GPG Company	55,806,366

a- Fondi limit:

Financimi për këtë objekt është bërë pjesërisht nga buxheti i Bashkisë Korçë, në vlerën 12,680,307 lekë (11,637,756 lekë vlere neto + 1,042,551 lekë TVSh) dhe SECO (Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike në vlerën 66,720,000 lekë pa TVSh. TVSh e kësaj pjesë të investimit do të mbulohet nga MIE, në vlerën 14,629,000 lekë.

Për Bashkinë Korçë, ky objekt është miratuar me VKB nr. 132 dhe 133, datë 22.08.2022.

Për këtë është hartuar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe SECO, protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 3060 prot., datë 21.04.2022.

Projekti është nënshkruar nga Drejtori i DPPKZhU, znj. ZH.L dhe është hartuar nga Ing. El. V.P , me licencë nr. E.0232/4 dhe Ark.

, dhe miratuar nga titullari i AK, z. S.F .

Nga verifikimi në internet, u konstatua se Ark. A.Q nuk është i pajisur me licencë profesionale për ushtrimin e profesionit të arkitektit¹¹, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 5.

Përgjegjësia për caktimin e detyrës së projektimit personave të papajisur me licencat profesionale përkatëse, është e titullarit të Bashkisë Korçë, z. S.F .

b- Specifikimet Teknike dhe Kriteret e vlerësimit:

Objekti në fjalë konsiston në përmirësimin e ndriçimit të rrugëve në Bashkinë Korçë, i paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Emri dhe lloji i rrugës		Eficienta lm/W	Fluksi në dalje lm
Rruga "Muzakajt"	Rruga	≥ 112	7450 (+/- 2%)

¹¹ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

	Trotuari	≥ 141	2796 (+/- 2%)
	Rreth rrotullimi	≥ 128	18152 (+/- 2%)
Bulevardi “Republika”	Bulevardi	≥ 94	8326 (+/- 2%)
	Trotuari	≥ 108	3350 (+/- 2%)
Rruga “Rexhep Telhaj”		≥ 100	9800 (+/- 2%)
Rruga “1 Maji”		≥ 109	9020 (+/- 2%)
Lulishte “Vangjush Mio”	Rrugë	≥ 110	4000 (+/- 2%)
	Mural	≥ 102	2000 (+/- 2%)
Rrugët “1 Maji”, “Sotir Polena”, “Viktor Eftimiu”, “10 Korriku”, “Koço Tupa”		≥ 140	8600 (+/- 2%)
Njësitë administrative		≥ 100	3000 (+/- 2%)

- Nga auditimi i Specifikimeve Teknike, u konstatua se në të gjitha rastet, limiti i lejuar për fluksin e ndriçimit ka qenë +/- 2%, ndërsa për fuqinë ka qenë i përcaktuar në vlerë absolute, pa asnjë tolerancë +/-, gjë e cila nuk është e argumentuar. Grupi i auditimit është i mendimit se, duke i bërë Specifikimet Teknike me një diapazon kaq të ngushtë, inxhinieri ka përcaktuar markën e ndriçuesave dhe automatikisht fituesin e procedurës së prokurimit, pasi me detaje kaq të hollësishme, në treg mund të gjendet vetëm një produkt i caktuar. Nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë argumentim teknik për një llampë ndriçimi e cila kërkohet, p.sh. 18152 lumen (+/- 2%), pasi të njëjtin ndriçim mund ta japë edhe një llampë 18157, 18100 apo 18200;
- Në dokumentet e tenderit nuk janë kërkuar të gjitha llampat sipas ST apo projektit, gjë e cila nuk është e argumentuar;
- Krahas sa më sipër, në disa raste, nga grupi i projektimit është përcaktuar edhe marka e bojës me të cilën duhet të jenë lyster ndriçuesat, si psh, për rrugën “Muzakajt”, kërkohet që ndriçuesat të jenë lyster me bojë “AKZO grey 900”, e cila prodhohet vetëm nga kompania ndërkombëtare AKZONOBEL¹², pavarësisht se del në treg me emra të ndryshëm; për Bulevardin “Republika”, kërkohet që ndriçuesat të jenë të lyster me bojë “RAL AKZO 900”, nga ku RAL është standard i cili përdoret për lysterjen, ndërsa AKZO është markë; për rrugët “Rexhep Telhaj”, “1 maji”, “Lulishte Vangjush Mio”, etj., është kërkuar që ndriçuesit të jenë të lyster me bojë RAL 7022/7042, i cili është përcaktimi i duhur, pa specifikuar markën, por vetëm standardin e lysterjes, ku secili nga numrat përfaqëson nga një cilësi të caktuar.
- Për ndriçuesat është kërkuar të jenë të certifikuar CE dhe ENEC. Kërkesa për CE është e gabuar, pasi ka të bëjë me vetëdeklarimin e shoqërive të ndryshme që janë konform një standardi të caktuar, ndërsa kërkesa për ENEC lëshohet nga një palë e tretë e pavarur, e cila garanton cilësinë dhe konformitetin e një malli/produkti të caktuar.
- Nga grupi i projektimit nuk është dhënë asnjë argument për përdorimin e detajeve shumë të hollësishme si më sipër, si psh, Eficenca lm/W: ≥ 112; ≥ 141; ≥ 128 dhe Fluksi në dalje lm 7450 (+/- 2%); 2796 (+/- 2%); 18152 (+/- 2%). Nga grupi i projektimit nuk sqarohet në procesverbal se pse duhet që raporti lm/W të jetë pikërisht ≥ 112; ≥ 141; ≥ 128 dhe nuk duhet të jetë, psh. ≥ 110; ≥ 140; ≥ 120, etj.
- Për shtyllat, krahas të tjerave kërkohet që “*kriteri i projektimit të aksesorëve të shtyllës*”, të jetë ISO 898. Standardi ISO 898 ka të bëjë vetëm me karakteristikat mekanike dhe fizike të vidhave dhe bulonave, të shprehura në njësinë matëse metrike, e cila nuk ka lidhje me këtë objekt prokurimi. Gjithashtu, për shtyllat kërkohet që kapaku të jetë me përmasa 45x186mm, cilësia e çelikut bazë të jetë S355 dhe cilësia e çelikut e aksesorëve të tjerë të jetë S235JR, specifikim i cili përdoret për qëllime të caktuara dhe është një mënyrë e kufizuar përcaktimi, e cila nuk përdoret domosdoshmërisht për shtyllat e ndriçuesave elektrikë. Konkretisht, çeliku S235JR nënkupton çelique strukturash jo prej aliazheve, ndërsa çeliku S355 përdoret për fletët dhe shufrat e gjata. Pra, pavarësisht se këto dy specifikime nuk kanë shumë lidhje me objektin e prokurimit, nga grupi i hartimit të ST duhet të ishte vendosur minimalisht fjala “ekuivalente”, si për çeliquet e shtyllave dhe aksesorëve, ashtu edhe për bojën, et.

¹² <https://akzonobel.com/en/about-us/our-brands->

- Nga grupi i auditimit, u konstatua se specifikimet e mësipërme janë të tepërta, të paargumentuara, të paqarta, konfuzuese për OE pjesëmarrës dhe rrjedhimisht kufizojnë pjesëmarrjen e shumë OE në procedurën e prokurimit.

Këto specifikime, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 36 “*Specifikimet teknike*”, pikat 1., 2., 3., 4. 5.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 2.

- Për hartimin e DT, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 11.01.2023, i cili është i paprotokolluar.

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 11.01.2023, i cili është i paprotokolluar.

- Në SPE, në datën 16.01.2023, është bërë ankesë nga OE M., i cili kërkon sqarime për këtë procedurë, ku ngrihet pretendimi se “*produktet identike të mara si referencë nuk ekzistojnë me karakteristikat e kërkuara*”, pasi nuk japin fluksin e kërkuar të dritës. Për këtë OE është përgjigjur ing. V.P , ku ka kundërshtuar pretendimin, duke u shprehur se “*modelet ekzistojnë...*”. Bashkëlidhur përgjigjes janë vendosur disa skeda teknike të cilat janë të palexueshme dhe nuk citojnë referencën.

- Në SPE, në datën 20.01.2023, është bërë ankesë nga OE Vibtis, i cili kërkon sqarime për këtë procedurë, ku ngrihen pretendimet se: “*1. Në pikën 2.2.8., kërkohet që OE duhet të paraqesin certifikatat ...ISO 9001:2015, ndërsa në Specifikimet Teknike 1 Të Përgjithshme kërkohen ISO 9001-2008; ISO 14001-2015; OHSAS 18001-2007; PAS 99-2012 dhe ISO/IEC 27001:2013. Bazuar në nenin 36 të LPP, ST duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor; dhe 2. Në ST kërkohet që furnizimi i materialeve dhe pajisjeve duhet të bëhet nga distributorë ekskluzivë të fabrikuesve në BE. Ky kriter është diskriminues pasi në nenin 36 të LPP, përcaktohet që duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*”. Për këtë OE është përgjigjur NjHDT, ku nuk ka dhënë sqarimin e kërkuar, por thjesht ka cituar përmbajtjen e pikave 2.2.8 dhe 2.2.9. në DT.

- Në SPE, në datën 26.01.2023, është bërë ankesë nga OE I., i cili kërkon sqarime për këtë procedurë, ku ngrihen pretendimet se: “*1. Në pikën 2.3.9./4., përcaktohet që ...OE duhet të dorëzojë edhe raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin për materialet e mëposhtme..... Në pikën 2.2.9./1./2./3., kërkohet 1. autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar; 2. Katalog ose skedat teknike, të cilat duhet të përputhen me përshkrimin e bërë në ST; 3. OE duhet të paraqesë nga një mostër të materialeve”; “2. A është e nevojshme të kërkohet kategoria C e licences N.P.-IIC për këto punime?”; “3. Në pikën 2.1.4. janë bërë ndryshimet: Eficienca për ndriçuesit LED 9020lm/3000K nga ≥ 109 lm/W është bërë ≥ 140 lm/W dhe për ndriçuesit LED 8600lm/3000K nga ≥ 140 lm/W është bërë ≥ 110 lm/W. Ju lutemi të na sqaroni për këtë ndryshim dhe ku bazohet AK për të bërë këtë ndryshim”. Për këtë OE është përgjigjur ing. V.P , e cila është shprehur: “*1. Në lidhje me raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin, ju sqarojmë se argumentimi për këtë kriter është bërë në PV datë 11.01.2023 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”; 2. Për kategorinë e licencës N.P.-IIC është bërë argumentimi në PV datë 11.01.2023 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”; 3. Është bërë korrigjimi i ST për shkak të disa lapsuseve të bëra gjatë shënimit të vlerave për këta dy ndriçues...*”.*

Në lidhje me përgjigjen për sqarimet, nga grupi i auditimit u verifikua argumentimi në PV datë 11.01.2023 “*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim*”, nga ku u konstatua se nuk ka asnjë argumentim teknik në lidhje me sa ngihet nga OE në ankesat e bëra.

- Në datën 17.01.2023, nga ing. V.P i është dërguar Drejtorisë së Prokurimeve një shkresë pa numër protokoll në lidhje me korigjimin e ST për ndriçuesit LED 9020lm/3000K, duke i ndryshuar nga ≥ 109 lm/W është bërë ≥ 140 lm/W dhe për ndriçuesit LED 8600lm/3000K, duke i ndryshuar nga ≥ 140 lm/W është bërë ≥ 110 lm/W. Në shkresë citohet shprehimisht se ndryshimet janë bërë për shkak të një “lapsusi”, por nuk është dhënë asnjë argument as në lidhje me ndryshimet të cilat duhet të bëhen në projekt dhe as argumentimi teknik.
- Në DT, gjithashtu kërkohet ndriçuesi 3363 lm, i cili nuk është parashikuar në ST;
- Në pikën 2.1.1. në DT, kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.
- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “...punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.
- Në pikën 2.2.2. në DT, krahas të tjerave kërkohet “...licenca profesionale e kategorisë NP-11/C “Ndërtime për n/stacionet, kabl t e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë””. Nga grupi i auditimit u konstatua se kjo kërkesë nuk është e përshtatshme, pasi, duke pasur parasysh se nuk është një objekt i vetëm, por janë mbi 11 objekte pa lidhje me njëri tjetrin, ku secili prej tyre mund të konsiderohet si lot më vete, nga AK duhet të ishte kërkuar kategoria A e kësaj licence; duke mos e ndarë kontratën në lote, si dhe duke vendosur kritere të cilat mund të plotësohen vetëm nga OE të mëdhenj, AK ka përjashtuar nga e drejta e prokurimit OE të vegjël, të cilët mund të realizojnë këtë kategori dhe lloj punë publike. Sa më sipër, është në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, pika 1. Këto kritere dhe specifikime teknike, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3. Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga M.S , M.B , B.M dhe V.P . Për specifikimet teknike të paargumentuara dhe të vendosura duke i përcaktuar në detaje për t’u përshtatur vetëm një marke apo prodhuesi, mban përgjegjësi ing. V.P .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 30.01.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 8 OE ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 5 OE dhe kualifikuar 3 OE.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	BOE I & I & E	52,856,879	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	BOE N & P	54,419,074	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku është përcaktuar shprehimisht se: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 24 persona, dokumentuar kjo me vërtetimin e pageses

		<p>se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.</p> <p><i>Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjil ose në kopje të njësuara me origjil lin”</i></p> <p>Konkretisht: Nga shqyrtimi i formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 rezulton se shoqëria P ShPK ka deklaruar se ka 12 punonjës. Nga shqyrtimi i Kontratës të Bashkëpunimit datë 30.01.2023 të lidhur ndërmjet shoqërisë P ShPK dhe shoqërisë N ShPK rezulton se shoqëria P ShPK ka marrë përsipër të kryejë 68% të punimeve. Në nenin 88 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” është përcaktuar shprehimisht se: <i>“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. “</i> Bazuar në sa më sipër shoqëria P ShPK duhet të kishte të paktën 24x68%=16 punonjës të deklaruar dhe jo 12 punonjës.</p> <p>1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale,pika 2.2.9.</p> <p>Konkretisht: Nga ofertuesi është paraqitur dokumentacioni i plotë i kërkuar vetëm për : -Ndricues led/ 142ë/ 3000k + krahun -Ndricues led/ 8,600 lumen/ 3000K Për materialet e mëposhtme nuk ka dorëzuar Autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi dhe skeda/kataloge :</p> <table border="1" data-bbox="657 1025 1348 1283"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Pershkrimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Kuader komandimi</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Kabell 3x1.5 mm2</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Kabell 4x6 mm2</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>Kabell 4x10 mm2</td> </tr> <tr> <td>11</td> <td>Percjelles tokezimi bakri S=16mm2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për materialet e mëposhtme nuk ka dorëzuar raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndricues dekorativ led 7,450 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 8,326 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k 	Nr	Pershkrimi	1	Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k	2	Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k	3	Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k	4	Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k	7	Kuader komandimi	8	Kabell 3x1.5 mm2	9	Kabell 4x6 mm2	10	Kabell 4x10 mm2	11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm2
Nr	Pershkrimi																					
1	Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k																					
2	Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k																					
3	Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k																					
4	Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k																					
7	Kuader komandimi																					
8	Kabell 3x1.5 mm2																					
9	Kabell 4x6 mm2																					
10	Kabell 4x10 mm2																					
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm2																					
3	BOE E & A	<p>58,201,614</p> <p>Skualifikuar për arsyt e mëposhtme: 1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale,pika 2.2.9.</p> <p>Konkretisht 1.1 Nuk ka dorëzuar raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin per materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndricues dekorativ led 7,450 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 8,326 lumen/ 3000k - Ndricues led, 142ë, 3000k + krahun - Ndricues led 8,600 lumen/ 3000K - Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k <p>1.2.Per materialet e meposhtme, skeda me te dhenat teknike nuk perputhet me te dhenat teknike te katalogut te cilit i eshte referuar.</p> <table border="1" data-bbox="657 1798 1348 1982"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Pershkrimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Ndricues led/ 142ë/ 3000k + krahun</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Ndricues led/ 8,600 lumen/ 3000K</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie, per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta kishte gabime aritmetike.</p>	Nr	Pershkrimi	1	Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k	2	Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k	3	Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k	4	Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k	5	Ndricues led/ 142ë/ 3000k + krahun	6	Ndricues led/ 8,600 lumen/ 3000K						
Nr	Pershkrimi																					
1	Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k																					
2	Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k																					
3	Ndricues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k																					
4	Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k																					
5	Ndricues led/ 142ë/ 3000k + krahun																					
6	Ndricues led/ 8,600 lumen/ 3000K																					

			<p>Konkretisht: Ne ofertën e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se janë bërë gabime aritmetike gjatë shumëzimit të sasive me cmimin për njësi. Bazuar në nenin 82 pika 3 e VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, KVO bëri korrigjimet....."</p> <p>Mbas mbledhjes të nentotaleve të korrigjuara rezultoi se vlera e ofertës mbas korrigjimit është 58,201,614 (pesëdhjetë e tete milion e dyqind e një mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) lek pa TVSh.</p> <p>Per sa me sipër, bazuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nëni 82 dhe në Dokumentatat e tenderit, në pikën 23 të seksionit F, "Vlerësimi i ofertave" KVO vendosi të kërkojë shoqërisë "A "ShPK si përfaqësuese e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë E " ShPK dhe "A " ShPK, që të pranojë korrigjimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave brenda datës 03.02.2023 në të kundërt oferta do të refuzohet.</p>
4	BOE XH & G	61,227,176	Kualifikuar
5	G	62,228,750	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.9.</p> <p>Konkretisht: 1.1 Nuk ka dorëzuar raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin për materialet e mëposhtme: - Ndricues dekorativ led 7,450 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 8,326 lumen/ 3000k - Ndricues led, 142ë, 3000k + krahun - Ndricues led 8,600 lumen/ 3000K</p> <p>1.2. Lidhur me "Ndricues led/ 142ë/ 3000k + krahun" parametrat teknike të ndricuesit të ofruar nuk janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuar konkretisht: fuqia është 150ë pra me e madhe se ajo e kërkuar dhe nuk ka të dhëna për "lumen" dhe eficienten "lumen/ë".</p> <p>1.3. Nuk ka paraqitur katalog/skede për "Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k" dhe "Ndricues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k"</p>
6	BOE H & B	62,276,320	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.9.</p> <p>Konkretisht: 1.1 Lidhur me " Ndricues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k" dhe "Ndricues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k " parametrat teknike të ndricuesit të ofruar nuk janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuar konkretisht: Per fuqite e ofruara nuk jepen lumen dhe lm/ë.</p> <p>1.2. Nuk ka dorëzuar raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin për materialet e mëposhtme: - Ndricues dekorativ led 7,450 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k - Ndricues dekorativ led 8,326 lumen/ 3000k - Ndricues led, 142ë, 3000k + krahun - Ndricues led 8,600 lumen/ 3000K</p>
7	BOE L & S	67,333,333	Kualifikuar
8	I	Pa ofertë	<p>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1-Ofertuesi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 2-Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara .</p>

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 1797 prot., datë 03.03.2022.
 - Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 07.03.2023, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.
 - Kontrata ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe BOE I & I & E është lidhur me nr. 1797/2 prot., datë 27.03.2023, me afat 6 muaj. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 1797/3 prot., datë 27.03.2023;
- Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:
- OE I nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore, si dhe nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore nga Bashkia Himarë, ku ushtron veprimtari biznesi sipas ekstraktit të QKB-së, në kundërshtim me pikën 1, "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit", germa dh) dhe me LPP, ;
 - OE I nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e energjisë elektrike, në kundërshtim me pikën 1, "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit", germa e);
 - OE I ka deklaruar dhe ka paraqitur vërtetim për mospërfjashtim nga e drejta për të përfituar fonde publike vetëm për shoqërinë, duke mos përfshirë personat "në cilësinë e anëtarit të

organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij”, në kundërshtim me pikën 1, “*Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit*”, germa i);

- OE I nuk përmbush kriterin e pikës 2.1.2. në DT, pasi bilanci e paraqitura nuk janë të konfirmuara nga Dega Tatimore përkatëse;

- OE I nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.1. në DT, pasi puna e ngjashme e paraqitur nuk është sipas kërkesës “*jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*”. Vlera e fondit limit pa TVSh është 78,357,756 lekë; OE I ka marrë përsipër të kryejë 57% të punimeve, pra për vlerën 44,663,921 lekë pa TVSh. Dyfishi i vlerës limit të kontratës është 89,327,842 lekë pa TVSh. Puna e ngjashme e paraqitur nga I është në vlerën 29,695,307 lekë me TVSh (24,746,089 lekë pa TVSh), pra më e vogël nga vlera takuese e kërkuar;

- OE I nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.3. në DT, për një inxhinier elektrik dhe një inxhinier ndërtimi, të cilët duhet të jenë drejtues teknikë. Duke qe në se OE I është subjekti i cili ka 57% të punimeve dhe do mban të gjitha përgjegjësitë, sipas Aktmarrëveshjes për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë, Drejtuesat Teknikë të kërkuar duhet të ishin domosdoshmërisht të disponueshëm nga ky OE;

- OE I nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.8. në DT, për certifikatën ISO 9001:2015, pasi certifikata e paraqitur është lëshuar nga shoqëria LMS, e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë;¹³

- OE E nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarin për shlyerjen e detyrimeve vendore për të gjitha adresat ku ushtron veprimtari biznesi sipas ekstraktit të QKB-së, konkretisht për Bashkitë Vlorë, Libohovë dhe Ura Vajguore/Dimal, në kundërshtim me pikën 1, “*Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit*”, germa dh) dhe me LPP;

- OE E ka deklaruar dhe ka paraqitur vërtetim për mospërfshirje nga e drejta për të përfituar fonde publike vetëm për shoqërinë, duke mos përfshirë personat “*në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij*”, në kundërshtim me pikën 1, “*Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit*”, germa i);

- OE E nuk plotëson pikën 2.2.7. në DT për:

- Një tokmak elektrik, pasi pajisja ngjeshëse e vetëdeklaruar dhe paraqitur me faturën nr. 001, datë 16.02.2021, me shitës T.Ç dhe blerës E , është ngjeshës (Badipal), me naftë, jo në përputhje me kërkesën;
- Një prerëse/sharrë asfalti, pasi në pajisjet e vetëdeklaruar dhe të paraqitura me faturën nr. 16, datë 30.05.2007, me shitës Ideal SI dhe blerës E , është një sharrë prerëse asfalti (nr. 1), një makinë prerëse hekuri (nr. 4) dhe një frezë asfalti (nr. 6), jo në përputhje me kërkesën;
- Dokumentacioni teknik dhe faturat për rulat e paraqitur është i papërkthyer. Nuk ka dokument bashkëlidhur për të vërtetuar që rulat e paraqitur janë me vibrim;
- Një kamion me kapacitet mbajtës deri 10 ton, pasi mjeti me targë AA684ZI, është furgon i mbyllur, jo në përputhje me kërkesën;
- Vinçi i marrë me qera nga SH.XH nuk është sipas kërkesave në DT, (nuk është as autovinç dhe as avinç me kosh), por është vinç kullë dhe dokumentacioni teknik i tij nuk është në gjuhën shqipe;
- Vinçi i deklaruar si vinç me kosh, me targë AA206NJ, i marrë me qera nga A.H , nuk është autovinç me kosh, por është autovinç, ndryshe nga sa është deklaruar;
- OE E , i cili në Aktmarrëveshjen për krijimin e BOE është subjekti që do të kryejë punimet e asfaltimit nuk disponon mjetin Bitumatriçe;

¹³ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

- Makineritë e mara me qera nga shoqëria “S ”, sipas kontratës përkatëse nuk janë paraqitur në Formularin e vetëdeklarimit dhe për pasojë nuk mund të merren në konsideratë;
- OE I nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore për të gjitha adresat ku ushtron veprimtari biznesi sipas ekstraktit të QKB-së, konkretisht për Bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Durrës, në kundërshtim me pikën 1, “*Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit*”, germa dh) dhe me LPP. deklarata e paraqitur nuk është pjesë e Shtojcës 8;
- OE I nuk plotësuar pikën 2.1.2. në DT, pasi nuk ka paraqitur Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për bilancet e viteve 2020 dhe 2021;
- OE I nuk plotësuar pikën 2. 2.1. në DT, pasi nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit për të vërtetuar përvojën e mëparshme me OE Fusha, objekti Vuno. Dokumenti i paraqitur është certifikatë e përfundimit të punimeve;
- OE I nuk plotëson pikën 2.2.8. në DT, pasi certifikata ISO 9001:2015 “*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*”, është lëshuar nga shoqëria KingCert, e cila nuk është organ i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.¹⁴
- OE I nuk plotëson pikën 2.2.7. në DT, për “*Aprat Luxmetër për fluksin e ndriçimit*”, pasi dokumentacioni i paraqitur është deklarata zhdoganimi për Spektrometer dhe faturë blerje për artikullin “*GL SPECTIS 1.0 T Flicker VIS*”, e cila është e papërkthyer (në kundërshtim me LPP) dhe nuk ka asnjë të dhënë nëse ky aparat i ka karakteristikat e kërkuara dhe nëse është në gjendje të bëjë ekzaminimet e kërkuara;
- OE I nuk plotësuar pikën 2.2.9. në DT, pasi:
 - Shtyllat e paraqitura nga shoqëria LDT, në certifikatën e qëndrueshmërisë së performancës kanë të përcaktuar që nuk janë të lyera, por të veshura me zink të nxehtë, jo sipas kërkesave në Specifikimet Teknike;
 - Fluksi në dalje për ndriçuesin e trotuarit të Rrugës “Muzakajt”, e ka gamën e ndriçimit +/-7% dhe jo +/-2%, sa është përcaktuar në ST;
 - Raportet e testimit nuk janë për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin sipas kërkesës në DT, por për mirëmbajtjen, e cila është në mospërputhje me DT. Gjithashtu, disa Raporte testimi të cilat janë nga palë të treta, nuk kanë vula apo referencat përkatëse me qëllim verifikimin e tyre;
 - Autorizimet e prodhuesit nga shoqëritë B , E dhe “I” nuk janë të rregullt, pasi nuk kanë vulën e shoqërisë, por vetëm nënshkrime të cilat nuk provojnë vërtetësinë e dokumentit;
 - Deklaratat e konformitetit nuk përputhen në terma sipas kërkesave në Specifikimet Teknike;
 - Autorizimet, Katalogët/Skedat teknike dhe Raportet e testimit nuk lidhen me njeri-tjetrin përçdo artikull me të njëjtat të dhëna si në DT, por janë me kode teknike dhe të dhëna të tjera, të ndryshme nga kërkesat në DT;
 - Autorizimet, Katalogët/Skedat teknike dhe Raportet e testimit nuk janë për të gjithë artikujt e kërkuar në DT dhe në ST;
 - Katalogët/Skedat teknike dhe Raportet e testimit nuk kanë asnjë element i cili të vërtetojë autenticitetin e tyre, si psh vulë apo mundësi verifikimi online. Këto lloj letrash Minimalisht, duhet të kishin referencë në një faqe interneti të shoqërive përkatëse. Këto lloj shkresash mund të prodhohen në çfarëdolloj kompjuteri, nga çdo person i cili ka pak njohuri në fushën e grafikës dhe dizajnit.
 - Duke pasur parasysh që dokumentet e kërkuara janë nga shtete të ndryshme, të gjitha duhet të ishin shoqëruar me shkresën përkatëse, e cila duhet të ishte zyrtarizuar dhe marrë

¹⁴ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

fuqi ligjore vetëm nëpërmjet vulës apostille, sipas “Konventës së Hagës, të datës 05.10.1961”, për shtet që e kanë nënshkruar;

Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte marrë në konsideratë Katalogët/Skedat teknike dhe Raportet e testimit, të cilat nuk janë autentike, pasi janë të pavlefshme, nul.

Konkluzion:

Sa më sipër, BOE I & I & E nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE I & I & E, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues BOE I & I & E, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **52,856,879 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga B.TH, kryetar; R.H ; A.D ; S.SH dhe M.B, anëtarë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar, personel i Bashkisë Korçë, është paraqitur observacioni me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, i administruar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit në lidhje me kriteret e vendosura për procedurën e mësipërme:

I. ...Lidhur me hartimin e dokumentave dhe vlerësimin e bërë nga KVO ju lutemi të mbani në vëmendjen tuaj se :

- Kjo procedurë është zhvilluar në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane, e cila ishte bashkëfinancuese në vlerën 66,720,000 lekë, pa TVSh. Të gjitha hapat e ndërmarrë nga ana jonë janë bërë mbasi janë konsultuar dhe miratuar paprapakisht prej tyre sipas shkresave që ju kemi dërguar me observacionin për aktet e konstatimit.

- Kjo procedurë është monitoruar nga APP, ku janë zbatuar rekomandimet e lëna prej saj.

- Në këtë procedurë kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm ofertuesish dhe është kualifikuar oferta më e ulët e cila në këndvështrimin tonë ka plotësuar dhe kriteret për kualifikim.

- Gjithashtu për këtë procedurë nuk ka patur asnjë ankesë nga operatorët pjesëmarrës në tender për vlerësimin e bërë nga KVO....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Sa pretendoni ju, nuk i justifikon mangësitë e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit. Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti i ndarë në lote: loti 1 naftë, loti 2 benzinë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr 521 prot, date 02.06.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 521, datë 02.06.2022 1. M.S, Juriste 2. M.B, Inxhinierë agro. ushq. 3. N.M, Ekonomist	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 521/1, datë 02.06.2022 1. B.TH, Kryetar 2. K.J, Anëtar 3. R.H, Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur (M. kuadër)	6. Oferta fituese: OE “M” ShPK. Loti 1: Norma e fitimit 8 lekë/liter Loti 2: Norma e fitimit 8 lekë/litër Minikontrata 1, datë 21.07.2022, me vlerë 5,458,650 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022 Minikontrata 2, datë 02.08.2022, me vlerë 4,166,567 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022 Minikontrata 3, 21.02.2023, me vlerë 7,005,075 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.08.2023	7. Diferenca me fondin limit:
5. Fondi Limit: 16,740,750 lekë pa TVSh. Loti 1: 15,654,500 lekë Loti 2: 1,086,250 lekë	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. OE Loti 1: a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
8. Data e hapjes së tenderit: 21.06.2022		

		OE Loti 2: a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Ska

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

a- Fondi limit:

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit nr. 400 të titullarit, me nr. 4021 prot., datë 06.05.2022 “*Për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit*”, i ndryshuar me urdhërin nr. 512, me nr. 4940 prot., datë 31.05.2022, në përbërje të së cilit janë: N.M , J.T , R.Q dhe G.J.R ;

Për këtë qëllim është mbajtur procesverbali datë 31.05.2022, ku u konstatua se janë përcaktuar ST, ndërsa për sasinë e konsumit të karburantit është paraqitur vetëm një tabelë për të cilën nuk është dhënë asnjë argument dhe nuk është përcaktuar metoda e përdorur për llogaritjen, në kundërshtim me LPP, neni 34 “*Për llogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit*” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “*Metoda të zbatueshme në për llogaritjen e vlerës së kontratës*”.

Përgjegjësia për llogaritjen e fondit limit është e grupit përkatës, i përbërë si më sipër.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 31.05.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Në pikën 2.1.1. në DT, kërkohet “*...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit të limit të lotit që prokurohet*”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “*...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit lotit që prokurohet*”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 40, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 4.

Në pikën 2.2.5. në DT, është kërkuar “*Autoboti pajisur me Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit...*”. Kjo kërkesë është në kundërshtim me Ligjin nr. 118/2012 “*Për transportin e mallrave të rrezikshme*”, neni 23 “*Llojet e mallrave për autorizim*”, pika 1.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga M.S , M.B , N.M .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 21.06.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 2 OE ofertues, të cilët janë kualifikuar. Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

-

Nr.	OE pjesmarrës	Norma e fitimit	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	M	8%	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	K	14.8%	Kualifikuar

- Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm është bërë me nr. 5838 prot., datë 29.06.2022.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 08.07.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.

- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “M ” ShPK është lidhur me nr. 5838/2 prot., datë 12.07.2022, me afat 12 muaj nga lidhja e marrëveshjes.

- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 6425/3 prot., datë 21.07.2022, me vlerë totale 6,682,930 lekë me TVSh, nga të cilat 6,550,380 lekë për naftë dhe 132,550 lekë benzinë, me afat lëvrimiti deri në datën 31.12.2022. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 6425/5 prot., datë 12.07.2022;

- Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 6647/3 prot., datë 02.08.2022, me vlerë totale 4,999,880 lekë me TVSh, naftë për përballimin e situatave emergjente, sipas VKB nr. 79, datë 23.05.2022, me afat lëvrimiti deri në datën 31.12.2022. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 6647/5 prot., datë 03.08.2022;

- Është lidhur minikontrata nr. 3, me nr. 1267/3 prot., datë 21.02.2023, me vlerë totale 8,406,090 lekë me TVSh, nga të cilat 7,235,140 lekë për naftë dhe 1,170,950 lekë benzinë, me afat lëvrimiti deri në datën 31.08.2023. Plani i zbatimit të kontratës, me personin/at përgjegjës strukturën e ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës është me shkresën nr. 1267/4 prot., datë 21.02.2023;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE M nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit pagesën e detyrimeve vendore, si dhe nuk ka paraqitur vërtetimet përkatëse;

Konkluzion:

Duke pasur parasysh se OE M ShPK ka paraqitur ofertën më të ulët, pavarësisht mangësisë për vetëdeklarimin dhe mungesës së vërtetimeve për shlyerjen e detyrimeve vendore, si dhe duke pasur parasysh që kjo mangësi rrjedh nga mungesa e kësaj kërkesë specifike në kriteret e kualifikimit, vendimi i KVO-së për shpalljen e tij fitues është i drejtë, nisur edhe nga përcaktimi në LPP, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë.

Vlerësimi i ofertave për lotin e dytë, benzinë nuk u auditua me detaje, duke pasur parasysh se kriteret ishin të njëjta, ofertat ishin të njëjta, vlera e vogël dhe nuk paraqeste risk auditimi.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar, personel i Bashkisë Korçë, është paraqitur observacioni me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, i administruar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit në lidhje me kriteret e vendosura për procedurën e mësipërme:

1. ... Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar ju sqarojmë se ky dokument është kërkuar mbështetur në rekomandimin e APP Nr 6732 Prot datë 21.10.2020, rekomandimin e APP Nr 3872 Prot datë 10.06.2021 dhe në formatet e procesverbaleve tip të publikuara nga APP për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Kjo çështje është trajtuar më sipër dhe nuk do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

2. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për kriterin “Certifikate për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit “, i cili ka ngarkuar me përgjegjësi njësinë e prokurimit, ju sqarojmë se:

Së pari: Ky kriter është vendosur nga grupi i punës i cili ka mbajtur procesverbalin datë 31.05.2022 “Per llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të pranimit për objektin e prokurimit “Blerje karburanti”, bazuar në pikën 4 të nenit 74 të VKM 285 dt 19.02.2021, ku dhe ka argumentuar kërkesat për kualifikim që kanë lidhje me kapacitetin teknik.

Së dyti: Lidhur me vendosjen e këtij kriteri, grupi i auditimit ka konstatuar se është në kundërshtim me ligjin 118/2012 “Per transportin e mallrave të rrezikshme” duke qënë se karburantet nuk kategorizohen si mallra të rrezikshme.

Për sa më sipër sqarojmë se në procedurat ndër vite të zhvilluara nga Bashkia Korçe, janë paraqitur nga ofertuesit Certifikatat per transport mallrash të rrezikshme per autobotet e naftës. Pra nqs nuk do të lejohej pajisja me kete certifikate nuk do te aplikohet per asnje mjet te kesaj natyre . (Bashkelidhur disa shembuj certifikatash te dorezuara nga operatoret ne procedurat e karburantit te zhvilluara nga Bashkia Korçe).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Sa pretendoni ju nuk është e argumentuar dhe e mbështetur në ligj, por vetëm justifikim.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Punime ndërtimore në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes së infrastrukturës”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 968 datë 19.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 968 datë 19.09.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 968/1 datë 19.09.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxh. agro.ushq. 3. B.M , Inxh.ndërtimi	1. B.TH , Kryetar 2. M.B , Anëtar 3. I.M , Anëtar
5. Fondi Limit: 6,619,660 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “S ShPK” ShPK, me vlere 5,592,960 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 8844/2 prot., datë 27.10.2022, me afat 28 ditë.	7. Diferenca me fondin limit: 1,026,700 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.10.2022	9. Burimi i FI ncimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 4 OE b) Skualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

a- **Fondi limit:**

Në dosje nuk disponohet urdhër për llogaritjen e fondit limit. Preventivi, Fondi limit, Specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit, etj., janë llogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;

Përgjegjësia për hartimin e Fondit limit pa urdhër të titullarit është e titullarit të Ak, z. S.F dhe znj. ZH.L , Drejtore DPKZHT Bashkia Korçë.

b- **Kriteret e vlerësimit:**

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 22.09.2022, i cili është i paprotokolluar.
- Nga auditimi u konstatua se kriteret e vendodura janë në përputhje me LPP.

c- **Vlerësimi i ofertave:**

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 03.10.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 11 OE ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 8 OE.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	S	5,592,960	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	A	5,628,147	Kualifikuar

3	Z	5,734,103	Kualifikuar
4	XH	6,387,255	Kualifikuar

- Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm është bërë me nr. 8844 prot., datë 14.10.2022.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 25.10.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “S” ShPK është lidhur me nr. 8844/2 prot., datë 27.10.2022, me afat 28 ditë.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE A nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me pagesën e detyrimeve vendore;

- OE A nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, seksioni B, detajet për mjetin e transportit sipas kërkesës në DT;

Konkluzion:

Në konsideratë të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë, grupi i auditimit konstaton se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 832, datë 17.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 832, datë 17.08.2022	3. Komisioni Vlerësimi i Ofertave: Nr. 832/1, datë 17.08.2022
4. Lloji i Procedurës: Procedurë e hapur	1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxhinierë agro. ushq. 3. B.M , Inxhinier Ndërtimi	1. B.TH , Kryetar 2. G.J.P , Anëtare 3. E.DH , Anëtare 4. A.D , Anëtare 5. E.V , Anëtare
5. Fondi Limit: 51,100,215 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: BOE “N” ShPK & “N” ShPK me vlerë oferte 34,381,007.30 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022, me vlerë 41,257,208.8 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 16,719,207.70 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 06.09.2022	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 9 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 8 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, janë siguruar fonde në vlerën 61,320,258 lekë nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË të miratuara sipas shkresës me nr. 888/4 prot., datë 20.07.2022, të Ministrisë së Mbrojtjes “Për aplikimin në programin Emergjencat Civile” dhe VKB nr. 68, datë 28.04.2022, “Për planifikimin e bashkëfi ncimit në kuadër të hapjes të thirrjes për programin “Fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore”“. Konfirmimi i fondeve është kryer nga Dega e Thesarit Korçë në mënyrë elektronike më datë 18.08.2022.

Për realizimin e projekteve që i përkasin procedurës së prokurimit “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, nga AK janë kontraktuar tre studio projektimi konkretisht “N” ShPK, “C” dhe “D”, nga të cilët janë hartuar projektet si më poshtë:

- “N” Shpk ka hartuar projektin “Mure mbrojtës vend derdhjen e përroit të Dvoranit në lumin Dunave”, “Mur mbajtës në vend takimin e përroit të Voskopit me lumin Dunavec” dhe “Mur në argji turë te varrezat, Pulahë”, së bashku me preventivat përkatës.

- C” ka hartuar projektin “Ndërtimi i kanalit në Drenovë”, “Ndërtimi i kanalit në Kamenicë” dhe “Ndërtimi i kanalit në Barç”, së bashku me preventivat përkatës.

- “D ” ka hartuar projektin “Mur mbajtës në rrugën “Lavdar i Vjetër-Lavdar i Ri”“ dhe “Argjinatura e përroit të Mborjes nga ish-fabrikat e qelqit deri në dalje të fshatit L=344 ml”, së bashku me preventivat përkatës.

Në datën 16.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentacionit teknik për objektin “Ndërrhyrja për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”. Me shkresën e datës 16.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është dërguar pranë Drejtorisë së Prokurimeve dokumentacioni teknik për nisjen e procedurës së prokurimit. Në dosjen e projektit përfshihen: Projekti i zbatimit; Preventivi i punimeve; Grafiku i punimeve; Specifikimet teknike dhe Analiza e çmimeve.

Me Urdhërin nr. 832, datë 17.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M .

Me Urdhërin nr. 832, datë 17.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Ndërrhyrja për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë” me fond limit në vlerën 51,100,215 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhërit nr. 832, datë 17.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ing. z. B.M ka mbajtur procesverbalin e datës 18.08.2022, për hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Në datën 18.08.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Në datën 18.08.2022, nga NjP e përbërë nga znj. M.S , zj. M.B dhe z. B.M është mbajtur procesverbali nr. 1, për hartimin e dokumentave të tenderit.

Më datë 22.08.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Korçë, rezulton se: Për procedurën me REF-39220-08-18-2022, me objekt “Ndërrhyrja për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, Bashkia Korçë me fond limit 51,100,215 lekë pa TVSh, ka sygjëruar disa kriterë të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në datën nr. 25.08.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali nr. 2, për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Ishte:

Pika nr. 2.2.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Copë 5	Në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Eskavator me goma, 0.25 m ³	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Betoniere	Copë 6	Në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Autovinç me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	Në pronësi ose me qira

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

-Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur janë me qira të paraqiten: Kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publike ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet të kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

Bëhet:

Pika nr. 2.2.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Eskavator me goma 0.25 m ³	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Betoniere	Copë 6	Në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Autovinç me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	Në pronësi ose me qira

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur janë me qira të paraqiten: Kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publikë ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet të kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

II. Në procesverbalin e datës 18.08.2022, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar së bashku me dokumentet e tenderit janë kryer plotësimet si më poshtë:

- Në argumentimin e vendosur lidhur me kriterin: 2.2.4, operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 84 persona, dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.”Shtohet edhe argumentimi si më poshtë”:

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në bazë të zberthimit të grafikut të punimeve, zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 84 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, specialistë dhe punëtorë të përllogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

- Në argumentimin e vendosur në pikën 2.2.5, lidhur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme që duhet të ketë operatori ekonomik shtohet edhe argumentimi i mëposhtëm:

Në përcaktimin e sasisë të mjeteve dhe pajisjeve të caktuara është mbajtur në konsideratë edhe fakti që për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, mbështetur edhe në afatin e punimeve, duhet të punohet paralelisht në 8 objekte të cilat janë të shpërndara dhe në largësi nga njëri-tjetri.

1. Në pikën nr. 2.2.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **84 persona**, dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Në pikën nr. 2.2.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Eskavator me goma, 0.25 m ³	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	Copë 3	Në pronësi ose me qira

Betoniere	Copë 6	Në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Autovinç me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	Në pronësi ose me qira

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur janë me qira të paraqiten: Kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publike ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet që kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për **pikën nr. 2.2.4**, dhe **nr. 2.2.5**, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, **profesionit të punëtorëve** dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

2. Në kërkesën e **pikës nr. 2.2.5**, për kapacitetin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive janë kërkuar **3 kamiona** me kapacitet mbajtës mbi 5 ton në pronësi ose me qira, **3 kamiona** me kapacitet mbajtës deri në 5 ton në pronësi ose me qira dhe **2 autovinça** me kapacitet mbajtës deri në 5 ton, që do të shërbejnë edhe për depozitimin e mbetjeve ndërtimore si rezultat e realizimit të gërmimeve apo transport dheu sipas zërave të preventivit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Njësia	Sasia
I	Ndërtim mur mbajtës Kamenicë		
2/37/5a	Transport mbetur ndërtimore	m ³	23.5
II	Ndërtim kanali në Barç		
2	Punime gërmimi dhe ndërtim kanali		
3.158/5a	Transport dheu me auto deri në 5 km	m ³	6,437
V	Ndërtim kanali në Drenovë		
2	Punime gërmimi dhe ndërtim kanali		
3.158/5a	Transport dheu me auto deri në 5 km	m ³	2,292
VII	Mur mbajtës në rrugën Lavdar i Vjetër-Lavdar i Ri L=70		
1	Punime për murin pritës		
3.158/2a	Transport dheu me auto deri në 5 km	m ³	544
VIII	Argji tura e përroit të Mborjes nga ish-Fabrika e Qelqit deri në dalje të fshatit (Variant me ngritje argji ture) L = 344 ml		
3.158/2a	Transport dheu me auto deri në 1 km	m ³	5,829.5

Në këtë kriter nuk është kërkuar çertifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licensën përkatëse” dhe Kapitulli III.2, “Transporti i mallrave për të vetë”, neni 45, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa çertifikatë”.

3. Në preventivin e punimeve është parashikuar realizimi i zërave të punimeve në rrugë si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Njësia	Sasia
VII	Mur mbajtës në rrugën Lavdar i Vjetër-Lavdar i Ri L=70		
2	Punime në rrugë	Njësia	Sasia
3.211	Shtresë çakulli t=20 cm	m ²	50.0

3.212/b	Shtresë stabilizant t=10 cm	m ²	25.0
VIII	Argji tura e përroit të Mborjes nga ish-Fabrika e Qelqit deri në dalje të fshatit (Variant me ngritje argji ture) L = 344 ml		
3.211	Shtresë çakulli t=20 cm	m ²	1,031
3.212/b	Shtresë stabilizant t=10 cm	m ²	516

Ndërkohë që në kërkesën e **pikës nr. 2.2.5**, për kapacitetin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive nuk është kërkuar si kriter disponibiliteti i mjetit Rul, i cili është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv si: shtresë çakulli dhe shtresë stabilizanti.

4. Në pikën nr. 2.2.7. Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”;
- Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”;
- Çertifikatën ISO 45001:2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Kërkesa për Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Ndërrhyrja për shmangien e përmblytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 832/1, datë 17.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. B.TH kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. G.J.P , znj. E.DH , z. A.D , znj. E.V .

Procesverbali nr. 3, i mbajtur nga KVO i datës 06.09.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 9 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali nr. 4, i mbajtur nga KVO i datës 15.09.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 8 OE dhe skualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e

favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “N ” ShPK (me Nipt J....U) & “N ” ShPK (me Nipt L....L) me vlerë ekonomike të ofertës 34,381,007.30 lekë pa TVSh.
2. BOE “XH ” ShPK (me Nipt J....M) & “B ” ShPK (me Nipt K....A) me vlerë ekonomike të ofertës 38,308,431 lekë pa TVSh.
3. OE “G ” ShPK (me Nipt K....A) & “E ” ShPK (me Nipt K....I) me vlerë ekonomike të ofertës 39,787,314 lekë pa TVSh.
4. OE “S ” ShPK (me Nipt J....G) me vlerë ekonomike të ofertës 40,827,181.50 lekë pa TVSh.
5. BOE “I ” ShPK (me Nipt J....Ë) & “N ” ShPK (me Nipt L....L) me vlerë ekonomike të ofertës 42,931,387 lekë pa TVSh.
6. BOE “I ” ShPK (me Nipt J....M) & “S ” ShPK (me Nipt K....J) me vlerë ekonomike të ofertës 44,082,497.55 lekë pa TVSh.
7. BOE “D ” ShPK (me Nipt K....B) & “E ” ShPK (me Nipt K....A) me vlerë ekonomike të ofertës 45,501,036 lekë pa TVSh.
8. BOE “S ” ShPK (me Nipt J....M) & “A ” ShPK (me Nipt K,...C) me vlerë ekonomike të ofertës 48,303,727 lekë pa TVSh.
9. BOE “A ” ShPK (me Nipt K....T) & “A ” ShPK (me Nipt K....A) me vlerë ekonomike të ofertës 48,803,234 lekë pa TVSh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. BOE “I ” ShPK & “N ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Kontrata e paraqitur nga BOE “I ” ShPK & “N ” ShPK në lidhje me përvojën në punë të ngjajshme me objekt *“Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Myslim Hida, Arapaj, Durrës”*, nuk është e ngjashme me objektin që prokurohet.

- Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit OE “I ” ShPK ka marrë përsipër të kryejë 72% të punimeve ose e konvertuar në vlerën 30,910,598 lekë pa TVSh. Në liçensën profesionale të paraqitur nga OE “I ” ShPK u konstatua se, ky operator ekonomik është i liçensuar për kategorinë N.P.-9 *“Punime dhe mbrojtje lumore sistematike hidraulike dhe bonifikime”* klasifikimi A. Në zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, përcaktohet se klasifikimi A i korrespondon vlerës së punimeve 0-20,000,000 lekë. Në kushte të tilla OE “I ” ShPK duhej të ishte e liçensuar me liçensën për kategorinë/klasifikimin B, pra liçensën N.P-9B dhe jo N.P-9A.

Më datë 28.09.2022, nga KVO është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin e dokumentacionit origjial të BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK. Në datën 10.10.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Me shkresën e datës 10.10.2022, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 8282 prot., datë 28.09.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Referuar Formularit të Vetëdeklarimit të publikuar në SPE, pika “c” Deklaratë *“Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”*, u konstatua se OE “N ” ShPK ka angazhuar mjete dhe pajisje konkretisht mjetin Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton me targë AA769KR me numër shasie ËDB6114181P0 55154 sipas kontratës së qirasë me nr. 3811 Rep., dhe nr. 1121 Kol., me afat nga data 03.11.2021, deri

më 02.11.2024, si dhe 2 betoniere sipas faturës tatimore të blerjes së tyre nr. 80, datë 29.04.2011, në dy kontrata njëkohësisht:

- Kontrata me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022, të lidhur ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe BOE “N ” ShPK & “N ” me objekt “Ndërhyrja për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, me vlerë kontrate 41,257,208.80 lekë me TVSh me afat tre mujor nga lidhje e kontratës.

- Kontrata me nr. 8003/2 prot., datë 04.10.2022, të lidhur ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe OE “N ” ShPK me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese”, me vlerë kontrate 12,024,261.52 lekë me TVSh me afat tre mujor nga lidhje e kontratës.

Në këtë deklaratë citohet se: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë. Mjetet e poshtë shënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti”.

Për sa trajtuar më sipër BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK.

Mosdisponimi, apo mosngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s’kualifikimin e BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzion: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit për vlerën **34,381,007.30 lekë**. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.F Kryetar i BASHKISË KORÇË në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. M.S , znj. M.B , z. B.M në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe znj. B.TH , znj. GJ.P , znj. E.DH , z. A.D , znj. E.V në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë, ku janë shkrehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se në dosje nuk disponohet një urdhër për llogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike etj., ju sqarojmë se:

Dokumentacioni i mësipërm është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, një nga detyrat funksionale të së cilës sipas rregullores të organizimit dhe funksionimit të BASHKISË KORÇË është edhe hartimi i dokumentacionit teknik të investimeve. Duke e konsideruar këtë detyrë funksionale të kësaj drejtorie nuk ka një urdhër të veçantë për caktimin e këtyre detyrave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa i përket pretendimeve të ngritura nga ana Juaj, ju bëjmë me dije se grupi i auditimit në asnjë rast nuk është shprehur se në dosjen e procedurës “Ndërhyrja për shmangien e përmytjeve dhe

erozionit në Bashkinë Korçë” nuk disponohet urdhër për për llogaritjen e fondit limit apo specifikimeve teknike. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me kriteret e vendosura për numrin e punëtorëve dhe mjeteve/pajisjeve të kërkuara, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 18.08.2022, nga specialisti i fushës, z. B.M Inxhinier Ndërtimi ritheksojmë se ato janë argumentuar në këtë procesverbal. Sqarojmë se numri prej 84 punonjësish nuk do të ndryshonte edhe sikur të ishin përcaktuar profesionet e punonjësve sepse ai ka dalë nga llogaritja e orëve totale të punës që nevojiten për kryerjen e të gjitha procesve të punës sipas zërave të preventivit. Konkretisht nga llogaritjet e bëra rezultojnë se:

Sasia e orëve të punës sipas manualit dhe analizave teknike është 42,960 orë. Llogaritja e numrit të punonjësve në varësi të orëve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	42,960
Ditë pune (orë pune/8)	5,370
Specialistë, punëtorë për 3 muaj	81
Inxhinier ndërtimi	1
Inxhinier topograf	1
Inxhinier hidroteknik	1
Numri i punëtorëve gjithsej	84

Si rrjedhim nuk mund të konsiderohet kriteri diskriminues kërkesa për 84 punonjësish për sa kohë që ajo nuk është vënë apriori apo në mënyrë subjektive por ka rezultuar nga llogaritjet e orëve të punës. Lidhur me përcaktimin e profesionit të punëtorëve, ritheksojmë se nuk është bërë detajimi për profesionin e secilit punonjës por është vendosur vetëm stafi kryesor inxhinierik duke u bazuar në nenin 39, pika 6, gërma c dhe ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku përcaktohet shprehimisht:

6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe liçencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) Fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

Pra specialisti i fushës në njësinë e prokurimit i është përmbajtur në mënyrë strikte përcaktimit ligjor të bërë më sipër. Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike, janë kërkuar, nga specialisti i fushës mjetet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Eskavator me goma, 0.25 m ³	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Betoniere	Copë 6	Në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Autovinç me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	Në pronësi ose me qira

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të investimit, volumin e konsiderueshëm të punimeve të parashikuara, afatin prej 3 muajsh të punimeve, faktin që punimet duhet të kryheshin 8 objekte të cilat janë të shpërndara dhe në largësi nga njëri-tjetri, vlerësojmë se mjetet e kërkuara janë minimale dhe nuk janë diskriminuese dhe penguese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Përfundimi i grupit të auditimit se kriteret teknike të vendosura kanë ngushtuar konkurrencën apo kanë penguar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke u mbështetur vetëm tek fakti që duhej një analizë më e thelluar për këto kriteret, mendojmë se nuk qëndron. Këtë e dëshmon edhe fakti që në këtë procedurë kanë marrë pjesë 9 operatorë dhe nuk ka patur ankesa në asnjë fazë të procedurës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Problematika e ngritur nga grupi i auditimit nuk ka të bëjë me faktin se, NjP nuk disponon dokumentacion mbi argumentimin e fuqisë punëtore, por që argumentimi i kryer nga NjP (inxhinier z. B.M anëtarë i NjP) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht. Për t’u përlllogaritur fuqia punëtore për një procedurë prokurimi me objete punime ndërtimi përmban disa elemente, konkretisht nuk janë vetëm orët e punës së bashku me preventivin (si pjesë e dokumentacionit të argumentimit) të

paraqitur nga Ju si pjesë e dosjes së kësaj procedure apo edhe në observacion por edhe analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive. Gjithashtu vlen të theksohet që, nga vetë NjP konfirmohet nëpërmjet këtij observacioni, se në dokumentacionin mbi argumentimin e fuqisë së punëtorëve nuk është përfshirë profesioni i punëtore, ndërkohë që ky është një prej elementëve më të rëndësishëm për përlllogaritjen e fuqisë punëtore. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

3. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me certifikatat ISO 9001 dhe 14001:

Ritheksojmë se ato janë vendosur bazuar në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Standartet ISO 9001 dhe 14001 janë standartet më të përdorura nga kompanitë dhe në këndvështrimin tonë (për sa kohë lejohen ligjërisht) ato janë një element i shtuar sigurie për autoritetin kontraktor që organizimi dhe realizimi i punës objekt prokurimi të kryhet me standarte, cilësi dhe të respektojë normat mjedisore duke minimizuar efektet negative në mjedis gjatë punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Kërkesa për Certifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, kjo certifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”.

Kërkesa për Certifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

4. Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me vlerësimin e procedurës të prokurimit me objekt “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se Shoqëria “N ” ShPK ka angazhuar një mjet kamion dhe dy betoniere në dy kontrata njëkohësisht “Përmirësimi i banesave ekzistues” dhe “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë” ju sqarojmë se:

Së pari: Qëndrimi i mbajtur nga ana jonë në observacionet e paraqitura nuk ka të bëjë me faktin se KVO e ka të pamundur të verifikojë plotësimin e kriterëve në dy procedura që zhvillohen njëkohësisht. Grupi i auditimit ka konstatuar se Shoqëria “N ” ShPK deklaruar mjete dhe makineri të cilat i ka angazhuar në një kontratë tjetër “Përmirësimi i banesave ekzistues”.

Për këtë arsye në observacionin e paraqitur është sqaruar se këto procedura janë zhvilluar dhe vlerësuar pothuaj në të njëjtën kohë. Në momentin kur është bërë nga KVO vlerësimi i procedurës “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë” Shoqëria “N ” ShPK nuk kishte lidhur kontratën me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistues”. Një mjet konsiderohet se është i angazhuar vetëm në momentin e lidhjes të kontratës dhe jo në momentin e që ka bërë deklarin.

Së dyti: Grupi i auditimit nuk është shprehur lidhur me observimin e bërë nga KVO se:

Në këtë procedure prokurimi Shoqëria “N ” ShPK ka dorëzuar ofertën si bashkim shoqërisht me

shoqërinë “N” ShPK.

Në kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit janë kërkuar gjithësej 6 betoniere, nga Shoqëria “N” ShPK janë deklaruar 6 betoniere dhe nga shoqëria “N” ShPK janë deklaruar 4 betoniere, pra në total 10 betonerie nga 6 të kërkuara.

Në lidhje me kamionët me kapacitet mbajtës deri në 5 ton janë kërkuar 2 copë, nga Shoqëria “N” ShPK janë deklaruar 2 kamionë dhe nga Shoqëria “N” ShPK është deklaruar 1 copë pra 3 mjete nga 2 që janë kërkuar.

Në përfundim edhe sikur të mos llogariten mjetet/pajisjet që nga audituesi janë konsideruar të angazhuara sërisht bashkimi i operatoreve “N” ShPK dhe “N” ShPK plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit për paraqitjen e 2 kamjonëve deri në pesë ton dhe 6 betonierve, sepse ka paraqitur më tepër mjete nga sa janë kërkuar.

3. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se: “Nga audituesi është arritur në përfundimin se KVO duhet të s’kualifikonte bashkimin e Shoqërive “N” ShPK dhe “N” ShPK dhe të anulonte procedurën e prokurimit “s qarojmë se

Observacionet e KVO lidhen me konstatimin tuaj se procedura duhet të anulohet.

Komisioni ka paraqitur observacionet dërguar me aktin e konstatimit nr. 8 duke sqaruar se edhe sikur të s’kualifikohej bashkimi i Shoqërive “N” ShPK dhe “N” ShPK (i cili në vlerësimin tonë i plotëson kriteret për kualifikim) procedura nuk mund të anulohet pasi janë kualifikuar edhe 8 operatorë të tjere për të cilët grupi i auditimit nuk ka paraqitur vërejtje lidhur me kualifikimin e tyre. Për sa më sipër në rast se do të ishte skualifikuar oferta ebashkimit të shoqërive “N” ShPK dhe “N” ShPK, oferta vijuese e rregullt ishte oferta e paraqitur nga bashkimi i shoqërive “XH” ShPK & “B” ShPK me vlerë 38,308,431 lekë, rrjedhimisht diferenca prej 3,927,423 lekë, pa TVSh, që do të krijohet si rezultat i kësaj vendimmarrje mund të konsiderohet keqpërdorim i fondeve publike.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari: Kontratat nuk janë lidhur në të njëjtën kohë, pretendim i cili është ngritur nga Ju por rreth 40 ditë nga njëra tjetra pra kontrata me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022, dhe kontrata me nr. 8003/2 prot., datë 04.10.2022. Në kushte të tilla pretendimi i Juaj nuk qëndron. Kjo situatë nuk ka të bëjë vetëm me momentin e lidhjes së kontratës por edhe zbatimin e saj pra zbatimi i tyre ka qenë në të njëjtën kohë.

Paraqitja nga BOE sasi të mjeteve apo pajisjeve më tepër nga çfarë është kërkuar në Dokumentet e Tenderit dhe në kushte të tilla kriteri është i përmbushur, është jashtë kontekstit për arsye se, jemi përballë faktit që OE i shpallur fitues është BOE dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit secili OE ka të përcaktuar përqindjet respektive për përmbushjen e kriterëve respektive. Konkretisht për pjesën (% sipas kontratës së bashkëpunimit) e OE “N” ShPK ka deklaruar mjete dhe pajisje të cilat i ka pasur të angazhuara në kontratë tjetër. Për më tepër në zbatim të plotësimit të Formularit të Vetëdeklarimit të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik gërma “c”, OE “N” ShPK është shprehur mjaft qartë dhe në mënyrë eksplicite se: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë. Mjetet e poshtë shënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti”, ndërkohë që mjetet dhe pajisjet e trajtuar më sipër janë angazhuar edhe në kontratë tjetër.

Për më tepër në rastin e parë njoftimi i fituesit është mbajtur me shkresën nr. 8282 prot., datë 28.09.2022, dhe tjetra me shkresën 8003 prot., datë 20.09.2022, pra 8 ditë nga njëra tjetra dhe në KVO kanë qenë anëtarët znj. B.TH ,

Së dyti: Në dijeninë e grupit të auditimit, nuk rezulton asnjë dispozitë ligjore në legjislacionin/rregullat e Prokurimit Publik në të cilën KVO mund të shpall fitues një operatorë ekonomik në kushtet që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT edhe pse ka ofertën ekonomike më të ulët.

Së treti: Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues të BOE “N” ShPK & “N” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të verifikonte dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në DT shpallte fitues OE/BOE konkures nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën 34,381,007.30 lekë pa TVSh.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova

dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 819, datë 11.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 819, datë 11.08.2022. 1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxhinier Agro-Ushqimore 3. B.M , Inxhinier Ndërtimi	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 819/1, datë 11.08.2022, i ndryshuar me Urdhërin nr. 819/2, datë 29.08.2022. 1. B.TH , Kryetar 2. E.DH , Anëtar 3. A.D , Anëtar 4. M.B , Anëtar 5. I.M , Anëtar
4. Lloji i Procedurës: Procedurë e hapur		
5. Fondi Limit: 24,755,991 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “A ” ShPK me vlerë oferte 18,913,309.62 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 7638/2 prot., datë 22.09.2022, me vlerë 22,647,971.54 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 5,842,681.38 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.08.2022	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 5 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”, janë siguruar fonde në vlerën 29,656,658 lekë si rezultat i bashkë fll ncimit të AZHBR sipas shkresës me nr. 1641/1 prot., datë 21.06.2022, “Njoftim për miratimin e aplikimit”, dhe BASHKISË KORÇË sipas VKB nr. 126, datë 29.07.2022, “Për miratimin e kontributit të Bashkisë për TVSh, mbikëqyrjen dhe kolaudimin për objektin “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë” financuar nga AZHBR” dhe VKB nr. 127, datë 29.07.2022, “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit dhe përdorimin e grandit për objektin “Punime shtesë tregu i gjësë së gjallë” financuar nga AZHBR”. Konfirmimi i fondeve është kryer nga Dega e Thesarit Korçë në mënyrë elektronike më datë 12.08.2022.

Situata: Në datën 10.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentacionit teknik për objektin “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”. Me shkresën e datës 10.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është dërguar pranë Drejtorisë së Prokurimeve dokumentacioni teknik për nisjen e procedurës së prokurimit. Në dosjen e projektit përfshihen: Projekti i zbatimit; Preventivi i punimeve; Grafiku i punimeve; Specifikimet teknike dhe Analiza e çmimeve.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga urb. znj. ZH.L , konfirmuar nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë. Nga verifikimit në internet është konstatuar se urb. znj. ZH.L nuk është e pajisur me liçensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit¹⁵, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5.

Ndikimi/Efekti: Caktimi i punonjësve të pa pajisur me liçensat përkatëse, ndikon në mos hartimin e projekt-preventivin e punimeve cilësorë dhe real në lidhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për punimet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

¹⁵ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Me Urdhërin nr. 819, datë 11.08.2022, të z. K.K me detyrë Nënkyetar i Bashkinë në cilësinë e personit të autorizuar në zbatim të Urdhërit nr. 790/1, datë 02.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M

Me Urdhërin nr. 819, datë 11.08.2022, të z. K.K me detyrë Nënkyetar i Bashkisë në cilësinë e personit të autorizuar, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: *“Punime shitesë tek tregu i gjësë së gjallë”* me fond limit në vlerën 24,755,991 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës *“Procedurë e hapur”*.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhërit nr. 819, datë 11.08.2022, të z. K.K me detyrë Nënkyetar i Bashkinë në cilësinë e personit të autorizuar, ing. z. B.M ka mbajtur procesverbalin e datës për hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Në datën 12.08.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Në datën 12.08.2022, nga NjP e përbërë nga znj. M.S , zj. M.B dhe z. B.M është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit.

Më datë 17.08.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Korçë, rezulton se: për procedurën me REF-38434-08-12-2022, me objekt *“Punime shitesë tek tregu i gjësë së gjallë”*, Bashkia Korçë me fond limit 24,755,991 lekë pa TVSh, ka sugjeruar disa kriterë të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në datën 18.08.2022, nga ing. B.M është mbajtur procesverbali për disa ndryshime në procesverbalin e datës 12.08.2022, *“Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për objektin e prokurimit “Punime shitesë tek tregu i gjësë së gjallë”*.

Në datën 18.08.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali nr. 2, për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Ishte	Bëhet
<p>2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: Kategoria klasifikimi emërtimi i kategorisë: -N. P. 1 A “Punime gërmimi në tokë”. -N. P. 2 A “Ndërtime civile e industriale”. -N. P. 4 A “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”. -N. P. 7 A “Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje”. -N. S. 12 A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. -N. S. 18 A “Punime topogjeodezike”.</p>	<p>2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: Kategoria klasifikimi emërtimi i kategorisë: -N. P. 1 A “Punime gërmimi në tokë”. -N. P. 4 A “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”. -N. P. 7 A “Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje”. -N. S. 12 A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”. -N. S. 18 A “Punime topogjeodezike”.</p>
<p>2.2.6. Në rast se nuk ka në pronësi apo me qira njeje të thyerjes të materialeve inerte duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, planin e vendosjes të njes, dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit). Në rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk është në pronësi apo me qira, duhet të paraqitet kontratë furnizimi me prodhuesin e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, planvendosjen e fabrikës dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit ose leja mjedisore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit).</p>	<p>Në rast se nuk ka në pronësi apo me qira njeje të thyerjes të materialeve inerte duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj. Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë që prodhuesi është i pajisur me leje mjedisore për njejen e thyerjes të materialeve inerte. Në rast se Fabrika e asfaltobetonit nuk është në pronësi apo me qira, duhet të paraqitet kontratë furnizimi me prodhuesin e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj. Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë që prodhuesi është i pajisur me leje mjedisore për fabrikën e asfaltobetonit.</p>
Data e zhvillimit të procedurës nuk ka ndryshuar	

1. Në pikën 2.2.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **36 persona**, dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listëpagesat

e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Në pikën nr. 2.2.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbartës ≥ 10 ton	Copë 1	në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 ton	Copë 1	në pronësi ose me qira
Mjet gjurmimi me goma	Copë 1	në pronësi ose me qira
Greider	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobot	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	në pronësi ose me qira
Betoinere	Copë 1	në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	Copë 1	në pronësi ose me qira
Asfaltshtruese	Copë 1	në pronësi ose me qira
Rrul	Copë 1	në pronësi ose me qira
Nyje thyerje materialesh inerte	Copë 1	në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi
Fabrikë asfaltbetoni	Copë 1	në pronësi, me qira, ose kontratë furnizimi

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur janë me qira të paraqiten: kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publike ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet të kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NJP për pikën nr. 2.2.5, dhe nr. 2.2.6, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërish për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, **profesionit të punëtorëve** dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

2. Në kërkesën e pikës nr. 2.2.6, për kapacitetin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive janë kërkuar **1 Kamion** me kapacitet mbartës ≥ 10 ton në pronësi ose me qira dhe **1 Kamion** me kapacitet mbartës deri në 5 ton në pronësi ose me qira që do të shërbejnë për transport dhe si rezultat e realizimit të gjurmimeve sipas zërave të preventivit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia
1	Punime për rrethim		
2/37/1a	Transport dhera 1 km	m ³	69
3.158/2a	Transport dheu me auto deri në 1 km	m ³	5,829.5

Në këtë kriter **nuk është kërkuar çertifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira** e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa liçencën përkatëse”.

3. Në pikën nr. 2.2.7. Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”;
- Çertifikatën ISO 14001: 2015 “Për menaxhim mjedisi”;
- Çertifikatën ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*". Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2015 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë"**, kjo çertifikatë në të gjithë "argumentimin" nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç'lidhje ka: "*Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve*", me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: "*Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë*".

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 "Për menaxhim mjedisi"**, Ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifitimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", si dhe nenet 39 "*Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike*" dhe neni 78 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 819/1, datë 11.08.2022, të z. K.K me detyrë Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e personit të autorizuar është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. B.TH kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. G.J.P , znj. E.DH , z. A.D , z. I.M .

Me Urdhërin nr. 819/2, datë 29.08.2022, të z. K.K me detyrë Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e personit të autorizuar është zëvendësuar një prej anëtarëve të KVO-së konkretisht znj. G.J.P me znj. M.B .

Procesverbali nr. 3, i mbajtur nga KVO i datës 30.08.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 5 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali nr. 4, i mbajtur nga KVO i datës 31.08.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga

ku ka rezultuar se janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “A ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “A ” ShPK (me Nipt K....C) me vlerë ekonomike të ofertës 18,913,309.62 lekë pa TVSh.
2. OE “S ” ShPK (me Nipt J....M) me vlerë ekonomike të ofertës 20,421,142.6 lekë pa TVSh.
3. OE “A ” ShPK (me Nipt K....T) me vlerë ekonomike të ofertës 20,421,142.6 lekë pa TVSh.
4. OE “XH ” ShPK (me Nipt J....M) me vlerë ekonomike të ofertës 22,772,343 lekë pa TVSh.
5. OE “I ” ShPK (me Nipt J....Ë) me vlerë ekonomike të ofertës 24,739,312 lekë pa TVSh.

Më datë 08.09.2022, nga KVO është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin e dokumentacionit origjinal të OE “A ” ShPK. Në datën 20.09.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Me shkresën e datës 20.09.2022, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 7638 prot., datë 08.09.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “A ” ShPK.

1. Nga OE “A ” ShPK nuk është plotësuar pika nr. 2.2.6, e DT ku kërkohet: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme*”:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbartës ≥10 ton	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 ton	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Mjet gjurmimi me goma	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Greider	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Autobot	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Betoinere	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Asfaltshtruese	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Rrul	Çopë 1	në pronësi ose me qira
Nyje thyerje materialesh inerte	Çopë 1	në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi
Fabrikë asfaltbetoni	Çopë 1	në pronësi, me qira, ose kontratë furnizimi

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur janë me qira të paraqiten: kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publike ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet të kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

- Për mjetin Kamion me targë AA083ZP (i evidentuar në deklaratën për disponimin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për realizim të punimeve objekt kontrate) kapaciteti mbajtës i tij është 25.8 ton (40,000-14,150 = 25,850) referuar të dhënave në lejen e qarkullimit me numër serie FRD0306620, ndërkohë që në kriter kërkohet që kapaciteti mbajtës ≥ 10 ton.

- Për makinerinë Greider, pasi mjeti i paraqitur me numër shasie DG65341, i marrë me qira sipas kontratës nr. 6873 Rep., dhe nr. 2227 Kol., datë 03.11.2021, të lidhur ndërmjet OE “A ” ShPK me përfaqësues z. A.GJ dhe Shoqërisë “L ” me përfaqësues administrator z. F.A , nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën/vërtetimin e zhdoganimit të datës 13.03.2003, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dogana Vlorë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998,

“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Maki t teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i maki ve teknologjike”.

Për sa trajtuar më sipër OE “A ” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO-ja nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE “A ” ShPK.

Mosdisponimi, apo mosngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “A ” ShPK, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO-ja dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga Titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “A ” ShPK. Sa më sipër KVO-ja nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “A ” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **18,913,309.62 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.F Kryetar i BASHKISË KORÇË në cilësinë e Titullarit të AK, znj. M.S , znj. M.B , z. B.M në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe znj. B.TH , znj. M.B , znj. E.DH , z. A.D , z. I.M në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë, ku janë shkrehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me kriteret e vendosura për numrin e punëtorëve dhe mjeteve/pajisjeve të kërkuara, sipas procesverbalit të mbajtur ne datë 12.08.2022, ndryshuar me procesverbalin datë 18.08.2022, nga specialisti i fushës z. B.M Inxhinier Ndërtimi ritheksojmë se ato janë argumentuar në këtë procesverbal. Sqarojmë se numri prej 36 punonjësish nuk do të ndryshonte edhe sikur të ishin përcaktuar profesionet e punonjësve sepse ai ka dalë nga llogaritja e orëve totale të punës që nevojiten për kryerjen e të gjitha procesve të punës sipas zërave të preventivit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera rezulton se:

Sasia e orëve të punës sipas manualit dhe analizave teknike është 12,021 orë. Llogaritja e numrit të punonjësve në varësi të orëve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	12,021
Ditë pune (orë pune/8)	1,503
Specialistë, punëtorë për 2 muaj	34
Inxhinier ndërtimi	1
Inxhinier topograf	1
Numri i punëtorëve gjithsej	36

Si rrjedhim nuk mund të konsiderohet kriter diskriminues kërkesa për 36 punonjësish për sa kohë që ajo nuk është vënë apriori apo në mënyrë subjektive por ka rezultuar nga llogaritjet e orëve të punës. Lidhur me përcaktimin e profesionit të punëtorëve, ritheksojmë se nuk është bërë detajimi për profesionin e secilit punonjës por është vendosur vetëm stafi kryesor inxhinierik duke u bazuar në nenin 39 pika 6 gërma c dhe ç të VKM VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku përcaktohet shprehimisht: 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale,

kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

Pra specialisti i fushës në njësinë e prokurimit i është përmbajtur në mënyrë strikte përcaktimit ligjor të bërë më sipër.

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike, janë kërkuar, nga specialisti i fushës mjetet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbartes ≥10 ton	Copë 1	në pronësi ose me qira
Kamion me kapacitet mbartes deri në 5 ton	Copë 1	në pronësi ose me qira
Mjet gjurmimi me goma	Copë 1	në pronësi ose me qira
Greider	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobot	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobetoniere	Copë 1	në pronësi ose me qira
Betoinere	Copë 1	në pronësi ose me qira
Tokmak elektrik	Copë 1	në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	Copë 1	në pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	Copë 1	në pronësi ose me qira
Rrul	Copë 1	në pronësi ose me qira
Nyje thyerje materialesh inerte	Copë 1	në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi
Fabrike asfaltbetoni	Copë 1	në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të investimit, volumin e punimeve të parashikuara, afatin prej 2 muajsh të punimeve, vlerësojmë se mjetet e kërkuara minimale dhe nuk janë diskriminuese dhe penguese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Përfundimi i grupit të auditimit se kriteret teknike të vendosura kanë ngushtuar konkurrencën apo kanë penguar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke u mbështetur vetëm tek fakti që duhej një analizë më e thelluar për këto kriteret, mendojmë se nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Problematika e ngritur nga grupi i auditimit nuk ka të bëjë me faktin se, NjP nuk disponon dokumentacion mbi argumentimin e fuqisë punëtore, por që argumentimi i kryer nga NjP (inxhinier z. B.M anëtarë i NjP) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërishit. Për t’u përlllogaritur fuqia punëtore për një procedurë prokurimi me obje punime ndërtimi përmban disa element, konkretisht nuk janë vetëm orët e punës së bashku me preventivin (si pjesë e dokumentacionit të argumentimit) të paraqitur nga Ju si pjesë e dosjes së kësaj procedure apo edhe në observacion por edhe analiza e detajuar mbi kuadrinin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive. Gjithashtu vlen të theksohet që, nga vetë NjP konfirmohet nëpërmjet këtij observacioni, se në dokumentacionin mbi argumentimin e fuqisë së punëtorëve nuk është përfshirë profesioni i punëtorëve, ndërkohë që ky është një prej elementëve më të rëndësishëm për përlllogaritjen e fuqisë punëtore. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me çertifikatat ISO 9001 dhe 14001:

Ritheksojmë se ato janë vendosur bazuar në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Standartet ISO 9001 dhe 14001 janë standartet më të përdorura nga kompanitë dhe në këndvështrimin tonë (për sa kohë lejohen ligjërishit) ato janë një element i shtuar sigurie për autoritetin kontraktor që organizimi dhe realizimi i punës objekt prokurimi të kryhet me standarte, cilësi dhe të respektojë normat mjedisore duke minimizuar efektet negative në mjedis gjatë punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Kërkesa për Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje

ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

3. Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me vlerësimin e procedurës te prokurimit me objekt “Punime shtesë tek tregu i gjësë së gjallë”.

1. Nga grupi i auditimit është konstatuar per mjeti i paraqitur nga shoqëria A , me targë AA083 ZP me kapacitet mbajtës 25.8 ton nuk plotëson kriterin e kualifikimit lidhur me kapacitetin mbajtës të mjetit sqarojmë se:

Në kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit është kërkuar “Kamion me kapacitet mbartës ≥ 10 ton” (më i madh baraz me 10 ton).Për sa kohë mjeti ishte me kapacitet mbartës 25.8 ton rrjedhimisht është më i madh se 10 ton (25.8 ton >10 ton), pra plotëson kriterin e vendosur.

2. Lidhur me mjetin grejder, KVO ka vlerësuar se se ky është një mjet që nuk kategorizohet në mjetet që shënohet në regjistrat publike sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 10 “Mjetet jashtë norme dhe transportet në kushte jonormale”, pika 1 përcaktohet “Konsiderohet jashtë norme mjeti që i kalon, për kërkesa funksionale të veçanta, kufijtë e përmasave gabaritë dhe kufijtë e ngarkesave të përcaktuara në nenet 61 dhe 62. Neni 58, “MakI t Teknologjike”, pika 4 parashikohet: “Për t’iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makI nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makI t teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale”. Neni 59, “Mjete rrugore të veçanta”, pika 1 parashikohet: “Quhen mjete rrugore të veçanta, ato që për karakteristikat e tyre të veçanta nuk bëjnë pjesë në mjetet e kategorizuara nga neni 52 deri te neni 58”.

Pra, referuar Ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, Kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, pajisen me leje qarkullimi dhe dokumentacion shoqëruet të gjitha ato mjete që qarkullojnë në rrugë. Duke qenë se mjeti grejder është mjet që përdort vetëm brenda në zonat e punës, në kantijere ndërtimi dhe nuk qarkullojnë/lëvizin në rrugë nacionale apo urbane lëvizja e tij nga një kantier në tjetrin bëhet me rimorkiator. Në këto kushte KVO ka gjykuar se këto janë mjete te cilat nuk shënohen në regjistra publikë dhe dorëzimi i kontratës të qirasë dhe deklaratës doganore përmbush kriterin e caktuar në dokumentat e tenderit për këto mjete.

3. Lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit se: “Nga audituesi është arritur në përfundimin se KVO duhet të skualifikonte shoqërinë A dhe të anulonte procedurën e prokurimit “sqarojmë se:

Observacionet e KVO lidhen me konstatimin tuaj se procedura duhet të anulohet.

Komisioni ka paraqitur observacionet dërguar me aktin e konstatimit nr. 9 duke sqaruar se edhe sikur të s’kualifikohej shoqërinë A (e cila në vlerësimin tonë i plotëson kriteret për kualifikim) procedura nuk mund të anulohet pasi janë kualifikuar edhe 4 operatorë të tjerë për të cilët grupi i auditimit nuk ka paraqitur vërejtje lidhur me kualifikimin e tyre.

Për sa më sipër në rast se do të ishte skualifikuar oferta e shoqërisë “A ” ShPK oferta vijuese e rregullt ishte oferta e paraqitur nga shoqëria “S ” ShPK me vlerë 20.421.142 lekë, rrjedhimisht diferenca prej 1,507,832 lekë, pa TVSh, që do të krijohej si rezultat i kësaj vendimmarrje mund të konsiderohej keqpërdorim i fondeve publike.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari: Përmbushja e kapacitetit mbajtës të një mjetit është një element shumë i rëndësishëm për realizimin e punimeve. Në rast se mjeti i paraqitur nga OE nuk përmbush këtë kriter përbën kusht s’kualifikues. Opinioni i KVO-së ku shprehet se, mjeti ka kapacitet mbajtës më të madh dhe përmbush këtë kriter, është jashtë kontekstit për arsye se kriteri është mjaft i qartë konkretisht ≥ 10

ton, dhe për këtë kriter mund të mos kenë marrë pjesë OE të tjerë që i kanë pasur mjetet me kapacitet më të madh se 10 ton.

Së dyti: Mjeti Grejder është mjet me goma dhe në kushte të tilla duhet të jetë i pajisur me targë, leje qarkullimi etj., në zbatim të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “MakI t teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makI ve teknologjike”, ku përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makI t teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”.

Së treti: Në dijeninë e grupit të auditimit, nuk rezulton asnjë dispozitë ligjore në legjislacionin/rregullat e Prokurimit Publik në të cilën KVO mund të shpall fitues një operatorë ekonomik në kushtet që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT edhe pse ka ofertën ekonomike më të ulët.

Së katërti: Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues të BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të verifikonte dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në DT shpallte fitues OE/BOE konkurrues nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën 18,913,309.62 lekë pa TVSh.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 839, datë 19.08.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 839, datë 19.08.2022.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 839/1, datë 19.08.2022, i ndryshuar me Urdhërin nr. 839/2, datë 06.09.2022.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.	1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxhinier Agro-Ushqimore 3. B.M , Inxhinier Ndërtimi	1. B.TH , Kryetar 2. I M , Anëtar 3. M.L , Anëtar 4. A.D , Anëtar 5. O.L , Anëtar
5. Fondi Limit: 13,724,917 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “N ” ShPK me vlerë 10,020,217.59 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 8003/2 prot., datë 04.10.2022, me vlerë 12,024,261.52 lekë me TVSh	7. Diferenca me fondin limit: 3,704,699.41 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 07.09.2022.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 4 OE b) Skualifikuar: 1 c) Kualifikuar: 3
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese”, janë siguruar fonde në vlerën 16,469,900 lekë nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË sipas njoftimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 144/30 prot., datë 28.07.2022, VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6, datë 27.01.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2021, mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë” dhe Urdhërit nr. 43, datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2022 të BASHKISË KORÇË dhe Institucioneve të Varësisë”. Konfirmimi i fondeve është kryer nga Dega e Thesarit Korçë në mënyrë elektronike më datë 19.08.2022.

Në datën 15.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentacionit teknik për objektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese”. Me shkresën e datës 15.08.2022, nga znj. ZH.L me detyrë Drejtor i DPKZHT është dërguar pranë Drejtorisë së Prokurimeve dokumentacioni teknik për nisjen e procedurës së prokurimit. Në

dosjen e projektit përfshihen: Projekti i zbatimit; Preventivi i punimeve; Grafiku i punimeve; Specifikimet teknike dhe Analiza e çmimeve.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar urbanistja znj. ZH.L konfirmuar nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë. Nga verifikimit në internet është konstatuar se znj. ZH.L nuk është e pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit¹⁶, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.

Me Urdhërin nr. 839, datë 19.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M .

Me Urdhërin nr. 839, datë 19.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese” me fond limit 13,724,917 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhërit nr. 839, datë 19.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ing. z. B.M ka mbajtur procesverbalin nr. 1, datë 22.08.2022, për hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Në datën 22.08.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Në datën 22.08.2022, nga NjP e përbërë nga nj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit.

1. Në pikën nr. 2.2.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

a) elektrikist 1 punonjës

Për stafin e sipërcituar të paraqitet:

I. Kontrata e punës;

II. Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Në pikën nr. 2.2.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **23 persona**, dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Në pikën nr. 2.2.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Betoniere	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Vinç stacioner	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinç	Copë 2	Në pronësi ose me qira

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet, çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

¹⁶ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Kur janë me qira të paraqiten: Kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk shënohen në regjistra publike ofertuesi duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qira duhet kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

Për sa trajtuar më sipër kriteri nr. 2.2.4, nr. 2.2.5, dhe nr. 2.2.6, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, **profesionit të punëtorëve** dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

2. Në kërkesën e pikës nr. 2.2.6, për kapacitetin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive janë kërkuar 2 Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton në pronësi ose me qira dhe 2 Autovinc me kapacitet mbajtës deri në 5 ton që do të shërbejnë edhe për depozitimin e mbetjeve ndërtimore sipas zërave të preventivit të punimeve si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Njësia	Sasia
I	Punime çatie, Pallati nr. 4, (1KT), Rruga Mihallaq Qirinxi, Lagja 5		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	31.0
II	Punime çatie, Pallati nr. 26, (2KT), Rruga Pandi Kërëku, Lagja 6		
I	Punime ndërtimore		
3.158/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	34.0
III	Hidroizolim tarace Pallati nr. 18, H/3 (5KT), Rruga Insan Korça, Lagja 17		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	28.0
IV	Punime çatie, Pallati nr. 12, dhe 13 (1KT), Rruga Ismail Lafifllari dhe Rruga Mihallaq Qirinxi, Lagja 5		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	34.0
V	Punime çatie, Pallati nr. 2, (2KT), Rruga Naum Karanxha, Lagja 4		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	5.0
VI	Punime çatie, Pallati nr. 4, (2KT), Rruga Jorgji Shtika, Lagja 4		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	12.0
VII	Punime çatie, Pallati nr. 6, (2KT), Rruga Jorgji Shtika, Lagja 4		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	12.0
VIII	Punime çatie, Pallati nr. 3, (3KT) Rruga Xhafer Cenko Lubonja, Lagja 17		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	28.0
IX	Punime çatie, Pallati nr. 7, (3KT), Rruga Xhafer Cenko Lubonja, Lagja 17		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	31.0
X	Punime çatie, Pallati nr. 15, (2KT), Rruga Branko Kadia, Lagja 6		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	31.0
XI	Punime çatie, Pallati nr. 37, (2KT), Rruga Sabaudin Kacidhja, Lagja 17		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	7.0
XII	Punime çatie, Pallati nr. 30, (3KT), Rruga Petro Strugji, Lagja 6		
I	Punime ndërtimore		
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	16.0

Në këtë kriter nuk është kërkuar çertifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41.

3. Në pikën nr. 2.2.7. Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”;
- Çertifikatën ISO 14001: 2015 “Për menaxhim mjedisi”;
- Çertifikatën ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”**, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarde të cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjegje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.S , znj. M.B dhe z. B.M në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 839/1, datë 19.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. B.TH kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. I M , znj. M.L , z. A.D , z. I.M . Me Urdhërin nr. 839/2, datë 06.09.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ka përsuar një ndryshim KVO konkretisht anëtari i komisionit z. I.M është zëvendësuar me z. O.L .

Procesverbali nr. 2, i mbajtur nga KVO i datës 07.09.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali nr. 3, i mbajtur nga KVO i datës 16.09.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 3 operatorë ekonomikë dhe skualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “N ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “N ” ShPK (me Nipt J....U) me vlerë ekonomike të ofertës 10,020,217.59 lekë pa TVSh.
2. OE “I ” ShPK (me Nipt J....Ë) me vlerë ekonomike të ofertës 10,467,141 lekë pa TVSh.
3. BOE “V ” ShPK (me Nipt K....F) & “A ” ShPK me Nipt (K....T) me vlerë ekonomike të ofertës 12,256,835 lekë pa TVSh.

4. OE “A ” ShPK (me Nipt J....O) me vlerë ekonomike të ofertës 13,476,112.65 lekë pa TVSh. Më datë 20.09.2022, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 4, mbi shqyrtimin e dokumentacionit origjinal të OE “N ” ShPK. Në datën 30.09.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e titullarit të AK. Me shkresën e datës 30.09.2022, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 8003 prot., datë 20.09.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “N ShPK.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. BOE “V ” ShPK & “A ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Për arsye se çertifikata ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi” dhe ISO 45001:2018 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”, nuk janë të vlefshme pasi afati i çertifikimit të tyre ka përfunduar në datën 28.05.2020.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë, ku janë shkrehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me kriteret e vendosura për numrin e punëtorëve dhe mjeteve/pajisjeve të kërkuara, sipas procesverbalit të mbajtur ne datë 22.08.2022, nga specialisti i fushës z. B.M inxhinier ndërtimi ritheksojmë se ato janë argumentuar në këtë procesverbal. Sqarojmë se numri prej 23 punonjësish nuk do të ndryshonte edhe sikur të ishin përcaktuar profesionet e punonjësve sepse ai ka dalë nga llogaritja e orëve totale të punës që nevojiten për kryerjen e të gjitha procesve të punës sipas zërave të preventivit. Konkretisht nga llogaritjet e bëra rezultojnë se:

Sasia e orëve të punës sipas manualit dhe analizave teknike është 11,783 orë. Llogaritja e numrit të punonjësve në varësi të orëve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	11,783
Ditë pune (orë pune/8)	1,473
Specialist, punëtorë për 3 muaj	22
Inxhinier ndërtimi	1
Numri i punëtorëve gjithsej	23

Si rrjedhim nuk mund të konsiderohet kriteri diskriminues kërkesa për 23 punonjësish për sa kohë që ajo nuk është vënë apriori apo në mënyrë subjektive por ka rezultuar nga llogaritjet e orëve të punës. Lidhur me përcaktimin e profesionit të punëtorëve, ritheksojmë se nuk është bërë detajimi për profesionin e secilit punonjës por është vendosur vetëm stafi kryesor inxhinierik duke u bazuar në nenin 39, pika 6, gërma c dhe ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku përcaktohet shprehimisht:

6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe liçencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Pra specialisti i fushës në njësinë e prokurimit i është përmbajtur në mënyrë strikte përcaktimit ligjor të bërë më sipër.

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike, janë kërkuar, nga specialisti i fushës mjetet e mëposhtme:

<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Sasia</i>	<i>Pronësia</i>
<i>Kamion me kapacitet mbajtës deri në 5 ton</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Betoniere</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Vinç stacioner</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Autovinç</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të investimit, volumin e punimeve të parashikuara, afatin prej 3 muajsh të punimeve, faktin që punimet duhet të kryheshin shumë objekte të cilat janë në largësi nga njëri-tjetri vlerësojmë se mjetet e kërkuara minimale dhe nuk janë diskriminuese dhe penguese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përfundimi i grupit të auditimit se kriteret teknike të vendosura kanë ngushtuar konkurrencën apo kanë penguar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë duke u mbështetur vetëm tek fakti që duhej një analizë më e thelluar për këto kritere mendojmë se nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Problematika e ngritur nga grupi i auditimit nuk ka të bëjë me faktin se, NjP nuk disponon dokumentacion mbi argumentimin e fuqisë punëtore, por që argumentimi i kryer nga NjP (inxhinier z. B.M anëtarë i NjP) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht. Për t'u përlllogaritur fuqia punëtore për një procedurë prokurimi me objekt punime ndërtimi përmban disa element, konkretisht nuk janë vetëm orët e punës së bashku me preventivin (si pjesë e dokumentacionit të argumentimit) të paraqitur nga Ju si pjesë e dosjes së kësaj procedure apo edhe në observacion por edhe analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive. Gjithashtu vlen të theksohet që, nga vetë NjP konfirmohet nëpërmjet këtij observacioni, se në dokumentacionin mbi argumentimin e fuqisë së punëtorëve nuk është përfshirë profesioni i punëtore, ndërkohë që ky është një prej elementëve më të rëndësishëm për përlllogaritjen e fuqisë punëtore. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me çertifikatat ISO 9001 dhe 14001:

Ritheksojmë se ato janë vendosur bazuar në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Standartet ISO 9001 dhe 14001 janë standartet më të përdorura nga kompanitë dhe në këndvështrimin tonë (per sa kohë lejohen ligjërisht) ato janë një element i shtuar sigurie per autoritetin kontraktor që organizimi dhe realizimi i punës objekt prokurimi të kryhet me standarte, cilësi dhe të respektojë normat mjedisore duke minimizuar efektet negative në mjedis gjatë punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Kërkesa për Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese”.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa**

bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

3. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me vlerësimin dhe shpalljen fituese të shoqërisë N ShPK, në kushtet kur nga ana juaj është pranuar observacioni i paraqitur nga KVO, rrjedhimisht KVO ka shpallur fituese një operator ekonomik i cili i ka përmbushur kriteret për kualifikim.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO është një observacion i cili është reflektuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit.

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 966, datë 19.09.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 966, datë 19.09.2022.	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 966/1, datë 19.09.2022.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.	1. M.S , Juriste 2. M.B , Inxhinier Agro-Ushqimore 3. E.GJ , Inxhinier IT	1. B.TH , Kryetar 2. K.J , Anëtar 3. R.H , Anëtar 4. M.B , Anëtar 5. S.D , Anëtar
5. Fondi Limit: 13,807,000 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “P” ShPK me vlerë oferte 12,238,400 lekë pa TVSh., me kontratë nr. 8978/1 prot., datë 07.11.2022, me vlerë 14,686,080 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 1,568,600 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 13.10.2022.	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 c) Kualifikuar: 2
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës*”, janë siguruar fonde në vlerën 16,568,400 lekë si rezultat i bashkë FI ncimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË me VKB nr. 134, datë 22.08.2022, “*Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit të vitit 2022 për Bashkinë Korçë*” (Grand nga MSHMS për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-ve) në vlerën 19,999,008 lekë, si dhe miratimin e kontributit të Bashkisë për projektin “*Qendër inovacioni dhe kreativiteti muntifunksional*” në vlerën 9,729,011 lekë”. Konfirmimi i fondeve është kryer nga Dega e Thesarit Korçë në mënyrë elektronike më datë 21.09.2022.

Me Urdhërin nr. 966, datë 19.09.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. M.S , znj. M.B dhe z. E.GJ .

Me Urdhërin nr. 966, datë 19.09.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “*Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës*” me fond limit në vlerën 13,807,000 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “*Procedurë e hapur*”.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Me Urdhërin nr. 882, datë 31.08.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve dhe kriterëve të veçanta të pranimit lidhur me kapacitetin teknik për procedurën e prokurimit “*Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës*”, i përbërë nga znj. M.K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, z. E.GJ me detyrë Specialist IT në DBNJPASHM dhe z. O.M me detyrë Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë/arkitekt.

Në datën 16.09.2022, nga grupi i punës i sipërpërmendur është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit lidhur me kapacitetin teknik për objektin *“Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës”*.

Në datën 27.09.2022, nga NjP e përbërë nga znj. M.S , znj. M.B dhe z. E.GJ është mbajtur procesverbali nr. 1, për hartimin e dokumentave të tenderit. Në datën 27.09.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me shkresën e datës 01.10.2022, nga OE “F” ShPK përfaqësuar nga z. A.K ka adresuar pranë BASHKISË KORÇË një kërkesë mbi argumentimin e specifikimin teknike konkretisht: *“Në preventivin e pajisjeve janë kërkuar 12 pajisje projektor për të cilat është paraqitur edhe planvendosja e tyre dhe gjithashtu janë kërkuar edhe 2 pajisje Personal Computer-Desktop”*.

Me shkresën e datës 03.10.2022, znj. M.S në cilësinë e Personit për Prokurimet është drejtuar grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit , hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, të përbërë nga znj. M.K , z. E.GJ dhe z. O.M për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga OE “F” ShPK.

Me shkresën e datës 05.10.2022, grupi i punës i sipërpërmendur i ka kthyer përgjigje OE “F” ShPK ku citohet se: *“Përdorimi i kompjuterëve (të cilësuar në preventiv në sasi 2 copë me aksesoret përkatës të nevojshëm) do të veprojë si një sistem i vetëm. Qëllimi është që të koordinohen me programet përkatëse apo edhe njëri tjetrin. Aplikacionet përsëri duhet të jenë menaxhueshme sikurse kompjuterat si një sistem, pra secili nga kompjuterat kanë nga 6 projektor por që funksionon si një. Ndarja e projektorëve të bëhet në mënyrë efikase. Ndërveprimi i tyre nuk do të ndryshojë funksionin”*.

Me shkresën e datës 30.09.2022, nga OE “P” ShPK përfaqësuar nga z. V.M ka adresuar pranë BASHKISË KORÇË një kërkesë mbi argumentimin e specifikimin teknike konkretisht: *“Për zërin F.V. Videoprojektor 600 Ansilumen, Rezolucion 1920x1080 me hyrje HDMI, Laser source 12 copë, përbën zërin më të rëndësishëm nga ku varet e gjithë vijueshmëria e zbatimit të projektit”*.

Ndërkohë AK nuk ka parashikuar asnjë kriter në tender se si mund të verifikohet autenticiteti i mallit, specifikimet teknike dhe origjI liteti i mallit. Mbështetur në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar, neni 40, duhet që AK të parashikojë *“katalogë ose fotografi për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”*.

Me shkresën e datës 03.10.2022, znj. M.S në cilësinë e Personit për Prokurimet është drejtuar grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit , hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, të përbërë nga znj. M.K , z. E.GJ dhe z. O.M për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga OE “P” ShPK.

Me shkresën e datës 05.10.2022, grupi i punës i sipërpërmendur i ka kthyer përgjigje OE “P” ShPK ku citohet se: *“Në përgjigje të pyetjes që parashtrohet për plotësimin e kriterëve për paraqitje katalogu/fragmenti nga katalogu/fotografi të mallit duhet që pajisja të shoqërohet me një dokument. Dokumenti duhet të përmbajë pajisjet e përzgjedhura të cilat duhet të kenë kushte minimale (të parashikuara në specifikime) ose optimale për përdorim dhe që nuk ndikon negativisht në funksionimin në tërësi. Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj se në specifikimet teknike të publikuara në SPE është përcaktuar: Pajisjet dhe programet duhet të jenë të shoqëruara me katalogun teknik/skemat teknike të produkteve të kërkuara dhe me manual përdorimi”*.

Më datë 03.10.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Korçë, rezulton se: për procedurën me REF-43521-09-27-2022, me objekt *“Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes së*

infrastrukturës”, Bashkia Korçë me fond limit 13,807,000 lekë pa TVSh, ka sygjerruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Me shkresën e datës 05.10.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për një ndryshim në procesverbalin e datës 16.09.2022, “*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret të veçanta të pranimit lidhur me kapacitetin teknik për objektin “Projeksioni grafiku dhe audio në kuadër të rehabilitimit të qendrës aktuale dhe ngritjes të infrastrukturës”*”.

Në datën nr. 05.10.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali nr. 2, për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Nisur nga konstatimet dhe rekomandimet e APP lidhur me specifikimet teknike për këtë objekt, kërkesat për sqarim dërguar nga operatorët e interesuar në sistem dhe me nismën e vet grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike bëri disa modifikime në specifikimet teknike të cilat konsistojnë kryesisht në përdorimin e termave në gjuhën shqipe (aty ku ishte e mundur), heqjen e specifikimeve fikse duke përcaktuar diapazon (aty ku ishte e mundur) dhe saktësimin e disa specifikimeve me qëllim moskufizimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes të operatorëve ekonomikë. Specifikimet teknike të modifikuara të cilat ofertuesit duhet ti referohen i bashkëlidhen kësaj shtojce. Nga sa më sipër në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike u konstatua se disa prej tyre nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në funksion të objektit të kontratës. Nuk argumentohet qëllimi i kërkesave të këtyre specifikimeve për cilësitë dhe karakteristikat e mallrave të kërkuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.K , z. E.GJ , z. O.M në cilësinë e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 966/1, datë 19.09.2022, të z. S.F Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga znj. B.TH kryetar i komisionit dhe anëtarët z. K.J , znj. R.H , z. M.B , z. S.D .

Procesverbali nr. 3, i mbajtur nga KVO i datës 13.10.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali nr. 4, i mbajtur nga KVO i datës 17.10.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “P ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “P ” ShPK (me Nipt L....A) me vlerë ekonomike të ofertës 12,238,400 lekë pa TVSh.

2. OE “F ” ShPK (me Nipt K....F) me vlerë ekonomike të ofertës 13,495,000 lekë pa TVSh.

Më datë 18.10.2022, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 5, mbi shqyrtimin e dokumentacionit origjinal të OE “P ” ShPK. Në datën 28.10.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Me shkresën e datës 28.10.2022, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 8978 prot., datë 18.10.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “P ” ShPK.

Procedurat e audituara nga prokurimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë:

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Meremetimi i institucioneve arsimore”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 20, datë 19.04.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 20, datë 19.04.2022.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 22, datë 19.04.2022.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.	1. V.T , Jurist 2. V.P , Financier 3. A.Q , Ekonomist	1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtarë 3.I.L , Anëtarë
5. Fondi Limit: 24,083,334 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “V.K ” ShPK me vlerë oferte 23,987,407.50 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 165 prot., datë 25.03.2022, me vlerë 28,784,889 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 95,926.50 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.08.2022	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Merementimi i institucioneve arsimore”, janë siguruar fonde në vlerën 23,400,000 lekë nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË të miratuara sipas VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6, datë 27.01.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë” si dhe Urdhërin nr. 42, datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2022 të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë, sipas programeve”. Vlen të theksohet se fondet e parashikuara në VKB-të e sipërpërmendura janë në vlerën 23,400,000 lekë ndërkohë që vlera e kontratës së lidhur për këtë procedurë prokurimi është 28,784,889 lekë. Urdhëri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Korçë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së FI ncave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Situata: Me Urdhërin nr. 20, datë 19.04.2022, të z. Y.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. V.T , znj. V.P , z. A.Q .

Me Urdhërin nr. 20, datë 19.04.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Merementimi i institucioneve arsimore” me fond limit në vlerën 24,083,334 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur”. Referuar urdhërit për ngritjen e NjP u konstatua se, në përbërje të saj nuk ka asnjë specialist fushe për objektin e prokurimit.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 74, pika 2 dhe pika 4.

Ndikimi/Efekti: Vendosja në njësinë e prokurimit punonjës të cilët nuk janë specialist fushe, ndikon në aplikimin e kriterëve për kualifikim jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Situata: Me Urdhërin nr. 21, datë 19.04.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Në dosjen e procedurës së prokurimit janë të përfshira:

- Preventivi i punimeve (i hartuar nga z. Ing. B.M , z. A.Q Përgjegjës Sektori dhe urb. Znj. ZH.L me Detyrë Drejtor i DPKZHT);
- Grafiku i punimeve (i hartuar nga z. Ing. B.M , z. A.Q Përgjegjës Sektori dhe urb. Znj. ZH.L me Detyrë Drejtor i DPKZHT);
- Specifikimet teknike i materialeve (i hartuar nga Ing. z. B.M);

- Analiza e çmimeve (ky dokumentacion nuk është i nënshkruar nga NjP);
- Procesverbal mbi argumentimin e specifikimeve teknike (i hartuar nga NjP).

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga urb. znj. ZH.L , ing. z. B.M dhe z. A.Q , konfirmuar nga z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ. Nga verifikimit në interenet është konstatuar se urb. znj. ZH.L , ing. z. B.M dhe z. A.Q nuk janë të pajisur me licensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit¹⁷.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5.

Ndikimi/Efekti: Caktimi i punonjësve të pa pajisur me licensat përkatëse, ndikon në mos hartimin e projekt-preventivin e punimeve cilësorë dhe real në lidhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për punimet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

b- **Hartimi i kriterëve të DT:**

Në datën 19.04.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar dokumentet e tenderit.

Më datë 05.05.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK NSHMAÇ, rezulton se: Për procedurën me REF-26685-04-27-2022, me objekt “Meremetimi i institucioneve Arsimore”, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë me fond limit 24,083,333 lekë pa TVSh, ka sygjerruar disa kriterë të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në datën 09.05.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Ishte	Bëhet:
<p>Pika nr. 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</p> <p>a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose</p> <p>b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.</p> <p>Pika nr. 2.3.1/a. Plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontratën/at e sipërmarrjes; -Situacion punimesh; -Fatura tatimore për çdo situacion punimesh; -Akt kolaudimi; 	<p>Pika nr. 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</p> <p>a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose</p> <p>b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.</p> <p>Pika 2.3.1/a. Plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontratën/at e sipërmarrjes; -Situacion përfundimtar punimesh; -Fatura tatimore që i korespondon situacionit përfundimtar; -Akt kolaudimi;
<p>Pika nr. 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit</p>	<p>Pika nr. 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:</p>

¹⁷ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

<p>të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: Punime të përgjithshme ndërtimi Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.P-1 A “Punime gjërmimi në tokë”; N.P-2 A “Ndërtime civile dhe industriale”; N.P-3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godl sh civile e industriale, veshje fasadash”; N.P-4 A “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”; N.P-12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”; Punime speciale ndërtimi -Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.S-1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”; N.S-2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhI , lavanteri, mirëmbajtja e tyre”; N.S-4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, M lik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”; N.S-18 A “Punime topogjeodezike”; Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme në zbatim, në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategorinë N-Z/A/7 “Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane”; Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, nr.42, datë 16.01.2008. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.</p>	<p>Punime të përgjithshme ndërtimi Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.P-1 A “Punime gjërmimi në tokë”; N.P-2 A “Ndërtime civile dhe industriale”; N.P-3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godl sh civile e industriale, veshje fasadash”; N.P-4 A “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”; Punime speciale ndërtimi -Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme: N.S-1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”; N.S-2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhI , lavanteri, mirëmbajtja e tyre”; N.S-4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, M lik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”; N.S-18 A “Punime topogjeodezike”; Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme në zbatim, në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategorinë N-Z/A/7 “Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane”; Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, nr.42, datë 16.01.2008. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.</p>
<p>Pika nr. 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: -Inxhinier Ndërtimi 1 (një) -Inxhinier Hidroteknik 1 (një) -Inxhinier Restaurues 1 (një) -Inxhinier Gjeodet 1 (një) -Inxhinier Mjedisit 1 (një) Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në listë pagesat të paktën për periudhën janar-mars 2022 si dhe të figurojnë në liçensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet: -Kontratë noteriale pune e vlefshme; -Diplomat përkatëse;</p>	<p>Pika nr. 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: -Inxhinier Ndërtimi 1 (një) -Inxhinier Hidroteknik 1 (një) -Inxhinier Restaurues 1 (një) -Inxhinier Gjeodet 1 (një) Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në listë pagesat të paktën për periudhën janar-mars 2022 si dhe të figurojnë në liçensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet: -Kontratë noteriale pune e vlefshme; -Diplomat përkatëse;</p>
<p>Pika nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Janar 2022-Shkurt 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.</p>	<p>Pika nr. 2.3.5. Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar dhe të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.108, datë 09.02.2011, “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, i cili të ketë kontratë pune, diplomë, liçensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. (Në mbështetje të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, neni 12/1, “Operatorët ekonomik pjesëmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme”. Njëkohësisht në përputhje me Vendimin nr. 632, datë 15.07.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Sipas kësaj VKM, AK do të pranojë që nëse punëdhënësit nuk kanë persona të ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë (dmth nëse nuk ka mjek të punësuar), mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënive kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.</p>
<p>Pika nr. 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:</p>	<p>Pika nr. 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:</p>

<p>-1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit si Ekspert për dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave” e dhënë nga një organizëm i licënsuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.</p> <p>-1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licënsuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.</p> <p>-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një inxhinjer si “Ekspert zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikatë/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës.</p> <p>-1 (një) Punonjës Specialist të çertifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi DPI Rënia nga lartësitë, punime në fasade, etj., sipas VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këto duhet të paraqitet: çertifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licënsuar/çertifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.</p>	<p>-1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licënsuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.</p> <p>-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një inxhinjer si “Ekspert zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikatë/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës.</p> <p>-1 (një) Punonjës Specialist të çertifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi DPI Rënia nga lartësitë, punime në fasade, etj., sipas VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këto duhet të paraqitet: çertifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licënsuar/çertifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.</p>
<p>Pika nr. 2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Teknik Ndërtimi 1 (një) -Specialist Ndërtimi 1 (një) -Hidraulik 1 (një) -Muratorë 1 (një) -Suvatues 1 (një) -Bojaxhi 1 (një) -Pllakashtrues 1 (një) -Hidroizolues 1 (një) -Punime durale 1 (një) -Karpentier 1 (një) <p>Të vërtetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim.</p> <p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) manovrator për eskavator si dhe 1 (një) shofer të mjeteve të rënda. Për manovratorin dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim.</p> <p>Për shoferin me leje drejtimi e vlefshme dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim.</p>	<p>Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Teknik Ndërtimi 1 (një) -Specialist Ndërtimi 1 (një) -Hidraulik 1 (një) -Muratorë 1 (një) -Suvatues 1 (një) -Bojaxhi 1 (një) -Pllakashtrues 1 (një) -Hidroizolues 1 (një) -Punime durale 1 (një) -Karpentier 1 (një) <p>Të vërtetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim.</p> <p>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) manovrator për eskavator si dhe 1 (një) shofer të mjeteve të rënda. Për manovratorin dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.</p> <p>Për shoferin me leje drejtimi e vlefshme dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2022-Mars 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.</p>
<p>Pika nr. 2.4.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Fabrikë prodhimi për Fino, Koll, Llaçra etj., në pronësi/kontratë qiraje/kontratë furnizimi të jenë të pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B). Furnizimi të ketë status aktiv në QKB; -Fabrika prodhimi i betoni pronësi, kontratë qiraje, kontratë furnizimi të jenë të pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B). Furnizimi të ketë status aktiv në QKB; -Fabrika prodhimi i Asfaltit pronësi, kontratë qiraje, kontratë furnizimi të jenë të pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B). Furnizimi të ketë status aktiv në QKB. 	<p>Pika nr. 2.4.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Fabrikë prodhimi për Fino, Koll, Llaçra etj., në pronësi/kontratë qiraje/kontratë furnizimi; -Fabrika prodhimi Betoni në pronësi/kontratë qiraje/kontratë furnizimi; -Fabrika prodhimi Asfalti në pronësi/kontratë qiraje/kontratë furnizimi.

Afati i vlerësimit të ofertave bëhet data 18.05.2022, ora 09:00

Situata: 1. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licënsë profesionale nga Qendra Kombëtare e Licënsimit (QKL) Kodi III.2.B “*Grumbullim*,

transportim, ruajtje e mbetjeve urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003, “*Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*” i ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, “*Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.B specifikohen në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Kriteri për disponimin e liçensës me kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve. Subjektet që kryejnë aktivitet, klasifikohen në operator që gjeneron mbetje urbane në njësinë administrative ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, hapja e NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në njësinë administrative), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifatat vendore (si taksë pastrami, gjelbërimi, tabelle etj., sipas ligjit dhe VKB-së përkatës).

Referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009, “*Për liçensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”, në aneksin 1, Kategoria III, Liçensimi i vepritarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullit/kontenier dhe jo t’i trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, çertifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, **çertifikatë transporti**.

2. Në pikën nr. 2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në liçensën e shoqërisë, si më poshtë: Inxhinier ndërtimi 1, Inxhinier hidroteknik 1, **Inxhinier restaurues 1** dhe Inxhinier gjeodet 1.

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në listëpagesat të paktën për periudhën janar-mars 2022 si dhe të figurojnë në liçensën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- Kontratë noteriale pune e vlefshme;
- Diplomat përkatëse;

Në lidhje me kërkesën për **inxhinier restaurues** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit në fjalë. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulojnë inxhinieri restaurues. Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e OE. Inxhinieri restaurues kërkohet në rastin e rikonstruksionin e objekteve antike ose të një rëndësie të veçantë me qëllim ruajtjen e pamjes së tyre kryesisht për fasadat e jashtme.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit për punonjësit e kërkuar në **pikën nr. 2.3.4**, është kriter kufizues për arsye se në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 21 “*Formatet e kontratës së punës*”, parashikohet që kontrata individuale e punës është e vlefshme kur lidhet në formë të shkruar ndërmjet punëdhësit dhe punëmarrësit jo në prani të noterit.

3. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “*Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë*” i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, VKM nr. 108, datë 09.02.2011, “*Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e*

sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, i cili të ketë kontratë pune, diplomë, liçensë urdhër mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën janar 2022 mars 2022 dhe në vazhdim. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. (Në mbështetje të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003, “*Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë*”, neni 12/1, “*Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme*”. Njëkohësisht në përputhje me Vendimin nr. 632, datë 15.07.2015, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*””. Sipas kësaj VKM, AK do të pranojë që nëse punëdhënësit nuk kanë persona të ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë (domethënë nëse nuk ka mjek të punësuar), mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për **mjek**. AK nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik t’i vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

4. Pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë*”, e dhënë nga një organizëm i liçensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një inxhinjer si “*Ekspert zjarrfikës*” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr. 152/2015, “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*”. Për këtë duhet të paraqitet certifikatë/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës.

- 1 (një) Punonjës Specialist të certifikuar dhe trajnuar për punimet në lartësi DPI rënia nga lartësitë, punime në fasade, etj., sipas VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*” e dhënë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këto duhet të paraqitet: certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i liçensuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.

Duke qenë se nga ana e AK është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me **Certifikatën ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi certifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kërkesa e autoritetit kontraktor, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar Ligjit nr. 152/2015, “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe*

shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës me leje nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës në kuptim të nenit 39, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

5. Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoreshë prej minimalisht 21 (njëzet e një) persona për periudhën janar-mars 2022 e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën janar-mars 2022.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën janar-mars 2022.

Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi: Teknik ndërtimi 1, Specialist ndërtimi 1, Hidraulik 1, Murator 1, Suvatues 1, Bojaxhi 1, Pllakashtrues 1, Hidroizolues 1, Punime durale 1 dhe Karpentier 1.

Të vërtetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën janar 2022-mars 2022 dhe në vazhdim.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) manovrator për eskavator si dhe 1 (një) shofer të mjeteve të rënda.

Për manovratorin dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën janar 2022-mars 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Për shoferin me leje drejtimi e vlefshme dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën janar 2022-mars 2022 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Në pikën nr. 2.3.9. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 7 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion 3.5-7.5 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion me vinç kapacitet mbajtës 3.5-7 ton	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinç me kosh	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Eskavator	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Fadromë (kovë para dhe krahë mbrapa)	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Rrul me vibrim	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Asfalto shtruese	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot uji	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Betoniere kantier	Copë 3	Në pronësi ose me qira
Matrapik	Copë 2	Në pronësi ose me qira
Motogenerator	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Depozitë 2000-5000 litra	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Skelë	2000 m ²	Në pronësi ose me qira
Rrjetë mbrojtëse	2000 m ²	Në pronësi ose me qira
Pompë suvatimi	Copë 2	Në pronësi ose me qira

Mjete mbrojtëse		
Kokore	Copë 35	Në pronësi ose me qira
Fikse zjarri	Copë 10	Në pronësi ose me qira
Tabela Sigurimi Teknik	Copë 20	Në pronësi ose me qira
Jelek	Copë 35	Në pronësi ose me qira

Kuti Ndihme e shpejt	Copë 4	Në pronësi ose me qira
Prozhektor për ndriçim	Copë 2	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qirasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qira të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës nr. 9.

Në pikën 2.3.7, dhe 2.3.8, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore të sipërpërmendur për një periudhë jo më pak se 3 mujore (janar-mars 2022) nga dita e hapjes së tenderit. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në të ardhmen nga njësia e prokurimit.

Në kërkesën e pikës nr. 2.3.9, për kapacitetin e mjeteve/pajisjeve dhe makinerive është kërkuar **1 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 7 ton në pronësi ose me qira, 1 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton në pronësi apo me qira, 1 Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-7.5 ton në pronësi ose me qira dhe 1 Autovinç me kosh që do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve ndërtimore si rezultat i realizimit të gërmimeve apo transport dheu sipas zërave të preventivit të punimeve si më poshtë:**

Nr.	Përshkrimi i objektit	Njësia	Sasia
2/37/5a	Transport mbeturI 5 km	m ³	100

Në këtë kriter **nuk është kërkuar çertifikata për transport mallrash për llogari të vetë apo për të tretë në rast marrje mjeti me qira** e cila është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licensën përkatëse”.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për pikën nr. 2.3.7, nr. 2.3.8, dhe nr. 2.3.9, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërish për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, **profesionit të punëtorëve** dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

6. Në pikën nr. 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë çertifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë*” ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit Mjedisor*” ose ekuivalent;
- OHSAS 18001:2007 “*Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë*” ose çertifikatën me standardin e azhurnuar dhe ekuivalent të njohur nga Standardet Shqiptare ISO 45001:2018, ose ekuivalent;
- ISO PAS 99:2012 “*Për sistemin e integruar të menaxhimit*” ose e përditësuar;
- ISO 39001:2012 “*Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor*”;

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë”**, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “*Merementimi i institucioneve arsimore*”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor”**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO OHSAS 39001-2012 “Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor”**: Ky Standard përcakton kërkesat minimale për një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi të sigurt të trafikut rrugor gjatë zbatimit të punimeve.

Kërkesa për **Çertifikatën PAS 99-2012 “Për sistemin e integruar të menaxhimit”**: Kjo çertifikatë është një specifike publike me qëllim të ndihmojë shoqëritë të integrojnë sa më shumë sisteme të menaxhimit të implementuar. Përdorimi i PAS 99 “*Për sistemin e integruar të menaxhimit*” ka si qëllim rritjen e efikasitetit dhe plotësimin e të gjitha kërkesave për standartet përfshirëse referuar planifikimit, implementimit dhe operimit të një sistemi menaxhimi integrat por dhe duke patur parasysh monitorimin dhe përmirësimin e performancës në organizim.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës për disponimin e **Çertifikatës PAS 99-2012 “Për sistemin e integruar të menaxhimit”** dhe **ISO 39001-2012 “Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor”**, nuk përmbush përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 44, pika 3, ku përcaktohet që: “*Çertifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit*”. Kriteri i vendosur nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

7. Në pikën nr. 2.4.4. Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë bashkangjitur me kontratën e furnizimit/porosisë me distributorin/prodhuesin, katalogët/skeda teknike si dhe çertifikatat e cilësisë të materialeve/mallrave të shoqëruara me raportet e testimi nga laboratorë të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara sipas specifikimeve teknike të mëposhtme dhe konkretisht, për produktet:

- **Bojë Akrilike** produkti duhet të përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 µg/m³ - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj larjes. Çertifikim ku të vërtetohet se produkti është bojë ekologjike.

- **Bojë Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 µg/m³ - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë - SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Çertifikim ku të vërtetohet se produkti është bojë ekologjike dhe antibakteriale.

- **Suva (Llaç mbushës)** produkti duhet të përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kërkuara edhe sipas SSH: EN 998-1.

- **Fino** Produkti duhet të përmbush specifikimet teknike të kërkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1.

- **Hidroizolues** material dy komponentesh me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarracë, themele, bodrume, etj., Produkti duhet të përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji.

- **Sistem Kapotë** produkti duhet të përmbush specifikimet teknike të kërkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 ose ekuivalent. Për këtë zë operatori ekonomik duhet të paraqesi mostrën e sistemit kapotë, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse. Mostra duhet të dorëzohet jo më vonë se data dhe ora e hapjes së ofertave.

Në lidhje me kriterin për paraqitjen e **raport testimit** vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga operatori ekonomik përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që artikujt apo mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 1, 2 dhe neni 21, pika 1, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, neni 78.

Ndikimi/Efekt: Kufizimi i pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

Shkak: Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë.
Rëndësia: E lartë.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 22, datë 19.04.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. P.X kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S.Z, znj.I.L .

Procesverbali nr. 2, i mbajtur nga KVO i datës 18.05.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 operatorë ekonomik ka marrë pjesë me vlerën ekonomike përkatëse të ofertuar. Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 18.05.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “V.K ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “V.K ” ShPK (me Nipt K...E) me vlerë ekonomike të ofertës 23,987,407.50 lekë pa TVSh.

Në datën 18.05.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Drejtorit të NSHMAÇ. Me shkresën e datës 20.05.2022, Drejtori i NSHMAÇ ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me datë 18.05.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “V.K ” ShPK.

1. Nga OE “V.K ” ShPK janë publikuar në SPE vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Vlorë për vitet 2021-2022. Për sa trajtuar më sipër nga OE “V.K ” ShPK nuk është përmbushur pika nr. 2.2.3, e kriterëve të veçanta “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021-2022 sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore “, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet t’i bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë”, për pagesën e detyrimeve vendore konkretisht nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Lezhë dhe Korçë referuar likuidimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Lezhë dhe Korçë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete sipas kontratave si më poshtë:*

- Kontrata nr. 48/4 prot., datë 22.01.2022, me objekt “*Rikonstruktion i ambienteve të grafisë*”, institucioni Spitali Lezhë. Fatura tatimore nr. 2, datë 01.02.2021, në vlerën 828,000 lekë regjistruar më datë 12.02.2021, dhe likuiduar më datë 15.02.2021, nga Dega e Thesarit Lezhë.

- Kontrata e datës 17.06.2021, me objekt “*Meremente institucione arsimore*”, institucioni Drejtoria Mbështetëse e Arsimit Bashkia Korçë. Fatura tatimore nr. 6/2021, datë 22.07.2021, në vlerën 8,537,426 lekë regjistruar më datë 04.08.2021, dhe likuiduar më datë 05.08.2021, nga Dega e Thesarit Korçë.

2. Në datën 10.03.2021, ndërmjet OE “S.C.” përfaqësuar nga Administratori z. A.Q dhe OE “V.K ” ShPK është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira të 1 Vinç me kosh me numër shasie ËMAL75ZZZYY064942 me targë AA347VF. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me numër Rep., 670, dhe Kol., 87, datë 10.03.2021.

Për mjetin **Vinç me kosh me numër shasie WMAL75ZZZYY064942 me targë AA347VF** dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore i përket periudhës nga data 24.09.2020, deri më 24.09.2021, pra i ka

mbaruar afati dhe nuk është e vlefshme duke marrë në konsideratë faktin që procedura e prokurimit zhvillohet në vitin 2022.

3. Mjeti Fadromë me goma CAT 938 G, i marrë me qira sipas kontratës nr. 5678 Rep., dhe nr. 2521 Kol., datë 01.12.2020, të lidhur ndërmjet OE “B ” me përfaqësues B. L. dhe OE “V.K ” ShPK nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur fatura tatimore e blerjes nr. 86, datë 27.11.2015, ndërmjet OE “S.” Sha dhe OE “B. C.” ShPK. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makl t teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makl ve teknologjike”.

Për sa trajtuar më sipër OE “V.K ” ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE “V.K ” ShPK.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “V.K ” ShPK dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “V.K ” ShPK. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Y.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. P.X , znj. S.Z, znj.L.L në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “V.K ” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **23,987,407.50 lekë**.

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Ushqime”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 26., datë 18.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 27., datë 18.08.2022.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 28 data e pa përcaktuar saktë.
4. Lloji i Procedurës: Procedurë e hapur	1. V.T , Jurist 2. V.P , Financier 3. A.Q , Ekonomist	1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtarë 3.L.L , Anëtarë
5. Fondi Limit: 27,326,475 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “G ” ShPK me vlerë oferte 27,321,400 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 336 Prot., datë 31.10.2022, me vlerë 32,785,680 lekë me TVSh, me afat 31.10.2022-31.10.2024.	7. Diferenca me fondin limit: 5,075 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 27.09.2022	9. Burimi i FI ncimit: Buxheti i Bashkisë Korçë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi rezulton se:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për vitin 2022”, nuk dokumentohet kërkesa nga institucionet përfituese të nevojave për këto artikuj ushqimorë në përputhje me menutë e miratuara dhe kuotat e miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, për çerdhet, kopshtet dhe

konviktin e nxënësve, të cilat janë nën juridiksionin e ofrimit të këtij shërbimi, nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, Bashkia Korçë.

2. Përgjatë gjithë dokumentacionit të vendosur në dispozicion, referenca ligjore për këtë procedurë prokurimi nuk përputhet me objektin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit dhe në disa raste i referohet dhe akteve nënligjore mbi rregullat e prokurimeve publike të shfuqizuara. Nëse i referohemi Urdhërit të Prokurimit nr. 26., datë 18.08.2022, AK i referohet nenit 34 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 e cila është e shfuqizuar.

a- **Hartimi i specifikimeve teknike:**

Titullari i AK, me urdhërin nr. 27, datë 18.08.2022 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike të përbërë nga V.T , A.Q dhe V.P .

Sipas këtij urdhëri, proces verbali për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike duhej të hartoj brenda datës 09.09.2022.

Nga auditimi u konstatua se:

Proces verbal mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim ka datën 09.04.2022 periudhë që përkon para daljes së urdhërit të prokurimit dhe i përketë Autoritetit Kontraktor Fondit Shqiptar i Zhvillimit.

Proces Verbali i sipërcituar nuk është firmosur nga komisioni i ngritur me urdhërin nr.27, datë 18.08.2022 të titullarit të AK z. Y.M .

b- **Llogaritja e fondit limit:**

Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve për përllogaritjen e fondit limit ka marrë për reference çmimet për njësi të 49 artikujt ushqimor nga Zyra Rajonale e Statistikës Korçë me shkresën hyrëse nr. 167 prot. datë 09.09.2022, e cila nuk ka nr. Protokollit të zyrës së protokollit të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, sic paraqitet në faksimile nr. 1., aneksi 2.3.

- Nga administrimi i dosjes së procedurës së prokurimit “Ushqime” u konstatua se:

- Nuk disponohet shkresa nr. 275 prot. datë 06.09.2022, ku sipas zyrës Rajonale të Statistikës Korçë është dhënë përgjigje me shkresën nr.167 prot datë 09.09.2022, mbi bazën e shkresës nr. 275 prot. datë 06.09.2022.

- Procesverbali i komisionit të përllogaritjes së Fondit Limit nuk është pjesë e dosjes.

- Referuar pikës II të Urdhërit nr. 27 datë 18.08.2022 të Titullarit të Institucionit, procesverbali për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike duhej të hartohej brenda datës 09.09.2022.

- Referuar Urdhërit të Prokurimit nr. 26. datë 18.08.2022, për procedurën e prokurimit të hapur është përcaktuar Fondi limit në shumën **27,326,475 lekë pa TVSh.**

Anëtarët e grupit të punës për llogaritjen e FL të përbërë nga V.T , A.Q dhe V.P dhe titullari i AK Y.M në cilësinë e miratuesit të fondit limit kanë vepruar në mospërputhje me LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76 “Mënyra për përllogaritjen e vlerës së fondit limit të prokurimit”.

Hartimi i DT:

Komisioni i ngritur për hartimin e DST ka kërkuar sigurimin e ofertës në shumën 546,529 lekë. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është përcaktuar data 27.09.2022 ora 09:00 DST ka pësuar ndryshime të kriterit 2.3.3; 2.3.4 dhe 2.3.5 me Shtojcën nr. 1 datë 16.09.2022.

Nga auditimi u konstatua se:

Referuar nenit 15 pika 3 gema b nga AK nuk është hartuar grafiku i lëvrimin të detajuar sipas kërkesave të AK dhe nenin 40 pika 1 e Rregullave të Prokurimit Publik nr. 285 datë 19.05.2021 Në lidhje me kriteret e veçanta:

Referuar proces verbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim nuk është argumentuar vendosja e kohëzgjatjes së kontratës prej 24 muaj duke vepruar në mospërputhje me nenin 106 pikës 1, 2 dhe 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

AK për kriterin 2.3.5 ka kërkuar një numër minimal punonjësish prej 4 (katër) punonjësish duke mos argumentuar vendosjen e këtij numri, i cila nuk përputhet me objektin e këtij prokurimi dhe kriterëve 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.4.4 të DST.

AK për kriteret e veçanta duhej të përfshinte kërkesat e nenit 40 pika 5.a,b,c,ç të VKM 285 date 19.05.2021 “*Mbi miratimin e rregullave te prokurimeve publike*”.

Zhvillimi i Procedurës:

Nga audimi ne SEP rezulton se, për këtë procedurë ka paraqitur ofertë vetëm OE G ShPK me ofertë ekonomike 27,321,400 lekë.

Referuar, Raportit Përmbledhës të KVO të mbajtur më datë 03.10.2022, miratuar nga titullari i AK z.Y.M , u konstatua se Raporti përmbledhës nuk plotëson kërkesat e nenit 84 pika 1, 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Miratimi i rregullave të prokurimit publik*”.

Sipas Raportit Përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga P.X , S.Z dhe I.L , kanë kualifikuar si oferte të suksesshme OE G , pasi sipas tyre ky OE i plotësonte kërkesat e AK dhe në kushtet që ishte oferte e vetme është shpallur për procedurën e hapur “Ushqime”.

Sipas KVO oferta ekonomike e OE G ishte e rregullt dhe pa gabime aritmetike.

Në përfundim KVO ka shpallur fitues OE G me ofertën ekonomike në shumën 27,321,400 lekë pa TVSh.

Situata: Nga auditimi në SEP, rezultoi se:

- OE G , nuk plotëson kriterin 2.3.3. të DST, pasi për mjetin në përdorim me targa KO 4716 B i markës Mercedes Benz model Vito 108 D Kombi, nuk ka paraqitur lejen higjeno-sanitare, Akt miratimi higjenosanitar nr. 36 mban datën 20.02.2016, dhe në referim të nenit 12 të ligjit nr. 7643 datë 02.12.1992 “*Për inspektoriatin Sanitar Shtetëror*”, i ndryshuar, OE duhej të bënte vetedeklarim për plotësimin e kushteve higjeniko-shendetësore në Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, i cil pas ekspertimit paraprak jep akt miratimin.

Në SEP mungon procesverbali i inspektimit për mjetin e transportit me targa KO 4716 B, mungon lista e verifikimit e inspektimit për mjetet e transportit të produkteve ushqimore për mjetin me targa KO 4716B.

- OE nuk plotëson kriterin 2.3.3 pasi në referim të kontratës së qirasë nr. rep.703 nr.kol.482 datë 11.02.2021, mungon proces verbali i inspektimit për mjetin Mercedes Benz të llojit ATV me targa AA497PT

- OE G nuk plotëson kriterin 2.3.5. për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit pasi për mjetin e marrë me qera ATV (frigorifer) nuk ka paraqitur në listë pagesën e muajit korrik 2022-gusht 2022 emrin e drejtuesit të mjetit Mercedes Benz të llojit ATV me targa AA497PT.

Për sa më lart, në kushtet kur kemi vetëm një OE dhe në mosplotësim të disa kriterëve të kërkuara nga AK të paraqitura në DST, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhej ta s’kualifikonte OE G dhe të fillonte nga e para procedurën e prokurimit për blerjen e ushqimeve.

Konkluzion:

Për sa më lart, rezulton se procedura është e parregullt, pasi AK nuk ka përllogaritur fondin limit mbi bazën e kërkesave të institucioneve përfituese të artikujve ushqimor, nuk janë

analizuar këta artikuj sipas menu-ve dhe kuotave ushqimore të miratuara, është e paqartë sesi Instituti i Statistikave Filiali Korçë ka dhënë çmimet për artikujt objekt prokurimi, e gjithë praktika nuk ka kaluar nëpërmjet protokollit të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbshtetëse të Arsimit dhe Çerdheve, gjithashtu KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE pjesëmarrës të vetëm në procedurë, i cili nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara nga AK.

Në këto kushte KVO duhej ta s'kualifikonte OE pjesëmarrës dhe Titullari i AK duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte një procedurë të re, për të mundësuar rritjen e numrit të pjesëmarrës dhe shmangur përdorimin pa efikasitet të fondeve publike në vlerën **32,785,680 lekë**.

Lidhja e kontratës:

Nga administrimi i dokumentacionit nga AK u konstatua se dokumentacioni në formën e shkruar (hard copy) i cili administrohet në dosjen e kësaj procedure nuk është protokolluar pranë AK.

OE G i shpallur fitues ka bërë sigurimin e kontratës në shumën 3,278,568 lekë pranë kompanisë së sigurimeve Sigma.

AK ka lidhur kontratën nr. 336 prot., datë 31.10.2022 me OE G .

Nga auditimi rezulton se:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje ushqime për vitin 2022*”, AK nuk ka hartuar një plan zbatimi të kontratës i cili duhej të nënshkruhej nga titullari i AK dhe kontraktuesit brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të saj.

AK nuk ka përcjellë planin e zbatimit të kontratës nr. 336 prot., datë 31.10.2022 pranë APP brenda 5 ditëve të nënshkrimit të saj, sipas prashikimeve të nenin 107 pika 1 deri 8 te VKM 285 datë 19.05.2021 “*Miratimi i rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Marrja në dorëzim:

Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga A.Q , S.Z,I.L dhe M.P të caktuar sipas urdhërave nr. 77 datë 04.11.2022; nr. 78 datë 07.11.2022; nr. 81 datë 14.11.2022; nr. 82 datë 24.11.2022, nr. 85 datë 05.12.2022, nr. 88 datë 19.12.2022, nr. 90 datë 27.12.2022.

Sipas proces verbaleve respektive të anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, malli është dorëzuar sipas kërkesave të AK.

Realizimi i kontratës:

Për periudhën objekt auditimi ecuria e realizimit të kontratës nr. 336 prot., datë 31.10.2022 me kontraktuesin G paraqitet në tabelën nr. 1 të aneksit 2.3.

Për sa më lart, me veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi V.T , A.Q dhe V.P në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të DST, P.X , S.Z dhe I.L në cilësinë e anëtarëve të KVO dhe anëtarët e monitorimit të kontratës të përbërë nga A.Q , S.Z,I.L , M.P dhe z. Y.M në cilësinë e titullarit të AK dhe miratuesit të procedurës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Rritje e shpenzimeve jo efektive.

Shkaku: Mosrespektim i LPP dhe akteve nënligjore të Prokurimit Publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Kyetari i BASHKISË KORÇË të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për Titullarin e Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetës për Arsimin dhe Çerdhet, i cili në cilësinë e miratuesit të kësaj procedure ka vepruar në mospërputhje të hapur me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve në shumën **32,785,680 lekë**.

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Naftë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 29, datë 18.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 30, datë 18.08.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 31 datë 18.08.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje – kuadër)	1. V.T , Jurist 2. A.Q , Pergj.Sektori i mirembajtjes 3. V.P , Specialiste	1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtar 3.I.L , Anëtar
5. Fondi Limit: 20,543,400 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “K ShA” me vlere 20,003,090 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.03.2023	7. Diferenca me fondin limit: 513,750 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.09.2022	9. Burimi i FI ncimit: Te ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Nga auditimi, u konstatua se të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

a- Fondi limit:

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit nr. 30 të titullarit, datë 18.08.2022 “*Për ngritjen e grupit të punës, për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike*”, në përbërje të së cilit janë: V.T , V.P dhe A.Q ;

Për këtë qëllim është mbajtur procesverbali datë 18.08.2022, ku u konstatua se është përcaktuar vetëm sasia e karburantit dhe nuk është dhënë asnjë argument, detaj apo analizë për llogaritjen e bërë në bazë të nevojave, si dhe nuk është përcaktuar metoda e përdorur për llogaritjen, në kundërshtim me LPP, neni 34 “*Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit*” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “*Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës*”.

Përgjegjësia për llogaritjen e fondit limit është e grupit përkatës, i përbërë si më sipër.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Nga verifikimi i dosjes, u konstatua se DT nuk disponoheshin në formatin “Hard copy”. Në dosje gjendeshin urdhërat për ngritjen e komisioneve, disa procesverbale dhe një shtojcë për ndryshim në DT, datë 14.09.2022;

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 08.09.2022, i paprotokolluar;

- Nga verifikimi i doklumentacionit, u konstatua se është kërkuar që ofertimi të bëhet mbi bazë çmimi dhe jo mbi bazën e normës/marzhit të fitimit, në kundërshtim me Aktin Normativ nr. 5, datë 12.03.2022 “*Për disa shtesa në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar*”, neni 21/5, “*Metodologjia e llogaritjes së çmimit*”, pika ç).

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “*...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 40, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 4.

Në nënpikën 2.5. të pikës 2.3. “*Kapaciteti teknik*”, në DT, është kërkuar “*...1 (një) autobot të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës (kondralitër)...*”. Kjo kërkesë është në kundërshtim me Ligjin nr. 118/2012 “*Për transportin e mallrave të rrezikshme*”, neni 23 “*Llojet e mallrave për autorizim*”, pika 1.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga V.T , A.Q dhe V.P , ndërsa për mënyrën e paraqitjes së çmimit, mban përgjegjësi edhe titullari i institucionit, z. Y.M .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 26.09.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 2 OE ofertues, të cilët janë kualifikuar. Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	K	183.38 lek/litër	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	O	185.40 lek/litër	Kualifikuar

- Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm është bërë në datën 30.09.2022, i paprotokolluar.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO në datën 30.09.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar prej tij po në atë datë. Raporti përmbledhës është hartuar në përputhje me kërkesat në LPP dhe në Rregullat e prokurimit publik.

- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK “Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes” dhe OE “K ” ShA është lidhur me nr. 334 prot., datë 31.10.2022, me afat deri në datën 31.03.2023 për vlerën 20,003,090 lekë pa TVSh.

- Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE K SHA nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit pagesën e detyrimeve vendore, si dhe nuk ka paraqitur vërtetimet përkatëse;

- OE K SHA nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, seksioni B, detajet për mjetin e transportit sipas kërkesës në DT;

- OE K SHA nuk vërteton disponimin e certifikatës për *transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës*, për mjetin e transportit sipas kërkesës në nënpikën 2.5. të pikës 2.3. “Kapaciteti teknik”, në DT, sipas kërkesës në DT.

Konkluzion: K SHA nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE K SHA, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE K SHA, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **20,003,090 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 8, datë 11.03.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 20, datë 19.04.2022.	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 9, datë 11.03.2022.

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 8, datë 11.03.2022.	1. V.T , Jurist 2. V.P , FI ncier 3. A.Q , Ekonomist	1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtar 3.I.L , Anëtar
5. Fondi Limit: 9,547,460.26 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “A.C ” ShPK me vlerë oferte 9,351,658.92 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 108 prot., datë 08.04.2022, me vlerë 11,221,990.70 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 195,801.34 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 25.03.2022	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- **Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “*F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL*”, janë siguruar fonde në vlerën 11,500,000 lekë si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË sipas VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “*Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë*”, VKB nr. 6, datë 27.01.2022, “*Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”*” si dhe Urdhërin nr. 43, datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë “*Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë, sipas programeve*”.

Urdhëri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Korçë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar, pika 154.

Situata: Me Urdhërin nr. 8, datë 11.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. V.T , znj. V.P , z. A.Q. Me Urdhërin nr. 8, datë 11.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “*F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL*” me fond limit në vlerën 9,547,460.26 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”. Me Urdhërin nr. 10, datë 11.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Referuar urdhërit për ngritjen e NjP u konstatua se, në përbërje të saj nuk ka asnjë specialist fushe për objektin e prokurimit.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 74, pika 2 dhe pika 4.

Ndikimi/Efekti: Vendosja në njësinë e prokurimit punonjës të cilët nuk janë specialist fushe, ndikon në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Për realizimin e projektit që i përket procedurës së prokurimit “*F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL*”, nga AK është kontraktuar studio e projektimit OE “*F*” ShPK, ku është hartuar dhe publikuar në SPE projektit “*Impiant furnizimi me GLN i kaldajës*” dhe “*Impianti i furnizimit me GLN i kaldajës për ngrohjen e Shkollës “Ymer Dishnica Korçë”*”. Gjithashtu në SPE është publikuar preventivi i punimeve por ky dokumentacion nuk ndodhet në dosjen e kësaj procedure prokurimi.

b- **Hartimi i kriterëve të DT:**

Nga NjP është mbajtur procesverbali pa datë dhe pa numër protokollit, për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar dokumentet e tenderit.

Më datë 23.03.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK NSHMAÇ, rezulton se: Për procedurën me REF-21836-03-11-2022, me objekt “*F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL*”, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë me fond limit 24,083,333 lekë pa TVSh, ka sygjerruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në datën 23.03.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Ishte	Bëhet:
<p>Pika 1.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: NP-3: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godi sh civile dhe industriale, veshje fasada “Kategoria A” Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. “Në kategorinë e punimeve të rikonstruksionit përfshihen, hapja e dyerve të reja në ambientet ekzistuese të klasave të shkollës që do të instalohen impiantet teknologjike”.</p>	<p>Hiqet si kriter</p>
<p>Pika nr. 2.3.3/4. Operatori ekonomik ofertues duhet që një nga drejtuesit teknik të përmbush kriterin për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe që të disponoj dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” e dhënë nga një organizëm i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj si dhe duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Janar 2022-Shkurt 2022. Nqs nuk plotësohet ky kriter shoqëria duhet të deklarojë nëpërmjet kontratës së punës ose të ketë të regjistruar në listëpagesat sipas afatit të kërkuar më sipër një punonjës me kualifikimin përkatës.</p>	<p>Pika nr. 2.3.3/4. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë/në stafin e tij 1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj. Për të cilin duhet të paraqiten:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontratë individuale të punës; • Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar-Shkurt 2022; • Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje. <p>Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>
Afati i vlerësimit të ofertave	
Data 25.03.2022	31.03.2022

1. Në pikën nr. 2.3.3. Dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

- Kamion vetëshkarkues (8 deri në 10 ton) copë 1 (një);

Shoqëria duhet të disponojë kamion vetëshkarkues për arsye se do të kryej grumbullimin e materialeve ndërtimore si rërë, çimento, hekur, transporti i rezervuarve të gazit, kaldajave dhe materialeve të tjera të nevojshëm për realizimin e procedurës.

- Betoniere copë 2 (dy);

Shoqëria duhet disponojë betoniere për përgatitjen e betonit në të cilën do ankorohen rezervuarët e gazit gjithashtu dhe për rehabilitimin e ambienteve teknike që do krijohen si pasojë e prishjeve duke e përshtatur me ambientin fillestar.

- Depozitë uji copë 1 (një);

Përpara dorëzimit të punës, sipas rregullave të instalimit të impianteve nën presion duhet t'u bëhet provë hidraulike për të provuar hermeticitetin e impiantit prandaj është e nevojshme që

shoqëria duhet të jetë e pajisur me depozitë uji e cila nevojitet në momentin kur të shkarkohet impianti.

- Pompë uji copë 1 (një);

Përpara dorëzimit të punës sipas rregullave të instalimit të impianteve nën presion duhet t'u bëhet provë hidraulike për të provuar hermeticitetin e impiantit ndaj është e nevojshme që shoqëria duhet të jetë e pajisur me pompë uji për realizimin e procedurës.

- Vibrator betoni copë 2 (dy);

Për arsye se rezervuarët e gazit sipas projektit janë të ankoruara mbi armaturë betoni.

- Matrapik copë 2 (dy);

Duke patur parasysh natyrën e punës e cila konsiston e hapjen e mureve ekzistues prishjen e dysHEMEVE prej betoni apo prej materialeve ndërtimi të forta.

- Trapano elektrike copë 1 (një)

Përhapjen e vrimave në të cilën do vendosen element lidhës për kapjen sa më të mirë të tubave të ujit të grohtë/ftohtë, gazit apo për punë të tjera të cilët kanë të bëjnë me hapjen e vrimave shoqëria duhet të ketë këtë pajisje.

- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

- Për manovratorin dhe shoferin duhet të paraqiten dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me Urdhërin nr. 200, datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi dhe/ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm: Lejen e qarkullimit; Çertifikatat e pronësisë; Siguracionin e mjetit; Kolaudimin; Çertifikatë transporti;

- Fotografi të mjetit të paraqitura (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qira dhënësit). Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë noteriale të blerjes;

- Ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit;

Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qiramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qirasë/furnizimit noteriale e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Kokore copë 18; Tabela sinjalizuse copë 10; Kutitë të ndihmës së shpejtë copë 5; Prozhektorë për ndriçim copë 5;

Për përmbushjen e këtij kriteri OE duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë deklaramit sipas shtojcës 8.

1. Në lidhje me fuqinë punëtore të operatorit ekonomik kërkohet:

Për realizimin e punimeve kërkohet që shoqëria pjesëmarrëse të ketë mesatarisht 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për periudhën **janar 2022-shkurt 2022**.

- Kjo pikë dokumentohet me vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës ose me vulë elektronike.

- Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-sig 25)

2. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të pasqyruar në listëpagesa (për periudhën janar 2022-shkurt 2022) të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ish IQT ose ekuivalentet e tij) dhe kontrata e punës e vlefshme: Teknik ndërtimi 1; Elektriçist 2; Hidraulik 2; Puntorë të thjeshtë 8; Specialist për punime gipsi 1; Specialist gazi dhe kaldaje 2; Manovrator 1; Shofer 1;

Për punonjësit specialist gazi dhe kaldaje duhen të jenë të pajisur me Dëshmi Aftësie për enët nën presion konkretisht për kaldajat dhe për instalimin e rezervuar më të vogël se 13 m³ GLN kjo gjë konform Ligjit nr. 32/2016.

Për punonjësit teknik ndërtimi të paraqiten edhe dokumentat që vërtetojnë kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë), të lëshuar nga organet shtetërore.

Për puntorët e thjeshtë nuk kërkohet asnjë dokument kualifikimi përveç prezencës në listëpagesë për periudhën e kërkuar dhe/ose kontratën e punës me Punëmarrësin.

Shoqëria duhet të ketë në stafin e saj drejtues (në liçensën e shoqërisë):

- Inxhinier ndërtimi 1;

Për realizimin e procedurës gjatë zhvillimit të punës shpesh herë lindi nevoja për prishjen e strukturave betonarme apo dhe për ndërhyrje në struktura mbajtëse për të bërë vlerësimin e tyre dhe për të rritur sigurinë në mos cënimin e sigurisë së strukturës mbajtëse të godinave shoqëria duhet të ketë një inxhinier ndërtimi.

- Inxhinier elektrik 1;

Duke qenë se disa pajisje të cilat do instalohen do punojnë me energji elektrike dhe për shak të shtimit të linjave të reja monofazë apo tre fazore shoqëria duhet të ketë inxhinier elektrik për të bërë ndryshime në linja apo ndërhyrje sipas nevojave të impiantit.

- Inxhinier hidroteknik 1;

Impiantet teknologjike të cilat do instalohen dhe pajisjet të cilat do furnizohen me ujë shoqëria duhet të ketë një inxhinier hidraulik për të bërë zbatimin e projektit sipas kushteve dhe normave teknike të instalimit të sistemeve të furnizimit me ujë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë pjesëmarrëse në këtë prokurim, që stafi i inxhinierëve, të kërkuar më sipër, janë të disponueshem për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

1. Në pikën 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore të sipërpërmendur për një periudhë jo më pak se 2 mujore (janar-shkurt 2022) nga dita e hapjes së tenderit. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 2-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në të ardhmen nga njësia e prokurimit.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për pikën nr. 2.3.3, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin

ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, **profesionit të punëtorëve** dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

2. Në pikën nr. 2.3.3/4. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë/në stafin e tij 1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj.

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës;
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **për periudhën janar-shkurt 2022;**
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Duke qenë se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.3.3/5. Shoqëria duhet të jetë e pajisur me çertifikatat e mëposhtme:

a) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001:2008 “Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”** (e vlefshme) **Ose ekuivalente.** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

b) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001:2015 “Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”** (e vlefshme) **Ose ekuivalente.** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

c) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001:2007 ose ekuivalenten e saj ISO 45001:2018 “Standard për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”** (e vlefshme) **Ose ekuivalente.** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2008 “Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”**, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve,

marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “F.V. kaldajë e plotë me djegës + linja e furnizimit me GNL”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 9, datë 11.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. P.X kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S.Z, znj.I.L .

Procesverbali nr. 2, i mbajtur nga KVO i datës 31.03.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë ku vetëm njëri prej tyre ka paraqitur ofertë me vlerën ekonomike përkatëse.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 31.03.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE dhe skualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “A.C ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “A.C ” ShPK (me Nipt M....L) me vlerë ekonomike të ofertës 9,351,658.92 lekë pa TVSh.

2. OE “S ” ShPK (me Nipt K....M) nuk ka ofertuar vlerë ekonomike.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE “S ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Nuk ka paraqitur ofertës me vlerë ekonomike.

Në datën 31.03.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Drejtorit të NSHMAÇ. Me shkresën e datës 01.04.2022, Drejtori i NSHMAÇ ka miratuar Raportin Përmbledhës. Në datën 31.03.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “A.C ” ShPK.

1. Pika nr. 2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomik duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

Nga OE "A.C " ShPK është paraqitur vërtetimi për xhiron vjetore vetëm për vitin 2020 sipas shkresës me nr. T05813812, datë 23.03.2022, por nuk është paraqitur vërtetimi për xhiron vjetore për vitin 2018 dhe 2019.

2. Pika nr. 2.2.2. Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitet 2018, 2019 dhe 2020 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (Administrata tatimore) me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, kur janë në kushtet e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Nga OE "A.C " ShPK janë paraqitur vetëm pasqyrat financiare të vitit 2020 të cilat janë depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por nuk është marrë konfirmi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori. Gjithashtu nga OE "A.C " ShPK nuk janë paraqitur pasqyrat financiare për vitin 2018 dhe 2019.

3. Në pikën nr. 2.3.3/2. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të pasqyruar në listëpagesa (për periudhën Janar 2022-Shkurt 2022) të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ish IQT ose ekuivalentet e tij) dhe kontrata e punës e vlefshme: Teknikë ndërtimi 1; Elektriçistë 2; Hidraulik 2; Puntorë të thjeshtë 8; Specialist për punime gipsi 1; Specialist gazi dhe kaldaje 2; Manovrator 1; Shofer 1;

Për punonjësit specialist gazi dhe kaldaje duhen të jenë të pajisur me Dëshmi Aftësie për enët nën presion konkretisht për kaldajat dhe për instalimin e rezervuar me të vogël se 13 m³ GLN kjo gjë konform Ligjit nr. 32/2016.

Për punonjësit teknik ndërtimi të paraqiten edhe dokumentat që vërtetojnë kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë), të lëshuar nga organet shtetërore.

Për puntorët e thjeshtë nuk kërkohet asnjë dokument kualifikimi përveç prezencës në listëpagesë për periudhën e kërkuar dhe/ose kontratën e punës me punëmarrësin.

Nga OE "A.C " ShPK në lidhje me kërkesën për disponibilitetin e 2 punonjësve me profesion Specialist gazi dhe kaldaje ka paraqitur 2 kontrata pune të datës 21.01.2021, të lidhur me punonjësit z. I.Ç dhe z. S.G të angazhuar për realizimin e punimeve të instalimeve të impianteve të kondicionimit, aspirimit dhe të sistemeve të ndryshme të klimës. Për këta punonjës nuk është paraqitur dëshmia e aftësisë për enët nën presion konkretisht për kaldajat dhe për instalimin e rezervuar me të vogël se 13 m³ GLN.

4. Në datën 20.09.2021, ndërmjet z. A.H dhe OE "A.C " ShPK është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira 1 Kamion me targë AA972BF. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me numër Rep., 5151, dhe Kol., 1670, datë 20.09.2021.

Për mjetin **Kamion me targë AA972BF** dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, policia për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta i përket periudhës nga data 15.10.2020, deri më 14.10.2021, pra i ka mbaruar afati dhe nuk është e vlefshme duke marrë në konsideratë faktin që procedura e prokurimit zhvillohet në vitin 2022.

Për sa trajtuar më sipër OE "A.C " ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet t'i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE "A.C " ShPK.

Mosdisponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE "A.C " ShPK dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "A.C " ShPK. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, neni 3, "*Parimet të përgjithshme*", neni 98 "*Anulimi i një procedure prokurimi*" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*" pika 2, neni 67 "*Klasifikimi i ofertave*" pika 2, neni 83 "*Njoftimi i fituesit*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Y.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. P.X , znj. S.Z, znj.I.L në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “A.C ” ShPK, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **9,351,658.92 lekë**.

14. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mobilje druri”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 23, datë 24.05.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 23, datë 24.05.2022.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 25, datë 24.05.2022.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”.	1. V.T , Jurist 2. V.P , FI ncë 3. A.Q , Ekonomist	1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtar 3.I.L , Anëtar
5. Fondi Limit: 9,750,000 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “SH ” ShPK me vlerë oferte 9.236.250 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 238 prot., datë 12.07.2022, me vlerë 11,083,500 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 513.750 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 06.06.2022.	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- **Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit:**

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mobilje druri”, janë siguruar fonde në vlerën 11,700,000 lekë si rezultat i bashkë fll ncimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË sipas VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6, datë 27.01.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë””, si dhe Urdhërin nr. 43, datë 28.01.2022, “Detajimi i shpenzimeve për investimeve për vitin 2022”. Urdhëri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit në datën 24.06.2022, në përputhje me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Situata: Me Urdhërin nr. 23, datë 24.05.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. V.T , znj. V.P , z. A.Q

Me Urdhërin nr. 23, datë 24.05.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Mobilje druri” me fond limit në vlerën 9,750,000 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Me Urdhërin nr. 24, datë 19.04.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Referuar urdhërit për ngritjen e NjP u konstatua se, në përbërje të saj nuk ka asnjë specialist fushe për objektin e prokurimit.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 2 dhe pika 4.

Ndikimi/Efekt: Vendosja në njësinë e prokurimit punonjës të cilët nuk janë specialist fushe, ndikon në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Në datën 24.05.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit. Në datën 25.05.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar dokumentet e tenderit. Në datën 30.05.2022, nga NjP është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Ishte	Bëhet:
1. Dollapë zyre kanat me çelës lartësia 1.2 m Dollapi duhet të ketë pëmasat 200 cm x 40 cm x 120 cm. Dollapi duhet të jetë prej materiali rezistent MDF të plastifikuar me trashësi jo më të vogël se 16 mm. Dollapi do të ketë dy kanata që do kenë çelës për kyçjen e tyre. Në brendësi të dollapit do të ketë 5 raftet, të cilat mund të jenë fikse ose të lëvizshme për t'u përshtatur sipas nevojës së përdoruesve. Raftet gjithashtu do të jenë prej materiali rezistent ndaj ngarkesave dhe do të ketë trashësi jo më të vogël se 18 mm.	1. Dollapë klase kanat me çelës Dollapi duhet të jetë prej materiali rezistent MDF të plastifikuar me trashësi jo më të vogël se 16 mm. Dollapi do të ketë dy kanata që do kenë çelës për kyçjen e tyre. Në brendësi të dollapit do të ketë 5 raftet, të cilat mund të jenë fikse ose të lëvizshme për t'u përshtatur sipas nevojës së përdoruesve. Raftet gjithashtu do të jenë prej materiali rezistent ndaj ngarkesave dhe do të ketë trashësi jo më të vogël se 18 mm.

1. Në pikën nr. 2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ISO 9001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë*” (të vlefshme) ose ekuivalent, që tregon se operon sipas Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Çertifikatën ISO 14001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit Mjedisor*” (të vlefshme) ose ekuivalent për menaxhimin e Mjedisit. Çertifikata duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 9001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë*”, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “*shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve*”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “*Mobileri druri*”.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 14001:2015 “*Sistemi i Menaxhimit Mjedisor*”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

2. Në pikën nr. 2.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 10 persona për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të sipërkërkuar sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për sa i përket kërkesës për disponibilitetin e fuqisë punëtore 10 punonjës, ky kriter nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se nuk argumentohet dhe dokumentohet analiza se për çfarë duhet ky kapacitet i fuqisë punëtore, duke marrë edhe faktin që kjo është procedurë blerje mallrash, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

3. Në pikën nr. 2.9. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti, me qëllim transportin e mallrave, me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm

për transport mallrash, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira. Pronësia e mjetit të mësipërm të vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi);

- Mjetet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit; Për mjetet e transportit duhet të paraqiten edhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore).

Kërkesa për disponibilitetin e një mjeti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash është një kërkesë e pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se mallrat janë për furnizimin e Autoritetit Kontraktor dhe jo në pikën e prodhimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 25, datë 24.05.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. P.X kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S.Z, znj.I.L .

Procesverbali nr. 2, i mbajtur nga KVO i datës 22.06.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 5 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlerat ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 22.06.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE dhe skualifikuar 3 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “SH ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “B ” ShPK (me Nipt J....C) nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. OE “E ” ShPK (me Nipt J....P) me vlerë ekonomike të ofertës 1,731,000 lekë pa TVSh.
3. OE “K ” ShPK (me Nipt K....F) me vlerë ekonomike të ofertës 9,159,500 lekë pa TVSh.
4. OE “SH ” ShPK (me Nipt J....J) me vlerë ekonomike të ofertës 9,236,250 lekë pa TVSh.
5. OE “A.C ” ShPK (me Nipt M....L) me vlerë ekonomike të ofertës 9,685,000 lekë pa TVSh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE “B ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Për mos dorëzimin e mostrave të produkteve në orën dhe datën e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

- Për mos paraqitjen e ofertës ekonomike.

2. OE “E ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- Për arsye se formulari i ofertës i paraqitur nga OE nuk përputhet me preventivin e përcaktuar në DT.

- Numri i referencës REF-99775-07-01-2021 nuk përputhet me numrin e referencës së procedurës “Mobileri druri” të shpallur nga Autoriteti Kontraktor REF-30679-05-25-2022.

- Nga OE oferta i referohet Drejtorisë Rajonale OSSH Shkodër dhe jo Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.

- Zërat e preventivit të paraqitur në formularin e ofertës nuk përputhen me zërat e pasqyruara në DT.

3. OE “K ” ShPK për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

Për arsye se mostratat e dorëzuara nuk përshtatetn me fotot dhe specififikimet e kërkuara në DT:

- Lartësia e pjesës ulëse të karriges 6 cm më e lartë.

- Lartësia e shpinës është 12 cm më e lartë.

- Pjesa ulëse është e sheshtë dhe jo e harkuar sipas fotos.

- Sipërfaqja e pjesës ulëse gjatësi/gjerësi është 4 cm më e madhe.

Në datën 01.07.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Drejtorit të NSHMAÇ. Me shkresën e datës 22.06.2022, Drejtori i NSHMAÇ ka miratuar Raportin Përmbledhës. Më datë 01.07.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “SH ” ShPK.

15. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Gaz i lëngshëm”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 7, datë 07.02.2022.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7, datë 07.02.2022. 1. V.T , Jurist 2. V.P , FI ncier 3. A.Q , Ekonomist	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 33, datë 16.03.2022. 1. P.X , Kryetar 2. S.Z, Anëtarë 3.I.L , Anëtarë
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”.		
5. Fondi Limit: 7,750,000 lekë pa TVSh	6. Oferta fituese: OE “T ” ShPK me vlerë oferte 7,686,000 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 106 prot., datë 06.04.2022, me vlerë 9,223,200 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: 64,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 23.03.2022.	9. Burimi i FI ncimit: Të ardhurat e Bashkisë + Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 c) Kualifikuar: 2
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Gaz i lëngshëm”, janë siguruar fonde në vlerën 9,300,000 lekë nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË të miratuara respektivisht me VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6, datë 27.01.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”” si dhe Urdhërin nr. 42, datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2022 të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë, sipas programeve”. Urdhëri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Korçë më datë 14.02.2022, në përputhje me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

b- Hartimi i kriterëve të DT:

Në datën 16.03.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit. Duke u bazuar në procesverbalin e sipërpërmendur NjP për caktimin e fondit limit është bazuar referuar kushteve të CIF në Shqipëri konkretisht çmimi 75 lekë/litër pa TVSh x 100,000 litra = 7,750,000 lekë (deri në datën 31.12.2022). Ky furnizim shërben për furnizimin me gaz të lëngshëm të çerdheve kopshteve që do të përdoret për gatim si dhe furnizimin e kaldajave. Nga auditimi u konstatua se nuk argumentohet sasia e kërkuar prej 100,000 litra e gazit të lëngshëm konkretisht, nuk argumentohet numri i çerdheve, kopshteve dhe kaldajave që do të furnizohen me gaz të lëngshëm, furnizimet e viteve të mëparshme, dhe analiza mbi konsumin e bombulave të gazit apo kaldajave plan shpërndarja. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë

19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76, pika 2. Për më tepër në lidhje me këtë problematikë janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse nga Agjencia e Prokurimit Publik më datë 10.02.2022.

Situata: Me Urdhërin nr. 7, datë 07.02.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. V.T , znj. V.P , z. A.Q

Me Urdhërin nr. 7, datë 07.02.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Gaz i lëngshëm” me fond limit në vlerën 7,750,000 lekë pa TVSh me anë të llojit të procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Me Urdhërin nr. 32, datë 16.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Referuar urdhërit për ngritjen e NjP u konstatua se, në përbërje të saj nuk ka asnjë specialist fushe për objektin e prokurimit.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 2 dhe pika 4.

Ndikimi/Efekti: Vendosja në njësinë e prokurimit punonjës të cilët nuk janë specialist fushe, ndikon në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Mos respektimi i kuadrit rregullator ligjor për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Situata: 1. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport analizimi për tregun e brendshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI) brenda 6 muajve nga data e hapjes së ofertave.

Vendosja e kërkesës se nga operatorët ekonomikë duhet të paraqitet raport analizimi për tregun e brendshëm mbi cilësinë e karburantit brenda 6 muajve nga data e hapjes së ofertave, është kriter kufizues për arsye se ky dokument mund të disponohet nga operatorët ekonomikë për një periudhë më të hershme.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 1, 2 dhe neni 21, pika 1, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, neni 78.

Ndikimi/Efekti: Kufizimi i pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

Shkaku: Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë.

Rëndësia: E lartë.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. V.T , znj. V.P , z. A.Q në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

c- Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhërin nr. 33, datë 16.03.2022, të z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. P.X kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S.Z, znj.I.L .

Procesverbali nr. 2, i mbajtur nga KVO i datës 28.03.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 operatorë ekonomikë kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar. Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 28.03.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “T ” ShPK.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “T ” ShPK (me Nipt L....S) me vlerë ekonomike të ofertës 7,686,000 lekë pa TVSh.
2. OE “K ” ShPK (me Nipt K....E) me vlerë ekonomike të ofertës 8,431,000 lekë pa TVSh.

Në datën 29.03.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Drejtorit të NSHMAÇ. Me shkresën e datës 29.03.2022, Drejtori i NSHMAÇ ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me datë 28.03.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “T ” ShPK.

Procedurat e audituara nga prokurimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë:

16. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Asfalto beton e bitum për spërkatje”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 467 datë 28.04.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 400 datë 15.04.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 475 datë 28.04.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje – kuadër)	1. P.M , Përgj. Menaxh. Kontratave 2. P.N , Jurist 3. P.N , Përgjegjëse prokurimesh	1. A.N , Kryetar 2. M.H , Anëtar 3. N.K , Anëtar
5. Fondi Limit: 33,333,217 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “V ” ShPK, me vlerë 24,227,700 lekë pa TVSh, me kontratë datë 14.06.2022, me afat 12 mujor	7. Diferenca me fondin limit: 9,105,517 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 18.05.2022	9. Burimi i FI ncimit: Vetëfinancim	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: OE c) Kualifikuar: 5 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 398 prot., datë 15.04.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për mallrat si më poshtë:

Asfalto Beton: 2,700 ton; Asfalto Beton i ftohtë: 80 ton dhe Bitum për spërkatje: 20,977 kg.

Në dosje nuk gjendet asnjë dokument nëpërmjet të cilit të argumentohet nevoja për përdorimin e sasisë së kërkuar.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 399 prot., datë 15.04.2022 “Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Asfalto beton e bitum për spërkatje””, nëpërmjet të cilat është ngarkuar tekniku i ndërtimit P.SH ;

Caktimi vetëm i një personi për llogaritjen e Fondit Limit është në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pikat 2 dhe 3.

Për llogaritjen e Fondit limit është përdorur metoda e studimit të tregut, ku konstatohet të jenë marrë tre oferta, si më poshtë:

Nr.	Ofertuesi	Data e ofertës	Nj. matëse	A/Beton	A/Beton i ftohtë	Bitum për spërkatje
1	V	13.04.2022	Ton	10,800	19,000	150
2	S	-	Ton	10,200	17,000	120
3	A	-	Kg	11,000	16,000	180

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet asnjë procesverbal, asnjë përlllogaritje dhe asnjë dokument tjetër në bazë të së cilit të jetë hartuar fondi limit, ku edhe të jenë përcaktuar projekti/projektet e rrugëve apo shesheve në të cilat parashikohet përdorimi i këtyre mallrave; Përgjegjësia për caktimin vetëm të një personi, i cili nuk ka as kualifikim të mjaftueshëm për llogaritjen e fondit limit është e titullarit të institucionit, z. I.D , ndërsa përgjegjësia për mosargumentimin e fondit limit është e z. P.SH , teknik ndërtimi.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e Fondit limit është hartuar procesverbali nr. 399/1 prot., datë 27.04.2022, nënshkruar nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e fondit limit.
- Në pikën 2.2. në DT, për kapacitetin ekonomik dhe financiar kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.
- Në pikën 2.3. në DT, kërkohet “...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5.
- Në pikën 2.4. në DT, krahas të tjerave, për fabrikën e asfaltobetonit është kërkuar “...leja mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore të leshuar nga Ministria e Mjedisit.”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi, si rregull, një fabrikë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të funksionojë apo ekzistojë pa këto lloj lejesh dhe nuk mund as të shesë materiale inerte. Ky kriter, është kërkuar të rishikohet edhe nga APP, pasi nuk është i lidhur direkt me LPP, por me personat e tretë dhe institucione të treta. Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.N , P.M dhe P.N .

c- Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 570 prot., datë 25.05.2022.
- Nga Raporti Përmbledhës, u konstatua pjesëmarrja e 5 OE ofertues, të cilët janë kualifikuar dhe fitues është shpallur OE V , me vlerë 24,227,700 lekë, e cila rezulton të jetë vlera më e ulët e ofertuar.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	V	24,227,700	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	A	26,297,470	Kualifikuar

3	Bi-Servis	26,601,321	Kualifikuar
4	Alb Korca 2002	30,367,240	Kualifikuar
5	Simaku	30,553,378	Kualifikuar

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 588 prot., datë 30.05.2022.
- Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 636 prot., datë 10.06.2022, i miratuar nga titullari.
- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “V” ShPK është lidhur me nr. 637/1 prot., datë 14.06.2022, pa afat.
- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 651/3 prot., datë 15.06.2022, me vlerë 8,700,000 lekë pa TVSh, me afat të papërcaktuar. Afati i përcaktuar në kërkesë është deri në datën 31.07.2022 për sasinë 1,000 ton asfalto beton dhe 8,000 kg bitum për spërkatje.
- Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar në datën 31.07.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .
- Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 892/3 prot., datë 08.08.2022, me vlerë 8,600,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 30.08.2022 për sasinë 1,000 ton asfalto beton dhe 7,000 kg bitum për spërkatje. Me amendamentin e kontratës nr. 984/3 prot., datë 30.08.2022, është shtyrë afati deri në datën 15.09.2022. Planin për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 892/5 prot., datë 08.08.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave. Për këtë minikontratë nuk është hartuar raport për mbikëqyrjen e kontratës;
- Është lidhur minikontrata nr. 3, me nr. 1119 prot., datë 20.09.2022 me vlerë 6,927,700 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 15.10.2022 për sasinë 801 ton asfalto beton dhe 5,998 kg bitum për spërkatje. Me amendamentin e kontratës nr. 1272 prot., datë 17.10.2022, është shtyrë afati deri në datën 19.10.2022.
- Planin për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1119/1 prot., datë 20.09.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar në me nr. 1119/3 prot., datë 16.12.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:
- OE V nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

Konkluzion:

Duke pasur parasysh se OE V ka paraqitur ofertën me vlerën më të ulët, si dhe në konsideratë të nenit 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi i dytë, grupi i auditimit konstaton se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

17. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti, loti 1 naftë, loti 2 benzinë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr 336 prot, date 05.04.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 329 datë 04.04.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 337 datë 05.04.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje kuadër)	1. P.M , Përgj. Men. Kontratave 2. P.N , Jurist 3. P.N , Përgj. prokurimesh	1. A.N , Kryetar 2. M.H , Anëtar 3. E.SH , Anëtar
5. Fondi Limit: 35,422,177 lekë pa TVSh Loti 1: Naftë 32,530,211 lekë	6. Oferta fituese: OE “M” ShPK. Loti 1: Norma e fitimit 5 lekë/liter Loti 2: Norma e fitimit 7 lekë/litër	7. Diferenca me fondin limit: Ska

Loti 2: Benzinë 2,891,966 lekë	Kontratat datë 16.05.2022, me afat 12 mujor	
8. Data e hapjes së tenderit: 26.04.2022	9. Burimi i FI ncimit: Vetëfl ncim + Buxheti i shtetit	10. OE Pjesëmarrës Loti 1: a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE OE Pjesëmarrës Loti 2: a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 327 prot., datë 04.04.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për mallrat: Naftë: 182,000 litra dhe Benzinë 18,000 litra.

Në dosje nuk gjendet asnjë dokument nëpërmjet të cilit të argumentohet nevoja për përdorimin e sasisë së kërkuar dhe as metoda e përdorur për llogaritjen e fondit limit.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 328 prot., datë 04.04.2022 *“Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Asfalto beton e bitum për spërkatje”*“, nëpërmjet të cilat është ngarkuar inxhinieri N.K ;

Caktimi vetëm i një personi për llogaritjen e Fondit Limit është në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 76 *“Mënyrat për për llogaritjen e vlerës së prokurimit”*, pikat 2 dhe 3.

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet asnjë procesverbal, asnjë për llogaritje dhe asnjë dokument tjetër në bazë të së cilit të jetë hartuar fondi limit, ku edhe të jenë përcaktuar konsumet e mjeteve dhe parashikimi i nevojave për mallin që kërkohet të prokurohet;

Përgjegjësia për caktimin vetëm të një personi është e titullarit të institucionit, z. I.D , ndërsa përgjegjësia për mosargumentimin e fondit limit është e z. N.K , teknik ndërtimi.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e Fondit limit janë hartuar procesverbalet nr. 336/1 prot., datë 05.04.2022 dhe nr. 336/2, datë 05.04.2022, nënshkruar nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e fondit limit.

- Në pikën 2.2. në DT, kërkohet *“...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e për llogaritur e kontratës ose lotit që prokurohet”*. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 43, *“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”*, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.3. në DT, kërkohet *“...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës të për llogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet.”*.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 40, *“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”*, pika 4.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 *“Kërkesat për kualifikim”*, neni 2 *“Qëllimi”*, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 40 *“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”*, pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.M , P.N dhe P.N .

c- Vlerësimi i ofertave:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, me nr. 487 prot., datë 29.04.2022, i paprotokolluar, nga ku konstatohet pjesëmarrja e 3 OE ofertues, nga të cilët janë kualifikuar 2 dhe është skualifikuar 1. Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Norma e fitimit	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	OE M	7 lekë	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	OE K	14.9 lekë	Kualifikuar
3	BOE A	18 lekë	Skualifikuar

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 487/3 prot., datë 04.05.2022.
 - Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 435 prot., datë 16.05.2022, i miratuar nga titullari.
 - Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “M ” ShPK është lidhur me nr. 435/3 prot., datë 16.05.2022, me afat 12 muaj.
 - Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 439/3 prot., datë 16.05.2022, me vlerë 10,072,500 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 17.08.2022.
 - Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.
 - Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 884/2 prot., datë 04.08.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave; Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .
 - Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 921/3 prot., datë 08.08.2022, me vlerë 6,120,491 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 08.09.2022. Planit për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 928 prot., datë 10.08.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave. Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 923/4 prot., datë 09.10.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
 - Është lidhur minikontrata nr. 3, me nr. 1057 prot., datë 08.09.2022 me vlerë 9,658,836 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 09.11.2022.
 - Planit për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1057/2 prot., datë 08.09.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
 - Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar në me nr. 1057/3 prot., datë 07.11.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
 - Është lidhur minikontrata nr. 4, me nr. 1428/2 prot., datë 09.11.2022 me vlerë 6,678,384 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022.
 - Planit për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1428/3 prot., datë 09.11.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
 - Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar në me nr. 1524/1 prot., datë 21.02.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
- Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:
- OE M nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

Konkluzion:

Duke pasur parasysh se OE M ka paraqitur ofertën me vlerën më të ulët, si dhe në konsideratë të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë, grupi i auditimit konstaton se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

18. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale Ndërtimi”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 230 datë 10.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 207 datë 04.03.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 230/1 datë 10.03.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje – kuadër)	1. P.M , Përgj. Menaxh. Kontratave 2. P.N , Jurist 3. P.N , Përgjegjëse prokurimesh	1. A.N , Kryetar 2. M.H , Anëtar 3. P.SH , Anëtar
5. Fondi Limit: 38,990,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “I ” ShPK., me vlerë 37,630,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 10.05.2022, me afat 12 mujor	7. Diferenca me fondin limit: 1,360,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 05.04.2022	9. Burimi i FI ncimit: VetëfI ncim + Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 205 prot., datë 04.03.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për materialet sipas listës përkatëse.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 206 prot., datë 04.03.2022 “Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Materiale ndërtimi””, nëpërmjet të cilat janë ngarkuar z. A.H , z. K.Z dhe NjP;

Për llogaritjen e Fondit limit është përdorur metoda e studimit të tregut, ku konstatohet të jenë marrë tre oferta, pa data.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP janë hartuar procesverbalet nr. 207/1 prot., datë 10.03.2022 dhe nr. 207/2 prot., datë 11.03.2022, nënshkruar nga NjP dhe personat e caktuar për llogaritjen e fondit limit.

- Në pikën 2.2. në DT, për kapacitetin ekonomik dhe financiar kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.3. në DT, kërkohet “...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5.

- Në pikën 2.6. në DT, krahas të tjerave, për nyjen e inerteve është kërkuar “...leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore të leshuar nga Ministria e Mjedisit”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi, si rregull, një fabrikë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të funksionojë apo ekzistojë pa këto lloj lejesh dhe nuk mund as të shesë materiale inerte. Ky kriter, është kërkuar të rishikohet edhe nga APP, pasi nuk është i lidhur direkt me LPP, por me personat e tretë dhe institucione të treta.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.N , P.M dhe P.N .

c- Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, me nr. 370 prot., datë 11.04.2022.
- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 370/1 prot., datë 11.04.2022.
- Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 285/1 prot., datë 12.04.2022, i miratuar nga titullari.
- Nga Raporti Përmbledhës, u konstatua pjesëmarrja e 1 OE ofertues, OE I , i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues, me vlerë 37,630,000 lekë.
- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “I” ShPK është lidhur me nr. 510/1 prot., datë 05.05.2022, me afat 12 muaj.
- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 433/3 prot., datë 20.05.2022, me vlerë 26,750,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 15.10.2022.
- Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 572/1 prot., datë 11.11.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave; Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .
- Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 1324/1 prot., datë 20.10.2022, me vlerë 6,500,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022. Planin për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1324/3 prot., datë 21.10.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 1324/4 prot., datë 13.02.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
- Është lidhur minikontrata nr. 3, me nr. 56/2 prot., datë 27.01.2022 me vlerë 4,380,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 15.03.2023.
- Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar në me nr. 56/3 prot., datë 15.03.2023, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave; Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE I nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarin e origjinës së dokumenteve për pikat c), ç) g) dhe h);

Konkluzion:

Në konsideratë të nenit 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, paragrafi i dytë, grupi i auditimit konstaton se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

19. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Prodhime betoni”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 238 datë 11.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 215 datë 07.03.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 239 datë 11.03.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur (marreveshje – kuadër)	1. P.M , Përgj. Menaxh. Kontratave 2. P.N , Jurist 3. P.N , Përgjegjëse prokurimesh	1. A.N , Kryetar 2. M.H , Anëtar 3. P.SH , Anëtar
5. Fondi Limit: 10,495,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “A ” ShPK., me vlerë 9,585,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 13.05.2022, me afat 12 mujor	7. Diferenca me fondin limit: 910,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 11.04.2022	9. Burimi i FI ncimit: Vetëfi ncim	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: OE c) Kualifikuar: 3 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 213 prot., datë 07.03.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për materialet sipas listës përkatëse.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 214 prot., datë 04.03.2022 “Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Prodhime betoni””, nëpërmjet të cilat janë ngarkuar z. A.H , z. K.Z dhe NjP;

Për llogaritjen e Fondit limit është përdorur metoda e studimit të tregut, ku konstatohet të jenë marrë tre oferta, pa data.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP është hartuar procesverbali nr. 215/1 prot., datë 11.03.2022, nënshkruar nga NjP dhe personat e caktuar për llogaritjen e fondit limit.

- Në pikën 2.2. në DT, për kapacitetin ekonomik dhe financiar kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.3. në DT, kërkohet “...dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.N , P.M dhe P.N .

c- Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, me nr. 464 prot., datë 27.04.2022.

- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 464/2 prot., datë 04.05.2022.

- Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 526 prot., datë 13.05.2022, i miratuar nga titullari.
- Nga Raporti Përmbledhës, u konstatua pjesëmarrja e 3 OE ofertues, OE A , me ofertë 9,585,000 lekë pa TVSh, OE V , me ofertë 9,602,500 lekë pa TVSh dhe OE Z , me ofertë 9,790,000 lekë pa TVSh të cilët janë kualifikuar. Fitues është shpallur OE A , me ofertën 9,585,000 lekë pa TVSh, e cila ka qenë edhe oferta me vlerën më të ulët.
- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “A ” ShPK është lidhur me nr. 526/3 prot., datë 13.05.2022, me afat 12 muaj.
- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 432/3 prot., datë 16.05.2022, me vlerë 5,505,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.08.2022.
- Nga auditimi, u konstatua se nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, në kundërshtim me LPP, neni 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*”, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 107 “*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”. Në të dy këto akte ligjore specifikohet që për zbatimin e kontratës, nga AK hartohet plani i zbatimit të kontratës dhe në vijim të tij procesverbalet përkatëse, në prani të kontraktorit.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 568/1 prot., datë 09.10.2022, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave; Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .
- Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 1166 prot., datë 29.09.2022, me vlerë 4,080,000 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022. Planin për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1166/2 prot., datë 30.09.2022, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 1166/3 prot., datë 09.10.2023, nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave; Përgjegjësia për mos hartimin e planit të zbatimit të kontratës është e titullarit të institucionit, z. I.D .

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE A nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarin e origjinës së dokumenteve për pikat c), ç), d), g) h) dhe i;
- OE A nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me pagesën e detyrimeve vendore;
- OE A nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, seksioni B, detajet për mjetin e transportit sipas kërkesës në DT;

Konkluzion:

OE A ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE A ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE A ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **9,585,000 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Përgjegjësia për sa më sipër është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga A.N , M.H dhe P.SH .

20. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale elektrike”		
1. Urdhër Prokurimi:	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:

Nr. 770 datë 06.07.2022	Nr. 743 datë 30.06.2022	Nr. 803 datë 18.07.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thejshuar (marreveshje –kuadër)	1. P.M , Përgj. Menaxh. Kontratave 2. P.N , Jurist 3. P.N , Përgjegjëse prokurimesh	1. V.P , Kryetare 2. M.H , Anëtar 3. B.M , Anëtare
5. Fondi Limit: 8,324,705 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “H ” ShPK., me vlerë 7,994,885 lekë pa TVSh, me kontratë datë 05.08.2022, me afat 12 mujor	7. Diferenca me fondin limit: 329,820 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 18.07.2022	9. Burimi i Financimit: VetëfI ncim	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 741 prot., datë 30.06.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për materialet sipas listës përkatëse.

Në dosje nuk gjendet asnjë dokument nëpërmjet të cilit të argumentohet nevoja për përdorimin e sasisë së kërkuar.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 742 prot., datë 30.06.2022 “Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Materiale elektrike”“, nëpërmjet të cilat janë ngarkuar znj. L.P.;

Caktimi vetëm i një personi për llogaritjen e Fondit Limit është në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pikat 2 dhe 3.

Për llogaritjen e Fondit limit është përdorur metoda e studimit të tregut, ku konstatohet të jenë marrë tre oferta.

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet asnjë procesverbal, asnjë përlllogaritje dhe asnjë dokument tjetër në bazë të së cilit të jetë hartuar fondi limit, ku edhe të jenë përcaktuar projekti/projektet e rrugëve apo shesheve në të cilat parashikohet përdorimi i këtyre mallrave; Përgjegjësia për caktimin vetëm të një personi, i cili nuk ka as kualifikim të mjaftueshëm për llogaritjen e fondit limit është e titullarit të institucionit, z. I.D , ndërsa përgjegjësia për mosargumentimin e fondit limit është e znj. L. P., brigadiere në sektorin e ndriçimit.

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP është hartuar procesverbali nr. 742/1 prot., datë 06.07.2022, nënshkruar nga NjP dhe personat e caktuar për llogaritjen e fondit limit.

- Në pikën 2.2. në DT, për kapacitetin ekonomik dhe financiar kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës se parashikuar te kontrates”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

Ky kriter, nuk përmbush parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.N , P.M dhe P.N .

c- Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës:

- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 2, me nr. 841 prot., datë 22.07.2022,
- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 855 prot., datë 27.07.2022.
- Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 894 prot., datë 03.08.2022, i miratuar nga titullari.
- Nga Raporti Përmbledhës, u konstatua pjesëmarrja e 3 OE ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	H	7,994,885	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	A	7,774,650	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Operatori Ekonomik A nuk plotëson kushtin teknik dhe profesional për furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës me një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit të kësaj kontrate. Operatori ka paraqitur tre fatura furnizimi me vlerë mbi 20% të fondit limit, por furniturat në faturë ishin të profilit hidraulik dhe jo material elektrike sipas objektit të prokurimit aktual. Operatori Ekonomik A nuk ka paraqitur mostrat e materialeve të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit brënda afateve të përcaktuara.
3	I	8,218,640	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Nga verifikimi I kryer I materieleve elektrike të mostrave bazuar në specifikimet teknike u konstatua : 1. Llama CMH 100Ë E 40 nuk përmbush kriterin e temperaturës së ngjyrës • Në specifikimet teknike temperaturë ngjyrës 3000-3500 K • Mostra e paraqitur nga I 2800K 2. Llama CMH 150Ë E 40N nuk përmbush kriterin e temperaturës së ngjyrës • Në specifikimet teknike temperaturë ngjyrës 4000-4200 K • Mostra e paraqitur nga I 2800K 3. Përcjellës alumini fi 16 mm2 nuk përmbush kriterin e mëposhtëm : • Në specifikimet teknike - Përcjellësi të jetë me dy mbulesa plastike. • Mostra e paraqitur nga I - Përcjellësi është me një mbulesë plastike. 7,994,885

- Kontrata/Marrëveshja Kuadër ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE "H" ShPK është lidhur me nr. 907 prot., datë 05.08.2022, me afat 12 muaj.
- Është lidhur minikontrata nr. 1, me nr. 910 prot., datë 05.08.2022, me vlerë 1,761,985 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 15.08.2022. Plani për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 910/2 prot., datë 08.08.2022, ku ngarkohet z. P.M, me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 910/3 prot., datë 09.09.2022, nga z. P.M, i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
- Është lidhur minikontrata nr. 2, me nr. 459 prot., datë 04.04.2022, me vlerë 3,120,400 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.05.2022. Plani për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 459/1 prot., datë 04.04.2022, ku ngarkohet z. P.M, me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 459/2 prot., datë 09.06.2023, nga z. P.M, i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;
- Është lidhur minikontrata nr. 3, me nr. 889/4 prot., datë 21.07.2022, me vlerë 2,711,800 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 04.08.2022. Plani për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 906 prot., datë 21.07.2022, ku ngarkohet z. P.M, me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- OE ka kërkuar shtyrje të afatit për dorëzimin e mallrave, e cila nuk është pranuar nga AK. Pas mospërmbushjes së dorëzimit të mallrave, në zbatim të kushteve dhe termave të kontratës, AK ka filluar procedurat për penalizimin e OE me kamatëvonesë në masën 4/1000, për 26 ditë vonesë, për sasinë e palëvruar të mallrave, e cila në total shkon 275,384 lekë;
- Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është hartuar me nr. 1336 prot., datë 13.10.2023, nga z. P.M, i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave;

Konkluzion:

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

21. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “MakI ”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1500 datë 25.11.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 1499/2 datë 24.11.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 1517 datë 30.11.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. P.N , Përgj. prokurimesh 2. J.Z , Jurist 3. M.G , Përgj. e burimeve njerëzore	1. A.N , Kryetar 2. M.H , Anëtar 3. E.SH , Anëtar
5. Fondi Limit: 8,000,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “V ” ShPK, me vlere 7,900,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 29.12.2022, me afat 20 mujor	7. Diferenca me fondin limit: 100,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.12.2022	9. Burimi i FI ncimit: Vetëfi ncim	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

a- Fondi limit:

Nevoja për këtë blerje ka lindur nga kërkesa për shpenzime, e hartuar me shkresën nr. 1499 prot., datë 24.11.2022, miratuar nga NA, z. I.D dhe NZ, znj. K.G , për makI t si më poshtë:

1. Kamion vetëshkarkues jo më pak se 3.5 ton dhe jo më shumë se 7.5 ton;
2. ATP 4x4, jo më shumë se 3.5 ton;
3. Kamion jo më pak se 7.5 ton.

Fondi limit është llogaritur në bazë të urdhërit të titullarit, me nr. 1499/1 prot., datë 24.11.2022 “Për caktimin e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Asfalto beton e bitum për spërkatje””, nëpërmjet të cilat është ngarkuar Përgjegjësi/Inxhinieri i sektorit mekanik, z. N.K ;

Caktimi vetëm i një personi për llogaritjen e Fondit Limit është në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pikat 2 dhe 3.

Për llogaritjen e Fondit limit është përdorur metoda e studimit të tregut, ku konstatohet të jenë marrë tre oferta.

Përgjegjësia për caktimin vetëm të një personi për llogaritjen e fondit limit është e titullarit të institucionit, z. I.D .

b- Kriteret e vlerësimit:

- Për hartimin e ST dhe kriterëve për kualifikim, nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e Fondit limit është hartuar procesverbali nr. 1499/3 prot., datë 25.11.2022, nënshkruar nga NjP dhe personi i caktuar për llogaritjen e fondit limit.

- Në pikën 2.1. në DT, për kapacitetin ekonomik dhe financiar kërkohet “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës se parashikuar te kontrates”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.000

- Nga AK, duhet të ishte kërkuar disponimi i licencës profesionale për tregtimin e mjeteve motorike, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, i ndryshuar, ku në Kreun III “Shitblerja e mjeteve”, neni 12 “Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve të reja ose të përdorura”, pika 1.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga P.N , J.Z dhe M.G .

c- Vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1568, datë 13.12.2022, nga AK i është kërkuar sqarim dhe dokumentacion shtesë OE të vetëm që ka paraqitur ofertë ekonomike;
- Për vlerësimin e ofertave, nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1571 prot., datë 14.12.2022.
- Nga Raporti Përmbledhës, u konstatua pjesëmarrja e 1 OE ofertues, OE V ShPK, me ofertë 7,900,000 lekë pa TVSh, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues.
- Formulari i njoftimit të fituesit është bërë me nr. 1589 prot., datë 19.12.2022.
- Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 1614 prot., datë 23.12.2022, i miratuar nga titullari.
- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Korçë dhe OE “V ” ShPK është lidhur me nr. 1632 prot., datë 29.12.2022, me afat 20 ditë nga nënshkrimi i saj.
- Plani për zbatimin e kontratës është hartuar me nr. 1 prot., datë 04.01.2023, ku ngarkohet z. P.M , me detyrë Përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
- Nga z. P.M , i cili është Përgjegjës për menaxhimin e kontratave nuk është hartuar Raporti për mbikëqyrjen e kontratës.

Përgjegjësia për mos hartimin e Raporti për mbikëqyrjen e kontratës është e Përgjegjësit për menaxhimin e kontratave, z. P.M .

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE V nuk ka plotësuar shtojcën 8 në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

Konkluzion:

Duke pasur parasysh se OE V është OE i kualifikuar i cili ka paraqitur ofertën me vlerën më të ulët, si dhe në konsideratë të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë, grupi i auditimit konstaton se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

- Procedurat e prokurimit “Blerje të vogla”:

Autoriteti Kontraktor Bashkia Korçë, gjatë vitit 2022 ka realizuar 97 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Procedurat janë zhvilluar nga Komisioni i Prokurimeve të Bashkisë Korçë, Sektori i Blerjeve të Vogla, bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021”.

Fondi total i prokuruar është 21,621,685 lekë pa TVSh.

Fondi total i realizuar është 17,529,015 lekë pa TVSh.

Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratave të realizuar në procedurat e blerjeve te vogla, është 4,092,670 lekë.

Autoriteti Kontraktor “Klubi Shumësportësh”, gjatë vitit 2022 ka realizuar 7 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Fondi total i prokuruar është 1,924,998 lekë pa TVSh.

Fondi total i realizuar është 1,681,379 lekë pa TVSh.

Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratave të realizuara në procedurat e blerjeve të vogla, është 243,619 lekë.

Autoriteti Kontraktor “Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë”, gjatë vitit 2022 ka realizuar 34 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Fondi total i prokuruar është 13,721,892 lekë pa TVSh.

Fondi total i realizuar është 10,774,461 lekë pa TVSh.

Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratave të realizuara në procedurat e blerjeve të vogla, është 2,947,431 lekë.

Autoriteti Kontraktor “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë”, gjatë vitit 2022 ka realizuar 23 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Fondi total i prokuruar është 16,314,600 lekë pa TVSh.

Fondi total i realizuar është 10,609,510 lekë pa TVSh.

Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratave të realizuara në procedurat e blerjeve të vogla, është 5,705,090 lekë.

Autoriteti Kontraktor “Qendra e Artit dhe e Kulturës Korçë”, gjatë vitit 2022 ka realizuar 45 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Fondi total i prokuruar është 14,465,303 lekë pa TVSh.

Fondi total i realizuar 12,861,292 lekë pa TVSh.

Diferenca e fondit limit me vlerën e kontratave të realizuara në procedurat e blerjeve të vogla, është 1,604,011 lekë.

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje prozhektorë dhe neone për palestrat e shkollave”:

Kërkesa për prokurimin e mallrave është bërë nga znj. A.D , në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Juridik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Korçë.

Situata: - Referuar fletëdaljes nr. 104 datë 11.03.2022, mallrat e prokuruar nga Bashkia Korçë, i janë bërë dalje Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, pra mallrat e prokuruar nga Bashkia Korçë, janë për nevojat e palestrave të shkollave të qytetit të Korçës, të cilat administrohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit, e cila është njësi shpenzuese dhe për vitin 2022 kishte planifikuar edhe vetë blerjen e këtyre mallrave në regjistrin e prokurimeve, me objekt “*Materiale elektrike*”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSh.

- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimore, për këto mallra nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë Bashkisë Korçë, pasi i ka parashikuar në regjistrin e prokurimeve të vitit 2022 me objekt: “*Materiale elektrike*” ku përshihen edhe mallrat e planifikuara e të prokuruar nga Bashkia Korçë. Mallrat e prokuruar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi mallrave	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
Prozhektore LED anësore 300 W	cope	10	25000	250,000
Prozhektorë LED anësore 150 W	cope	16	18000	288,000
Neone dysh 120 cm me mbrojtëse	cope	8	6000	48,000
Shuma ne leke pa TVSH				586,000

Hartimi i specifikimeve teknike:

Titullari i AK nëpërmjet Urdhërit nr. 102 datë 15.02.2022, ka caktuar z. P.GJ , punonjës pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për hartimin e specifikimeve teknike për këtë objekt prokurimi. Specifikimet teknike janë pasqyruar në proces verbalin nr. 1094/1 prot., datë 16.02.2022.

Nga auditimi rezultoi se:

Në strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit ka specialist me profil elektrikist, të cilët kanë objekt të veprimtarisë së tyre mirëmbajtjen e sistemeve elektrike dhe të ndriçimit pranë palestrave të shkollave në juridiksionin e kësaj ndërmarrje.

Megjithëse Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, ka specialist të

fushës së prokurimit dhe për më tepër që AK Bashkia Korçë prokuron mallra për këtë ndërmarrje, specifikimet teknike janë hartuar nga një punonjës i një ndërmarrje tjetër, asaj të Shërbimeve Publike.

Përlllogaritja e Fondit Limit:

Anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla, të përbërë nga A.K , R.E dhe O.P , për përlllogaritjen e Fondit Limit kanë marrë oferta ekonomike nga OE Ligus, OE H dhe OE M.H , të cilat janë pasqyruar në procesverbalin nr. 1066/1 prot., datë 16.02.2022 dhe vlera e fondit limit është përlllogaritur në shumën 586,000 lekë pa TVSh, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	F. Hyrje	Fatura	Data	Vlera	U. Shpenzimi	Dt. Pagesës
1	34	93/2022	04.11.2022	423,672	416	23.12.2022
2	35	95/2022	07.11.2022	791,040	417	23.12.2022
3	36	96/2022	14.11.2022	913,800	420	29.12.2022
4	11	99/2022	24.11.2022	99,060	421	29.12.2022
5	37	109/2022	05.12.2022	522,180	422	29.12.2022
6	39	118/2022	19.12.2022	379,920	423	29.12.2022
7	40	125/2022	27.12.2022	769,800	51	23.02.2023
Totali				3,899,472		

Nga auditimi, rezultoi se:

- Urdhër prokurimi nr. 108 datë 16.02.2022 për blerje prozhektorë dhe neone për palestra, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vulë të thesarit;

- Ftesa për ofertë nr. 1144/1 prot., datë 17.02.2023.

Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël sipas proces verbalit nr. 1066/1 prot., datë 16.02.2022 kanë marrë ofertë nga OE Ligus, H dhe M.H , ndërkohë që OE M.H me Nipt L...A në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB, rezulton se subjekti është me statusin “Pezulluar”;

- Komisioni i prokurimeve të blerje të vogla nuk posedon ofertën e këtyre OE, mbi bazën e të cilave ka përlllogaritur fondin limit;

Referuar procedurës së prokurimit me vlerë të vogël “*Blerje materiale elektrike*”, të realizuar nga AK “*Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve*”, artikulli “*Prozhektor LED anësor 150 W*”, është përlllogaritur me çmimin për njësi me 1,867 lekë pa TVSh, ndërkohë që komisioni i blerjeve të vogla në Bashkinë Korçë e ka përlllogaritur këtë zë me çmimin për njësi me 18,000 lekë pa TVSh ose 9.6 herë më shumë se çmimi i përlllogaritur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve.

Vlerësimi i ofertave:

Referuar Proces verbalit nr. 1144/3 prot. datë 18.02.2022 të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël, të përbërë nga A.K , R.E dhe O.P n, në cilësinë e komisionit të vlerësimit të ofertave, në sistemin SPE kanë paraqitur ofertë 31 OE, nga ku 6 prej tyre janë skualifikuar, pasi kanë paraqitur ofertë ekonomike më të ulët se 50% të fondit limit.

Ndërsa 2 OE, respektivisht S.RR me oferte 535,000 lekë pa TVSh dhe OE J me oferte 580,000 lekë pa TVSh, për mosrealizim të kontratave të mëparshme.

OE A, me ofertë 745,000 lekë pa TVSh është skualifikuar pasi paraqiti ofertë ekonomike më të lartë se vlera e fondit limit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar 22 OE dhe ka shpallur fitues OE E me çmimin me të ulët të ofertës, në shumën 358,720 lekë pa TVSh.

Pas njoftimit të shpalljes fituesit OE E , në date 21.02.2022 ka njoftuar nëpërmjet SEP që tërhiqet nga realizimi i kësaj procedure duke mos dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

Komisioni i blerjeve të vogla, nëpërmjet procesverbalit nr. 1144/4 prot., datë 21.02.2022, ka shpallur fitues OE “I”, I i renditur i dyti, sipas kriterit të çmimit më të ulët.

Pas tërheqjes të OE “I ” komisioni i prokurimeve me procesverbalin 1144/5 prot., datë 22.02.2022 ka shpallur fitues OE N.H i renditur i treti me ofertë ekonomike në shumën 428,000 lekë pa TVSh.

Pas tërheqjes së OE “N.H ” për mosplotësim të specifikimeve, komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla ka shpallur fitues OE “E.SH ”, me ofertë në shumën 438,000 lekë pa TVSh. Pas tërheqjes së OE “E.SH ”, komisioni i prokurimeve pas hedhjes së shortit midis dy OE “E ” dhe “H.XH ” që kishin ofertuar në shumën 498,000 lekë pa TVSh, komisioni i vlerësimit të ofertave me proces verbalin nr.1144/7 prot., datë 25.02.2022 ka shpallur fitues OE E .

Pas refuzimit të OE E , komisioni i vlerësimit të ofertave nëpërmjet procesverbalit nr. 1144/8 prot., datë 01.03.2022 ka shpallur fitues OE H.XH të renditur në vendin e gjashtë.

Pas tërheqjes së OE H.XH komisioni i prokurimeve ka shpallur fitues OE E.H të cilën e ka pasqyruar në procesverbalin nr. 1144/9 datë 02.03.2022.

OE i shpallur fitues “E.H ” nuk u paraqit dhe nuk njoftoi arsyet e mosrealizimit, me procesverbalin nr. 1144/10 prot., datë 07.03.2022, komisioni i prokurimit ka shpallur fitues OE “E.H ” i renditur i 8, në shumën 514,000 lekë pa TVSh.

Pas dorëzimit të dokumentacionit me nr. 1774 prot., datë 08.03.2022 nga OE “E.H ” komisioni i prokurimeve e ka shpallur fitues dhe ka mbajtur Procesverbalin nr. 1774/1 prot., datë 08.03.2022

Marrja në dorëzim:

Me urdhërin nr. 220, datë 11.03.2022 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të përbërë nga A.Q , P.GJ dhe I.J .

Sipas Procesverbalit për marrjen në dorëzim të mallit të mbajtur nga anëtarët e komisionit më datë 11.03.2022, malli është dorëzuar pranë magazinës së bashkisë më datë 11.03.2022 nga OE E.H me faturën nr. 40/2022, datë 11.03.2022 dhe është bërë hyrje me faturën nr. 10 datë 11.03.2022.

Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk i kanë identifikuar mallrat me numrat serialë (E), gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre mallrave.

Marrja në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim pa verifikuar dhe kontrolluar më parë përputhshmërinë e parametrave teknikë të kërkuar me përputhshmërinë e parametrave teknikë të ofruar dhe të dorëzuar fizikisht nga OE i shpallur fitues, përbën veprim në mospërputhje me kriteret e miratuara nga AK në ftesën për ofertë dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 47.

Konkluzion:

- Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje prozhektorë dhe neone për palestrat e shkollave*” e prokuruar nga AK Bashkia Korçë për llogari të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, ku kjo e fundit ka planifikuar dhe realizuar prokurimin me objekt “*Blerje materiale elektrike*”, ku përfshihen edhe mallrat objekt prokurimi të tenderuara nga Bashkia Korçë, rezultoi të realizuar dy herë, pra dy procedura prokurimi me objekt të njëjtë me Fond limit total në shumën 1,386,000 lekë pa TVSh, duke e copëzuar në dy procedura prokurimi me blerje të vogël respektivisht në vlerën 586,000 lekë dhe 800,000 lekë pa TVSh, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Rregullat e prokurimit publik*”, neni 56, pika 2 dhe 11;

- Kërkesa për këto mallra nuk ka ardhur nga AK përfitues por është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, jashtë objektit të veprimtarisë së saj;

- Specifikimet teknike nuk janë hartuar nga një komision ku në përbërje të kishte specialist të fushës;

- Përllogaritja e fondit nuk është bërë mbi bazën e ofertave të pretenduara nga komisioni i blerjeve të vogla, pasi ato nuk janë pjesë e dosjes, gjithashtu njëri prej OE është me statusin i pezulluar në periudhën kur pretendohet se janë marrë ofertat;

- Konstatohen diferenca të mëdha të çmimeve për artikuj të njëjtë të tenderuar nga AK Bashkia Korçë dhe AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve;

- Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë identifikuar mallrat e dorëzuara nga kontraktuesi sipas karakteristikave dhe nr. serial (E), i cili tregon përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK, duke vepruar në mospërputhje me rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkojë nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo procesverbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shkërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK;

Për sa lart, vlera e kontratës 616,800 lekë me TVSh do të konsiderohet një shpenzim pa efikasitet për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Me veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi A.D në cilësinë e hartuesit të kërkesës për mallrat e prokuruar, A.K , R.E dhe O.P në cilësinë anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla, M.S në cilësinë e Drejtorit të Prokurimit në Bashkinë Korçë, A.Q , P.GJ dhe I.J në cilësinë e anëtarëve të komisionit për marrjen në dorëzim.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, neni 56, pika 2 dhe 11, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Rekomandimi i APP-së nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 47.

Ndikimi/Efekti: Rritje të shpenzimeve pa efektivitet të Bashkisë.

Shkaku: Moszbatimi i LPP dhe akteve nën ligjore mbi prokurimet.

Rëndësia: E lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 Prot., datë 28.02.2024 të Bashkisë Korçë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Për sa më sipër ritheksojmë se Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7, ka përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë se nuk administrohen ofertat e marra por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Gjithashtu, për sa i përket administrimit të ofertave për përllogaritjen e fondit në blerjet e vogla, sqarojmë se as në udhëzimin e sipërcituar dhe as në legjislacionin e prokurimeve nuk bëhet dallim ndërmjet ndërmjet operatorëve lokalë dhe atyre jashtë qytetit të Korçës.

Për sa më sipër, komisioni ka hartuar dhe mbajtur procesverbalin e përllogaritjes të fondit limit, ku ka vendosur treguesit e çmimeve të marra, veprime të cilat janë në përputhje me udhëzimin e sipërcituar. Pra komisioni në këtë rast nuk ka kryer asnjë veprim që të vijë në kundërshtim me udhëzimin e sipërcituar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Objekti i observacionit nuk përputhet me gjetjen, prandaj ky observacion nuk do të merret në konsideratë.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Materiale Elektrike”:

Autoriteti Kontraktor “Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve” nëpërmjet Urdhër Prokurimit nr. 9, datë 04.02.2022 ka filluar procedurën e prokurimit për blerjen e materialeve elektrike.

Kërkesa për shpenzime për nevojat e institucioneve arsimore është hartuar nga drejtoria ekonomike më datë 01.02.2022.

Në këtë kërkesë përfshihen 31 artikuj elektrikë, ndër to janë kërkuar edhe prozhektorë 150W 20 copë, Llamba neon 70 copë, prozhektor LED 45-55W 10 copë.

Këto artikuj, janë të njëjtë me artikujt e procedurës së kryer nga Bashkia Korçë me objekt “Blerje prozhektorë dhe neone për palestrat e shkollave”.

Përlllogaritja e fondit limit:

Referuar urdhërit nr. 9/1 prot., datë 01.02.2022, titullari i institucionit z. Y.M ka ngarkuar znj. R.P për përlllogaritjen e fondit limit.

Fondi limit i përlllogaritur nga personi i ngarkuar në urdhërin nr. 9/1 prot., datë 01.02.2022 është përcaktuar në shumën 960, 000 lekë me TVSh.

Në dosjen e kësaj procedure gjenden ofertat e OE S , A , A , të cilat kanë shërbyer për përlllogaritjen e Fondit Limit mbi bazën e mesatarizimit të vlerave të tyre.

Situata: Titullari i Autoritetit Kontraktor “Ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdheve”, ka vepruar në mospërputhje me nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikës 2, 7 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, detyrë që kuadri ligjor në fuqi për prokurimet publike parashikon të kryet nga komisioni i blerjeve të vogla, i përbërë nga 3 anëtarë. Gjithashtu në dosjen e administruar, nuk gjendet tabela e përlllogaritjes së fondit limit mbi bazën e ofertave të marra nga OE.

Në mungesë të tabelës përmbledhëse të përlllogaritjes së fondit limit nga AK, grupi i KLSH hartoi tabelën përmbledhëse për përlllogaritjen e fondit limit të paraqitur më poshtë:

Nr.	Emertimi	sasia	OE Sorte	vlera 1	OE Albon	Vlera 2	ADD Print	vlera 3	mesataria e cimit	Perlllogaritja e fondit limit
1	Automat, 16, 20 Amp	30	900	27,000	800	24,000	1,000	30,000	900	27,000
2	Celbsa elektrik te thjeshte	20	70	1,400	80	1,600	100	2,000	83	1,667
3	celsa	100	70	7,000	80	8,000	100	10,000	83	8,333
4	Kapak	200	20	4,000	20	4,000	30	6,000	23	4,667
5	Llamba Led 18 W 6000 KW	500	120	60,000	130	65,000	150	75,000	133	66,667
6	Izolant M3	50	30	1,500	30	1,500	40	2,000	33	1,667
7	Prozhektor 45-55 W	10	1,800	18,000	1,800	18,000	2,000	20,000	1,867	18,667
8	Rezistence bolieri me8 vrime dhe 1 vrime	10	700	7,000	700	7,000	900	9,000	767	7,667
9	Suporte	250	60	15,000	60	15,000	100	25,000	73	18,333
10	Tel 2.5 mm	300	60	18,000	60	18,000	70	21,000	63	19,000
11	termostat bolieri	20	500	10,000	500	10,000	600	12,000	533	10,667
12	Neon Led 120 W 6000 KW	100	1,700	170,000	1,700	170,000	1,800	180,000	1,733	173,333
13	Neon Led 9W te vegjel 60 cm 6000 KW	100	1,200	120,000	1,200	120,000	1,200	120,000	1,200	120,000
14	Spote LED 20-26 W 6000 KW	100	500	50,000	550	55,000	700	70,000	583	58,333
15	Priza	100	100	10,000	110	11,000	150	15,000	120	12,000
16	Tapa	100	5	500	5	500	10	1,000	7	667
17	Automat 40 AMP 4P	4	1,900	7,600	2,000	8,000	2,500	10,000	2,133	8,533
18	Komplet Kacavidash elektrik 1000w profesio	1	1,500	1,500	1,500	1,500	2,000	2,000	1,667	1,667
19	Indikator	1	300	300	300	300	400	400	333	333
20	Ndricues 120 cm 36 W Led	70	1,500	105,000	1,500	105,000	2,000	140,000	1,667	116,667
21	Kapse kablli	500	10	5,000	10	5,000	10	5,000	10	5,000
22	Pince elektrike 1000 w profesionale	1	500	500	500	500	1,000	1,000	667	667
23	koft elektrike	1	900	900	900	900	1,000	1,000	933	933
24	Acaline shtrirje teli 5 m	1	700	700	700	700	700	700	700	700
25	Acaline shtrirje teli 10 m	1	900	900	900	900	900	900	900	900
26	Acaline shtrirje teli 20 m	1	1,000	1,000	1,100	1,100	1,000	1,000	1,033	1,033
27	Punto me slite 6 m	20	400	8,000	400	8,000	550	11,000	450	9,000
28	Prozhektor 150 W 6400 K Led	20	1,800	36,000	1,800	36,000	2,000	40,000	1,867	37,333
29	Motor aspiratori	3	2,400	7,200	2,500	7,500	4,000	12,000	2,967	8,900
30	Kabell elektrik 3x4	600	60	36,000	60	36,000	70	42,000	63	38,000
31	Kanalina 16x6	500	40	20,000	40	20,000	50	25,000	43	21,667
Totali ne leke pa TVSH				750,000		760,000		890,000		800,000

Nga auditimi rezultoi se:

AK nuk ka hartuar procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Në ftesën për ofertë, AK ka përcaktuar se data e zhvillimit është data 04.02.2022, ora 10.00, ndërkohë që në SEP, afati i fundit për pranimin e ofertave është përcaktuar data 04.02.2022 ora 11:00.

Komisioni i prokurimeve të blerjeve të vogla i përbërë nga S.Z,I.L dhe V.T nuk kanë mbajtur proces verbal të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga OE pjesëmarrës por janë mjaftuar me

printimin e vlerësimit të gjeneruar nga SEP.

Vlerësimi i ofertave:

Pas refuzimit të 2 OE të renditur respektivisht i pari dhe i dyti për nga vlera e ofertës sipas kriterit të vlerësimit të çmimit më të ulët, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël kanë shpallur fitues OE “E. L.” me ofertën 489,000 lekë pa TVSh.

Titullari i institucionit me formularin e njoftimit të fituesit datë 07.02.2022 ka njoftuar OE E.L si Ofertë ekonomike e shpallur fitues.

Marrja në dorëzim:

Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga A.Q , S.Z,I.L dhe A.L kanë marrë në dorëzim mallrat e prokuruar nga kontraktuesi me Faturën nr. 10 datë 21.02.2022 të cilat janë bërë hyrje në magazinë me FH nr. 16 - 17 datë 21.02.2022

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. Y.M , në cilësinë e titullarit të institucionit.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, neni 76, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pikat 2 dhe 7.

Ndikimi/Efekti: Në cilësinë dhe eficienten e mallrave të prokuruar.

Shkaku: Mos zbatim të kudit Ligjor të Prokurimeve Publike

Rëndësia: E mesme.

3. Procedura e blerjeve të vogla me objekt: “Mjete kancelarike (Projekti Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me baze komunitare)”:

Hartimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë përcaktuara nga znj. M.SH mbi bazën e urdhërit nr. 1189, datë 07.11.2022.

Përlllogaritja e fondit limit:

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga A.K , R.E dhe O.P , mbi bazën e mesatarizimit të ofertave të marra nga OE ka përlllogaritur si fond limit për këtë procedurë shumën 100,000 lekë pa TVSh.

Urdhëri i prokurimit nr. 1201 datë 08.11.2022 “Për prokurimet me vlerë të vogël me objekt: “Mjete kancelarike (Projekti Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për fëmijën dhe familjen me bazë komunitare)”“

Vlerësimi i ofertave:

Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në rolin e komisionit të vlerësimit sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave nr. 9650/3 prot. datë 11.11.2022, në këtë procedurë kanë marrë pjesë 14 OE, nga ku 7 OE janë skualifikuar pasi disa prej tyre kanë paraqitur ofertë ekonomike më të lartë se FL.

Nga 7 OE të kualifikuar, komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, në rolin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi bazën e kriterit të vlerësimit të çmimit më të ulët, ka shpallur fitues OE “O ”.

Marrja në dorëzim:

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga M.SH , L.DH dhe G.H , sipas proces verbalit të datës 17.11.2022 ka marrë në dorëzim pa vërejtje mallrat e prokuruar sipas faturës nr. 46/2022 datë 17.11.2022, të cilat janë bërë hyrje me F.H nr. 99 datë 17.11.2022.

4. Procedura e prokurimit “Veshje, uniforma policie”:

Kërkesa për blerjen e veshjeve, uniforma policie është bërë nga Drejtori i Policisë Bashkiake. Urdhër prokurimi nr. 1145 datë 27.10.2022 me objekt “Veshje, uniforma policie”.

Specifikimet teknike:

Sipas procesverbalit nr. 9052/1 prot., datë 24.10.2022, Specifikimet teknike janë hartuar nga z. E. K. i ngarkuar për hartimin e specifikimeve teknike në urdhërin nr. 1115 datë 20.10.2022.

Përlllogaritja e fondit limit:

Sipas procesverbalit nr. 9026 prot., datë 28.10.2022, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i përberë nga A.K., R.E dhe O.P mbi bazën ofertave të marra ka përlllogaritur mbi bazën e mesatarizimit të tyre Fondin Limit në shumën 443,200 lekë pa TVSh.

Vlerësimi i ofertave:

Sipas procesverbalit nr. 9284/3 prot., datë 01.11.2022, në këtë procedurë kanë paraqitur ofertë ekonomike 15 OE, nga këta 11 OE janë skualifikuar pasi oferta e tyre ishte më e lartë se vlera e fondit limit.

Në përfundim janë kualifikuar 4 OE, komisioni i vlerësimit mbi bazën e kriterit të çmimit më të ulët ka shpallur fitues Subjektin “E.S ” me ofertën 329,000 lekë pa TVSh.

Pas mospranimit nga subjekti “E.S ”, komisioni ka shpallur fitues OE “Amel-E. Z.” me ofertë 358,000 lekë pa TVSh, të pasqyruar në procesverbalin nr. 9284/4 prot., datë 02.11.2022

Marrja e dorëzimit:

Komisioni i marrjes në dorëzimit, i përbërë nga E.K., M. Q.dhe G.H sipas faturës 33/2022 datë 18.11.2022, ka marrë në dorëzimit mallin pa vërejtje, siç pasqyrohet në proces verbalin nr. 1247, datë 18.11.2022.

5. Procedura e prokurimit “Pajisje zyre”

Titullari i AK ka nxjerrë urdhërin e prokurimit nr. 1029 datë 03.10.2022, për blerje të vogla me objekt: “Pajisje zyre”

Përlllogaritja e fondit limit:

Pas anulimit të procedurës AK ka ndryshuar zërat e sasisë dhe për këtë ka bërë rillogariten e fondit limit, duke përcaktuar Fondin Limit në shumën 299,996 lekë pa TVSh.

Vlerësimi i ofertave:

Sipas procesverbalit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël nr. 8391/3 prot., datë 06.10.2022., në këtë procedurë kanë marrë pjesë 19 OE, nga ku 7 OE janë skualifikuar pasi kanë paraqitur ofertë më të lartë se vlera e fondit limit.

Sipas vlerësimit të komisionit në SEP, 12 OE kanë rezultuar të suksesshëm dhe mbi bazën e kriterit të vlerësimit të çmimit më të ulët është shpallur fitues OE “D ” në shumën 256,8140 lekë pa TVSh.

Sipas vlerësimit të bërë në SEP, OE të suksesshëm të renditur deri tek i nënti janë tërhequr nga procedura, komisioni i blerjeve të vogla ka shpallur fitues OE A , i renditur i dhjeti me ofertë në shumën 291,119 lekë pa TVSh.

Anulimi i procedurës:

Pas mospranimit edhe të OE A , AK ka njoftuar nëpërmjet formularit të anulimit të procedurës nr. 8391/14 prot., datë 27.10.2022 anulimin e kësaj procedure.

Urdhër prokurimi nr. 1258 datë 22.11.2022 me objekt: “Pajisje zyre”.

Përlllogaritja e fondit limit:

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga A.K., R.E , O.P kanë përlllogaritur mbi bazën e mesatarizimit të ofertave vlerën e fondit limit në shumën 298,550 lekë pa TVSh.

Zhvillimi i procedurës:

Sipas procesverbalit të komisionit të prokurimeve të vogla nr. 10099/3 prot., datë 24.11.2022, në SEP kanë paraqitur ofertë 11 OE., nga të cilët 7 OE janë skualifikuar për arsye të paraqitjes së ofertës më të madhe se vlera e fondit limit.

Komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ka kualifikuar 4 OE të suksesshëm duke shpallur fitues OE “O.H ” në shumën 246,800 lekë pa TVSh.

Pas tërheqjes së OE të renditur i dyti, komisioni i prokurimeve të vogla ka shpallur fitues OE S.A në shumën 289,000 lekë pa TVSh.

Marrja në dorëzim:

Sipas procesverbalit të datës 07.12.2022, komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga N.M , J.Q dhe G.H kanë marrë në dorëzim pajisjet e zyrës sipas faturës nr. 374/2022, datë 07.12.2022 dhe janë bërë hyrje me FH nr.117 date 07.12.2022.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Kompjuter printer fotokopje”

Hartimi i fondit limit:

Titullari i AK, ka ngarkuar znj. R.P nëpërmjet urdhërit nr. 16/1 prot., datë 14.02.2022 për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Kompjuter Printer Fotokopje”. Sipas procesverbalit të datës 14.02.2022, personi i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit ka përcaktuar si fond limit shumën 475,000 lekë pa TVSh.

Në dosjen e kësaj procedure prokurimi gjenden ofertat e OE A , BOA S dhe OE A , mbi bazën e të cilave personi i autorizuar ka përlllogaritur vlerën e fondit limit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se: Titullari i Autoritetit Kontraktor “Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve”, ka vepruar në mospërputhje me nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikës 2, 7 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, detyrë që kuadri ligjor në fuqi për prokurimet publike për përlllogaritjen e fondit limit parashikon të kryhet nga komisioni i blerjeve të vogla, i përbërë nga 3 anëtarë.

Ofertat e paraqitura të OE të sipërcituar janë fotokopje (jo origjI le) dhe nuk kanë datën se kur janë emetuar.

Personi i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit nuk ka pasqyruar përlllogaritjen e fondit mbi bazën e ofertave të marra.

Titullari i AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes nuk ka ngritur grup pune për hartimin e specifikimeve teknike, duke vepruar në mospërputhje me nenin 76 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 2, 7 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Ofertat ekonomike janë marrë në mungesë të specifikimeve teknike, pasi në ftesën për ofertë nuk përcaktohet lloji i printerit LaserJet apo InkJet, si dhe shpejtësia e faqeve të printuara për minutë, rezolucioni i skanerit, i printimit, monitorit, etj.

Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike ku në përbërjen e tij të ishte edhe një specialist IT.

Zhvillimi i procedurës:

Për nevoja të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes për blerjen e kompjuterëve dhe printerave, pas përlllogaritjes së fondit limit, Titullari i AK, ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr. 16 datë 16.02.2022.

Në ftesën për ofertë AK, ka përcaktuar që procedura e prokurimit do të zhvillohet në SEP të APP më datë 17.02.2022 ora 11:00.

AK ka kërkuar që të blejë 10 copë Kompjuterat (monitor +tastier+mouse) dhe 10 copë Printera All in One Multifunksional.

Në ftesën për ofertë (formulari 3) është kërkuar që pajisjet të kenë garanci 1 vit, të jenë të reja dhe të shoqërohen me certifikatë origjI le.

Afati i lëvrimit të mallit është përcaktuar 48 orë duke filluar nga dita e njoftimit të fituesit.

Në ftesën për ofertë janë dhënë disa specifikime teknike si: Kompjuteri te jete I5, i gjeneratës 4, me Hard Disk 500 Gb dhe RAM 8 GB; Monitori të jetë 23 inch dhe Printeri te jetë *Oll in One multifunksion*, siç paraqiten në tabelën më poshtë:

1. Kompjuter - I5 Gjenerata 4-të, HDD 500 Gb, RAM 8 GB (sasia 10 copë)
2. Monitor 23 inc- 10 copë
3. Printer All in One multifunction 10 copë

Vlerësimi i ofertave:

Nga auditimi në SEP, u konstatua se: në këtë procedurë kanë paraqitur Ofertë ekonomike 28 OE, nga këta 5 OE janë skualifikuar pasi kishin paraqitur ofertë ekonomike më të lartë se vlera e fondit limit.

Sipas anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla të përbërë nga S.Z,I.L dhe V.T mbi bazën e kriterit të çmimit më të ulët është shpallur fitues OE “A ” me ofertën në shumën 366,890 lekë. Referuar SEP, njoftimi i fituesit për procedurën “*Blerje Kompjuter Printer*” është bërë në datë 17.02.2022 ora 15:10.

Referuar formularit të Ofertës (shtojca 1) të OE “A ”, ky OE sipas zërave ka ofertuar për mallrat objekt auditimi, siç paraqitet në tabelën më poshtë:

Pershkrimi i mallit	Sasia	Cmimi per njesi	Vlera
Kompjuter-I5, gjenerat 4, HDD 500 GB, RAM 8GB	10	15,000	150,000
Monitor 23 inc	10	2,500	25,000
tastier	10	1,000	10,000
mouse	10	1,000	10,000
Printer all in One Multifunksion	10	17,189	171,890
Cmimi neto pa TVSH			366,890

Marrja në dorëzim:

Titullari i AK në urdhërin nr. 23, datë 23.02.2022, ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përbërë nga A.Q , S.Z,I.L dhe A.L .

Grupi i sipërcituar me procesverbalin e datës 23.02.2022, ka marrë në dorëzim mallin nga kontraktuesi A me faturën nr. 20 datë 23.02.2022 dhe i ka bërë hyrje në magazinë me FH nr. 27 datë 23.02.2022.

Nga auditimi rezulton se:

Kontraktuesi A ka dorëzuar materialet kompjuterike pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë më datë 23.02.2022, ndërkohë që duhej t'i dorëzonte brenda datës 21.02.2022, ora 15:30 ku përfshihet dhe afati i ankimimit.

Kontraktuesi i ka dorëzuar mallrat objekt të prokurimit me 2 ditë vonesë sipas kushteve të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Zbatimi i kontratës:

Për verifikimin e mallrave të dorëzuar nga kontraktuesi, me ato të kërkuara nga AK sipas kërkesave të paraqitura në ftesën për ofertë, grupi i auditimit të KLSH, në datë 07.12.2022 kreu një verifikim pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve.

Nga verifikimi rastësor për llojin dhe markën e kompjuterit dhe monitorit të dorëzuar nga OE Andis K dhe të pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim, rezulton se:

Kompjuterat janë të markës: Fujitsu-Esprimo P910 E85+, Model MI5Ë;

Monitorët të markës: Samsung Model S22E450BË.

Nga auditimi u konstatua se:

Nga konsultimi në faqen zyrtare të Web-it për këto Brand-e rezulton se:

- Modeli i kompjuterit dhe monitorit të dorëzuar nga kontraktuesi janë prodhime të vitit 2015.
- Monitori Samsung model S22E450BW është 22 inch dhe jo 23 inch siç parashikohet në ftesën e AK.

- Kompjuteri Fujitsu “Esprimo P910 E85+” është i gjeneratës së 3-të dhe jo të 4-të, siç kërkohet nga AK në ftesën për ofertë.

- Kompjuteri, monitori, tastiera dhe mouse nuk janë i të njëjtit brand.

Për sa më lart, komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar pajisjet me numrat serialë, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre pajisjeve. Marrja në dorëzim e mallrave nga komisioni i marrjes në dorëzim pa verifikuar dhe kontrolluar më parë përputhshmërinë e parametrave teknikë të kërkuar me përputhshmërinë e

parametrave teknike të ofruar dhe të dorëzuar fizikisht nga OE i shpallur fitues, përbën veprim në mospërputhje me kriteret e miratuara nga AK në ftesën për ofertë dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 47.

Për sa më lart, vlera e kontratës në shumën 440,268 lekë me TVSh do të konsiderohet përdorim pa efektivitet i fondeve të të buxhetit të njësisë vendore.

Me veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi z. Y.M në cilësinë e titullarit të AK dhe A.Q , S.Z,I.L , A.L në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, neni 76, pika 2 dhe 7, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 47.

Ndikimi/Efekti: Në rritjen e shpenzimeve jo eficiente në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mosrespektim të kuadrit ligjor në fuqi në fushën e prokurimeve publike.

Rëndësia: E lartë.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Bojëra printimi fotokopje”:

Hartimi i fondit limit:

Titullari i AK, ka ngarkuar znj. R.P nëpërmjet urdhërit nr. 12/1 prot., datë 10.02.2022 për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Bojëra printimi fotokopje”.

Sipas procesverbalit të datës 10.02.2022, personi i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit ka përcaktuar si fond limit shumën 416,666 lekë pa TVSh.

Në dosjen e kësaj procedure prokurimi gjenden ofertat e OE A , BOA S dhe OE A , mbi bazën e të cilave personi i autorizuar ka përlllogaritur vlerën e fondit limit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se: OE “A ” me NIPT K....D nuk ka objekt të veprimtarisë tregtimin e bojërave dhe tonerave për printera dhe fotokopje. Nga verifikimi në QKB, rezulton se ky OE ka për objekt të veprimtarisë së vet ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit.

Titullari i Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve ka vepruar në mospërputhje me nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikës 2, 7 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, detyrë që kuadri ligjor në fuqi për prokurimet publike për përlllogaritjen e fondit limit parashikon të kryet nga komisioni i blerjeve të vogla i përbërë nga 3 anëtarë.

Ofertat e paraqitura të OE të sipërcituar janë fotokopje (jo origjiale) dhe nuk kanë datën se kur janë emetuar.

Personi i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit nuk ka pasqyruar përlllogaritjen e fondit mbi bazën e ofertave të marra.

Titullari i AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes nuk ka ngritur grup pune për hartimin e specifikimeve teknike, duke vepruar në mospërputhje me nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 2 dhe 7 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Ofertat ekonomike janë marrë në mungesë të specifikimeve teknike, pasi në ftesën për ofertë nuk përcaktohet lloji i printerit LaserJet apo InkJet, si dhe shpejtësia e faqeve të printuara për minutë, rezolucioni i skanerit, i printimit, monitorit, etj.

Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, ku në përbërjen e tij duhet të ishte një specialist IT.

Zhvillimi i procedurës:

Për nevoja të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes për blerjen e

kompjuterëve dhe printerave, pas përlogaritjes së fondit limit, Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr. 12 datë 11.02.2022.

Në ftesën për ofertë, AK ka përcaktuar që procedura e prokurimit do të zhvillohet në SEP të APP më datë 15.02.2022 ora 09:00.

AK, ka kërkuar që të blejë 29 lloje bojëra printeri duke përfshirë dhe ato te fotokopjeve.

Në Ftesën për ofertë (formulari 3) është kërkuar që:

1. Tonerat e shënuara kompatibël duhet të vijnë të tilla, ndërsa tonerat e vendosura origjinale duhet të vijnë origjinale sipas fabrikave prodhuese dhe *part number* përkatëse të vendosura në ftesën për ofertë;
2. Operatori duhet të ketë ISO 9001:2015 ose ekuivalente dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente;
3. Afati i lëvrimit të mallit është përcaktuar 48 orë duke filluar nga dita e njoftimit të fituesit.

Vlerësimi i ofertave:

Nga auditimi në SEP, u konstatua se:

Në këtë procedurë kanë paraqitur Ofertë ekonomike 18 OE, nga këta 4 OE janë skualifikuar pasi kishin paraqitur ofertë ekonomike më të lartë se vlera e fondit limit.

Sipas anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla të përbërë nga S.Z,I.L dhe V.T mbi bazën e kriterit të çmimit më të ulët, është shpallur fitues OE “B ” me ofertën në shumën 275,800 lekë.

Marrja në dorëzim:

Titullari i AK në urdhërin nr. 14 datë 23.02.2022, ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim përbërë nga A.Q , S.Z,I.L dhe A.L .

Grupi i sipërcituar me procesverbalin e datës 23.02.2022 ka marrë në dorëzim mallin nga kontraktuesi “B ” me faturën nr. 8 datë 17.02.2022 dhe i ka bërë hyrje në magazinë me FH nr. 25 datë 23.02.2022.

Nga auditimi rezulton se:

Kontraktuesi i ka dorëzuar me 4 ditë vonesë mallrat sipas afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, duke përfshirë dhe afatin e ankimimit.

Nga verifikimi në faqen Web <http://aqscert.org>, rezulton se OE “B ” nuk është i pajisur me certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO/IEC 27001:2013.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar mallrat me numrat *part number*, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre mallrave. Marrja në dorëzim e mallrave nga komisioni i marrjes në dorëzim pa verifikuar dhe kontrolluar më parë përputhshmërinë e parametrave teknikë të kërkuar me përputhshmërinë e parametrave teknikë të ofruar dhe të dorëzuar fizikisht nga OE i shpallur fitues, përbën veprim në mospërputhje me kriteret e miratuara nga AK në ftesën për ofertë dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 47.

Për sa më lart, vlera e kontratës në shumën 330,960 lekë me TVSh do të konsiderohet përdorim pa efektivitet i buxhetit të Ndërmarrjes.

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi z. Y.M në cilësinë e titullarit të AK dhe A.Q , S.Z,I.L , A.L në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Rregullat e prokurimit publik*”, neni 76, pika 2 dhe 7, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 47.

Ndikimi/Efekti: Rritje të shpenzimeve pa efikasitet për buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor në fushën e prokurimeve publike.

Rëndësia: E lartë.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të kësaj nënpike të Programit të auditimit, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë, nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022.

Nga grupi i auditimit, në bazë të nivelit të materialitetit, riskut cilësor dhe kohës në dispozicion, u gjykuan për t'u audituar kontratat për punë publike, pasqyruar në Aneksin Z1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, me vlerë totale 189,067,227 lekë pa TVSh mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimin, zbatimin e afateve të kontratave si dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8282/3 Prot., datë 14.11.2022	15. Vlera e kontratës: 41,257,208.8 lekë me TVSh BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK	16. Likuiduar deri dt. 12.12.2023 41,257,208 lekë me TVSh ose 100% e vlerës së situacionit përfundimtar.
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSh 41,257,208.4 lekë -Vlera pa TVSh 34,381,007 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 1 muaj e 10 ditë Fillimi punimeve: 14.11.2022 Përfundimi punimeve:23.12.2023	19. Zgjatja e kontratës: Ska
20. Mbikëqyrësi i punimeve “M ” ShPK	Licenca Nr: MK. 1811/8	Kontrata nr. 8235/3 prot. datë 14.11.2022
21. Kolaudatori i punimeve “M ” ShPK	Licenca Nr: MK. 1503/6	Kontrata nr. 10891/2 prot. datë 20.12.2022
22. Akt Kolaudimi: datë 24.12.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim: Datë 24.12.2022	

Për objektin e mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “N ” ShPK, & “N ” ShPK, me nr. 8282/3 prot. datë 14.11.2022.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe OE “M ” ShPK, me nr. 8235/3 prot., datë 14.11.2022.

- Korrespondencat mes BASHKISË KORÇË dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “M ” ShPK

Kontratat:

Punimet janë realizuar sipas kontratës për punë publike, me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 me objekt “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Korçë, të përfaqësuar nga Titullari z. S.F dhe BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, me licencë profesionale të subjektit “N ” ShPK NZ. 2798/16 të përfaqësuar nga znj. SH.N dhe z. S.SH . Vlera e kontratës është 41,257,208.8 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga data e lidhjes së saj si dhe periudha e garancisë së punimeve është 24 muaj kjo e përcaktuar në nenin 15 pika 5.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 8235/3 prot., datë 14.11.2022 me OE “M ” ShPK, me përfaqësues T.S dhe licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1811/8, me vlerë të kontratës 1,280,574 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbim Kolaudimi me nr. 10891/2 prot., datë 20.12.2022 me OE “M ” ShPK me përfaqësues G.J.D dhe licencë

mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1503/6 dhe me vlerë të kontratës 192,086.4 lekë me TVSh.

Hartimi i projektit:

Projekti është hartuar nga OE “N ” ShPK Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohen: Mur mbajtës në fshatin Kamenicë; ndërtim kanali në Bare; mur mbajtës në vendtakimin e përroit të Dvoranit me lumin Dunavec dhe vendosjen e dy portave M like me mekanizëm si dhe ndërtimin e murit anësor me gjatësi 24 m; mur mbajtës në vendtakimin e përroit të Voskopit me lumin Dunavec, ndërtim kanali në Drenovë; mur mbajtës në argjinaturë të varrezave në fshatin Pulahë; mur mbajtës në rrugën “Lavdar i Vjetër-Lavdar i Ri” me gjatësi 70 m; argjI tura e përroit të Mborjes nga ish Fabrika e Qelqit deri në dalje të fshatit (variant me ngritje argjI ture me gjatësi 344 ml). FI ncimi i këtij objekti është realizuar nga fondet e pa kushtëzuara të buxhetit të shtetit për fatkeqësi natyrore të menaxhuara, i cili nuk trashëgohet në vitin pasardhës.

Zbatimi i punimeve:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimit të kontraktorit nr. 56 prot., datë 14.11.2022 dhe mbikëqyrësit të punimeve nr. 214/1 prot., datë 14.11.2022 dhe procesverbaleve përkatëse kanë filluar po këtë datë 14.11.2022.

Me shkresën datë 20.12.2022 sipërmarrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e korigjimit të projektit sipas kërkesës së investitorit e cila sjell ndryshimin e volumeve për disa zëra të kontratës, kjo e shoqëruar me relacionin teknik, tabelën përmbledhëse të ndryshimit të volumeve ku përdoret edhe fondi rezervë si dhe preventivi dhe projekti i rishikuar me ndryshimet e propozuara nga sipërmarrësi. Rritja e kostos nga ndryshimi i volumeve është mbuluar nga fondi rezervë pa e kaluar vlerën fillestare të kontratës. Ndryshimet e volumeve si dhe përdorimi i fondit rezervë janë miratuar me procesverbalet datë 22.12.2022.

Referuar shkresës së sipërmarrësit të punimeve nr. 56/5prot., datë 23.12.2022 mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. extra. prot., datë 23.12.2022 drejtuar BASHKISË KORÇË njofton përfundimin e punimeve. Sipas shkresave të mësipërme punimet kanë përfunduar më datë 23.12.2022 1 muaj e 10 ditë nga fillimi i tyre, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë i cili ishte 3 muaj.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit, nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 383,349 lekë pa TVSh. Verifikimi i punimeve në terren u krye në murin mbajtës Kamenicë dhe në ndërtim kanali, Drenovë, ku rezultoi si më poshtë:

Situata: Në objektin “Ndërrhyrja për shmangien e përmblytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë” sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 41,257,208.8 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSh)
1	Ndërtim muri mbajtës Kamenicë	Ndërtim mur mbajtës b/a C 25/30	190,105.6
		F.V hekur për mur mbajtës	163,888
		Mbushje me zhavorr pas mureve	29,355.6
Shuma			383,349

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “M ” ShPK, z. T.S sipas kontratës së shërbimit nr. 8235/3 prot., datë 14.11.2022 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit” në Bashkinë Korçë”.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1., Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagraf 3.2 dhe 3.3.; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 8235/3 prot., datë 14.11.2022, neni 6, pika 2 “Shërbimet që kërkohen”.

Ndikimi/Efekt: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 383,349 lekë pa TVSh.

Shkaku: Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit për volume punimesh të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajeve të projektit.

Rëndësia: E lartë.

2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Korçë”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8405/2 Prot. datë 13.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 75,565,671 lekë OE “XH ” ShPK	16. Likuiduar deri dt. 15.12.2023 75,565,665.80 lekë me TVSh
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSh 75,565,667 lekë -Vlera pa TVSh 62,971,389 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 1 muaj e 10 ditë Fillimi punimeve: 25.10.2022 Përfundimi punimeve: 02.07.2023	19. Zgjatja e kontratës: Amendim kontrate datë 17.03.2023 zgjatje afati 80 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “E ” ShPK & “A ” ShPK	Licenca Nr: MK. 3459/2 MK.1846/7	Kontrata Nr.8488/2Prot. datë 12.10.2022
21. Kolaudatori i punimeve BOE “D ” ShPK & “B ” ShPK	Licenca Nr: MK. 4190 MK. 3492/1	Kontrata Nr.5210/2Prot. datë 11.07.2023
22. Akt Kolaudimi: datë 31.07.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: Datë 31.07.2023	

Për objektin e mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “XH ” ShPK, me nr. 8405/2 prot. datë 14.11.2022.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “E ” ShPK dhe “A ” ShPK, me nr. 8488/2 prot., datë 12.10.2022.

- Korrespondencat mes BASHKISË KORÇË dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “M ” ShPK.

Kontratat:

Punimet janë realizuar sipas kontratës për punë publike, me nr. 8405/2 prot., datë 13.10.2022, me objekt “Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Korçë”, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Korçë, të përfaqësuar nga Titullari z. S.F dhe OE “XH ” ShPK, përfaqësuar nga administratori z. A.XH me licencë profesionale të subjektit NZ. 1251/10. Vlera e kontratës është 75,565,671 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e lidhjes së saj si dhe periudha e garancisë së punimeve është 24 muaj kjo e përcaktuar në nenin 15 pika 5. Afati i përfundimit të kontratës është zgjatur me 80 ditë me Amendim Kontrate datë 17.03.2023 për arsye të kushteve atmosferike të pafavorshme për kryerjen e punimeve, kjo referuar kërkesës së sipërmarrësit të punimeve nr. 122 prot., datë 26.12.2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Mbikëqyrje nr. 8488/2 prot., datë 12.10.2022 me BOE “E ” ShPK, me përfaqësues A.G dhe “A ” ShPK, me përfaqësues A.N dhe licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh përkatësisht MK. 3459/2 dhe MK. 1846/7, me vlerë të kontratës 871,519 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbim Kolaudimi me nr. 5210/2 prot., datë 11.07.2023, me BOE “D ” ShPK & “B ” ShPK, me përfaqësues Henrid Lleshaj dhe licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh përkatësisht MK. 4190 dhe MK. 3492/1, me vlerë të kontratës 104,582 lekë me TVSh.

Hartimi i projektit:

Projekti arkitektonik është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të bashkisë. Projekti i furnizimit me ujë sanitar dhe largimi i tij dhe projekti nga mbrojtja kundra zjarrit është hartuar nga “H” ShPK Projekti elektrik është hartuar nga “M ”. Projekti konstruktiv është hartuar nga “G ” ShPK

Në këtë projekt është parashikuar rikonstruksion i plotë i ambienteve të brendshme (suva, sistem elektrik, sistem hidraulik, dyert, dritaret, pajisjet Hidrosanitare, etj), instalim i sistemit nga mbrojtja kundra zjarrit, sistem komunikimi (internet), sistem ngrohje. Rikonstruksion i ambienteve të jashtme, veshje fasade me polisterol kompakt dhe suvatim grafiato, sistemim i ambienteve të jashtme dhe vendosje e shtresave të reja për hidroizolim e tarracës. Gjithashtu është parashikuar ndërtimi i palestrës me konstruksion M lik dhe i veshur dhe i mbuluar me panele sanduiç.

Zbatimi i punimeve:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimit përkatës dhe procesverbaleve të mbajtura janë në datë 25.10.2022. Me shkresat përkatëse sipërmarrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e korrigjimit të projektit sipas kërkesës së investitorit e cila sjell ndryshimin e volumeve për disa zëra të kontratës, kjo e shoqëruar me relacionin teknik, tabelën përmbledhëse të ndryshimit të volumeve. Në këto ndryshime është hequr sistemi i kaldajës me pajisjet përkatëse dhe janë shtuar volumet e zërave të punimeve në rikonstruksionin e godinës dhe ndërtimin e palestrës sipas atyre faktike.

Volumet e punimeve që zbriten dhe shtohen janë miratuar me procesverbalet përkatëse më datë 15.05.2023 dhe të miratuara nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Sipas shkresave të mësipërme, punimet kanë përfunduar më datë 07.07.2023, 6 muaj e 80 ditë nga fillimi i tyre, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë dhe amendimin e saj.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 217,464 lekë pa TVSh. Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

Situata: Në objektin “Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Korçë” sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “XH ” me nr. 8405/2 prot., datë 13.10.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 75,565,671 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me Amendim Kontrate datë 17.03.2023, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera dhe të dëmtuara. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSh)
1	Punime ndërtimore palestra e shkollës	Prishje shtresë betoni fusha ekzistuese	112,500
		Zbarkim dheu me makineri 20 cm	21,300

2	Punime ndërtimore rikonstruksion i shkollës	Prishje shtresë tarracë dhe hidroizolimi	83,664
Shuma			217,464

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit BOE "E" ShPK & "A" ShPK, ing. E.D sipas kontratës së shërbimit nr. 8488/2 prot. datë 12.10.2022 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme "Themistokli Gërmenji", Korçë".

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Pika 8.1., Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.; Kontrata e shërbimit e lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE "E" ShPK & "A" ShPK, me nr. 8488/2 prot., datë 12.10.2022 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme "Themistokli Gërmenji", Korçë", neni 6, pika 2 "Shërbimet që kërkohen".

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën **217,464** lekë pa TVSh.

Shkaku: Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt.

Rëndësia: E lartë.

Për sa është paraqitur në Projekt Raportin e Auditimit, nga mbikëqyrësi i punimeve, me e-mail datë 04.03.2024, janë bërë komente dhe shpjegime për Akt Konstatimin nr. 21, datë 22.12.2023, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit për objektin "Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme "Themistokli Gërmenji", Korçë".

Pretendimi i subjektit:

1. Për sa i përket zërit "Prishje e betonit fusha ekzistuese" dhe "Zbarkom dheu fusha ekzistuese", theksojmë se sipërfaqja e fushës ekzistuese ishte vetëm 65% e sipërfaqes ku u vendos palestra. Po kështu prishja e shtresave të betonit dhe zbarkomi i dheut janë bërë mbas betonimit të trarëve të themelit.

2. Në zërin "Prishje shtrese tarrace dhe hidroizolimi" ju kujtojmë se tarraca ekzistuese kishte dy shtresa hidroizolimi, një hidroizolim menjëherë pas soletës së betonit, dhe një hidroizolim të mëvonshëm pas termoizolimit. Në bashkëpunimin me projektuesin dhe kontraktorin, u gjykua që njëra prej shtresave të hidroizolimit të soletës të mos hiqet në mënyrë që të shërbejë si anti kondesant, pasi në projekt nuk është parashikuar diçka e tillë. Vetëm në dukje se lënia e kësaj shtrese kishte një kosto suplementare për kontraktorin që e kreu me shpenzimet e veta.

3. Për sa i përket zërit "Transport material ndërtimi dheu me auto deri 10 km" ku thuhet se ky zë nuk ekziston librezë e masave, bashkangjitur po ju vemë në dispozicion një kopje të librezës së masave për këtë zë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Ju sqaroni se prishja e strukturave të betonit dhe zbarkimi i fushës është kryer pas betonimit të trarëve të themelit, sqarojmë se; niveli i fushës së re është më lartë se strukturat betonit që duhen prishur dhe zbarkimi i dheu. Gjithashtu nga materiali fotografik u konstatua se ka filluar mbushja për nivelimin e platformës e kështu këta zëra nuk janë kryer. Për sa më sipër observacioni juaj për këtë pikë nuk merr në konsideratë.

2. Nga ana juaj nuk janë dokumentuar të gjitha shtresat ekzistuese të tarracës dhe nuk është mbajtur një peocesverbal i punimeve të maskuara për lënien e shtresës së hidroizolimit. Gjithashtu në zërin "Prishje shtrese tarrace dhe hidroizolimi" përfshihen të gjitha shresat ekzistuese të tarracës qofshin ato edhe të mbivendosura. Për sa më sipër observacioni juaj për këtë pikë nuk merr në konsideratë.

3. Për zërin "Transport material ndërtimi dheu me auto deri 10 km" ju keni bashkëlidhur librezën e masave e cila tregon se nga kanë rezultuar këto volume të transportuara dhe observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë.

Për sa më sipër, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

3. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: "Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i eficientës të energjisë)".

14. Lidhja e kontratës Nr. 1797/2 Prot. datë 27.03.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 75,565,671 lekë OE "XH" ShPK	16. Likuiduar deri dt.
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSh 63,428,254.8 lekë -Vlera pa TVSh 52,856,879 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 7 muaj Fillimi punimeve: 28.03.2023 Përfundimi punimeve: 27.10.2023	19. Zgjatja e kontratës: Amendim kontrate datë 18.09.2023 zgjate afati me 31 ditë.
20. Mbikëqyrësi i punimeve "G" ShPK	Licenca Nr: MK. 2812/5	Kontrata Nr.716/2Prot. datë 27.03.2023
21. Kolaudatori i punimeve "R" ShPK	Licenca Nr: MK. 1506/11	Kontrata Nr.8652/2Prot. datë 06.11.2023
22. Akt Kolaudimi nuk ka	23. Akt i marrjes në dorëzim nuk ka	

Për objektin e mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe BOE "I" ShPK & "E" ShPK dhe "I" ShPK me nr. 1797/2 prot. datë 27.03.2023.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe OE "G" ShPK, me nr. 716/2 prot. datë 27.03.2023.

- Korrespondencat mes BASHKISË KORÇË dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE "G" ShPK

Kontratat:

Punimet janë realizuar sipas kontratës për punë publike, me nr. 1797/2 prot., datë 27.03.2023 me objekt "*Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efikasitetit të energjisë)*", të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Korçë, të përfaqësuar nga Titullari z. S.F dhe BOE "I" ShPK & "E" ShPK & "I" ShPK, të përfaqësuar nga z. G.Z , z. Ç.S dhe z. S.Z , me licencë profesionale NZ. 7368/2 të firmës "I". Vlera e kontratës është 63,428,254.2 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e lidhjes së saj si dhe periudha e garancisë së punimeve është 24 muaj kjo e përcaktuar në nenin 15 pika 5. Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me Amendim Kontrate datë 18.09.2023 ku është e zgjatur me 31 ditë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 716/2 prot., datë 27.03.2023 me OE "G" ShPK, me përfaqësues z. G.B dhe licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/5, me vlerë të kontratës 1,135,501.2 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbim Kolaudimi me nr. 8652/2 prot., datë 06.11.2023 me OE "R" ShPK me përfaqësues R.N , licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1506/11 dhe me vlerë të kontratës 103,227.6 lekë me TVSh.

Hartimi i projektit:

Projekti është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të bashkisë. Në këtë projekt janë parashikuar rikonstruksioni i ndriçimit në rrugën "Viktor Eftimiu"; në rrugën "1 Maji"; në rrugën "10 Korriku"; në bulevardin "Republika"; në rrugën "Rexhep Telhaj"; në rrugën "Sotir Polena"; në lulishten "Vangjush Mio"; rrugët e Njësive Administrative dhe rruga "Muzakajt". Në të gjitha rrugët është parashikuar të çmontohen shtyllat e vjetra dhe të vendosen shtylla M like të zinkuara dhe të lyera me bojë me pjekje. Për lidhjen e shtyllave me rrjetin elektrik ekzistues do të kryhet prishja e trotuareve, bordurave si dhe pjesë të rrugëve të shtruara me asfalt ku është e nevojshme për shtrimin e kablllove. Gjithashtu do të kryhet rehabilitimi i pjesëve të prishura duke i kthyer në gjendjen fillestare. Projekti është bashkëfinancim nga SECO (Qeveria Zvicerane) në masën 76.80% dhe Bashkia Korçë, me të ardhurat e saj në masën 23.20%.

Zbatimi i punimeve:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 57 prot., datë 28.03.2023 referuar njoftimit të sipërmarrësit dhe procesverbaleve përkatëse kanë filluar po këtë datë 28.03.2023. Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 18.08.2023 midis kontraktorit dhe mbikëqyrësit punimet janë ndërprerë me arsyen se gjatë vizitës në terren, në shtyllat ekzistuese është konstatuar prezenca e linjave të internetit si dhe ka linja elektrike dhe sistem ujësjellësi në pjesët ku do të kryhen punimet. Kështu që për mosdëmtimin e linjave në infrastrukturën nëntokësore kërkohet ndërhyrja e institucioneve përkatëse. Punimet janë pezulluar deri në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hasura gjatë zbatimit. Pas liritimit të sheshit të ndërtimit me shkresën nr. 44 prot., datë 18.09.2023 kërkohet rifillimi i punimeve, ku për këtë është mbajtur procesverbali i rifillimit të punimeve më datë 18.09.2023. Referuar procesverbaleve dhe njoftimeve përkatëse rezultoi se punimet kanë përfunduar më datë 27.10.2023, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë dhe amendimin e saj ku në total ishte 7 muaj.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë, nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 566,377 lekë pa TVSh. Verifikimi i punimeve në terren u krye në rrugët: “Viktor Eftimiu”, “Koco Tupa”, “Sotir Polena”, “Muzakajt” si dhe në Njësinë Administrative Bulgarec, rruga e fshatit Bulgarec ku rezultoi si më poshtë:

Situata: Në objektin “*Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efikasitetit të energjisë)*” sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “I” ShPK & “E” ShPK & “I” ShPK, me nr. 1797/2 prot. datë 27.03.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 63,428,254.2 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me Amendim Kontrate datë 18.09.2023, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera dhe të dëmtuara. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSh)
1	Rikonstruksimi i ndriçimit të rrugës “Muzakajt”	Shtresë rëre	204,545
		Shtresë stabilizanti t=10cm, granil, gurë. Shtresë binderi 4 cm me makineri	236,840
		Shtresë asfaltobetoni 3 cm me makineri,	
2	Rikonstruksimi i ndriçimit të rrugës “Viktor Eftimiu”	Shtresë stabilizanti t=10cm, granil, gurë. Shtresë binderi 4 cm me makineri	124,992
		Shtresë asfaltobetoni 3 cm me makineri,	
Shuma			566,377

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “G” ShPK, z. G.B sipas kontratës së shërbimit nr. 716/2 prot., datë 27.03.2023 me objekt: “*Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efikasitetit të energjisë)*”.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1., Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3.; Kontrata e shërbimit e lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe “G” ShPK, me nr. 716/2 prot., datë 27.03.2023 me objekt: “*Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efikasitetit të energjisë)*”, konkretisht neni 6, “*Përgjegjësitë e furnizuesit*”, neni 7 “*Detyrimet e përgjithshme të furnizuesit*”, neni 8 “*Detyrimet e veçanta të furnizuesit*”.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 566,377 lekë pa TVSh.

Shkaku: Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt ose të dëmtuara.

Rëndësia: E lartë.

4. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)”.			
14. Lidhja e kontratës Nr. 2520/3 Prot. datë 05.04.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 46,629,580.66 lekë OE “A ” ShPK		16. Likuiduar deri dt.
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSh 46,629,542.34 lekë -Vlera pa TVSh 38,857,952 lekë	18. Afati i kontratës në dite: Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 2.5 muaj Fillimi punimeve: 05.04.2023 Përfundimi punimeve:22.06.2023		19. Zgjatja e kontratës: Ska
20. Mbikëqyrësi i punimeve “M ” ShPK	Licenca Nr: MK. 1503/6	Kontrata Nr.2689/2Prot. datë 05.04.2023	
21. Kolaudatori i punimeve “D ” ShPK	Licenca Nr: MK. 4190	Kontrata Nr.4718/2Prot. datë 20.06.2023	
22. Akt Kolaudimi 03.07.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim 03.07.2023		

Për objektin e mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe OE “A ” ShPK, me nr. 2520/3 prot. datë 05.04.2023.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis BASHKISË KORÇË dhe OE “M ” ShPK, me nr. 2689/2 prot., datë 05.04.2023.

- Korrespondencat mes BASHKISË KORÇË dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “M ” ShPK

Kontratat:

Punimet janë realizuar sipas kontratës për punë publike, me nr. 2520/3 prot., datë 05.04.2023 me objekt “Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)” sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 10779 prot. datë 16.12.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Korçë, të përfaqësuar nga Titullari z. S.F dhe OE “A ” ShPK, të përfaqësuar nga administratori z. A.B , me licencë profesionale për zbatimin e punimeve civile NZ. 2306/17. Vlera e kontratës është 46,629,580.66 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga data e lidhjes së saj si dhe periudha e garancisë së punimeve është 24 muaj kjo e përcaktuar në nenin 15 pika 5.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 2689/2 prot., datë 05.04.2023 me OE “M ” ShPK, me përfaqësues administratorin GJ.D dhe licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1503/6, me vlerë të kontratës 588,433 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbim Kolaudimi me nr. 4718/2 prot. datë 20.06.2023 me OE “D ” ShPK, me përfaqësues nga administratori H.LI, licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 4190 dhe me vlerë të kontratës 70,611 lekë me TVSh.

Hartimi i projektit:

Projekti është hartuar nga Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të bashkisë. Në këtë projekt janë parashikuar rikonstruksioni i: rrugës “Haxhi Dvorani”, rrugica “Qamil Panariti”, rruga “Ajet Xhindoli”, rruga Çiflig, rruga Dishnicë, lagjia në hyrje të rrugës Korçë – Voskop, rruga tek njësia administrative Voskop, rruga Mborje, rruga tek plehrat Ravonik, rruga “Riza Mance”, “Koco Mio” dhe “Bantia” si dhe korsitë e biçikletave.

FI ncimi i këtij projekti do të jetë nga të ardhurat e BASHKISË KORÇË në tre vite buxhetore sipas përcaktimit të bërë në Urdhërin e Kryetarit nr. 285, datë 15.03.2023.

Zbatimi i punimeve:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimit të mbikëqyrësit të punimeve nr. 414 prot., datë 05.04.2023, referuar njoftimit të sipërmarrësit dhe procesverbaleve përkatëse kanë filluar po këtë datë 05.04.2023.

Me procesverbalet e mbajtura më datë 12.06.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe mbikëqyrësit të punimeve janë miratuar volumet e punimeve që shtohen dhe zbriten sipas matjeve faktike në terren si dhe përdorimi i fondit rezervë prej 5% të vlerës së kontratës.

Me shkresën e sipërmarrësit të punimeve, me nr. extra prot., datë 22.06.2023, referuar procesverbalit përkatës njofton se punimet kanë përfunduar më datë 22.06.2023, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë i cili ishte 3 muaj.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë, nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 249,807 Lekë pa TVSh. Verifikimi i punimeve në terren u krye në rrugët: “Haxhi Dvorani”, “Qamil Panariti”, “Ajet Xhindoli”, “Lagjia në hyrje të rrugës Korçë-Voskop” si dhe Rruga tek Njësia Administrative Voskop ku rezultoi si më poshtë:

Situata: Në objektin “Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “A ” ShPK, me nr. 2520/3 prot., datë 05.04.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 46,629,580.66 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera dhe të dëmtuara. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSh)
1	Rruga “Haxhi Dorani	F.V bordura betoni 30x15cm	71,856
		F.V pllaka vetshtrenguese 6 cm Shtresë çakulli 15 cm Shtresë stabilizanti 10 cm	75,250
2	Rruga “Qamil Panariti”	F.V pllaka vetshtrenguese 6 cm Shtresë çakulli 15 cm Shtresë stabilizanti 10 cm	14,207
3	Rruga tek Njësia Administrative Voskop	F.V pllaka vetshtrenguese 6 cm Shtresë çakulli 15 cm Shtresë stabilizanti 10 cm	88,494
SHUMA			249,807

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “M ” ShPK, z. GJ.D sipas kontratës së shërbimit nr. 2689/2 prot., datë 05.04.2023 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)”.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1., Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.; Kontrata e shërbimit e lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe “M ” ShPK, me nr. 2689/2 prot., datë 05.04.2023, me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)”, neni 5, “Detyrimet e palëve”.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 249,807 lekë pa TVSh.

Shkaku: Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt ose të dëmtuara.

Rëndësia: E lartë.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Bashkia Korçë ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019.

➤ Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022

Duke iu referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Korçë, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 janë miratuar 105 leje zhvillimi, 40 leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m², 28 leje ndërtimi me sipërfaqe deri në 250 m², 1 leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m², 16 leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m², 51 çertifikata përdorimi, 122 deklarata paraprake për kryerje punimesh dhe 3 leje infrastrukture, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Korçë, lejet për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², janë paraqitur në Aneksin L2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e lejeve së ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m², të paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan 4 procedura ku pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit, hapësirat e gjelbërta dhe hapësirat e parkimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatua se nuk janë respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat përfshijnë intensitetin e ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë e ndërtimit, hapësirat e gjelbëra dhe hapësirat e parkimit, për objektet e mëposhtme:

1. “Banesë kolektive (8 kate + podrum)”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K” ShPK, në adresën: Lagjia 18, rruga “Dhora Leka”, Korçë. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 817/22, datë 10.02.2022. Parcela në të cilën zhvillohet objekti, bën pjesë në njësinë strukturore KO/UB 681, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në PPV-në e njësisë KO/UB 681, intensiteti i lejuar i ndërtimit është 2.3. Për sipërfaqen e parcelës 793 m², në të cilën zhvillohet ndërtimi i ri, me intensitetin

e lejuar 2.3, sipërfaqja totale e ndërtimit e lejuar mbi tokë, është 1,824 m². Në bazë të verifikimit në autocad (dwg) të projektit të ndërtimit të miratuar, u konstatua se, sipërfaqja e ndërtimit nuk përputhej me të dhënat e pasqyruara në tabelën e treguesve të zhvillimit, të pasqyruar në plavendosjen e miratuar. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë nga 1,823.8 m², rezulton të jetë 2,047.5 m², duke shtuar 223.7 m² sipërfaqe ndërtimi mbi sipërfaqen e lejuar. Diferenca në sipërfaqe ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke e tejkaluar atë nga 2.3 i lejuar për njësinë përkatëse, në 2.56, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 38 dhe Planin e Përgjithshëm Vendor, të miratuar me vendimin e KKT-së nr. 5, datë 17.05.2019.

2. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 7879/22, datë 26.09.2022. Parcela në të cilën zhvillohet objekti, bën pjesë në njësinë strukturore KO/UB 573, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Duke u bazuar në PPV të njësisë KO/UB 573, intensiteti i lejuar i ndërtimit është 3.6. Për sipërfaqen e parcelës 3,333.75 m², në të cilën zhvillohet ndërtimi i ri, me intensitetin e lejuar 3.6, sipërfaqja totale e ndërtimit e lejuar mbi tokë, është 12,002 m². Në bazë të verifikimit në autocad (dwg) të projektit të ndërtimit të miratuar, u konstatua se, sipërfaqja e ndërtimit nuk përputhej me të dhënat e pasqyruara në tabelën e treguesve të zhvillimit të pasqyruar në plavendosjen e miratuar. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë nga 11,416.13 m², rezulton të jetë 12,319.8 m², duke shtuar 318.3 m² sipërfaqe ndërtimi mbi sipërfaqen e lejuar. Diferenca në sipërfaqe ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke e tejkaluar atë nga 3.6 i lejuar për njësinë përkatëse, në 3.69, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 38 dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me vendimin e KKT-së nr. 5, datë 17.05.2019.

- Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, neni 54, “Sipërfaqja e gjelbërimit publik në zonë”, koeficienti i lejuar për sipërfaqet e gjelbërimit publik në zonë duhet të jetë 2.5 m²/banor. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, rezulton që për të tre objektet që do të zhvillohen në parcelë, janë 112 apartamente në total, me një numër minimal prej 2 banorësh për apartament, me një numër total banorësh 224 për njësinë strukturore. 224 banorë x 2.5 m²/banor = 560 m². Nga verifikimi rezulton që sipërfaqja e gjelbërimit është 389 m², nga 560 m² e nevojshme për zonën.

- Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, neni 56, “Numri minimal i vendparkimeve”, përcaktohet se duhet të ketë një vendparkim për dy banorë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, rezulton që për të tre objektet që do të zhvillohen, numri minimal i banorëve është 224 dhe nevojiten 112 vende parkimi. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, u konstatua që në tre katet nëntokë të objekteve janë në total 47 vende parkimi, me një diferencë 65 vende parkimi më pak.

3. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 10640/21, datë 16.12.2021. Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore KO/UB 573, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, neni 54, “Sipërfaqja e gjelbërimit publik në zonë”, koeficienti i lejuar për sipërfaqet e gjelbërimit publik në zonë duhet të jetë 2.5 m²/banor. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, rezulton që për të tre objektet që do të zhvillohen në parcelë, janë 63 apartamente në total, me një numër minimal prej 2 banorësh për apartament, me një numër total banorësh 126 për njësinë strukturore. 126 banorë x 2.5 m²/banor= 315 m². Nga verifikimi, rezulton që sipërfaqja e gjelbërimit është 137 m², nga 315 m² e nevojshme për zonën. Bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, neni 56, numri minimal i

vendparkimeve, në të cilin përcaktohet që duhet të jetë një vendparkim për dy banorë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, rezulton që për të tre objektet që do të zhvillohen numri minimal i banorëve është 126 dhe nevojiten 63 vende parkimi. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, u konstatua që në tre katet nëntokë janë në total 23 vende parkimi, me një diferencë 40 vende parkimi më pak.

4. “Banesë 3 kate + Podrum”, miratuar me vendimin nr. 7246/22, datë 05.10.2022, me zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën: Lagjia 1, Rruga e Bilbilave, Korçë. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 1828/22, datë 17.03.2022. Parcela në të cilën zhvillohet objekti, bën pjesë në njësinë strukturore KO/UB125, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Duke u bazuar në PPV të njësisë KO/UB125, intensiteti i lejuar i ndërtimit është 2. Për sipërfaqen e parcelës 189.12 m², në të cilën zhvillohet ndërtimi i ri, me intensitetin e lejuar 2, sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë e lejuar është 378.24 m². Në bazë të verifikimit në autocad (dwg) të projektit të ndërtimit të miratuar, u konstatua se, sipërfaqja e ndërtimit nuk përputhet me të dhënat e pasqyruara në tabelën e treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosjen e miratuar. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë nga 378.24 m², rezulton të jetë 572.2 m², duke shtuar 194 m² sipërfaqe ndërtimi mbi sipërfaqen e lejuar. Diferenca në sipërfaqe ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke e tejkaluar atë nga 2 i lejuar për njësinë përkatëse, në 3, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 38 dhe me nenin 75 të Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar me vendimin e KKT-së nr. 5, datë 17.05.2019.

- Duke u bazuar në PPV të njësisë KO/UB125, koeficienti i shfrytëzimit të territorit i lejuar është 70%. Në bazë të verifikimit në autocad (dwg) të planvendosjes së miratuar, rezulton se sipërfaqja e njollës së objektit është 144,3 m² dhe KSHT-ja është 76%, duke tejkaluar koeficientin e lejuar të njësisë.

- Në bazë të përcaktimit të njësisë KO/UB125 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar, ndërhyrjet në Ansamblin Urban, sipas nenit 75, pika 2, përcaktohet se lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet t’i kalojë 3 katet. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, objekti është në lartësinë e 4 kateve, pasi ajo që përcaktohet si kat nëntokë, është mbi tokë, sepse lartësia e xokolit është më e lartë se 1.2 metra, sipas përcaktimit në nenin 78, pika 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; Znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011;

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 20, “Plani i Përgjithshëm Vendor”, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, nenet 54 dhe 56.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, ndikon në shtimin e sipërfaqeve dhe volumeve të ndërtimit për njësinë përkatëse, rritjen e intensitetit të ndërtimit, rritjen e koeficientit të shfrytëzimit të territorit dhe rritjen e lartësisë së ndërtimit, duke çenuar edhe zhvillimin e ndërtimeve të reja. Gjithashtu reduktimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe reduktimi i numrit të parkimeve, ndikon në mosplotësimin e kondicioneve urbane sipas njësisë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan 3 procedura ku pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në mënyrën e saktë të planvendosjes dhe mosrespektimin e

distancave nga kufiri i pronës, distancave ndërmjet objekteve, si edhe distancave nga trupi i rrugës.

Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatua se nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës, distanca ndërmjet objekteve dhe distanca nga trupi i rrugës, për objektet e mëposhtme:

1. “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjia 18, Rruga “Dhora Leka”, Korçë. Planvendosja e miratuar nuk përkon me konfigurimin e gjurmës së projektit të ndërtimit. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, u evidentua se në planvendosjen e miratuar nuk janë reflektuar daljet konsol (ballkonet), në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 7. Në orientimin verior, objekti kufizohet nga rruga me gjerësi më të vogël se 7 metra. Distanca nga trupi i rrugës është 1.7 metra, duke përfshirë edhe daljet konsol, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 36, pika 3/a. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, distanca minimale ndërmjet objekteve ku njëri është në lartësinë e 8 kateve, ndërsa tjetri në lartësinë e 7 kateve, është 5.71 metër. ndërsa distanca ndërmjet objektit në lartësinë e 6 kateve dhe atij në lartësinë e 7 kateve, është 3.46 metër dhe distanca nga kufiri i pronës është 1 metër për objektin në lartësinë e 8 kateve, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 2 dhe pika 3.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Planvendosja e miratuar nuk përkon me konfigurimin e gjurmës së projektit të ndërtimit. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, u evidentua se në planvendosjen e miratuar nuk janë reflektuar daljet konsol (ballkonet), në kundërshtim VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 7. Në orientimin jugor, objekti me numër 12 kufizohet nga rruga me gjerësi 7 metra. Distanca nga trupi i rrugës është 0.4-0.9 metra, duke përfshirë edhe daljet konsol, në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 36, pika 3/b. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, distanca minimale ndërmjet dy objekteve në lartësinë e 8 kateve është 2 metër dhe ajo maksimalja është 13 metër, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 2. Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, neni 58, pika 14, në treguesit e distancave përcaktohet se distanca minimale nga kufiri i pronës llogaritet sipas formulës $d = hst \times 0.4$, ku d është distanca nga kufiri i pronës dhe hst -ja lartësia e ndërtimit. Për objektin në lartësinë e 26 metrave, distanca minimale nga kufiri i pronës duhet të jetë $26 \times 0.4 = 10.4$ metra. Në bazë të planvendosjes së miratuar, distanca ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është 9 metra, nga 10.4 metra e lejuar.

3. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, distanca minimale ndërmjet dy objekteve në lartësinë e 8 kateve është 3.8 metër, ndërsa ajo maksimale është 15.4 metër, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 2. Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, neni 58, pika 14, në treguesit e distancave përcaktohet se distanca minimale nga kufiri i pronës llogaritet sipas formulës $d = hst \times 0.4$, ku d është distanca nga kufiri i pronës

dhe hst-ja lartësia e ndërtimit. Për objektin në lartësinë e 25.98 metrave, distanca minimale nga kufiri i pronës duhet të jetë $25.98 \times 0.4 = 10.38$ metra. Në bazë të planvendosjes së miratuar, distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është 1 metër dhe 1.5 metër, ndërsa ajo maksimalja 9 metër, nga 10.38 metra e lejuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; Znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011;

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 34, pika 2; pika 3; pika 7 dhe neni 36, pika 3/a; Planit i Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, neni 58, pika 14.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës dhe distancave ndërmjet objekteve, çënon ndërtimet me të cilat kufizohet objekti dhe zhvillimin e ndërtimve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Korçë.

Rëndësia: E mesme.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua 1 procedurë ku pasqyrohet situata në lidhje me miratimin e lejes së zhvillimit pa pasur të miratuar planin dhe kondicionet urbane mbi të cilën do të zhvillohet njësia strukturore përkatës dhe pa pasur të ngarkuar në sistemin e-leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Situata: Nga auditimi i lejeve të zhvillimit, u konstatua se për objektin “V. Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.” ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë, leja e zhvillimit është miratuar pa qenë i miratuar plani për njësinë strukturore përkatëse dhe në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së zhvillimit.

Parcela në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore VS/UB 21_1, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 90/22, datë 24.01.2022. Objekti gjendet brenda zonës “Ansambël historik Voskopojë” dhe çdo punim në të është subjekt i VKM-së nr. 60, datë 29.01.2020. Në shqyrtimin e dokumentacionit teknik të lejes së zhvillimit, nuk është ngarkuar projektideja arkitektonike e zhvillimit të parcelës, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 10, pika 1/d. Në nenin 6, pika d, të VKM-së nr. 60, datë 29.01.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore “ansambël historik urban”, zonës mbrojtëse të tij dhe zonës arkeologjike “b”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, parashikohet një plan për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore “ansambël historik urban”, zonës mbrojtëse të tij dhe zonës arkeologjike “b”, të fshatit Voskopojë. Në verifikimin e bazës ligjore dhe të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Korçë, nuk ka një plan të miratuar mbi të cilin do të zhvillohen njësia strukturore VS/UB 21_1. Në këto kushte, leja e zhvillimit është miratuar pa u bazuar në legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Leja e ndërtimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore e Materiale, në mbledhjen e datës 08.04.2022 dhe Ministria e Kulturës dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore dhe Bashkia Korçë, janë vënë në dijeni me shkresën nr. 261/1, datë 13.04.2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; Znj. ZH.L , me detyrë

Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011;

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 10, pika 1/d dhe VKM nr. 60, datë 29.01.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore “ansambël historik urban”, zonës mbrojtëse të tij dhe zonës arkeologjike “b”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, neni 6, pika d.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me leje zhvillimi ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë aplikimi për lejen e zhvillimit.

Shkaku: Neglizhencë e BASHKISË KORÇË .

Rëndësia: E lartë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 procedura ku pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit.

Situata: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit, u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit. Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi, është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar, për objektet e mëposhtme:

1. “Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë. Në shqyrtimin e dokumentacionin të ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, gërma j. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqiten fotografi në të gjitha orientimet, të cilat janë të fragmentura dhe nuk evidentohen të gjitha ndërhyrjet në godinë.

2. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, gërma j. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqiten fotografi në të gjitha orjentimet, të cilat janë të fragmentura dhe nuk evidentohen të gjitha ndërhyrjet në godinë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011; z. I.L , me detyrë kryeinspektor i IMT-së dhe z. E.K , me detyrë inspektor i IMT-së.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42 dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me certifikatë përdorimi, ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë, duke ndikuar në realizimin e projektit të ndërtimit në terren jo në përputhshmëri me

lejen e ndërtimit të miratuar.

Shkak: Neglizhencë nga ana e DPZHT Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “*Certifikatave të përdorimit*”, u konstatua 1 procedurë ku pasqyrohej situata në lidhje me zbatimin e punimeve në terren në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Situata: Nga auditimi i procedurave për miratimin e “*Certifikatave të përdorimit*”, u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B. ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, nuk përputhet me zbatimin në terren të objektit. Nga verifikimi i fotove të punimeve të ndërtimit të ngarkuara në sistem, u konstatuan ndryshime në realizimin e punimeve të ndërtimit nga projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, pasi është shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin e fundit, duke ndryshuar edhe konfigurimin e fasadës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011; z. I.L , me detyrë kryeinspektor i IMT-së dhe z. E.K , me detyrë inspektor i IMT-së.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 42, pika 3; Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”, neni 10, “*Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar*” dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27/1 dhe 27/2.

Ndikimi/Efekti: Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit, të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik, në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

Shkak: Neglizhencë nga ana e DPZHT Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikateve të përdorimit, u konstatuan 5 procedura ku pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrealizimin në mënyrën e duhur të marrëveshjes për 3% të sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, mungesa e marrëveshjes për kalimin e 3% të sipërfaqes funksionale dhe moskalimi i sipërfaqes funksionale në favor të bashkisë, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

Situata 1.: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatua se në marrëveshjen e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social, në mospërputhje me Ligjin nr. 22/2018, “*Për strehimin social*”, datë 03.05.2018, neni 19, pika 1, për objektet e mëposhtme:

1. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Në marrëveshjen e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social. Sipërfaqja e banimit mbi tokë të objektit që do të zhvillohet, është 10,884.8 m², prej të cilës 3% e sipërfaqes duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, konkretisht sipërfaqja

326.5 m² ose e shprehur në vlerë monetare 326.5 x 45,800 lekë/m² (çmimi i shitjes për metër katror) = 14,953,700 lekë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Në marrëveshjen e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social. Sipërfaqja e banimit mbi tokë të objektit që do të zhvillohet, është 5,758.9 m², prej të cilës 3% e sipërfaqes duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, konkretisht sipërfaqja 172.7 m² ose e shprehur në vlerë monetare 172.7 x 45,800 lekë/m² (çmimi i shitjes për metër katror) = 8,379,199.5 lekë.

Situata 2.: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatua se në lejen e ndërtimit nuk është realizuar marrëveshja ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe subjektit zhvillues për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, në mospërputhje me Ligjin nr. 22/2018, “*Për strehimin social*”, datë 03.05.2018, neni 19, pika 1, për objektin “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjia 18, rruga “Dhura Leka”, Korçë. Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Korçë, për lejen e ndërtimit të miratuar me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2,000 metra katrorë, nuk është realizuar marrëveshja ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe subjektit zhvillues, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale. Sipërfaqja e banimit mbi tokë të objektit që do të zhvillohet është 2,047.5 metra katrorë, prej të cilës 3% e sipërfaqes së saj duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, konkretisht sipërfaqja 61.4 m² ose e shprehur në vlerë monetare 61.4 x 45,800 lekë/m² (çmimi i shitjes për metër katror) = 2,812,120 lekë.

Situata 3.: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit, u konstatua se marrëveshja për 3% e sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik është realizuar me objektin e akt-marrëveshjes: “*Akumulimin në formë bonusi duke u njohur si “borxh” i subjektit ndaj bashkisë*” Në kontrata nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me objektin në të cilin do të jepet kjo sipërfaqe ndërtimore dhe përshkruhet “*...që do të përcaktohet në të ardhmen në marrëveshjen ndërmjet palëve dhe mund t’ja kalojë bashkisë në një objekt tjetër brenda afatit 5-vjeçar nga marrëveshja e nënshkruar në miratimin e certifikatës së përdorimit.*”. Kjo pikë e akt-marrëveshjes mbështetet edhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak, me nr. 114, datë 30.09.2021, pika 7, ku përcaktohet që: “*... mund ta akumulojë në formë bonusi duke u njohur si “borxh” ndaj bashkisë...*”. Pika 10 e këtij vendimi është në kundërshtim me kushtin e kontratës të përcaktuar në nenin 5, pika 2, ku përcaktohet se “*kalimi fizik i pasurive të përfituara sipas këtij vendimi, bëhet jo më vonë se në momentin e lëshimit të certifikatës së përdorimit...*” dhe në mospërputhje me Ligjin nr. 22/2018, “*Për strehimin social*”, datë 3.5.2018, neni 19, pika 1. Sa më sipër është evidentuar për objektet e mëposhtme:

1. “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë. Çertifikata e përdorimit është miratuar pa realizuar kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të bashkisë, por duke u akumuluar në formë “borxhi” për një afat 5 vjeçar, pas miratimit të certifikatave të përdorimit, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L. ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë. Çertifikata e përdorimit është miratuar pa realizuar kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të bashkisë, por duke u akumuluar në formë “borxhi” për një

afat 5 vjeçar, pas miratimit të çertifikatave të përdorimit, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011; znj. A.Q , me pozicion drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, nga viti 2016;

Kriteri: Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, datë 03.05.2018, neni 19, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mosrealizimi i marrëveshjes ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues ndikon në moskalimin e sipërfaqes funksionale pa shpërblim në favor të fondit publik të banesave sociale.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 2 procedura ku pasqyrohej situata në lidhje me mosllogaritjen e rregullt të taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Situata 1.: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, sipas përcaktimeve në nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Sipas Vendimit nr. 137, datë 25.11.2021, të Këshillit Bashkiak Korçë “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë”, pika 1.4/2, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është 4% mbi çmimin e shitjes për m². Sa më sipër, është konstatuar për objektet e mëposhtëm:

1. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga Rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të BASHKISË KORÇË është 26,099,148 lekë, ndërsa llogaritja e saktë rezulton 26,241,128.32 lekë. Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt, pasi nga verifikimi i sipërfaqeve të projektit të ndërtimit dhe mënyrës së përllogaritjes së taksës duke marrë për bazë çmimin e shitjes për metër katror dhe me koeficientët përkatës sipas ambienteve (hapësirë parkimi, hapësirë shërbimi ose hapësirë banimi), rezulton me një diferencë prej 141,980 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Korçë.

2. “Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. Fatura e përllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të BASHKISË KORÇË është 13,430,026 lekë, ndërsa llogaritja e saktë rezulton 13,567,975.2 lekë. Mënyra e përllogaritjes nuk është e rregullt, pasi nga verifikimi i sipërfaqeve të projektit të ndërtimit dhe mënyrës së përllogaritjes së taksës duke marrë për bazë çmimin e shitjes për metër katror dhe me koeficientët përkatës sipas ambienteve (hapësirë parkimi, hapësirë shërbimi ose hapësirë banimi), rezulton me një diferencë prej 137,949 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Situata 2.: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se tipologjia e ndërtimit në bazë të projektit të ndërtimit mund të ndryshojë destinacion, nga objekt në funksion të turizmit në objekt në funksion të banimit. Me ndryshimin e destinacionit, duhet të përllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektin “V. Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.”ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë.

Në realacionin teknik, përshkruhet që kompleksi turistik është i ndarë në 2 zona. Në zonën e parë ofrohen shërbime në lidhje me turizmin dhe hotelinë, ndërsa në zonën e dytë, në parcelën që propozohet për tu zhvilluar leja e ndërtimit, pozicionohen vila në lartësinë e 3 kateve, me një kat nëntokë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit të miratuar, konstatohet që tipologjia e ndërtimit dhe funksioni i dy zonave është i ndryshëm. Në zonën e parë evidentohet që objektet e propozuara janë në funksion të turizmit, ndërsa në zonën e dytë, e cila është e shkëputur nga zona e parë, zhvillohen objekte në funksion të banimit, të cilët mund të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në lejen e ndërtimit të miratuar, nga objekt turistik në objekte për shitje. Nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, duhet të përlogarit taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës, sipas përcaktimeve në nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Sipas Vendimit nr. 137, datë 25.11.2021, të Këshillit Bashkiak Korçë “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë”, pika 1.4/2, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është 4% mbi çmimin e shitjes për m².

Diferenca e taksës së ndërtimit në infrastrukturë, nëse objekti i sipërpërmendur ndryshon destinacionin nga “Objekte për qëllim turizmi” në “Objekte për qëllim banimi”, është 1,525,253 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë; znj. ZH.L , me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Korçë, nga viti 2011; z. E.GJ , me detyrë përgjegjës sektori në DPKZHT, nga viti 2011; z. O.P , me detyrë specialist i financës.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 46, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” dhe Vendimi nr. 137, datë 25.11.2021, i Këshillit Bashkiak Korçë, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë”, pika 1.4/2;

Ndikimi/Efekt: Diferenca e konstatuar nga përlogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Korçë. Në rastin e ndryshimit të destinacionit diferenca e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë ndikon në të ardhura të munguara për bashkinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Me shkresën protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024 dhe të protokolluar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË janë paraqitur kundërshtitë si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për mosrespektimin e të gjithë kondicioneve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit, hapësirat e gjelbërta dhe hapësirat e parkimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, për objektet: 1. “Banesë Kolektive (8 kate +podrum)” miratuar me vendim Nr. 2097/22, datë 16/05/2022, me zhvillues K në adresën Lagjia 18, Rr. “Dhora Leka”, Korçë; 2. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 8 – 9)- 8 kate +podrum”, miratuar me vendim Nr. 9998/22, datë 14/12/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë; 3. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 10 – 11 -12) 8 kate +podrum”, miratuar me vendim Nr. 2468/22, datë 24/05/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë; 4. “Banesë 3 kate + Podrum”, miratuar me vendim Nr. 7246/22, datë 05/10/2022, “me zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën Lagjia 1, rruga e Bilbilave, Korçë, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:” Në lidhje me ndryshimin e sipërfaqes së ndërtimit

duke llogaritur edhe sipërfaqet e ballkoneve konsol sqarojmë se bazuar në VKM Nr. 626, datë 15.7.2015 "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave", Kapitulli I, pika 2 përcakton përkufizimet si me poshte: 2.16 Intensiteti i ndërtimit (I), për një ndërtim ose parcelë, është raporti i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit në një parcelë të ndërtueshme, me sipërfaqen e parcelës së ndërtueshme. Ku sipërfaqja e ndërtimit përcaktohet si me poshte : 2.11 Sipërfaqja e ndërtimit, është tërësia e sipërfaqeve të shfrytëzimit të banesave, të shkallëve e të muraturave të matura në planimetritë e kateve, ku sipërfaqja e muraturave përcaktohet si më poshtë :2.9 Sipërfaqja e muraturës, tërësia e sipërfaqeve në plan të muraturave mbajtëse dhe ndarëse (përfshirë dyer dhe dritare) të matura në planimetri. Në këto kushte meqenëse në fjalorin e gjuhës shqipe ka përcaktim të saktë për termin "llozhë" dhe termin "ballkon" ku "Llozhë" është "Ballkon i futur në ndërtesë" dhe "Ballkon" është "Shesh i vogël, zakonisht katër këndësh dhe i ngushtë, i rrethuar me parmakë, që del jashtë murit të një ndërtese dhe që lidhet me pjesën e brendshme të saj nëpërmjet një dërrë". Si përfundim: Sipërfaqet e llozhave bëjnë pjesë brenda sipërfaqeve të muraturave mbajtëse, ndërsa ballkonet nuk mund të konsiderohen sipërfaqe ndërtimi në llogaritjen e Intensitetit të ndërtimit, Duke u nisur nga sa më lart, janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e ndërtimit etj. Gjithashtu sqarojmë se në bazë të sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuara me vendim të KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, nenet 54 hapësirat e gjelbërta llogariten për njësi strukturore dhe jo për parcelë ndërtimi. Gjithashtu edhe parkimet llogariten për njësi strukturore. Sqarojmë se, rekomandimet tuaja janë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbahen parasysht nga ana jonë."

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 3, pika 2, Intensiteti i ndërtimit është është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit mbi tokë, përfshihen edhe sipërfaqet e ballkoneve ose daljet konsol. Ashtu sikurse në përlllogaritjen e TNI-së keni llogaritur të gjithë sipërfaqen e ndërtimit, përfshirë edhe daljet konsol, e njëjta sipërfaqe llogaritet edhe në intensitetin e ndërtimit. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për mosparaqitje në mënyrën e saktë të plan vendosjes dhe nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve, si dhe distancat nga trupi i rrugës, për objektet: 1. "Banesë Kolektive (8 kate +podrum)" miratuar me vendim Nr. 2097/22, datë 16/05/2022, me zhvillues K , në adresën Lagjia 18, Rr. "Dhora Leka", Korçë. 2. "Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 8-9)- 8 kate +podrum", miratuar me vendim Nr. 9998/22, datë 14/12/2022, me zhvillues shoqëria "L " ShPK, në adresën Rr. "Midhi Kostani" dhe "I Maji", Lagjia 9, Korçë. 3. "Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 10 – 11 -12) 8 kate +podrum", miratuar me vendim Nr. 2468/22, datë 24/05/2022, me zhvillues shoqëria "L " ShPK, në adresën Rr. "Midhi Kostani" dhe "I Maji", Lagjia 9, Korçë, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:" Sqarojmë se rekomandimet tuaja janë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbahen parasysht nga ana jonë."

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar dhe me atë për të cilën jeni shprehur, do të vijoni me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin në të cilën leja e zhvillimit për objektin "Voskopole Resort-Kompleks turistik 3 kate + 1 kat nën tokë (Zona 2)", miratuar me vendim Nr. 8590/22, datë 09/12/2022, me zhvillues shoqëria "Selmani Construcion" ShPK, në adresën Fshati Voskopojë, Korçë, është miratuar pa miratuar planin dhe kondicionet urbane mbi të cilën do të zhvillohet njësi strukturore përkatëse dhe pa pasur të ngarkuar në sistemin e-leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në bazë të legjislacionit në fuqi, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:"Sqarojmë se, rekomandimet tuaja janë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbahen parasysht nga ana jonë".

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar nga ana juaj dhe në raport me atë për të cilën jeni shprehur, do të vijoni me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin në të cilin nuk janë paraqitur në sistemin e-Leje dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit, për objektet: 1. “Godinë Banimi dhe Shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat me 1 kat parkim nën tokë”, miratuar me vendim Nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqëria B ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, L. 9, Korçë. 2. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 5, 6) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendim Nr. 5526/22, datë 13/07/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:”Sqarojmë se, dokumentacioni i ngarkuar në sistem ka qenë i plotë dhe se rekomandimet tuaja janë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbahen parasysht nga ana jonë”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 27/2, në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje për miratimin e certifikatës së përdorimit, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm. Nuk paraqiten dokumente ose fakte të reja që provojnë pretendimin tuaj. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin e mosrealizimit në terren të punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit dhe me “Çertifikatën e përdorimit” të miratuar për objektin: 1. “Godinë Banimi dhe Shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat me 1 kat parkim nën tokë”, miratuar me vendim Nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqëria B ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, L.9, Korçë, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:”Sqarojmë se objekti përputhet me projektin e miratuar pasi ka të miratuara edhe 2 leje ndërtimi për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, përkatësisht me nr. 4780/20 dt. 27.07.2020 dhe nr.6778/20 dt. 19.10.2020. Sqarojmë se, rekomandimet tuaja janë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbahen parasysht nga ana jonë”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 27/2, në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje për miratimin e certifikatës së përdorimit, nevojitet të paraqitet leja e ndërtimit mbi të cilën është miratuar certifikata e përdorimit dhe projekti i ndërtimit i miratuar. Nga verifikimi i dokumentacionit, realizimi i punimeve të ndërtimit nuk janë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për mosrealizimin në mënyrën e duhur të marrëveshjes për 3 % të sipërfaqes funksionale për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, mungesa e marrëveshjes për kalimin e 3% të sipërfaqes funksionale, si dhe mos kalimi i sipërfaqes funksionale në favor të Bashkisë, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit, për objektet: 1. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 10 – 11 -12) 8 kate +podrum”, miratuar me vendim Nr. 2468/22, datë 24/05/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. 2. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 8 – 9)- 8 kate +podrum”, miratuar me vendim Nr. 9998/22, datë 14/12/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë. 3. “Banesë Kolektive (8 kate +podrum)” miratuar me vendim Nr. 2097/22, datë 16/05/2022, me zhvillues K , në adresën Lagjia 18, Rr. “Dhora Leka”, Korçë. 4. “Godinë Banimi dhe Shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat me 1 kat parkim nën tokë”, miratuar me vendim Nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqëria B ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, L. 9, Korçë. 5. “Godinë banimi me ambjente shërbimi (Nr. 5, 6) - 8 kate me bodrum”, miratuar me vendim Nr. 5526/22, datë 13/07/2022, me zhvillues shoqëria “L ” ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, përfaqësuesit e BASHKISË KORÇË shprehen se:”Në lidhje me pikën 3. duke ju referuar sqarimit të mësipërm të gjetjes 20, për llogaritjen e sipërfaqes së ndërtimit, ky objekt nuk e kalon sipërfaqen e ndërtimit funksionale për banim mbi 2 000 m² . Sqarojmë se, rekomandimet tuaja do të mbahen parasysht nga ana jonë”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit Nr.22/2018, “Për strehimin social”, datë 3.5.2018, Neni 19, pika 1, përcaktohet që: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një

sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohët në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.” Nga verifikimi i të dhënave të projektit të ndërtimit për objektin “Banesë Kolektive (8 kate +podrum)” miratuar me vendim Nr. 2097/22, datë 16/05/2022, me zhvillues K , në adresën Lagjia 18, Rr. “Dhora Leka”, Korçë. 4. “Godinë Banimi dhe Shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat me 1 kat parkim nën tokë”, miratuar me vendim Nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqëria B. ShPK, në adresën Rr. “Midhi Kostani”, L. 9, Korçë, sipërfaqja e banimit mbi tokë e objektit që do të zhvillohet është 2047.5 metra katrorë, prej të cilës 3% e sipërfaqes së saj duhet t’i kalojë bashkisë pa shpërblim, një sipërfaqe prej 61.4 m². Nuk paraqiten dokumente ose fakte të reja që provojnë pretendimin tuaj. Përsa më sipër, pretendimi juaj nuk merren në konsideratë.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, IMTV ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 4 vende vakante. Bashkia Korçë është një bashki me shtrirje të gjerë territoriale, e cila përmbledh edhe 7 njësi administrative, çka do të thotë që 2 inspektorë janë të pamjaftueshëm për të mbuluar një territor me përmasa të tilla, duke rrezikuar në parandalimin e ndërtimeve të paligjshme.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. S.F , me detyrë kryetar i Bashkisë Korçë.

Kriteri: Urdhëri nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës të administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e punonjësve në strukturën organizative të kësaj njësie, sjell pasoja në performancë, duke rrezikuar përmbushjen e objektivave dhe misionit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e strukturave drejtuese dhe vendimarrëse të Bashkisë Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Situata: Nga auditimi i zhvilluar në Bashkinë Korçë, rezultoi se nuk janë vjelë disa gjoba të mbajtura për kundërvajtjet e konstatuara. Nga të dhënat e marra për shtetasit: GJ.S , F.I dhe L.F , janë mbajtur procesverbalet për “dënim me gjobë” përkatësisht në vlerën 35,000 lekë për shtetasin GJ.S , në vlerën 50,000 lekë për shtetasin F.I dhe në vlerën 50,000 lekë për shtetasin L.F , me një vlerë totale 135,000 lekë, e cila rezulton e papaguar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. I.L , me detyrë kryeinspektor i IMT-së, Bashkia Korçë.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Kreu V, neni 31, pika 5.

Ndikimi/Efekti: MoS ëtimi i gjobave me vlerë 137,000 lekë, krijon të ardhura të munguara në buxhetin e saj.

Shkaku: Neglizhencë nga e IMT, Bashkia Korçë.

Rëndësia: E mesme.

Me shkresën protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024 dhe të protokolluar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga përfaqësuesit e bashkisë dhe inspektoriatit i mbrojtjes së territorit janë paraqitur pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për moS ëtimin gjobave, shprehen se: “Për moS ëtimin gjobave e tre gjobave në vlerë totale 137,000 lekë, ka kryer kërkesën pranë Gjykatës Administrative Tiranë për lëshimin e Urdhërit për ekzekutim të gjobave ndaj shtetasve, G.J.S , Kujtim Rënjollari dhe F. I.. Konkretisht :

- G.J.S n është bërë kërkesa nr. 1700 prot. Dt. 27.02.2023

- K. R. është bërë kërkesa nr. 1701 prot. Dt. 27.02.2023

- F.I është bërë kërkesa nr. 1699 prot. Dt. 27.02.2023

Pas daljes së Urdhrave nga Gjykata Administrative do të bëjmë vjeljen e gjobave në bashkëpunim me Zyrën Përmbarimore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar nga ana juaj dhe në raport me atë për të cilën jeni shprehur, jeni duke proceduar me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

Situata: 1. Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 3845/20, datë 28.07.2020 nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 5, 6) - 8 kate me bodrum*”, me zhvillues shoqërinë L. ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr. 5526/22 datë 13.07.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren dhe nga verifikimi i fotove ajrore, u konstatuan ndryshime, pasi daljet konsol nuk janë realizuar sipas projektit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit të miratuar, por janë realizuar me një tjetër konfigurim, duke ndryshuar njollën e objektit.

2. Nga verifikimi i zbatimit në terren i lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 8058, datë 08.11.2019, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr.1236/22, datë 16.03.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi është shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin e fundit, duke ndryshuar edhe konfigurimin e fasadës.

3. Nga verifikimi i zbatimit në terren i lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 1372, datë 01.04.2022, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Kompleks turistik Divizioni, me godI 3 katëshe + 1 kat nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë L dhe O.L , në adresën: Lagjia nr. 3, Rruga “Çlirimi i Korçës”, Korçë, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi objektet në lartësinë e 3 kateve të ndërtimit mbi tokë dhe një kat nën tokë, janë realizuar në 4 kate mbi tokë, duke tejkaluar lartësinë dhe numrin e kateve të lejuar në zonë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohe me përgjegjësi z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë, z. I.L , me detyrë kryeinspektor i IMT-së dhe z. E.K , me detyrë inspektor i IMT-së.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, neni 51, “*Inspektimi*”, neni 52, “*Kundërvajtjet administrative*” dhe Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”, neni 10, “*Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar*”.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kontrollit të punimeve të ndërtimit në terren nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Korçë, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve, ka sjellë si pasojë ndryshimin e njollës së ndërtimit dhe mosrealizimin e objektit në përputhje me lejen

e ndërtimit të miratuar. Në rastin 2., ka sjellë si pasojë shtimin e sipërfaqes së ndërtimit ndërsa në rastin 3., moskontrolli i situatës ka sjellë si pasojë ndryshimin në lartësinë mbi tokë të objektit që zhvillohet.

Shkaku: Neglizhencë nga e IMT, Bashkia Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Me shkresën protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024 dhe të protokolluar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga përfaqësuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së territorit janë paraqitur pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara, inspektoriatit i mbrojtjes së territorit shprehet se: “Nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit u kryen përsëri kontrolle dhe rezultoi që shoqëria “L ” ShPK. ka marrë leje për ndryshim projekti nr. 3972/22 dt. 13.05.2022. Projekti është zbatuar me përpikmëri nga shoqëria e ndërtimit dhe nuk kemi të bëjmë me ndryshim të ndërtimit nga ajo e miratuar.

Për pikën 2 të kësaj gjetje, ju sqarojmë se shoqëria “B ”ka marrë dy leja të tjera për ndryshim projekti. Nr. 4780/20 dt. 27.07.2020 dhe nr. 6778/20 dt. 19.10.2020. Arkitekti nuk ka pasqyruar pamjet 3D të ndryshimeve në sistem, por në planimetria e armimit të soletës së baxhesë në kotën + 28.19, dy ballkonet figurojnë të mbyllura. Edhe në ndryshimin tjetër të mitatuar në leja nr. 6778/20 dt. 19.10.2020. në planimetrinë e taracës, këto dy ballkone figurojnë të mbyllura. Për sa më sipër mbyllimi i dy ballkoneve figuron i realizuar sipas projektit të miratuar.

Për pikën 3 të kësaj gjetje për lejen e ndërtimit me zhvillues L dhe O.L godinë 3 kat me 1 kat nën tokë, ju informojmë se Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit bëri kontroll dhe rezultoi se zbatimi i projektit është kryer sipas projektit të miratuar. Terreni ka një pjerresi me disnivel – 4 m në planin lindje – perëndim,. Në lindje kuota është fiks sipas projektit -1 ndërsa në perëndim ka mospërputhje për shkak të pjerrësisë së terrenit. Kjo mospërputhje do të realizohet nga subjekti në momentin e kryerjes së sistemimit të jashtëm të kompleksit. Firma do të realizojë kuotë në miratuar sipas projektit në momentin e sistemimit të jashtëm. Ky subjekt do të kontrollohet përsëri nga ana jonë deri në përfundim të punimeve.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë nuk paraqiten dokumente ose fakte të reja që provojnë pretendimin tuaj. Përsa më sipër, pretendimi juaj nuk merren në konsideratë.

Situata: Nga verifikimi i zbatimit në terren të ndërtimeve të kundërligjshme, u kostatua që në fshatin Dishnicë, në Korçë, është ndërtuar strukturë kolonash dhe trarësh beton arme, mbi katin e dytë të një objekti ekzistues. Për këtë shkelje është mbajtur procesverbali nr. 25, datë 13.10.2022 për konstatimin e kundërvajtjes dhe vendimi për prishje nr. 7, datë 16.10.2022, i cili nuk është ekzekutuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. S.F , Kryetar i BASHKISË KORÇË dhe z. I.L , me detyrë kryeinspektor i IMT-së, Bashkia Korçë.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, neni 52, “Kundërvajtjet administrative” dhe Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 10, “Detyrat e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”.

Ndikimi/Efekti: Mosekzekutimi i vendimeve të prishjes nga ana e IMT-Bashkia Korçë, stimulon edhe më shumë ndërtimet pa leje duke sjellë kaos urban me ndërtime.

Shkaku: Neglizhencë nga e IMT, Bashkia Korçë.

Rëndësia: E lartë.

Me shkresën protokolluar në Bashkinë Korçë me nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024 dhe të protokolluar në KLSH me nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga përfaqësuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së territorit janë paraqitur pretendimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimin për ekzekutimin e vendimeve, shprehen se: “Nga ana jonë nuk është prishur një strukturë me kolona betoni në katin e tretë të banesës së shtetasit G. Ç. në Dishnicë. Kemi patur veshitësi pasi pronarët janë larguar jashtë shtetit, dhe e vetmja mundësi është prishja nga brenda banesës, nga tarraca e katit të dytë. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit do të ndërhyjë me prishje në momentin që do të kthehet pronari. Çështja do jetë nën vëmendje në të ardhmen.”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”, ekzekutimi i vendimeve për prishjen duhen realizuar duke zbatuar edhe afatet kohore të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

2.7. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit**2.7.1. Auditim me zgjedhje mbi shpenzimet e konsumit të karburantit për mjetet e Bashkisë Korçë, Sektori i MZSH-së dhe Njësive Shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes.****a. Mënyra e mbajtjes së dokumentacionit ligjor për lëvizjen e mjeteve:**

Situata: Në gjendjen e inventarit të BASHKISË KORÇË në të cilën përfshihet edhe Sektori i MZSH-së dhe Njësive Shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes ndodhen në total 84 mjete/makineri dhe pajisje në gjendje pune, të llojit: autoveturë, furgon, kamion, fadromë, eskavator, traktor, prerëse asfalti, vinç, fryrëse gjethesh, makinë vijëzimi, borëpastruese, skrep, bobcat, autoshkallë, zjarrëfikëse, rul, betoniere, kaldajë, motokorrëse, motosekë, gjenerator, motor pompe etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Mjetet/makineri dhe pajisje në dispozicion
1	Aparati i BASHKISË KORÇË + Sektori i MZSH-së	23
2	Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike	59
3	Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	2
Totali		84

- Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistohen të gjitha të dhënat e mjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu të evidentohet kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, me zgjedhje u konstatua se, 13 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik dhe 12 mjete nuk janë të pajisura me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Nr.	Mjeti	Drejtuesi i mjetit	Pajisur me çertifikatën e kontrollit teknik	Pajisur me siguracion
Aparati i Bashkisë Korçë				
1	Autoveturë KO8491B	E.G	Jo	Jo
2	Autoveturë AA714HF	E.R	Jo	Po
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike				
1	KO8205A	R.M	Jo	Jo
2	Skrep	P.B	Jo	Jo
3	Eskavator	R.Z	Jo	Jo
4	Eskavator	S.F	Jo	Jo
5	Eskavator	A.A	Jo	Jo
6	Rul Volvo	M.XH	Jo	Jo
MZSH				
1	Iveco Kamion	R.K	Jo	Jo
2	Autoshkallë Kamion	E.M	Jo	Jo
3	Daf Zjarrëfikës Kamion	L.ç	Jo	Jo

4	Policia 1181	G.Q	Jo	Jo
5	Policia 1180	D.SH	Jo	Jo
Totali			13	12

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje, u konstatua se, për 3 mjete të tipit ekskavator, pjesë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (me drejtues mjete z. R.Z , z. S.F dhe z. A.A) nuk janë të regjistruar në regjistratat publikë, pra nuk disponojnë çertifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimit.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22, Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 4, gërma “a”, Ligji nr. 32/2021, datë 16.03.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 2, pika 1, gërma “a”, Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58, neni 113 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrim i saktë dhe transparent i procesit të monitorimit për konsumin e karburantit për mjete të institucionit. Mospajisja me çertifikatë të kontrollit teknik është tregues se mjete kanë defekte teknike gjatë përdorimit të tyre. Mospajisja me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, çon në Mosmbulimin nga kompanitë e sigurimeve të dëmeve që shkaktohen nga aksidentet rrugore.

Shkak: Moszbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

b. Normativat mbi konsumin e karburantit:

Situata: a. Me shkresën nr. 724 prot., datë 03.02.202, të z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë, janë miratuar normativat për konsumin e karburantit për 11 mjete të Aparatit të Bashkisë Korçë, 1 mjet i Sektorit të Pyjeve dhe 14 mjete të Sektorit të MZSH-së. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, nga Bashkia Korçë nuk disponohet urdhër për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e normativave me qëllim kryerjen e një analize mbi caktimin e normativave mbi konsumin e karburantit për secilin mjet të institucionit mbi bazën e testimeve, duke u mbajtur procesverbalet përkatëse.

b. Me shkresën nr. 6 prot., datë 05.01.2022, grupi i punës i përbërë nga z. N.K , Përgjegjës i Sektorit Mekanik Transportit dhe Mirëmbajtjes, z. E.SH , Specialist i Mjeteve të Transportit, z. P.L , Xhenerik/Motorist, z. I.ZH , Përgjegjës Ofiçine dhe z. F.M , ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e normativave për konsumin e karburantit për 54 mjete/makineri dhe pajisje që disponon NSHP, miratuar nga z. A.N , me detyrë Drejtor i Punëve Publike të Qytetit në cilësinë e personit të autorizuar. Nga grupi i punës i sipërpërmendur janë mbajtur procesverbalet përkatëse për testimin e secilit mjet/makineri apo pajisje, por për mjete që kanë njësi matëse kilometrazhin nuk evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit përgjatë procesit të testimit me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave për konsumin e karburantit.

c. Me shkresën nr. 35 prot., datë 05.01.2022, grupi i punës i përbërë nga znj. R. P., Përgjegjës i Sektorit Ekonomik, znj. A.L , Magazinier, z. A.Q , Përgjegjës i Brigadës së Shërbimeve, znj. V.P , FI ncier, z. D. Gj., Specialist në Brigadën e Shërbimeve dhe z. A.XH , Shofer i Ndërmarrjes, ka mbajtur procesverbalin mbi përcaktimin e normativave për konsumin e karburantit për 2 mjete që disponon NSHMAÇ, miratuar nga z. Y.M , Drejtor i NSHMAÇ. Nga grupi i punës i sipërpërmendur nuk është kryer një analizë mbi konsumin e karburantit pra nuk janë kryer teste në rrugë urbane dhe nacionale apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit) në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22.

Ndikimi/Efekti: Moskryerja e testeve nga grupet e punës, nuk jep siguri mbi catimin e normativave reale mbi konsumin e karburantit.

Shkaku: Mosimplementimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

c. Mbi mënyrën e përlogaritjes së kilometrave apo orëve të punës:

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, u konstatua se, nga totali i përgjithshëm vetëm 39 mjete janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik. Referuar këtij dokumentacioni janë konstatuar parregullsi në evidentimin e kilometrave të përshkuara nga këto mjete ndër vite si më poshtë:

- Në 11 raste, nuk evidentohen kilometrat e përshkuara të mjetit konkretisht: për 8 mjete të NSHP, për 2 mjete të NSHMAÇ dhe për 1 mjet të MZSH-së.

- Në 7 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara të mjetit në vitet e mëparshme por vetëm të vitit të fundit që është kryer kontrolli teknik konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 3 mjete të NSHP dhe për 2 mjete të MZSH-së.

- Në 14 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara të mjetit në mënyrë të rregullt sipas viteve por pjesërisht, konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 11 mjete të NSHP dhe për 1 mjet të MZSH-së.

- Në 10 raste, evidentohet ulja e kilometrave të përshkuara nga mjeti në çertifikatën e kontrollit teknik nga viti në vit, konkretisht: për 1 mjet të Bashkisë Korçë, për 6 mjete të NSHP dhe për 3 mjete të MZSH-së.

Mosevidentimi në mënyrë të saktë dhe kronologjike të përvitshme apo ulja e kilometrave nga viti në vit, referuar çertifikatave të kontrollit teknik, bën të paverifikueshëm/pamonitorueshëm procesin e përcaktimit të normativave apo rakordimin e karburantit të konsumuar dhe të dhënave të pasqyruara në fletët e udhëtimit për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22.

Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi i saktë dhe në mënyrë kronologjike i kilometrave të përshkuara nga mjeti, ndikon në Mosrakordimin e kilometrave të hedhura në fletët e udhëtimit me ato reale.

Shkaku: Mosimplementimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

d. Furnizimi i mjeteve:

Për të gjitha mjetet/makineritë dhe pajisjet që disponohen nga Bashkia Korçë (duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së), Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, furnizimi me karburant kryhet mbi bazën e planit të shpërndarjes në fillim të vitit për secilin mjet/makineri. Furnizimi i mjeteve me karburant kryhet nëpërmjet kartave elektronike. Bashkëlidhur faturës përmbledhëse mujore, e cila lëshohet nga operatori ekonomik dhe fletë-hyrjeve/fletë-daljeve nga magazI , (të cilat janë mujore nga magazI dhe jo sipas çdo furnizimi), nga drejtuesit e mjeteve nuk disponohen kuponat tatimorë, dokument i cili përmban targën e mjetit, datën, sasinë e furnizimit të realizuar. Kuponi tatimor është elementi më i rëndësishëm mbi verifikimin nëse sasia e bërë dalje nga magazI sipas fletë-daljeve përkatëse, është e njëjtë me atë që është furnizuar mjeti në pikën e furnizimit me karburant.

e. Auditim me zgjedhje i shpenzimeve mbi konsumin e karburantit për mjetet e Bashkisë Korçë, Sektorit të MZSH-së, NSHP dhe NSHMAÇ:

Situata: a. Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, për 23 mjete të BASHKISË KORÇË duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së, është tërhequr në total karburant, naftë 28,813 litra dhe benzinë 3,674 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 11 automjete, për muajt shkurt, mars, qershor, korrik, nëntor dhe dhjetor të vitit 2022, ku është konsumuar sasia e karburantit naftë 16,201 litra, në vlerën 3,590,435 lekë dhe benzinë 1,655 litra në vlerën 299,078 lekë, ku u konstatua se në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim të lëvizjes dhe në përfundim por është përmbledhësja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Në disa raste, në fletët e udhëtimit evidentohet pasqyrim i lëvizjes së mjeteve brenda territorit të qytetit të Korçës, pa destinacion por vetëm me emërtimin “Korçë-Korçë” apo “Korçë qytet” të cilat variojnë nga 60 deri në 120 km në ditë apo lëvizje drejt qytetit të Tiranës (vajtje ardhje) të cilat variojnë nga 400 km deri në 420 km ndërkohë që referuar të dhënave në internet distanca është 330 km. Nuk disponohet dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo udhër pune, autorizim dhe urdhër shërbimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. S.F , Kryetar i Bashkisë Korçë, në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. V.Z , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. A.Q , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në cilësinë e drejtuesit të drejtorisë që ndjek shpenzimet mbi konsumin e karburantit, z. N.M , me detyrë Specialist Logjistike, si dhe drejtuesit e mjeteve, z. R.Q , z. J.T , z. E.G , z. I.L , z. E.K , z. K.SH , z. J.M , z. J.M , z. E.R dhe z. K.J .

b. Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, për 52 mjete/makineri dhe pajisje të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, janë tërhequr karburant naftë 168,041 litra dhe benzinë 19,696 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 41 autovetura dhe mjete pune të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për muajt prill, qershor, tetor dhe dhjetor të vitit 2022, ku është konsumuar sasia e karburantit naftë 53,711.32 litra, në vlerën 12,291,402 lekë dhe benzinë 3,855 litra në vlerën 840,808 lekë, ku u konstatua se në dokumentacionin justifikues për mjetet që njësi matëse kanë kilometrazhin, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim të lëvizjes dhe në përfundim, por është përmbledhësja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Nuk disponohet dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo udhër pune, autorizim dhe urdhër shërbimi. Për mjetet që njësi matëse kanë volumet dhe orët e punës, në fletët e udhëtimit nuk ndodhet i përcaktuar vendi i punës, (sipas rrugëve apo kanaleve etj., për çdo ditë pune), objekti i punës, orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësia/distanca e rrugëve apo kanaleve në të cilën është kryer punimi apo pastrimi, faturat shoqëruese të mallrave në rastin e shtrimit apo sistemimit të çakullit dhe fotot e punimeve të realizuara, por është vetëm përmbledhësja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave së bashku me vendin e punës (emërtimin sipas njësive administrative) për secilin mjet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi: z. I.D , Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. K.G , Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. E.SH , me detyrë Specialist i Lartë i Transportit, si dhe të gjithë drejtuesit e mjeteve, z. H.M , z. P.D , z. E.G , z. K.K , z. A.S , z. S.Q , z. K.Z , z. J.M , z. D.Z , z. M.P , z. O.A , z. GJ.XH , z. R.M , z. M.Ç , z. R.Z , z. A.A , z. B.M , z. E.G , z. M.M , z. P.P , z. A.T , z. K.Z , z. V.P , z. P.B , z. J.Ç , z. G.K , z. S.F , z. N.S , z. I.P , z. E.R , z. D.G , z. XH.B , z. R.K dhe z. N.K .

b.1. Nga auditimi i shpenzimeve të konsumit të karburantit, u konstatua se Bashkia Korçë, përfaqësuar nga z. TH.T ish-Drejtor i NSHP dhe z. I.D Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publik, kanë nënshkruar katër kontrata hua-përdorimi me personat fizikë si më poshtë:

Nr.	Kontrata	Huamarrësi	Huadhënësi	Afati i kontratës	Mjeti	Marrësi në dorëzim
1	Nr. 692 prot., datë 09.12.2016	NSHP TH.T	V.D	01.01.2016, deri më 31.12.2017	JCB AA382HV JCB, KC Teknologjike	TH.T

					AAMT49	
2	Nr. 44 prot., datë 13.01.2017	NSHP TH.T	GJ.SH	01.01.2016, deri më 31.12.2017	JCB ADMT64	TH.T
3	Nr. 1126 prot., datë 31.12.2020	NSHP I.D	S.A	Pa afat	AJMT 78	I.D
4	Nr. 4 prot., datë 05.01.2021	NSHP I.D	O.P	Pa afat	ADMT55	I.D

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë nuk dokumentohet në mënyrë shkresore apo elektronike nëpërmjet emaile-ve, komunikimi ndërmjet palëve për vendosjen e mjeteve në dispozicion të bashkisë përpara fazës së nënshkrimit të kontratave të hua-përdorimit. Gjithashtu nuk ka një vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak për marrjen e këtyre mjeteve me kontratë-huapërdorimi.

Në total për vitin 2022 janë përdorur katër mjete me kontratë hua-përdorimi në raste emergjencash. Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, për katër mjete është konsumuar saisa e karburantit naftë 15,996 litra, në vlerën 3,228,173 lekë për të cilat paraqiten fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit por nuk ka një kërkesë, program pune për lëvizjen e tyre drejt fshatrave apo qytetit të Korçës për rastet e emergjencave (bllokim bore, pastrim në raste rrëshkitje dherash etj.). Në fletët e udhëtimit ndodhet i përcaktuar vendi i punës, por nuk përcaktohet orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësia/distanca e rrugëve apo kanaleve në të cilët është kryer punimi apo pastrimi, por është vetëm përmbledhësja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave, së bashku me vendin e punës (emërtimin sipas njësive administrative) për secilin mjet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi: z. I.D , Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. K.G , Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. E.SH , me detyrë Specialist i Lartë i Transportit, si dhe drejtuesit e mjeteve z. A.A., z. S.F , z. M.Ç , z. R.Z dhe z. Z. B.

d. Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, për 2 mjete të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, janë tërhequr në total karburant naftë 3,000 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 2 automjete, ku për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, është konsumuar sasia e karburantit naftë 3,000 litra, në vlerën 501,120 lekë, ku u konstatua se në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim të lëvizjes dhe në përfundim por është përmbledhësja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Nuk disponohet dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune dhe urdhër shërbimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi: z. Y.M , Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. J.T , Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. R.P (për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 01.01.2022), znj. S.Z (për periudhën nga data 02.11.2022, deri më 31.12.2022), Përgjegjës i Sektorit Ekonomik në cilësinë e personave që ndjekin shpenzimet mbi konsumin e karburantit dhe z. A.XH me detyrë drejtues mjeti.

Për sa trajtuar më sipër, në total nga Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes është konsumuar naftë 88,908 litra, në vlerën 19,611,130 lekë dhe benzinë 5,510 litra, në vlerën 1,139,886 lekë, vlerë e cila për Buxhetin e Bashkisë Korçë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 10, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 5, pika 10, pika 19, pikat 35-36.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar në vlerën 20,751,016 lekë.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Situata: Nga auditimi i shpenzimeve të konsumit të karburantit u konstatua se Bashkia Korçë përfaqësohet nga z. S.F Kryetar i Bashkisë ka nënshkruar pesë kontrata hua-përdorimi me personat fizik si më poshtë:

Nr.	Kontrata	Huamarrësi	Huadhënësi	Afati i kontratës	Mjeti	Përdoruesi i mjetit
1	Nr. 210 prot., datë 13.01.2022	Bashkia Korçë	T.I	13.01.2022, deri më 31.12.2022	AA383HF Honda Civic	M.M Administrator i NjA Drenovë
2	Nr. 210 prot., datë 13.01.2022	Bashkia Korçë	A.H	13.01.2022, deri më 31.12.2022	AA906FG Audi A4	L.SH Administrator i NjA Mollaj
3	Nr. 210 prot., datë 13.01.2022	Bashkia Korçë	R.N	13.01.2022, deri më 31.12.2022	AA990NT BMW	K.Z Administrator i NjA Voskopojë
4	Nr. 210 prot., datë 13.01.2022	Bashkia Korçë	F.B	13.01.2022, deri më 31.12.2022	AA042FE Daimler Chrysler	E.D Administrator i NjA Voskop
5	Nr. 210 prot., datë 13.01.2022	Bashkia Korçë	L.XH	13.01.2022, deri më 31.12.2022	AA053PG Nissan Terrano II	I.P Administrator i NjA Vithkuq

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, nga Bashkia Korçë nuk dokumentohet në mënyrë shkresore apo elektronike nëpërmjet emaile-ve, komunikimi ndërmjet palëve për vendosjen e automjeteve në dispozicion të bashkisë përpara fazës së nënshkrimit të kontratave të hua-përdorimit. Gjithashtu nuk ka një vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak për marrjen e këtyre mjeteve me kontratë-huapërdorimi.

Në total, për vitin 2022 kanë qenë aktive pesë kontrata hua-përdorimi, për të cilat automjetet janë përdorur nga Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop dhe Vithkuq. Sasia e karburantit e tërhequr sipas kontratave të hua-përdorimit të sipërpërmendura, i përket administratorëve të NjA konkretisht z. M.M (NjA Drenovë) 1,100 litra naftë, në vlerën 247,256 lekë, z. L.SH (NjA Mollaj) 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. K.Z (NjA Voskopojë) 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. E.D (NjA Voskop) 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë dhe z. I.P (NjA Vithkuq) 1,320 litra naftë, në vlerën 295,872 lekë.

Si dokumentacion justifikues nga administratorët e NjA të cilët kanë përfituar karburant paraqiten fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit, por nuk ka një kërkesë, program pune për lëvizjen e tyre drejt fshatrave apo qytetit të Korçës. Theksojmë që punonjësit që kanë tërhequr këtë sasi karburant ushtrojnë funksionim e administratorëve të NjA dhe detyra funksionale e këtyre punonjësve është në zyrë dhe jo në terren.

Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, bëhet mbi bazën e VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit) sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifën e transportit të udhëtarëve” i ndryshuar. Në total për vitin 2022 për 5 punonjës është tërhequr karburant naftë 5,720 litra, në vlerën 1,282,808 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Kriteri: VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, pika 4.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik në vlerën 1,282,808 lekë.

Shkaku: Trajtimi me karburant i punonjësve në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 7773/56 prot., datë 28.02.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 862/9 prot., datë 04.03.2024, nga z. S.F Kryetar i Bashkisë Korçë, ku janë shkrehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

I. MZSH-ja prej datës 01.01.2024, në fletët e udhëtimit ka paraqitur kilometrazhin e mjeteve në fillim të lëvizjes dhe në përfundim të tij. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korçë do të hartojë kartela përkatëse të mjeteve, ku do të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet

e mjeteve.

2. Nga ana e MZSH-së janë hapur kartelat për çdo mjet me të gjitha të dhënat e mjetit dhe shpenzimet që kryhen për to, evidentimi i kilometrazhit në fillim të vitit, kartelat e gomave. Në lidhje me dy mjete të cilat nuk kanë certifikatë pronësie, certifikatë të kontrollit teknik, policë sigurimi, u kryhen veprimet e mëposhtme:

a. Për automjetin zjarrfikës tip “DENISA” me targë Policia 180, nga ana e Drejtorisë së MZSH-së duke parë kapacitetet dhe efektiviteti i ndërhyrjes së këtij automjeti, nuk është e nevojshme të kryhet procedura për regjistrimin e tij dhe do të jetë fizikisht në ambjentet e kë saj Drejtorie.

b. Në lidhje me automjetin zjarrfikës tip “IVECO”, pa targë, pa certifikatë, pa kontroll teknik, pa siguracion, nga ana e Drejtorisë së MZSH-së, Bashkia Korçë, ka filluar procedura për rregjistrimin e saj ndaj u krye pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë me kërkesën e dërguar nga ana jonë për rregjistrimin e këtij mjeti dhe kryerjen e veprimeve të tjera me qëllim zbatimin e ligjshmërisë për këtë lloj transporti duke i vënë në dispozicion të dhënat e disponueshme të mjetit dhe burimin e ardhjes së këtij automjeti.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korçë ka planifikuar një zë të veçantë në buxhet me objekt “Shpenzime për ndryshim targe dhe pronësie” për ndryshimin e targave dhe pajisjen me certifikatë pronësie të mjeteve motorrike si dhe pajisjen me certifikatë të kontrollit teknik dhe policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

3. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korçë do të ngrejë grupin e punës:

-Për kryerjen e testeve përkatëse të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve duke caktuar normat sa më reale, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së ndërmarrjes në këtë mënyrë do të evidenton km. në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit përgjatë procesit të testimit.

-Për të evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të vitit duke evidentuar shpenzimet periodike.

-Për të bërë verifikimin faktik të kilometrave të përshkruara nga mjetet dhe rakordimin me DSHPTRR Korçë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Observacioni i sipërcituar nuk kundërshton në thelb problematikat e ngritura nga grupi i auditimit, por flet për masat që po merr institucioni për përmirësimin e praktikës së mbajtjes dhe pajisjes me dokumentacion për lëvizjen e mjeteve, normativave apo plotësimin e fletëve të udhëtimit që i përkasin vitit 2024. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.**

2. Pretendimi i subjektit:

Njësitë Administrative përbëhen nga Administratori, 1-2 punonjës për mbledhjen e taksave 1-2 punonjës të Kujdesit Social të cilët është e nevojshme të lëvizin në terren si dhe të paraqiten pranë Bashkisë për derdhjen e lekëve, të grumbulluara nga mbledhja e taksave. Detyrat e administratës së njësisë administrative janë parashikuar në nenin 66 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe konsistojnë si më poshtë:

a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;

b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;

c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;

ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;

d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;

dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;

Pra referuar sa më sipër dhe konkretisht gërmës b) të nenit 66 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, detyra e administratorëve nuk është një punë zyre dhe nisur nga kjo dhe për një njohje dhe administrim sa më mirë të territorit ku njësi administrative ka juridiksionin e saj është menduar që administratorët të kenë në përdorim një makinë. Në kushtet kur buxheti i bashkisë është i pamjaftueshëm për blerjen e 7 makinave (Bashkia Korçë ka 7 njësi administrative) referuar nenit 9 pika 1.6 gërma b) e Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”

i ndryshuar dhe neneve 913 -934 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Bashkia Korçë në cilësinë e personit juridik që ka të drejtë të lidhë kontrata ka marrë me huapërdorje makI të cilat janë vendosur në dispozicion të administratorve me qëllim kryerjen e funksioneve sa me pranë banorëve të çdo njësie administrative.

Referuar VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, parashikohet se “ Punonjësit e njëjtit të qeverisjes së përgjithshme, të cilët shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit”. Sqarohet se qendra e punës për administratorët është Njësia Administrative përkatëse për secilin prej tyre dhe rrjedhimisht të gjitha funksionet ushtrohen brenda territorit të Njesisë Administrative. Në këto kushte, administratorët nuk janë subjekt i aplikimit të VKM së sipërpërmendur për sa i përket shërbimeve që kryejnë në territorin e Njesisë Administrative.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, bëhet mbi bazën e VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. Çdo trajtim tjetër, jashtë kësaj baze ligjore është i pa ligjshëm. Konkretisht në pikë 1 përcaktohet që: “Për shërbime në një largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë setarifa përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me Vendimin nr. 307, datë 20.07.1992, të Këshillit të Ministrave “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar. Gjithashtu qendër pune nuk quhet qyteti apo qarku konkretisht qyteti Korçë por institucioni që ushtron aktivitetet. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

2.7.2. Verifikimi i ankesës së z. R.T , protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 510/5 prot., datë 05.07.2022.

Me shkresën protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 510/5 prot., datë 05.07.2022, z. R.T , ka paraqitur një ankesë, në bazë të së cilës u konsiderua i nevojshëm zhvillimi i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së, T.A dhe J.P , (përgjegjës grupi) në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit z. S.F , Kryetar i BASHKISË KORÇË dhe znj. A.D me detyrë Drejtore e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Bazuar në ankesën e ardhur në KLSH, z. R.T pretendon se është pronar i një trualli ku ushtron aktivitet Ndërmarrja e Pastrim Gjellbërimit dhe një subjekt privat i cili paguan qera mujore në Bashkinë Korçë. Në vitin 2010, Gjykata ka dalë me vendim të formës së prerë dhe ka vendosur që Bashkia Korçë të paguajë paditësin deri në momentin e privatizimit të objektit, vendim të cilin ankuesi shprehet se Bashkia Korçë e ka fshehur. Më tej pretendon se Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoresha Juridike, akoma sot e kësaj dite nuk e zbatojnë vendimin e formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Korçë. Gjithashtu ai shprehet se ka kryer edhe një deklaratë noteriale (kontratë) e firmosur nga ish Kryetari i Bashkisë dhe Juristja, ku sipas kësaj deklarate Bashkia Korçë do ta shlyente detyrimin duke përcaktuar një vlerë prej 300,000 lekë në muaj.

Sa më sipër, Bashkia Korçë pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 150 datë 19.01.2010, e detyron të paditurin Bashkia Korçë të paguajë në favor të paditësit R.T , M.P , L.A (si subjekte të shpronësuar) si çmim qiraje të truallit në pronësi, dhënë në përdorim të tretëve prej të paditurit, shumën prej 2,315,400 lekë (6,344 lekë në ditë). Shlyerja e detyrimit fillon nga dita që pala e paditur ka ardhur në dijeni të kërkesës së paditësit, me datë 28.08.2008, duke vazhduar deri në momentin e privatizimit të objekteve në pronësi të Bashkisë Korçë. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe është vendosur në ekzekutim.

Bashkia Korçë nuk ka qenë dhe nuk është institucioni i vetëm i cili duhet të disponojë për privatizimin e kësaj pasurie. Bashkia Korçë qysh në krye të herës me VKB 108 datë 21.10.2016 të ndryshuar, po vijon procedurën e privatizimit duke përmbushur detyrimet ligjore siç i

takojnë. Është Ministria e Financave institucioni kompetent për finalizimin e kësaj procedure referuar VKM 926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës që privatizohet apo transferohet me procedurë shitje”.

Nga Bashkia Korçë janë ndjekur të gjithë hapat e duhur ligjor për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv duke plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji dhe përcjellë ministrisë. Është Ministria e Financave kompetente për finalizimin e kësaj procedure ndaj dhe nuk mund të vijojë penalizimi i BASHKISË KORÇË për pagimin e qirasë kur nga ana jonë janë zbatuar gjithë detyrimet ligjore për privatizim, është dhënë pëlqimi dhe është plotësuar gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe përcjellë ministrisë. Ndaj dhe Bashkia Korçë nuk ka shkelur asnjë të drejtë kreditorit por ka përmbushur detyrimin e saj ligjor.

Nga ana jonë u kërkuar informacion dhe dokumentacion në Bashkinë Korçë dhe u morën në administrim për shqyrtim dokumentat sa më poshtë:

- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- Kontrata e lidhur midis palëve mbi rregullimin e marrëdhënieve të detyrimit për pagesën e qerasë.
- VKB nr. 108 datë 21.10.2016 “Për dhënien e pëlqimit për privatizimin e objektit “Ish Ndërmarrja e Gjelbërimit Korçë”” dhe korrespondenca me MFE;
- VKM nr. 926 datë 29.12.2014;

Konkluzion: Referuar Vendimit të Gjykatës nr. 150, datë 19.01.2010, është përcaktuar se Gjykata detyron të paditurin Bashkia Korçë të paguajë në favor të paditësit R.T , M.P , L.A (si subjekte të shpronësuar) si çmim qiraje të truallit në pronësi, dhënë në përdorim të tretëve prej të paditurit, shumë prej 2,315,400 lekë (6,344 lekë në ditë). Shlyerja e detyrimit fillon nga dita që pala e paditur ka ardhur në dijeni të kërkesës së paditësit, me datë 28.08.2008 duke vazhduar deri në momentin e privatizimit të objekteve në pronësi të Bashkisë Korçë.

Referuar kontratës së nënshkruar midis palëve, me datë 06.04.2010, neni 3, pika 3, është përcaktuar që “Detyrimin mujor të përcaktuar nga gjykata (6,344 lekë në ditë), do ta paguajë prej datës 22.02.2010 e në vazhdim deri në momentin e nxjerrjes të objektit për privatizim...”.

Bazuar në këtë përcaktim të marrëveshjes, sipas interpretimit literal të bërë nga ana e Bashkisë është konsideruar i ezauruar në momentin e nxjerrjes për privatizim, i cili sipas bashkisë, lidhet me momentin e fillimit të procedurës së privatizimit, pavarësisht nëse është fi lizuar ose jo. Pretendimet e palës tjetër lidhen me momentin e privatizimit, duke nënkuptuar mbylljen e plotë të procesit, e cila lidhet me marrjen e pronësisë. Po kështu, në VKM-në nr. 926 datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, kapitulli II, pika 16, përcaktohet se: “Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen mbyllën në çastin e ndryshimit të pronësisë...”, pra ky proces lidhet me përfundimin e tij dhe jo me fillimin e procedurës.

Në kushtet e interpretimit të dispozitave të legjislacionit “Për privatizimin”, si dhe në zbatim të nenit 681 dhe vijues të Kodit Civil, interpretimi i kontratave bëhet gjithmonë duke patur parasysh qëllimin e lidhjes së kontratës, pa u bazuar në interpretimin literal të fjalëve dhe duke qënë në mirëbesim të palëve.

Sa më sipër duke qënë se qëllimi i personave nëpërmjet lidhjes së kontratës ka qënë përmbushja e detyrimit, kjo kontratë nuk mund te interpretohet në disfavor të palës gjyqfituese, për më tepër kur është edhe në kundërshtim me ligjin. Si e tillë ajo do të interpretohet ose në favor të palës gjyqfituese ose do te kërkohet pavlefshmëria e saj.

Në lidhje me këtë situatë, KLSH nuk ka tagër ligjore për të interpretuar kontratën, por si e tillë kjo mosmarrëveshje mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, i cili mund të vihet në lëvizje nga palët.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik rezultoi se:

- Menaxhimi i lartë i Bashkisë Korçë, nuk ka ngritur dhe nuk ka siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Punonjësit e BASHKISË KORÇË nuk janë trajnuar mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Bashkia Korçë nuk ka hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut duke identifikuar dhe evidentuar sektorët me risk të lartë.

- Bashkia Korçë nuk ka hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 36-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Menaxhimi i lartë i Bashkisë Korçë, të marrë masat për të ngritur dhe siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin:

- Duke trajnuar punonjësit e BASHKISË KORÇË mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Duke hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut, në përputhje me kërkesat e MFK, duke angazhuar strukturat përgjegjëse në identifikimin e risqeve dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë.

- Duke hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Korçë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime ka qenë 1,889,325 mijë lekë, planifikimi përfundimtar ka qenë 2,138,790 mijë lekë, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka qenë 1,607,320 mijë lekë me një diferencë 282,005 mijë lekë nga plani fillestar ose 531,470 mijë lekë nga plani përfundimtar, në masën 85% nga plani fillestar dhe 75% nga plani përfundimtar. Planifikimi i të ardhurave ka qenë 1,062,056 mijë lekë, ndërsa realizimi ka qenë 751,455 mijë lekë ose në masën 71%. Bashkia Korçë në riplanifikimin e shpenzimeve duke parë realizimin e ulët të të ardhurave, në vend që të bënte ulje në planin e shpenzimeve, ka bërë rritje, duke e thelluar hendekun e mosrealizimit nga 85% në 75% të totalit.

Stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2022 ka qenë 95,967 mijë lekë ose në masën 4.5% e totalit të shpenzimeve të planifikuara, të cilat duke pasur parasysh kohën e krijimit të tyre duhet të ishin likuiduar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, “Për fll ncat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, UMFE nr. 7, datë 26.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”; etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

Të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura sipas faturave të palikuiduara për

blerje mallra dhe shërbime, gjendje në fund të vitit 2022.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të BASHKISË KORÇË u konstatua se, për vitin 2022 në total janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale në vlerën 15,936,605 lekë. Kjo vlerë nuk është e kontabilizuar saktë, për arsye se në pasqyrat financiare të Qendrës së Artit dhe Kulturës është kryer pakësim në vlerën 4,000,000 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare të konsoliduara është kontabilizuar si nxjerrje jashtë përdorimit. Gjithashtu në regjistrin e aktiveve të Aparatit të BASHKISË KORÇË është kryer nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën 3,270,276 lekë ndërkohë që në bilancin e konsoliduar është kontabilizuar si pakësim.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për sistemimin e saktë të vlerave të kontabilizuara nga pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2022 të Aparatit të BASHKISË KORÇË dhe Qendrës së Artit dhe Kulturës në pasqyrat financiare të konsoliduara, në lidhje me klasifikimin e gabuar të aktiveve afatgjata materiale nga pakësim në nxjerrje jashtë përdorimit dhe e kundërta.

Deri më 30.06.2024

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, Kryetari i BASHKISË KORÇË për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Aparatit të Bashkisë dhe Njësive Administrative ka nxjerrë Urdhrin nr. 1157, datë 01.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit, Referuar raportit mbi përfundimin e procesit të inventarit, komisioni i inventarizimit ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive që i përkasin inventarit ekonomik në vlerën 3,270,275 lekë dhe inventar i imët në vlerën 330,004 lekë, ku totali shkon në vlerën 3,600,280 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procesin e asgjësimit të aktiveve, u konstatua se, në listë e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme (pajisje elektrike dhe elektronike), për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga z. S.F , Kryetar i Bashkisë dhe z. K.K , Nënkryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi inventarizimin e aktiveve të institucionit të bashkisë dhe njësive në varësi, rezultoi se:

a. Klubi Shumësportësh Skënderbeu, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 1, datë 29.12.2022. Referuar dokumentacionit të vënë në

dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit, nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara, ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit duhet t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

b. Qendra Ditore e Zhvillimit, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 92, datë 31.12.2021. Komisioni i vlerësimit është i njëjtë me komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

c. Drejtori i Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 78/1, datë 27.10.2022. Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 25.11.2022, komisioni i inventarizimit ka hartuar raportin për inventarin fizik, ku ka propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive që i përkasin llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën 46,714 lekë. Me Urdhrin nr. 79/2, datë 28.10.2022, të znj. D.L, Drejtor i QRZH, është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit është i përbërë nga tre anëtarë dhe jo nga pesë anëtarë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pika 85, gërma “c”, pika 96, gërma “c” dhe pika 100.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Klubit Shumësportësh Skënderbeu, Qendrës Ditore të Zhvillimit dhe Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit në çdo rast të kryerjes së inventarizimit të aktiveve, duhet të mbahet në konsideratë:

- Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, të paraqitet para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

- Ngritja e komisioneve të vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: **a.** Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*” dhe pasqyrës nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, pjesë e pasqyrave financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes, u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 11,899,991 lekë që i përkasin llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, në vlerën 2,098,296 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, në vlerën 9,791,595 lekë për të cilat nuk është kryer procedurë asgjësimi, për më tepër nga NSHMAÇ nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre. Duke u bazuar në dokumentacionin mbi realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të NSHMAÇ, nga znj. J.T me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës është mbajtur relacioni mbi vlerësimin për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra sipas inventarit fizik të vitit 2022, sipas shkresës nr. 366 prot., datë 14.11.2022, miratuar nga z. Y.M Drejtor i NSHMAÇ. Me shkresën nr. 366 prot., datë 14.11.2022, NSHMAÇ ka informuar Këshillin Bashkiak për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit. Vetëm dy shkresat e sipërpërmendura janë i vetmi dokumentacion i cili disponon NSHMAÇ në lidhje me procesin e asgjësimit.

b. Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” pjesë e pasqyrave financiare të Qendrës Rezidenciale e Zhvillimit u konstatua se, janë nxjerrë aktive afatgjata materiale jashtë përdorimit në vlerën 46,714 lekë, e cila i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. Kjo situatë nuk pasqyrohet në procesin e inventarizimit të aktiveve të institucionit apo të jetë pjesë e informacionit të dërguar pranë Këshillit Bashkiak pas përfundimit të procesit të inventarizimit, por thjesht ka mbetur në fazën e ngritjes së komisionit të asgjësimit sipas Urdhrit nr. 79/2, datë 28.10.2022, të titullarit të institucionit. Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se, nga QRZH për vlerën 46,714 lekë të nxjerrë jashtë përdorimit, nuk është kryer një procedurë vlerësimi dhe asgjësimi pra nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, data 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Korçë, të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale 11,946,705 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes dhe Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

Deri më 30.06.2024

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 243,257,382 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 288,036,175 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 165,855,343 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 42,398,117 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 79,782,715 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, pika 49 dhe pika 50.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më 31.03.2024

8. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi u konstatua se, në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 57,852,130 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,166,300 lekë (400,000 lekë NjA Drenovë + 529,300 lekë NjA Mollaj + 100,000 lekë NjA Bulgarec + 137,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 4,348,849,060 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 414,379,276 lekë (59,289,103 lekë NjA Drenovë + 111,081,721 lekë NjA Mollaj + 24,298,721 lekë NjA Vithkuq + 12,667,671 lekë NjA Lekas + 30,703,530

lekë NjA Voskopojë + 75,177,420 lekë NjA Voskop + 101,161,565 lekë NjA Bulgarec), e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

c. Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,544,741,034 lekë kosto historike është përfshirë vlera 767,685,964 lekë (128,064,232 lekë NjA Drenovë + 172,096,034 lekë NjA Mollaj + 97,316,422 lekë NjA Vithkuq + 6,235,020 lekë NjA Lekas + 70,267,947 lekë NjA Voskopojë + 83,147,853 lekë NjA Voskop + 210,558,456 lekë NjA Bulgarec) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

d. Në gjendjen e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në vlerën 219,912,236 lekë kosto historike është përfshirë vlera 8,833,400 lekë (2,988,000 lekë NjA Drenovë + 2,565,400 lekë NjA Mollaj + 480,000 lekë NjA Voskopojë + 2,800,000 lekë NjA Voskop) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Këto vlera të pa analizuar, të trashëguara nga bilanci i ish-komunave të mësipërme, ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më 31.03.2024

9. Gjetje nga auditimi: **a.** Nga auditimi mbi administrimin e pronave të BASHKISË KORÇË për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve i janë transferuar kësaj njësie vendore gjithsej **1742 prona**, nga të cilat 1549 prona në pronësi dhe 193 prona në përdorim. Nga pronat në pronësi, nga Bashkia Korçë janë pajisur me certifikatë pronësie gjithsej 246 prona dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie 1158 prona. Ndërsa nga **193 pronat** në përdorim, janë pajisur me certifikatë pronësie 7 prona dhe nuk janë pajisur me certifikatë 186 prona.

b. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të BASHKISË KORÇË dhe Njësie Administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Voskop, Voskopojë dhe Lekas, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, neni 37.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, Bashkia Korçë nga 451 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 181 prej tyre posedojnë titull pronësie.

Nga Bashkia Korçë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” (nuk disponohet asnjë certifikatë pronësie), llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhje edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë të gjitha masat për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të kaluara me VKM në ASHK Dega Korçë.

9.2. Rekomandimi: Drejtoria e FI ncës, Bashkia Korçë, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha aseteve të llogarive 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “*Për aktive afatgjata materiale*” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 56,040,598 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” e cila paraqitet në vlerën 14,319,706 lekë dhe llogarinë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*” në vlerën 72,152,293 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”, Aneksi 1, germa “c”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Investime në proces*” me kundërparti llogaritë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*”, 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “*Fondi Bazë*”.

Deri më 31.03.2024

11. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë, 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” në vlerën 2,350,476 lekë, 435 “*Sigurime shoqërore*” në vlerën 13,991,302 lekë, 436 “*Sigurime shëndetësore*” në vlerën 1,926,994 lekë dhe 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në vlerën 9,813,633 lekë ku totali shkon në vlerën 50,421,514 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, në vlerën 66,171,637 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”, Aneksi nr. 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më 31.03.2024

12. Gjetje nga auditimi: a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 4,770,920 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 22,339,109 lekë dhe pakësime në vlerën 4,770,920 lekë, ndërsa më datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 22,339,109 lekë e cila i përket faturave të pa likuiduara nga Bashkia Korçë. Kjo vlerë kryesisht përbëhet nga shpenzime për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., si rezultat i angazhimeve të marra mbi bazën e burimit të FI ncimit nga të ardhurat e veta të BASHKISË KORÇË por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat deri më datën 01.01.2022, janë në vlerën 33,876,466 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,554,125 lekë dhe pakësim në vlerën 33,616,958 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 9,813,633 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, pikat 82-91, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i BASHKISË KORÇË dhe Drejtorja e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 9,813,633 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të BASHKISË KORÇË në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 9,813,633 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për objektet e përfunduara dhe të marra në dorrëzim nga Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes janë ngurtësuar fonde në vlerën totale 2,039,521 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtorja e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 2,039,521 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së FI ncave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave për cilat u ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit për mungesë dokumentacioni ligjorë, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik. Për garancitë e të cilat janë brenda afatit ligjorë, në momentin e përfundimit të afatit t’i kërkohet

subjekteve zbatuese paraqitja e dokumentacionit ligjorë dhe pas verifikimit të punimeve të bëhet likuidimi i garancive.

Deri më 31.12.2024

14. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 7,653,040,409 lekë. Llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*” në vlerën 1,881,147,211 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 36,718,839 lekë sipas llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*”. Llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 1,540,850,382 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 505,191,521 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” është nënvlerësuar në vlerën 7,524,864,556 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 17.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e FI ncës Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*”, me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2024

15. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Korçë, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjithsej 53 procedura prokurimi me vlerë të madhe (Bashkia Korçë: 8 procedura “*e hapur*”, 21 “*e hapur e thjeshtuar*”; (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike: 5 procedura “*e hapur*”, 8 “*e hapur e thjeshtuar*” dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes: 3 procedura “*e hapur*”, 8 “*e hapur e thjeshtuar*”), nga të cilat pas analizës së riskut dhe duke filluar nga vlera më e madhe e prokuruar u audituan gjithsej 21 procedura, me fond limit 629,482,501 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 507,674,978 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, neni 2 “*Dokumentimi i procesit*” dhe “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

- Në 20 procedura nga 21 të audituara, sipas pasqyrës së mëposhtme, me vlerë totale të fondit limit prej 578,382,286 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 473,293,971 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit, mungesa e personelit të kualifikuar/specialistë të fushës apo caktimi i vetëm një personi për hartimin e fondit limit. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për*

prokurimin publik”, neni 34 “*Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit*” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “*Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës*” dhe neni 74 “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*”, pikat 2 dhe 4, neni 76, “*Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit*”; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 5;

- Në 18 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 570,065,841 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 452,213,618 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës, për vlerën totale të kontraktuar 452,213,618 lekë pa TVSh;

Vendosja e kriterëve të vlerësimit në mënyrë të paargumentuar apo të papërshtatshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, rrjedhimisht në mospërputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, shkel qëllimin dhe parimet kryesore të LPP, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, etj., konkretisht neni 1, “*Objekti*”; neni 2, “*Qëllimi*”; neni 3, “*Parime të përgjithshme*”, pikat 1 dhe 2; neni 21, “*Autoriteti ose enti kontraktor*”; neni 39, “*Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike*”; neni 40, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”; neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”; pika 3; neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87, “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1; dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “*Specifikimet teknike*”, neni 39, “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 5; neni 78, pika 4, “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”; etj.;

- Në 11 procedura nga 21 të audituara, me vlerë totale të fondit limit prej 445,020,075 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 340,885,638 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Korçë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor të marrë masat që:

- Në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me licencat përkatëse, duke përdorur eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike.

- Në procedurat e prokurimit publik, të vendosen kritere në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të mirëargumentuara, në përputhje me procedurën e parashikuar, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së ofertuesve dhe konkurrencën e lirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi miratimin e lejeve të ndërtimit nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Korçë, rezultoi se:

- **Në 4 procedura**, nuk janë respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të tilla si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, lartësia e

ndërtimit, hapësirat e gjelbërta dhe hapësirat e parkimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, për objektet:

1. “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: Lagjja 18, rruga “Dhura Leka”, Korçë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

3. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

4. “*Banesë 3 kate + Podrum*”, miratuar me vendimin nr. 7246/22, datë 05.10.2022, me zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën: Lagjja 1, Rruga e Bilbilave, Korçë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 20, “*Plani i Përgjithshëm Vendor*”, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, nenet 54 dhe 56.

- **Në 3 procedura**, nuk janë paraqitur në mënyrën e saktë planvendosjet, nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve, si edhe distancat nga trupi i rrugës, për objektet:

1. “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjja 18, Rruga “Dhura Leka”, Korçë;

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë;

3. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjja 9, Korçë.

Sa më sipër, është në mospërputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 2; pika 3; pika 7 dhe neni 36, pika 3/a; Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019, neni 58, pika 14.

- **Në 1 (një) procedurë**, leja e zhvillimit për objektin “*Voskopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S.C.” ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë, është miratuar pa miratuar më përpara planin dhe kondicionet urbane mbi të cilën do të zhvillohet njësia strukturore përkatëse dhe pa pasur të ngarkuar në sistemin e-leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit për Bashkinë Korçë, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, etj.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 202-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet urbane, që përfshijnë intensitetin e ndërtimit, koeficientin i shfrytëzimit të territorit, lartësinë e ndërtimit, sipërfaqen e gjelbërimit dhe numrin e parkimeve, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i realizimit të aktmarrëveshjeve ndërmjet subjektit zhvillues dhe bashkisë përpara miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, u konstatuan problematika në **5 procedura**, si më poshtë vijon:

- **Në 2 procedura** të lejeve të ndërtimit të miratuar, në aktmarrëveshjen e realizuar ndërmjet subjektit dhe bashkisë, nuk përcaktohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për objektet:

1. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë.

- **Në 1 procedurë** të lejes së ndërtimit të miratuar, nuk është realizuar aktmarrëveshja ndërmjet BASHKISË KORÇË dhe subjektit zhvillues, për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, për sigurimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, për objektin:

1. “*Banesë kolektive (8 kate + podrum)*”, miratuar me vendimin nr. 2097/22, datë 16.05.2022, me zhvillues shoqërinë “K ” ShPK, në adresën: lagjia 18, rruga “Dhora Leka”, Korçë.

- **Në 2 procedura** të certifikatave të përdorimit të miratuara, nuk është realizuar kalimi i sipërfaqes ndërtimore në favor të bashkisë, por është akumuluar në formë “borxhi” për një afat 5 vjeçar, pas miratimit të certifikatave të përdorimit, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi, për objektet:

1. “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 22/2018, “*Për strehimin social*”, datë 03.05.2018, neni 19, pika 1.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 202-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 114, datë 30.09.2021, sipas pikës 7 dhe të realizohet kalimi pa shpërblim i të paktën 3% të sipërfaqes funksionale për strehimin social, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Gjithashtu në aktmarrëveshjet që janë lidhur ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, të përcaktohen të dhëna të sakta e specifike në lidhje me sipërfaqen që duhet të kalojë në favor të bashkisë për strehimin social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit, u konstatuan **2 procedura**, në të cilat nuk është paraqitur në sistemin e-Leje dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit, për objektet:

1. “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë;

2. “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5,6) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 5526/22 datë 13.07.2022, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi

Kostani”, Lagjia 9, Korçë.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42 dhe VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 202-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për miratimin e “Certifikatave të përdorimit”, u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar për objektin “Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë”, miratuar me vendimin nr. 1236/22, datë 16.03.2022, me zhvillues shoqërinë B ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, **nuk përputhet me zbatimin në terren të objektit.**

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” dhe VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 202-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se gjatë vitit 2022, IMT ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 4 vende vakante. Bashkia Korçë është një bashki me shtrirje të gjerë territoriale, e cila përmbledh edhe 7 njësi administrative, çka do të thotë që 2 inspektorë janë të pamjaftueshëm për të mbuluar një territor me përmasa të tilla, duke rrezikuar në parandalimin e ndërtimeve të paligjshme.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Urdhërin nr. 46, datë 01.02.2022, “Për miratimin e strukturës të administratës së BASHKISË KORÇË për vitin 2022”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 214-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për plotësimin e vendeve vakante të IMTV me inspektorë në plotësim të kriterëve të duhura për çdo pozicion pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT, rezultojë se nuk janë arkëtuar disa gjoba të mbajtura për kundërvajtjet e konstatuara për “dënim me gjobë” në vlerën totale prej **135,000 lekë** për shtetasit: G.J.S , F.I dhe L.F , veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Kreu V, neni 31, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 214-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Korçë, të marrë masa ligjore dhe administrative për të arkëtuar gjobat me vlerë **35,000 lekë** për shtetasin G.J.S , **50,000 lekë** për shtetasin F.I dhe **50,000 lekë** për shtetasin L.F , të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.

Brenda datës 30.06.2024

22. Gjetje nga auditimi: 1. Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 3845/20, datë 28.07.2020 nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi me ambient shërbimi (Nr. 5, 6) - 8 kate me bodrum*”, me zhvillues shoqërinë L ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr. 5526/22 datë 13.07.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren dhe nga verifikimi i fotove ajrore, u konstatuan ndryshime, pasi daljet konsol nuk janë realizuar sipas projektit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit të miratuar, por janë realizuar me një tjetër konfigurim, duke ndryshuar njollën e objektit.

2. Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 8058, datë 08.11.2019, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 6 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë “B ” ShPK, në adresën: Rruga “Midhi Kostani”, Lagjia 9, Korçë, pajisur me çertifikatë përdorimi, për të cilën është marrë vendimi nr. 1236/22, datë 16.03.2022, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet plotësisht me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi është shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin e fundit, duke ndryshuar edhe konfigurimin e fasadës.

3. Nga verifikimi në terren për zbatimin e lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatua se leja e ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi nr. 1372, datë 01.04.2022, nga Kryetari i Bashkisë Korçë, për objektin “*Kompleks turistik D., me godi 3 katëshe + 1 kat nëntokë*”, me zhvillues shoqërinë L dhe O.L , në adresën: Lagjia nr. 3, Rruga “Çlirimi i Korçës”, Korçë, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit në terren nuk përputhet me projektin e ndërtimit të miratuar. Nga verifikimi në terren, u konstatuan ndryshime, pasi objektet në lartësinë e 3 kateve të ndërtimit mbi tokë dhe një kat nën tokë, janë realizuar në 4 kate mbi tokë, duke tejkaluar lartësinë dhe numrin e kateve të lejuar në zonë.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 214-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Korçë, të marrë masa për të realizuar kontrollin e objekteve të cilat janë me leje ndërtimi, nëse e zbatojnë me përpikmëri projektin e ndërtimit të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit në terren të ndërtimeve të kundërligjshme, u konstatua se në fshatin Dishnicë, Korçë, është ndërtuar strukturë kolonash dhe trarësh beton arme, mbi katin e dytë të një objekti ekzistues. Për këtë shkelje është mbajtur procesverbali nr. 25, datë 13.10.2022 për konstatimin e kundërvajtjes dhe vendimi për prishje nr. 7, datë 16.10.2022, i cili nuk është ekzekutuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 214-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Korçë, të marrë masa për të ekzekutuar vendimet e prishjes të marra prej tyre sipas afateve ligjore.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen e inventarit të Bashkisë Korçë, në të cilën përfshihet edhe Sektori i MZSH-së dhe Njësive Shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes, ndodhen në total 84

mjete/makineri dhe pajisje në gjendje pune të llojit: autoveturë, furgon, kamion, fadromë, eskavator, traktor, prerëse asfalti, vinç, fryrëse gjethesh, makinë vijëzimi, borëpastruese, skrep, bobcat, autoskallë, zjarrëfikëse, rul, betoniere, kaldajë, motokorrëse, motosekë, gjenerator, motor pompe etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit.

- Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit, si dhe shpenzimet që do të kryhen për to. Gjithashtu, duhet të jetë i evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim dhe fund të vitit, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

- Gjithashtu, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, u konstatua se, 3 mjete nuk janë të pajisur me çertifikatë pronësie, 13 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik dhe 12 mjete nuk janë të pajisura me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, Ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 217-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Sektori i MZSH-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, të marrë masa për:

- Hartimin e kartelave përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve.

- Pajisjen me çertifikatë pronësie, çertifikatë të kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për mjetet të cilat nuk i disponojnë këto dokumente, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përcaktimin e normativave për konsumin e karburantit, u konstatua se:

a. Nga Bashkia Korçë për mjetet në përdorim nuk disponohet urdhër për ngritjen e grupit të punës mbi përcaktimin e normativave me qëllim kryerjen e një analize mbi caktimin e normativave të konsumit të karburantit për secilin mjet të institucionit, mbi bazën e testimeve duke u mbajtur procesverbalet përkatëse.

b. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për mjetet në përdorim të cilat kanë njësi matëse kilometrazhin, nuk janë evidentuar kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit përgjatë procesit të testimit, me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

c. Nga NSHMAÇ për mjetet në përdorim nuk janë kryer testime në rrugë urbane dhe nacionale apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit), në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km), me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 217-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, në të ardhmen të merren masa që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet

e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve, u konstatua se, nga totali i përgjithshëm vetëm 39 mjete janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik. Referuar këtij dokumentacioni janë konstatuar parregullsi në evidentimin e kilometrave të përshkuara nga këto mjete ndër vite si më poshtë:

- Në 11 raste, nuk evidentohen kilometrat e përshkuara nga mjete, konkretisht: për 8 mjete të NSHP, për 2 mjete të NSHMAÇ dhe për 1 mjet të MZSH-së;

- Në 7 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara nga mjete në vitet e mëparshme, por vetëm në vitin e fundit që është kryer kontrolli teknik, konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 3 mjete të NSHP dhe për 2 mjete të MZSH-së;

- Në 14 raste, nuk janë evidentuar kilometrat e përshkuara nga mjete në mënyrë të rregullt sipas viteve, por pjesërisht, konkretisht: për 2 mjete të Bashkisë Korçë, për 11 mjete të NSHP dhe për 1 mjet të MZSH-së;

- Në 10 raste evidentohet ulja e kilometrave të përshkuara nga mjete në çertifikatën e kontrollit teknik nga viti në vit, konkretisht: për 1 mjet të Bashkisë Korçë, për 6 mjete të NSHP dhe për 3 mjete të MZSH-së.

Mosevidentimi në mënyrë të saktë dhe kronologjike të përvitshme apo ulja e kilometrave nga viti në vit, referuar çertifikatave të kontrollit teknik, bën të paverifikueshëm/pamonitorueshëm procesin e përcaktimit të normativave apo rakordimin e karburantit të konsumuar dhe të dhënave të pasqyruara në fletët e udhëtimit për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, Sektorit të MZSH-së, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë fushe, për verifikimin faktik të kilometrave të përshkuara nga mjetet, duke rakorduar me DSHPTRR Korçë.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në zonën Pyjore e Kullosore, aset i Bashkisë Korçë, sipas lejeve aktive të marra nga regjistri i AKBN-së ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi për gurore 7 subjekte, nga të cilët 5 subjekte janë brenda fondit pyjor/kullosor. Nga ana e BASHKISË KORÇË nuk rezulton që për subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet tregtar për shfrytëzim mineralesh, të jetë lidhur kontratë qeraje për përdorimin e tokës e cila është aset i Bashkisë Korçë. Nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Korçë), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Korçë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), sipas regjistrimit të AKBN, të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjor, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjnë kërkesën për zbritje nga fondi pyjor, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të FI ncave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Korçë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,416,997 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 41,257,208.8 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 3 (tre) zëra punimesh në shumën **383,349 lekë pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Kontratën nr. 8235/3 prot., datë 14.11.2022, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa, për arkëtimin e shumës **383,349 lekë** pa TVSh, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “N ” ShPK & “N ” ShPK, sipas kontratës së lidhur me nr. 8282/3 prot., datë 14.11.2022 për realizimin e punimeve civile.

Brenda datës 30.6.2024

2. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni dhe shtesa e shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Korçë”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “XH ” me nr. 8405/2 prot. datë 13.10.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 75,565,671 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre ndryshuar me Amendim Kontrate datë 17.03.2023, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 3 (tre) zëra punimesh në shumën **217,464 lekë pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Kontratën e shërbimit nr. 8488/2 prot., datë 12.10.2022, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për arkëtimin e shumës **217,464 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat

nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE “XH ” ShPK, sipas kontratës së lidhur me nr. 8405/2 prot. datë 13.10.2022 për realizimin e punimeve civile.

Brenda datës 31.6.2024

3. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “*Shfrytëzimi inteligjent i energjisë (Projekti i efencës të energjisë)*”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe dhe BOE “I ” ShPK & “E ” ShPK & “I ” ShPK, me nr. 1797/2 prot., datë 27.03.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 63,428,254.2 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me Amendim Kontrate datë 18.09.2023, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 4 (katër) zëra punimesh në shumën **566,377 lekë** pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, Kontratën e shërbimit nr. 716/2 prot., datë 27.03.2023, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për arkëtimin e shumës **566,377 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e pakryera nuk kryhen, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I ” ShPK & “E ” ShPK & “I ” ShPK sipas kontratës së lidhur me nr.1797/2 Prot. datë 27.03.2023 për realizimin e punimeve civile.

Brenda datës 31.6.2024

4. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “*Investime në infrastrukturën rrugore, (Marrëveshje Kuadër – Faza I)*”, sipas kontratës të lidhur midis BASHKISË KORÇË dhe OE “A ” ShPK, me nr. 2520/3 prot. datë 05.04.2023 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 46,629,580.66 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga data e fillimit të tyre, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të BASHKISË KORÇË rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 4 (katër) zëra punimesh në shumën **249,807 lekë** pa TVSh e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, Kontratën nr. 2689/2 prot., datë 05.04.2023, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtorinë e Përgjithshme e FI ncës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për arkëtimin e shumës **249,807 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e pakryera nuk realizohen, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OE “A ” ShPK, sipas kontratës së lidhur me nr. 2520/3 prot., datë 05.04.2023 për realizimin e punimeve civile.

Brenda datës 31.6.2024

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë u konstatua se, pjesë e zërave të projekteve artistike është edhe zëri honorare të cilat **nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit** (nuk janë prokuruar së bashku me zërat e tjerë të projekteve artistike), parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën””, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 6, datë 27.01.2022, të Këshillit Bashkiak “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147, datë 22.12.2022, “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë””. Nga Bashkia Korçë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total për Qendrën e Kulturës “Vangjush Mio”, Teatrin “Andon Zako Çajupi” dhe Bibliotekën “Thimi Mitko” pjesë të Qendrës së Artit dhe Kulturës është likuiduar shuma **19,150,000 lekë**, e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik, duke i përjashtuar këto procedura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme e Financës Buxhetit dhe Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit, u konstatua se:

a. Për 23 mjete të Bashkisë Korçë, duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së, janë tërhequr në total karburant, naftë 28,813 litra dhe benzinë 3,674 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 11 automjete, për muajt shkurt, mars, qershor, korrik, nëntor dhe dhjetor të vitit 2022, ku është konsumuar sasia e karburantit naftë 16,201 litra, në vlerën 3,590,435 lekë dhe benzinë 1,655 litra, në vlerën 299,078 lekë.

b. Për 52 mjete/makineri dhe pajisje të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, janë tërhequr karburant naftë 168,041 litra dhe benzinë 19,696 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 41 autovetura dhe mjete pune të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, për muajt prill, qershor, tetor dhe dhjetor të vitit 2022 ku është konsumuar sasia e karburantit naftë 53,711.32 litra, në vlerën 12,291,402 lekë dhe benzinë 3,855 litra, në vlerën 840,808 lekë.

c. Për **2 mjete** të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes janë tërhequr në total karburant naftë 3,000 litra. Me zgjedhje janë audituar shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 2 automjete, ku është konsumuar sasia e karburantit naftë 3,000 litra, në vlerën 501,120 lekë.

Për sa trajtuar më sipër, në total nga Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes, është konsumuar naftë 88,908 litra, në vlerën 19,611,130 lekë dhe benzinë 5,510 litra, në vlerën 1,139,886 lekë, vlerë e cila për Buxhetin e Bashkisë Korçë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, pasi në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim të lëvizjes dhe në përfundim, por është përmbledhësja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Nuk disponohet dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune dhe urdhër shërbimi. Në

disa raste, nga mjete të Bashkisë Korçë, duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së, në fletët e udhëtimit evidentohet pasqyrim i lëvizjes së mjeteve brenda territorit të qytetit të Korçë pa destinacion por vetëm me emërtimin “Korçë-Korçë” apo “Korçë qytet”, të cilat variojnë nga 60 deri në 120 km në ditë apo lëvizje drejt qytetit të Tiranës (vajtje ardhje) të cilat variojnë nga 400 km deri në 420 km ndërkohë që referuar të dhënave në internet, distanca është 330 km. Për mjetet/makineritë dhe pajisjet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike që njësi matëse kanë volumet dhe orët e punës, në fletët e udhëtimit nuk ndodhet i përcaktuar vendi i punës (sipas rrugëve apo kanaleve etj., për çdo ditë pune), objekti i punës, orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësia/distanca e rrugëve apo kanaleve në të cilët është kryer punimi apo pastrimi, faturat shoqëruese të mallrave në rastin e shtrimit apo sistemimit të çakullit dhe fotot e punimeve të realizuara, por është vetëm përmbledhësja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave së bashku me vendin e punës, (emërtimin sipas njësive administrative) për secilin mjet.

d. Nga auditimi i shpenzimeve të konsumit të karburantit, u konstatua se Bashkia Korçë, përfaqësuar nga z. TH.T, ish-Drejtor i NSHP dhe z. I.D, Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, janë nënshkruar katër kontrata hua-përdorimi me personat fizikë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë, nuk dokumentohet në mënyrë shkresore apo elektronike nëpërmjet emailëve, komunikimi ndërmjet palëve për vendosjen e mjeteve në dispozicion të bashkisë përpara fazës së nënshkrimit të kontratave të hua-përdorimit. Gjithashtu nuk ka një vendimarrje nga Këshilli Bashkiak për marrjen e këtyre mjeteve me kontratë-huapërdorimi. Në total, për vitin 2022, janë përdorur katër mjete me kontratë hua-përdorimi në raste emergjencash. Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, për katër mjete është konsumuar saisa e karburantit naftë 15,996 litra, në vlerën 3,228,173 lekë, për të cilat paraqiten fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit por nuk ka një kërkesë, program pune për lëvizjen e tyre drejt fshatrave apo qytetit të Korçës për rastet e emergjencave (bllokim bore pastrim në raste rëshkitje dherash etj.). Në fletët e udhëtimit ndodhet i përcaktuar vendi i punës, por nuk përcaktohet orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësia/distanca e rrugëve apo kanaleve në të cilën është kryer punimi apo pastrimi, por është vetëm përmbledhësja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave së bashku me vendin e punës (emërtimin sipas njësive administrative) për secilin mjet.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të Bashkisë Korçë, Sektori i MZSH-së, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes të analizohet vlera **20,751,016 lekë**, e cila ka të bëjë me mosevidentimin e të gjithë procesit mbi konsumin e karburantit, duke hartuar rregulla, në të cilët të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit të shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet dhe pajisjet e institucionit, si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me blerje të vogël, me objekt “Blerje prozhektor dhe neone për palestrat e shkollave” rezultoi se:

- Procedura e prokurimit është prokuruar nga AK Bashkia Korçë për llogari të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, ku kjo e fundit ka planifikuar dhe realizuar prokurimin me objekt “Blerje materiale elektrike”, ku përfshiheshin edhe mallrat objekt prokurimi të tenderuar nga Bashkia Korçë. Sa më sipër, janë realizuar dy procedura prokurimi me objekt të njëjtë, me fond limit total në shumën 1,386,000 lekë pa TVSh, duke e copëzuar në dy procedura prokurimi me blerje të vogël respektivisht në vlerën 586,000 lekë dhe 800,000

lekë pa TVSh, veprim në kundërshtim me VKM-në 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 2 dhe 11.

- Kërkesa për këto mallra nuk ka ardhur nga AK përfitues, por është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore jashtë objektit të veprimtarisë së saj.

- Specifikimet teknike nuk janë hartuar nga një komision ku në përbërje të kishte specialist të fushës.

- Përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë mbi bazën e ofertave të pretenduara nga komisioni i blerjeve të vogla, pasi ato nuk janë pjesë e dosjes, gjithashtu njëri prej OE është me statusin i pezulluar në periudhën kur pretendohet se janë marrë ofertat.

- U konstatuan diferenca të mëdha të çmimeve për artikujt e njëjtë të tenderuar nga AK Bashkia Korçë dhe AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve.

- Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë identifikuar mallrat e dorëzuara nga kontraktuesi sipas karakteristikave dhe numrit serial (E), gjë e cila nuk vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK, duke vepruar në mospërputhje me rekomandimin e APP nr. 2106 prot. datë 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkojë nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo procesverbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK.

Për sa më lart, vlera e kontratës prej **616,800 lekë** me TVSh, do të konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Këto veprime janë në mospërputhje me kriteret e miratuara nga AK në ftesën për ofertë dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 47.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i BASHKISË KORÇË të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e komisioneve të marrjes në dorëzim dhe të blerjeve të vogla, si dhe të hartuesve të kërkesës për këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën të prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të BASHKISË KORÇË në shumën **616,800 lekë** dhe mos përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël “Kompjuter, printer, fotokopje” rezultoi se:

- Modeli i kompjuterit dhe monitorit të dorëzuar nga kontraktuesi janë prodhime të vitit 2015.

- Monitori Samsung model S22E450BW është 22 inch dhe jo 23 inch siç parashikohet në ftesën e AK.

- Kompjuteri Fujitsu “Esprimo P910 E85+” është i gjeneratës së 3-të dhe jo të 4-të, siç kërkohet nga AK në ftesën për ofertë.

- Kompjuteri, monitori, tastiera dhe mouse nuk janë i të njëjtit brand.

- Komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar pajisjet me numrat serialë, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre pajisjeve.

- Anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk kanë identifikuar mallrat e dorëzuara nga kontraktuesi sipas karakteristikave dhe numrit serial (E), gjë e cila nuk vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK,

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël “Bojëra printimi fotokopje” rezultoi se:

Kontraktuesi i ka dorëzuar me 4 ditë vonesë mallrat, sipas afateve të përcaktuar në ftesën për ofertë, duke përfshirë dhe afatin e ankimimit.

Nga verifikimi në faqen e internetit <https://aqscert.org/>, rezultoi se OE “B” nuk është i pajisur me certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO/IEC 27001:2013.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk i ka identifikuar mallrat me numrat *part number*, gjithashtu në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar emri i markës së këtyre mallrave. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 47, etj.

Për sa më lart, vlera e kontratës prej **771,228 lekë** me TVSh, do të konsiderohet shpenzim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet për buxhetin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, Bashkia Korçë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kyetari i BASHKISË KORÇË të analizojë këto procedura dhe të marrë masa për titullarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, i cili në cilësinë e titullarit të AK dhe në cilësinë e miratuesit të këtyre procedurave, ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve në shumën **771,228 lekë**.

4.2. Rekomandimi: Titullari i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, të kërkojë nga OE Andis K, zëvendësimin e monitorëve të dorëzuar me monitorë LCD 23 inch, të të njëjtës markë me atë të njësisë së kompjuterëve, pasi është kusht që kompjuterat (pc+monitor) të jenë brand, në rast të kundërt vlera e monitorëve të dorëzuar nga kontraktuesi dhe të marrë në dorëzim nga AK, do të konsiderohet dëm ekonomik në ngarkim të titullarit të institucionit dhe anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Investime në infrastrukturën rrugore*”, rezultoi se OE “K”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë, duke i shkaktuar BASHKISË KORÇË përdorim të fondeve pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **4,824,193 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur.

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme e përgjithshme “Themistokli Gërmenji”*”, rezultoi se OE “N”, është skualifikuar në mënyrë të padrejtë, duke i shkaktuar BASHKISË KORÇË përdorim të fondeve pa Eficencë, Efektivitet dhe Ekonomicitet në vlerën **2,063,302 lekë** pa TVSh, si diferencë e ofertës së shpallur fituese me ofertën më të ulët të paraqitur.

Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i BASHKISË KORÇË ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese, sipas rastit), të analizojë arsyet e skualifikimit/kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e këtyre praktikave të parregullta, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të konsumit të karburantit, u konstatua se Bashkia Korçë, përfaqësuar nga z. S.F , Kryetar i Bashkisë, ka nënshkruar pesë kontrata hua-përdorimi me personat fizikë për vitin 2022. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nga Bashkia Korçë nuk dokumentohet në mënyrë shkresore apo elektronike nëpërmjet emaile-ve, komunikimi ndërmjet palëve për vendosjen e automjeteve në dispozicion të bashkisë, përpara fazës së nënshkrimit të kontratave të hua-përdorimit. Gjithashtu nuk ka një vendimarrje nga Këshilli Bashkiak për marrjen e këtyre mjeteve me kontratë-huapërdorimi.

Në total, për vitin 2022 kanë qenë aktive pesë kontrata hua-përdorimi, për të cilat automjetet janë përdorur nga Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop dhe Vithkuq. Sasia e karburantit e tërhequr sipas kontratave të hua-përdorimit të sipërpërmendura, i përket administratorëve të NjA, konkretisht: z. M.M (NjA Drenovë), 1,100 litra naftë, në vlerën 247,256 lekë, z. L.SH (NjA Mollaj), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. K.Z (NjA Voskopojë), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë, z. E.D (NjA Voskop), 1,100 litra naftë, në vlerën 246,560 lekë dhe z. I.P (NjA Vithkuq), 1,320 litra naftë, në vlerën 295,872 lekë.

Si dokumentacion justifikues, nga administratorët e NjA të cilët kanë përfituar karburant, paraqiten fletët e udhëtimit për lëvizjen e mjetit, por nuk ka një kërkesë, program pune për lëvizjen e tyre drejt fshatrave apo qytetit të Korçës. Theksojmë që punonjësit të cilët kanë tërhequr këtë sasi karburanti, ushtrojnë funksionin e administratorëve të NjA dhe detyra funksionale e këtyre punonjësve është në zyrë dhe jo në terren.

Trajtimi financiar i punonjësve të cilët dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, bëhet mbi bazën e VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet mënyra e rimbursimit të shpenzimeve të transportit sipas dokumentacionit tatimor (biletës së udhëtimit), sipas tarifave përkatëse dhe distancës kilometrike të linjave, të miratuara me Vendimin nr. 146, datë 26.02.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar. Në total, për vitin 2022, për 5 punonjës, është tërhequr karburant, naftë 5,720 litra, e cila konsiderohet përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë (3-E), i fondeve për sasinë e karburantit të konsumuar **në vlerën 1,282,808 lekë.**

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 977, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 217-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të FI ncës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në rastet e mungesës së mjeteve për kryerjen e shërbimeve të ndryshme të Bashkisë Korçë, të parashikojë fonde dhe të miratojë në Këshillin Bashkiak marrjen me qira të mjeteve të domosdoshme sipas drejtorive, me argumentet e duhura dhe të eliminojë marrjen e mjeteve me qira nga punonjësit e bashkisë të cilët kanë në përdorim mjete, për të eliminuar përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë (3-E), të fondeve për sasinë e karburantit të konsumuar në vlerën **1,282,808 lekë.**

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hapësirave publike (tavoli t) sipas paketës fiskale të miratuar për vitin 2022 rezulton se për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavoli jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, për muajt maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tarifa është 19 lekë/m² në ditë, për muajt mars, prill, tetor, nëntor tarifa është 10 lekë/m² në ditë. Nga auditimi rezultoi se llogaritja nga ana e BASHKISË

KORÇË nuk është kryer sipas ditëve por është përlllogaritur për çdo muaj me 30 ditë, në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 137 datë 25.11.2021 pika 7/5, faqe 24, për hapësirën publike e cila e përcakton qartë se tarifa është 10/19 lekë/ditë për m², duke sjellë të ardhura të munguara në shumën **226,963 lekë** në buxhetin e Bashkisë Korçë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të kryejë faturimet sipas ditëve të muajve, referuar tarifave të përcaktuara në paketën fiskale, si dhe të kërkojë në rrugë administrative vlerën e pataksuar prej **226,963 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Korçë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur **125 kontrata/marrëveshje** për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qera pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **11 subjekte** debitore në vlerën **57,917,505 lekë** në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Korçë, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për:

- Ndjekjen e të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **57,917,505 lekë** nga 11 qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.

- Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Vlera totale e detyrimit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Korçë paraqitet:

Vlera e detyrimeve tatimore të paarkëtuara nga debitorët e krijuar gjatë vitit 2022, është **110,094 mijë lekë**. Kjo vlerë është e kontabilizuar dhe përbëhet nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, në vlerën totale 40,715 mijë lekë;

- Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 69,379 mijë lekë.

Për vitin 2022 gjendja progresive e debitorëve në Bashkinë Korçë është:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, në vlerën 203,003 mijë lekë;

- Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 234,521 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresivë për bizneset dhe familjarët është **437,524 mijë lekë, vlerë kjo që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë**.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga ana e DTTV nuk duhen të ndalen por duhet të zbatojnë përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Korçë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **110,094 mijë lekë**, sipas

përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet, është i paqartë planifikimi i të ardhurave të kësaj takse nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, duke mos u bazuar në parashikime realiste të të ardhurave faktike të viteve të mëparshme. Vlera e planifikuar (prej 60,425,066 lekë) nuk është e mbështetur në asnjë fakt, për më tepër, në vitin 2021 kjo taksë është planifikuar 36,873,515 lekë dhe janë arkëtuar 5,125,663 lekë, ndërkohë që në vitin 2022, kjo taksë është planifikuar në vlerën 60,425,066 lekë dhe realizimi është 16,782,885 lekë, pavarësisht se borxhi progresiv nga viti 2018 deri në dhjetor të vitit 2021 ka qenë në vlerën 19,925,978 lekë.

Gjithashtu lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë u konstatua se, nga legalizimet e bëra ndër vite, deri në 31.12.2022, 381 qytetarë në vlerën 19,925,978 lekë nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë. Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 337 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 13,692,213 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 195 qytetarë/individë me vlerë 8,268,310 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 142 qytetarë me vlerë totale 5,423,903 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Për vitin 2022, nuk e kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë ndaj BASHKISË KORÇË 142 qytetarë/individë që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara qytetarë, për vlerën totale 5,423,903 lekë dhe 381 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2022, me vlerë totale të detyrimeve 19,925,978 lekë. Në total, vlera e detyrimeve nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi 25,349,881 lekë për 523 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Korçë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, VKB-në nr. 137, datë 25.11.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Korçës”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Korçë, të marrë masa për:

- Planifikimin e të ardhurave bazuar në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme sipas legjislacionit në fuqi.
- Të bashkëpunojë me DTTV Bashkia Korçë për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **523 debitorë në vlerën 25,349,881 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se 25 subjekte janë pajisur me leje ndërtimi edhe pse kanë qenë debitorë ndaj BASHKISË KORÇË në vlerën 2,127,093 lekë, në kundërshtim me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2022, kapitulli VII.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të miratojnë lejet e ndërtimit pasi të sigurohen që subjektet i kanë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura në Bashkinë Korçë, si dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **2,127,093 lekë ndaj 25 subjekteve** të pajisur me leje ndërtimi, sipas Aneksit A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar diferenca në përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 6 objektet të pajisura me leje ndërtimi me sipërfaqe >250 m², në shumën totale prej **13,847,443 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Korçë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 40-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe specialistin e buxhetit Bashkia Korçë të marrin masa që të arkëtojnë diferencat e shkaktuara nga përlllogaritjet e gabuara për taksën e ndikimit në infrastrukturë për **6 leje ndërtimi në shumën 13,847,443 lekë**, përkatësisht si më poshtë:

- **vlera 11,914,178 lekë** me pronar dhe zhvillues **L L dhe O.L** për **5** leje ndërtimi.

- **vlera 1,933,265 lekë** me zhvillues dhe pronar trualli **BASHKISË KORÇË**.

Brenda datës 30.6.2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan **2 procedura** në të cilat taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur në përputhje me PPV-në dhe legjislacionin në fuqi. Nga verifikimi i sipërfaqeve të projektit të ndërtimit dhe mënyrës së përlllogaritjes së taksës, duke marrë për bazë çmimin e shitjes për metër katror dhe me koeficientët përkatës sipas ambienteve (hapësirë parkimi, hapësirë shërbimi ose hapësirë banimi), rezultuan diferenca për objektet: 1. “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 9998/22, datë 14.12.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën rruga Rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë, me një diferencë në vlerën 141,980 lekë; 2. “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*”, miratuar me vendimin nr. 2468/22, datë 24.05.2022, me zhvillues shoqërinë “L ” ShPK, në adresën rruga Rruga “Midhi Kostani” dhe “1 Maji”, Lagjia 9, Korçë, me një diferencë në vlerën 137,949 lekë; 3. “*Voscopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S.C.”ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë, ku zhvillohen objekte të cilët mund të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në lejen e ndërtimit nga “*Objekte për qëllim turizmi*” në “*Objekte për qëllim banimi*”. Nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar në lejen e ndërtimit, duhet të përlllogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës në vlerën 1,525,253 lekë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, dhe Vendimin nr. 137, datë 25.11.2021, i Këshillit Bashkiak Korçë, “*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 202-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Korçë, të bëhet kontabilizimi dhe të merren të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **141,980 lekë** për objektin “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 10 - 11 - 12) - 8 kate me bodrum*” nga shoqëria zhvilluese “L ” ShPK dhe vlerës **137,949 lekë** për objektin “*Godinë banimi me ambjent shërbimi (Nr. 8-9) - 8 kate me bodrum*” nga shoqëria zhvilluese “L ” ShPK, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

7.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë të merren masa për të monitoruar destinacionin e përdorimit të objektit “*Voscopole Resort - Kompleks Turistik 3 Kate + 1 Kat Nëntokë (Zona 2)*”, miratuar me vendimin nr. 8590/22, datë 09.12.2022, me zhvillues shoqërinë “S. C.” ShPK, në adresën: Fshati Voskopojë, Korçë dhe, nëse ndryshon destinacioni i objekteve të zhvilluar

në lejen e ndërtimit, të përlogaritët taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të likuidohet diferenca e taksës për vlerën **1,525,253 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

a. “Lirim nga shërbimi civil”, për 1 punonjës, si më poshtë:

1. Znj. ZH.L, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për:

- Planifikimin e të ardhurave të TNI, duke mos u bazuar në parashikime realiste të të ardhurave faktike të viteve të mëparshme, sipas legjislacionit në fuqi;
- Përlogaritje të TNI jo në përputhje me paketën fiskale, për rrjedhojë duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 13,847 mijë lekë;
- Dhënien e lejeve të ndërtimit për subjektet, pa u pajisur me vërtetime për pagesat e detyrimeve të prapambetura.
- Parregullsitë e konstatuara në 7 raste, në lejen e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit, të miratuar me vendimin KKT-së nr. 9, datë 25.01.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 17.05.2019; VKM nr. 60, datë 29.01.2020, “Për deklarimin pasuri kulturore “ansambël historik urban”, zonës mbrojtëse të tij dhe zonës arkeologjike “b”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar;

b. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”, për 7 punonjës, si më poshtë:

1. Z. J.M, në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, dhe

2. Z. M.B, në cilësinë e Inspektor në Sektorin e Inspektimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, pasi nuk rezulton që për 5 subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetet tregtar për shfrytëzim mineralesh, të jetë lidhur kontratë qeraje për përdorimin e tokës e cila është aset i Bashkisë Korçë;

3. Z. I.L, në cilësinë e Kryeinspektor Inspektoriatit të Monitorimit të Territorit për:

- Moskonstatim të objekteve të dala nga leja e zhvillimit;
- Parregullsitë e konstatuara në **4 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara.

4. Z. E.K, në cilësinë e Inspektor Inspektoriatit të Monitorimit të Territorit;

- Moskonstatim të objekteve të dala nga leja e zhvillimit;
- Parregullsitë e konstatuara në **4 raste** në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara.

5. Z. E.GJ , në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit për Zhvillimin e Tokës dhe ish Përgjegjës Sektori i Planifikimit në DPKZHT, për:

- Dhënien e lejeve të ndërtimit për subjektet, pa u pajisur me vërtetime për pagesat e detyrimeve të prapambetura.

- Parregullsitë e konstatuara në **7 raste**, në lejet e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar.

6. Znj. A.Q , me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, nga viti 2016, për parregullsitë e konstatuara në **5 raste**, në marrëveshjet e realizuara ndërmjet bashkisë dhe subjektit zhvillues, për lejet e ndërtimit dhe në certifikatat e përdorimit të miratuar.

7. Z. O.P , me detyrë specialisti i fllncës, për parregullsitë e konstatuara në **7 raste**, në mënyrën e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për lejet e ndërtimit.

c. “Vërejtje” për 1 (një) punonjës:

1. Znj. V.Z , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, UMFE nr. 7, datë 26.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”; UMFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. UMF nr. 2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

E.2. Për punonjësit e mëposhtëm, të cilët kanë qenë anëtarë të Njesisë së Prokurimit ose Komisionit për Vlerësimin e Ofertave vetëm në një procedurë secili, si dhe për problematikat e konstatuara nga auditimi i shpenzimeve të karburantit, Kryetari i Bashkisë Korçë, Drejtori i Ndërmarrjes Publike dhe Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, sipas rastit dhe përkatësisë institucionale, të bëjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur më poshtë dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

- Anëtarë të njësive të prokurimit vetëm në nga një procedurë:

1. Z. N.M ;
2. Z. E.GJ ;
3. Z. J.Z ;
4. Znj. M.G .

- Anëtarë të komisioneve për vlerësimin e ofertave vetëm në nga një procedurë:

1. Z. K.J ;
2. Z. J.Q ;
3. Z. S.SH ;
4. Znj. GJ.P ;
5. Znj. I M ;
6. Znj. M.L ;
7. Z. A.N ;
8. Z. E.SH ;
9. Z. M.H ;
10. Z. O.L .

11. Znj. A.Q , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në cilësinë e drejtuesit të drejtorisë që ndjek shpenzimet mbi konsumin e karburantit.

12. Z. N.M , me detyrë Specialist Logjistike, si dhe drejtuesit e mjeteve.

- Për mos dokumentim e plotë të shpenzimeve të konsumit të karburantit të BASHKISË KORÇË dhe Sektorit të MZSH-së:

13. Z. I.D , Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

14. Znj. K.G , Përgjegjës i Sektorit të FI ncës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

15. Z. E.SH , me detyrë Specialist i Lartë i Transportit, si dhe të gjithë drejtuesit e mjeteve.

- Për mos dokumentim e plotë të shpenzimeve të konsumit të karburantit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike:

16. Z. I.D , Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, në cilësinë e nëpunësit autorizues

17. Znj. K.G , Përgjegjës i Sektorit të FI ncës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

18. Z. E.SH , me detyrë Specialist i Lartë i Transportit, si dhe drejtuesit e mjeteve

- Për mos dokumentim e plotë të shpenzimeve të konsumit të karburantit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike kontratat e hua-përdorimit në raste emergjencash.

19. Znj. J.T , Përgjegjës i Sektorit të FI ncës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

20. Znj. R.P (për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 01.01.2022).

21. Znj. S.Z (për periudhën nga data 02.11.2022, deri më 31.12.2022), Përgjegjës i Sektorit Ekonomik në cilësinë e personave që ndjekin shpenzimet mbi konsumimin e karburantit.

- Për mos dokumentim e plotë të shpenzimeve të konsumit të karburantit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes:

22. Z. T.I , me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Drenovë.

23. Z. A.H , me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Mollaj.

24. Z. K.Z , me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Voskopojë

25. Z. E.D , Administrator i Njesisë Administrative Voskop

26. Z. I.P , me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Vithkuq, në cilësinë e personave që kanë përfituar karburant nga kontratat e hua-përdorimit.

- Për përfitimin e karburantit në kundërshtim me ligjin në lidhje me kontratat e hua-përdorimit për mjetet e administratorëve të Njësive Administrative.

E.3. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, i rekomandojmë, Kryetarit të BASHKISË KORÇË të marrë masat për vendosjen e masave disiplinore si më poshtë, pas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

a. Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, për 1 (një) punonjës:

1. Z. Y.M , me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin dhe Çerdhet, pasi:

Në cilësinë e Titullarit të AK dhe miratuesit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Ushqime” për vitin 2022, rezultoi se:

1. Procedura e prokurimit është bërë në mungesë të kërkesës nga institucionet përfituese të nevojave për këto artikuj ushqimorë, në përputhje me menutë e miratuara dhe kuotat e miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, për çerdhet, kopshtet dhe konviktin e nxënësve, të cilat janë nën juridiksionin e ofrimit të këtij shërbimi, nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, Bashkia Korçë.

2. Dokumentacioni integral i kësaj procedure prokurimi ka mospërputhje me objektin e prokurimit dhe gjithashtu ka mospërputhje të referencës ligjore në fushën e prokurimeve

publike, pasi Procesverbali mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim ka datën 09.04.2022, periudhë që përkon para daljes së urdhërit të prokurimit dhe i përket AK Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

3. Në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, rezulton se AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve për përlllogaritjen e fondit limit ka marrë për referencë çmimet për njësi të 49 artikujve ushqimorë nga Zyra Rajonale e Statistikës Korçë, me shkresën hyrëse nr. 167 prot. datë 09.09.2022, e cila nuk ka numër protokollit të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, pasi nuk disponohet shkresa nr. 275 prot., datë 06.09.2022, ku sipas zyrës Rajonale të Statistikës Korçë është dhënë përgjigje me shkresën nr. 167 prot., datë 09.09.2022, mbi bazën e shkresës nr. 275 prot., datë 06.09.2022.

Procesverbali i komisionit të përlllogaritjes së Fondit Limit nuk është pjesë e dosjes.

Referuar pikës II të Urdhërit nr. 27, datë 18.08.2022 të Titullarit të Institucionit, Procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike duhej të hartohej brenda datës 09.09.2022.

Referuar Urdhërit të Prokurimit nr. 26 prot., datë 18.08.2022, për procedurën e prokurimit të hapur është përcaktuar Fondi limit në shumën **27,326,475 lekë pa TVSh**.

Referuar nenit 15, pika 3, gema b, nga AK nuk është hartuar grafiku i lëvrimin të detajuar sipas kërkesave të AK dhe nenin 40, pika 1 e Rregullave të Prokurimit Publik nr. 285 datë 19.05.2021.

4. Procedura është e parregullt, pasi AK nuk ka përlllogaritur fondin limit mbi bazën e kërkesave të institucioneve përfituese të artikujve ushqimorë, nuk janë analizuar këta artikuj sipas menuve dhe kuotave ushqimore të miratuara, është e paqartë sesi Instituti i Statistikave Filiali Korçë ka dhënë çmimet për artikujt objekt prokurimi, e gjithë praktika nuk ka kaluar nëpërmjet protokollit të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, gjithashtu KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE pjesëmarrës të vetëm, i cili nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara nga titullari i AK. Në këto kushte KVO duhej ta skualifikonte OE pjesëmarrës dhe Titullari i AK duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte një procedurë të re, për të mundësuar rritjen e numrit të pjesëmarrësve për të shmangur përdorimin pa efikasitet të fondeve publike në vlerën 32,785,680 lekë.

- Për mos dokumentim e plotë të shpenzimeve të konsumit të karburantit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

